FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 137

Tiranë – E martë, 30 qershor 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 57/2026, datë 18.6.2026	Për dhënie amnistie	12461
Dekret i Presidentit nr. 375, datë 30.6.2026	Për shpallje ligji	12465
Ligj nr. 59/2026, datë 18.6.2026	Për sektorin e energjisë elektrike	12465
Dekret i Presidentit nr. 376, datë 30.6.2026	Për shpallje ligji	12558
Ligj nr. 60/2026, datë 18.6.2026	Për informacionin elektronik të transportit të mallrave	12559
Dekret i Presidentit nr. 377, datë 30.6.2026	Për shpallje ligji	12568
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave nr. 2, datë 9.6.2026	Për një shtesë dhe disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 19.7.2022, "Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike	12568

LIGJ
Nr. 57/2026

PËR DHËNIE AMNISTIE

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 e 2, shkronja "ë", dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1
Qëllimi dhe parimet e ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është përjashtimi nga vuajtja e dënimit dhe ndjekja penale, tërësisht ose pjesërisht, i të gjithë personave që plotësojnë kriteret sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Dhënia e amnistisë sipas këtij ligji udhëhiqet, nga:

a) parimi i humanizmit;

b) arritja e qëllimit të dënimit;

c) rrezikshmëria e ulët e personave që amnistohen;

ç) edukimi dhe rehabilitimi;

d) mbrojtja e interesit publik;

dh) dhënia e mundësisë së integrimit më të lehtë dhe më të shpejtë të të dënuarve të mitur dhe gra;

e) rritja e eficiencës në sistemin e drejtësisë;

ë) mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "I dënuar" konsiderohet:

a) personi i dënuar nga gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe që brenda afatit ligjor nuk është bërë ankim ose ankimi nuk është pranuar në gjykatat përkatëse të apelit, duke marrë formë të prerë brenda datës 31.5.2026, pavarësisht nga data e zbardhjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të gjykatës;

b) personi i dënuar deri në datën 31.5.2026, pavarësisht nga data e zbardhjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të gjykatës nga gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe Gjykata e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

c) personi i dënuar deri në datën 31.5.2026, kur Gjykata e Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, si dhe personi i dënuar nga Gjykata e Lartë kur kjo gjykatë ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë deri në datën 31.5.2026, pavarësisht nga data e zbardhjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë të gjykatës

2. "Person që i është shmangur drejtësisë" është personi i fshehur, i arratisur ose i ikur, i cili, megjithëse ka dijeni, i shmanget me vullnet procedimit penal, zbatimit të masave të sigurimit ose ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë të dënimit.

Neni 3
Kriteret për përfitimin e amnistisë nga vuajtja e dënimit

1. Përjashtohen nga vuajtja e dënimit:

a) personat burra, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 3 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31.5.2026, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi;

b) personat gra, dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim deri në 4 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, duke përfshirë gjobën ose një nga llojet e alternativave të dënimit me burgim, për dënime të dhëna deri në datën 31.5.2026, pavarësisht nga koha e mbetur nga dënimi;

c) personat burra, dënuar me burgim, të cilëve deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 3 vjet;

ç) personat gra, dënuar me burgim, të cilave deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji u ka mbetur pa vuajtur nga ky dënim deri në 4 vjet;

d) personat e dënuar burra, të cilët në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë baras ose mbi moshën 60 vjeç;

dh) personat e dënuar gra, të cilat në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji janë baras ose mbi moshën 50 vjeç;

e) personat e dënuar me burgim, të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë baras ose nën moshën 18 vjeç.

2. Nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit personat të cilët i janë shmangur drejtësisë, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 2 të këtij ligji.

Neni 4

Kriteri ndalues për përfitimin e amnistisë

1. Pavarësisht nga parashikimet e shkronjave "a", "c" dhe "d", të pikës 1, të nenit 3 të këtij ligji, nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit personat e dënuar për:

a) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a dhe 75 të Kodit Penal;

b) krime kundër jetës të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 80, 81, 82, 83, 83/a, 83/b dhe 84/a të Kodit Penal, si dhe në nenin 77 të Kodit Penal Ushtarak;

c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, 88, 89/a, 93, 96 dhe 99 të Kodit Penal;

ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 107/a, 108 dhe 108/a të Kodit Penal;

d) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenet 109, 109/a, 109/b, 109/c, në paragrafin e dytë, të nenit 110, në nenet 110/a, 110/b, 110/c dhe 111 të Kodit Penal;

dh) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuara në nenin 114, në paragrafët e dytë dhe të tretë, të nenit 117, në nenet 119, 120, 121 dhe 121/a të Kodit Penal;

e) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafin e dytë, të nenit 124, në nenin 124/a, në paragrafët e dytë e të tretë, të nenit 124/b, në nenet 128/a, 128/b, 129 dhe 130/a të Kodit Penal;

ë) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në paragrafin e tretë të nenit 134, në nenet 135 e 136, në paragrafin e dytë të nenit 137/a, në paragrafin e dytë të nenit 138, në nenet 138/a, 139, 140, 141, 141/a, në nenet 143/a, 143/b, 144/a, 151, 152, 153, 154, 154/a, në paragrafin e dytë dhe të tretë të nenit 155, në paragrafin e dytë të nenit 159, në paragrafin e dytë të nenit 160, në nenet 164/a, 164/b, 175, në paragrafët e dytë dhe të tretë të nenit 180 dhe në nenin 181/a të Kodit Penal, si dhe në paragrafët e dytë dhe të tretë, të nenit 59 të Kodit Penal Ushtarak;

f) vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 186/a, në paragrafin e dytë të nenit 187, në paragrafin e dytë të nenit 188, në nenet 190, 191, 192 dhe në paragrafin e dytë të nenit 192/b të Kodit Penal;

g) veprat penale që cenojnë regjimin juridik të tokës dhe të ndërtimeve, të parashikuara në paragrafët e tretë dhe të katërt, të nenit 199/a dhe në nenin 199/b të Kodit Penal;

gj) vepra penale kundër mjedisit, të parashikuara në paragrafin e dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë, të nenit 201, në nenet 201/a, 201/b, 201/c, 201/ç, 202, 202/b, 203, 206/a dhe 206/b të Kodit Penal;

h) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 dhe 225 të Kodit Penal;

i) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 dhe 228 të Kodit Penal;

j) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a dhe 234/b të Kodit Penal;

k) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenet 237, 238, 243, 244, 244/a, 245, në paragrafin e dytë dhe të katërt, të nenit 245/1, në paragrafin e dytë të nenit 247, në nenet 248, 248/a, 250, 252, 253, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 265, 265/a, 265/b, 265/c, 266, 267, 268, 270, 271, në paragrafët e parë, të dytë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë, të nenit 278, në nenet 278/a e 278/b, në paragrafin e dytë të nenit 281, në paragrafin e dytë të nenit 282, në nenet 282/a, 282/b, 282/c, 283, 283/a, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 284/d, 285, 286, 287, 287/a, 287/b, 288, 288/a, 288/b, 288/c, 288/ç, në paragrafin e dytë të nenit 289, në paragrafët e dytë, të tretë dhe të katërt, të nenit 290, në paragrafin e dytë të nenit 292, në nenet 293/a, 293/b, 293/c, 293/ç, 294, 295, në paragrafët e parë, të tretë, të katërt, të pestë dhe të gjashtë, të nenit 295/a, në paragrafin e katërt dhe të pestë, të nenit 298, në nenin 299 të Kodit Penal, si dhe në nenin 70 të Kodit Penal Ushtarak;

l) vepra penale kundër drejtësisë, të parashikuara në nenet 302, 303, 311, 312, 312/a, 313, 313/a, 313/b, 314, 316, 317, 318, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, në paragrafin e dytë të nenit 323, në nenin 324 dhe në paragrafin e dytë, të nenit 324/a të Kodit Penal;

ll) vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 325, 326, 326/a, 327, 327/a, 328, 328/a, 328/b, 329, 330, 330/a, 331, 331/a, 332 dhe 332/a të Kodit Penal;

m) vepra penale të kryera nga banda të armatosura dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal;

n) vepra penale të parashikuara në nenet 8 dhe 9, të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", i ndryshuar.

2. Pavarësisht nga parashikimet e shkronjave "b", "ç", "dh" dhe "e", të pikës 1, të nenit 3 të këtij ligji, nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit personat e dënuar për:

a) krime kundër njerëzimit, të parashikuara në nenet 73, 74, 74/a dhe 75 të Kodit Penal;

b) krime kundër jetës të kryera me dashje, të parashikuara në nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c,81 dhe 83/b të Kodit Penal;

c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, të parashikuara në nenet 86, 87, 88 dhe 89/a dhe 93 të Kodit Penal;

ç) krime seksuale, të parashikuara në nenet 100, 101, 103, 104, 105, 106, 107/a 108 dhe në paragrafin e dytë të nenit 108/a të Kodit Penal;

d) vepra penale kundër lirisë së personit, të parashikuara në nenet 109, 109/b, 109/c, në paragrafin e dytë, të nenit 110, në nenet 110/a, 110/b, 110/c dhe 111 të Kodit Penal;

dh) vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, të parashikuara në paragrafin e dytë, të nenit 114, në paragrafët e dytë dhe të tretë, të nenit 117 dhe në nenin 121 të Kodit Penal;

e) vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, të parashikuara në paragrafin e dytë, të nenit 124, në nenin 124/a, në paragrafin e dytë dhe të tretë, të nenit 124/b, në nenet 128/a, 128/b dhe 129 të Kodit Penal;

ë) vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, të parashikuara në nenet 135, 136, në paragrafin e dytë, të nenit 137/a, në paragrafin e dytë, të nenit 138, në nenet 139, 140, 141, 143/a, 143/b, 144/a, 151, 152, 153, 154, 154/a, në paragrafin e dytë dhe të tretë, të nenit 155, në paragrafin e dytë të nenit 159, në nenet 164/a, 164/b, 175, në paragrafin e dytë dhe të tretë, të nenit 180 dhe në nenin 181/a të Kodit Penal;

f) vepra penale kundër falsifikimit të dokumenteve, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 186/a, në paragrafin e dytë, të nenit 187, në paragrafin e dytë, të nenit 188, në nenet 190, 191 dhe 192 dhe në paragrafin e dytë, të nenit 192/b të Kodit Penal;

g) vepra penale kundër mjedisit, të parashikuara në paragrafin e dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë, të nenit 201, në nenet 201/a, 201/b, 201/c, 201/ç, 202, 202/b, 203, 206/a, 206/b të Kodit Penal;

gj) krime kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, të parashikuara në nenet 208, 209, 210, 211, 212, 213, 214, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 223, 224 dhe 225 të Kodit Penal;

h) krime që cenojnë marrëdhëniet me shtetet e tjera, të parashikuara në nenet 226 dhe 228 të Kodit Penal;

i) vepra me qëllime terroriste, të parashikuara në nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a dhe 234/b të Kodit Penal;

j) krime kundër autoritetit të shtetit, të parashikuara në nenet 243, 244, 244/a, 245, 248, 248/a, 250, 253, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 265, 265/a, 265/b, 265/c, 266, 267, 268, në paragrafin e pestë, të gjashtë, të shtatë dhe të tetë, të nenit 278, në nenet 278/a, 278/b, në paragrafin e dytë të nenit 281, në paragrafin e dytë të nenit 282, në nenet 282/a, 282/b, 282/c, 283, 283/a, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 284/d, 285, 286, 287, 287/a, 287/b, 288, 288/a, 288/b, 288/c, 288/ç, në paragrafin e dytë të nenit 289, në paragrafin e dytë, të tretë dhe të katërt, të nenit 290, në paragrafin e dytë të nenit 292, në nenet 293/a, 293/b, 293/c, 293/ç, 294, 295, në paragrafin e parë, të tretë, të katërt, të pestë dhe të gjashtë, të nenit 295/a, në paragrafin e katërt dhe të pestë, të nenit 298 dhe në nenin 299 të Kodit Penal, si dhe në nenin 70 të Kodit Penal Ushtarak;

k) vepra penale kundër drejtësisë, të parashikuara në nenet 302, 303, 311, 312, 312/a, 313, 313/a, 313/b, 314, 316, 317, 318, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, në paragrafin

e dytë të nenit 323, në nenin 324 dhe në paragrafin e dytë të nenit 324/a të Kodit Penal;

l) vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, të parashikuara në nenet 325, 326, 326/a, 327, 327/a, 328, 328/a, 328/b, 329, 330, 330/a, 331, 331/a, 332 dhe 332/a të Kodit Penal;

ll) vepra penale të kryera nga banda e armatosur dhe organizata kriminale, të parashikuara në nenet 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal;

m) vepra penale të parashikuara në nenet 8 dhe 9, të ligjit nr. 95/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", i ndryshuar.

Neni 5
Kriteret për përfitimin e amnistisë nga zbritja e dënimit

1. Të gjithë personave të dënuar, të cilët nuk plotësojnë kriteret për t'u përjashtuar nga vuajtja e dënimit, sipas nenit 3 të këtij ligji ose, edhe pse plotësojnë kriteret për përfitimin e amnistisë sipas këtij neni, nuk përjashtohen nga vuajtja e dënimit për shkak të kritereve ndaluese të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të këtij ligji, u zbritet:

a) 1 vit e gjysmë për personat e dënuar gra dhe të mitur;

b) 1 vit për personat e dënuar burra.

2. Pavarësisht nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni, nuk përfitojnë zbritje të dënimit:

a) personat e dënuar me burgim për veprat penale të parashikuara në nenet 79, 79/a, 79/b dhe 79/c të Kodit Penal;

b) personat e dënuar me burgim të përjetshëm;

c) personat e dënuar, akuzat penale ndaj të cilëve janë gjykuar nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas përcaktimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale apo personat e dënuar për çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

3. Nuk përfitojnë zbritje të dënimit personat të cilët i janë shmangur drejtësisë sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 2 të këtij ligji.

Neni 6
Kriteret për përfitimin e amnistisë nga ndjekja penale

1. Përjashtohen nga ndjekja penale të gjitha çështjet penale në hetim, çështjet e pashqyrtuara ose në proces shqyrtimi nga gjykatat, si dhe kallëzimet që ndodhen në këto organe, pavarësisht nga data e regjistrimit të tyre, për veprat penale të kryera deri në datën 31.5.2026, për të cilat Kodi Penal dhe Kodit Penal Ushtarak parashikojnë një dënim me burgim në maksimum deri në 3 vjet ose çdo lloj dënimi tjetër më të butë, me përjashtim të veprave të parashikuara në nenet 83/a, 83/b, 84/a, 88/b, 90, 91, 92, 96, 105, në paragrafin e dytë të nenit 112, 113, në paragrafin e parë të nenit 117, në nenet 119, 119/a, 119/b, 120, 121,122, 124, në paragrafin e parë të nenit 124/b, në nenet 125, 127, 130/a, 131, 132, në paragrafin e dytë dhe të tretë, të nenit 134, në nenet 137, 137/a, 142, 143/a/2, 143/a/3, 143/a/4, 143/a/5, 149, 150, 156, 160, 161, 164/a, 170/c, 170/ç, 178, 179, 179/b, 180, 180/a, 181, 185, 186, 186/a, 187, 188, në paragrafin e parë të nenit 191, në nenin 192, në paragrafin e parë të nenit 192/a, në paragrafin e parë të nenit 192/b, në paragrafin e parë të nenit 193, në paragrafin e parë të nenit 197, në paragrafin e parë të nenit 201, në paragrafin e parë të nenit 202/a, në nenet 204, 205, 206, 207, 223, në paragrafin e parë të nenit 224, në nenin 225, në paragrafin e parë të nenit 236, në paragrafin e parë të nenit 237, në paragrafin e parë, të dytë, të katërt dhe të pestë, të nenit 238, në paragrafin e tretë të nenit 242/a, në paragrafin e parë dhe të dytë, të nenit 244, në nenin 244/a, në paragrafin e parë, të dytë dhe të tretë, të nenit 245/1, në paragrafin e parë të nenit 251, në nenet 254, 255, 256, në paragrafin e parë dhe të dytë të nenit 257/a, në nenin 259, në paragrafin e dytë të nenit 261, në paragrafin e parë të nenit 263, në nenet 265/c, 269, 271, në paragrafin e parë të nenit 274/a, në paragrafin e tretë të nenit 274/b, në paragrafin e katërt të nenit 278, në paragrafin e parë të nenit 279, në nenin 287/a, në paragrafin e parë të nenit 287/b, në paragrafin e parë të nenit 288, në paragrafin e parë të nenit 288/a, në paragrafin e parë të nenit 288/c, në nenet 288/ç e 293, në paragrafin e parë të nenit 293/b, në paragrafin e parë të nenit 295, në paragrafin e dytë dhe të katërt, të nenit 295/a, 296, në paragrafin e parë të nenit 300, në nenin 301, në paragrafin e dytë të nenit 306, në paragrafin e dytë të nenit 308, në paragrafin e parë të nenit 309, në

paragrafin e dytë të nenit 313/b, në nenet 317 e 318, në paragrafin e dytë të nenit 320/a, në paragrafin e parë të nenit 324/a, në paragrafin e parë dhe të dytë, të nenit 327, në paragrafin e parë dhe të tretë, të nenit 327/a, në paragrafin e parë, të dytë, të tretë, të katërt, të nenit 328/a, në paragrafin e parë të nenit 329, në paragrafin e parë të nenit 330/a, në paragrafin e parë të nenit 331/a, në nenin 332 të Kodit Penal, si dhe në paragrafin e parë të nenit 21, në nenin 23, në paragrafin e dytë të nenit 38, në paragrafin e dytë të nenit 39, në paragrafin e parë të nenit 42, në paragrafin e parë të nenit 47, në paragrafin e parë të nenit 51, në paragrafin e parë të nenit 67, në paragrafin e parë të nenit 74, në paragrafin e dytë të nenit 81, në nenet 85 e 92 të Kodit Penal Ushtarak.

2. Nuk përfitojnë nga ky nen personat të cilët i janë shmangur drejtësisë.

3. Nuk përfitojnë nga pika 1 e këtij neni subjektet që kanë detyrimin për të deklaruar sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, si dhe subjektet e posaçme, akuzat penale ndaj të cilëve gjykohen nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas përcaktimeve të nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale dhe për çdo vepër penale tjetër që është e lidhur ngushtë me hetimin apo çështjen penale brenda kompetencave të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 7
Të drejtat civile në procesin penal

Nga zbatimi i këtij ligji nuk cenohen të drejtat civile në procesin penal dhe as shpenzimet gjyqësore të kryera gjatë gjykimit deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.6.2026.

Shpallur me dekretin nr. 375, datë 30.6.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 375, datë 30.6.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 57/2026, "Për dhënie amnistie".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 59/2026

PËR SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

[1] Ky ligj është përafruar pjesërisht me: Direktivën (BE) 2019/944 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 qershor 2019, për rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe për ndryshimin e direktivës 2012/27/BE (riformuluar). Numri CELEX 32019L0944, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, 158, datë 14.6.2019, faqe 125–199. Rregulloren (BE) 2019/941 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 qershor 2019, për gatishmërinë ndaj rreziqeve në sektorin e energjisë elektrike. Numri CELEX 32019R0941, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 158, datë 14.6.2019, faqe 1–21. Rregulloren (BE) 2019/942 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 qershor 2019, për krijimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER). Numri CELEX 32019R0942, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 158, datë 14.6.2019, faqe. 22–53. Rregulloren (BE) 2019/943 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 5 qershor 2019, për tregun e brendshëm të energjisë elektrike. Numri CELEX 32019R0943. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L 158, datë 14.6.2019, faqe. 54–124.

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve nëpërmjet krijimit të një tregu funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe nevoja për të integruar tregun shqiptar të energjisë elektrike me tregjet e tjera rajonale të energjisë elektrike dhe tregun e integruar evropian të energjisë elektrike. Në këtë kuadër ky ligj synon të promovojë çmime dhe kosto të përballueshme e transparente të energjisë për konsumatorët, do të rrisë të drejtat dhe mbrojtjen e tyre, do të promovojë efikasitetin energjetik dhe do të sigurojë një tranzicion të qetë drejt një sistemi energjetik të qëndrueshëm me karbon të ulët.

Neni 2
Fusha e veprimit

Ky ligj rregullon marrëdhëniet në veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit me energji elektrike, agregimit, reagimit ndaj kërkesës, funksionimit të tregut, depozitimit të energjisë elektrike dhe funksionimit të pikave të rikarikimit, si dhe vendos rregullat lidhur me:

a) hapjen, organizimin dhe funksionimin e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;

b) pjesëmarrjen në tregun e energjisë elektrike;

c) dhënien e autorizimeve dhe licencave në sektorin e energjisë elektrike;

ç) rregullimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike, mbrojtjen e klientëve, sigurinë e furnizimit dhe krijimin e strukturave konkurruese të tregut të energjisë elektrike;

d) integrimin e tregut shqiptar në tregun rajonal dhe atë evropian të energjisë elektrike.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "ACER" është Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë.

2. "Agregim" është funksioni i kryer nga një person fizik ose juridik, i cili kombinon disa ngarkesa të konsumatorëve ose të energjisë elektrike të prodhuar për shitje, blerje ose ankand në çdo treg të energjisë elektrike.

3. "Agregues" është pjesëmarrësi në tregun e energjisë elektrike që ushtron aktivitetin e agregimit.

4. "Akses i palëve të treta" është e drejta e të gjithë përdoruesve të sistemit për përdorimin e rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, bazuar në kushte të përcaktuara dhe të publikuara, në përputhje me parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit, kundrejt tarifave të miratuara nga ERE-ja.

5. "Aktivitet i energjisë elektrike" është aktiviteti ekonomik që lidhet me prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin me energji elektrike, agregimin, përgjigjen ndaj kërkesës, operimin e depozitimit të energjisë, operimin e pikave të rikarikimit, si dhe funksionimin e tregut.

6. "Alokim kapacitetesh" është dhënia e kapaciteteve ndërzonale.

7. "Balancim" është tërësia e proceseve nëpërmjet të cilave Operatori i Sistemit të Transmetimit operon dhe ruan frekuencën e sistemit brenda kufijve të përcaktuar të qëndrueshmërisë së tij, si dhe i përmbahet sasisë së rezervave që nevojiten për cilësinë e kërkuar.

8. "Bord" është organi vendimmarrës i ERE-s, i emëruar sipas këtij ligji.

9. "Burim rezervë" është një burim dytësor i furnizimit me energji elektrike, që nuk është i lidhur me sistemin elektroenergjetik.

10. "Burime të rinovueshme të energjisë" janë burimet e rinovueshme jofosile të energjisë, si: era, energjia diellore, energjia aerotermale, energjia gjeotermale, energjia hidrotermale dhe oqeanike, energjia hidrike, biomasa, gazi i përftuar prej vendgroposjes së mbetjeve, gazi i përftuar prej impianteve të trajtimit të ujërave të zeza dhe biogazi, siç është përcaktuar në ligjin për energjinë e rinovueshme.

11. "Central prodhues" është një tërësi godinash dhe impiantesh të caktuara, të cilat kanë si destinacion bazë prodhimin e energjisë elektrike.

12. "Certifikim" është procedura, e cila përcakton përputhshmërinë me kushtet që sigurojnë pavarësinë dhe ndarjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, si një parakusht për përcaktimin dhe miratimin e këtij operatori.

13. "Çmim i disbalancës" është çmimi, qoftë pozitiv, zero ose negativ, në çdo periudhë të shlyerjes së disbalancës për një disbalancë në çdo drejtim.

14. "Depozitim i energjisë", në sistemin e energjisë elektrike, është shtyrja e përdorimit përfundimtar të energjisë elektrike nëpërmjet mjeteve fizike ose kimike për një moment më të mëvonshëm se ai kur është prodhuar ose shndërrimi i energjisë elektrike në një formë energjie që mund të depozitohet, depozitimi i kësaj energjie dhe rikonvertimi i mëvonshëm i kësaj energjie në energji elektrike ose përdorimi si një mbartës tjetër energjie, duke përfshirë depozitimin e pompuar".

15. "Derivativ elektrik" është një instrument financiar siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për tregjet e kapitalit, që mund të përdoret nga pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike si mjet sigurie ndaj luhatjeve të mundshme të çmimit të energjisë elektrike në treg.

16. "Detyrim i shërbimit publik" është detyrimi i vendosur ndaj mbajtësit të licencës për të kryer një shërbim publik, siç përcaktohet në nenin 49 të këtij ligji.

17. "Dispeçerim" është veprimtaria e kryer nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, që konsiston në menaxhimin në kohë reale të flukseve të energjisë elektrike dhe zbatimin e masave të nevojshme për operimin e bashkërenduar të komponentëve të sistemit elektroenergjetik, përfshirë centralet prodhuese, rrjetin e transmetimit dhe shërbimet ndihmëse të nevojshme për operimin e sistemit.

18. "Dispeçerim prioritar" është dërgimi i impianteve të prodhimit në bazë të kritereve që janë të ndryshme nga rendi ekonomik i ofertave, duke i dhënë prioritet dërgimit të teknologjive të veçanta të prodhimit të energjisë elektrike.

19. "Eficiencë energjetike" është raporti ndërmjet daljes së performancës, shërbimit, mallrave ose energjisë dhe hyrjes së energjisë.

20. "Energji e balancimit" është energjia e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin.

21. "ENTSO-E (European Network of Transmission System Operators for Electricity)" është Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike.

22. "Enti Rregullator i Energjisë" ose "ERE" është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për sektorin e gazit natyror.

23. "Eksport i deklaruar" është dispeçerimi i energjisë elektrike që i korrespondon sasisë së energjisë elektrike që livrohet njëkohësisht në një vend tjetër si import i deklaruar mbi bazën e një marrëdhënieje kontraktuale.

24. "Fluks ndërkufitar" është një fluks fizik i energjisë elektrike në sistemin e transmetimit të Shqipërisë që rezulton nga ndikimi i aktivitetit të prodhuesve, klientëve ose të dyve jashtë Shqipërisë.

25. "Forcë madhore" është një akt ose ngjarje natyrore apo shoqërore, si: tërmetet, rrufetë, ciklonet, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret ose luftërat, konfliktet e armatosura, kryengritjet, veprime terroriste ose ushtarake, të cilat pengojnë të licencuarin të përmbushë detyrimet e tij sipas licencës, si dhe akte apo ngjarje të tjera që janë përtej kontrollit të arsyeshëm dhe që nuk kanë ardhur për faj të të licencuarit dhe i licencuari nuk ka pasur mundësi të shmangë një akt ose ngjarje të tillë nëpërmjet ushtrimit të vullnetit, përpjekjeve, aftësive dhe kujdesit të tij të arsyeshëm.

26. "Furnizim" është shitja, përfshirë rishitjen e energjisë elektrike te klientët.

27. "Furnizues" është një shoqëri e licencuar për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit.

28. "Furnizues i mundësisë së fundit" është një furnizues i caktuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj klientëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre.

29. "I licencuar" është një person i pajisur me licencë për aktivitete të energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

30. "Import i deklaruar" është energjia elektrike që livrohet në një vend, e cila në të njëjtën kohë

dispeçerohet si eksport i deklaruar nga një vend tjetër.

31. "Impiant i depozitimit të energjisë" është në sistemin e energjisë elektrike një hapësirë ku bëhet depozitimi i energjisë.

32. "Infrastrukturë transevropiane e energjisë" është rrjeti i sistemeve dhe objekteve ndërkufitare të energjisë që lidhin, integrojnë dhe mundësojnë rrjedhën e energjisë nëpër vendet evropiane dhe rregullohet nga rregulloret e Rrjetit Transevropian për Energjinë.

33. "Interkonektor" ose "linja interkoneksioni" është linja e transmetimit, e ndërtuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose një palë e tretë, e cila kalon nëpërmjet kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe të një vendi tjetër dhe lidh sistemet kombëtare të transmetimit të të dyja vendeve.

34. "Interkonektor i ri" është një interkonektor i papërfunduar dhe/ose i përfunduar, por i pakomisionuar deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

35. "Interkonektor me rrymë të alternuar" është një interkonektor që përdor rrymë të alternuar.

36. "Interkonektor me rrymë të drejtpërdrejtë" është një interkonektor që përdor rrymë të drejtpërdrejtë me tension të lartë.

37. "Kabinë elektrike" është tërësia e mjeteve themelore dhe pajisjeve elektrike të lidhura në tensionin e mesëm dhe të ulët me rrjetin e shpërndarjes, funksioni i të cilave është të kontrollojnë lidhjen, të transformojnë, të transmetojnë dhe të matin energjinë elektrike që furnizohet ose prodhohet për lidhjet e reja apo modifikimin e lidhjeve ekzistuese të klientëve ose prodhuesve për këto nivele tensioni.

38. "Kapacitet i balancimit" është një vëllim kapaciteti që një ofrues i shërbimit të balancimit ka rënë dakord të mbajë dhe për të cilin ofruesi i shërbimit të balancimit ka rënë dakord të paraqesë oferta për një vëllim korrespondues të energjisë balancuese tek Operatori i Sistemit të Transmetimit për kohëzgjatjen e kontratës.

39. "Kapacitet i kufizuar" është situata në të cilën një linjë interkoneksioni nuk mund të sigurojë transmetimin e të gjithë fluksit fizik të energjisë elektrike që rezulton nga kërkesa e pjesëmarrësve të tregut për shkak të mungesës apo reduktimit të kapaciteteve të linjave të interkoneksionit dhe/ose të sistemit kombëtar të transmetimit.

40. "Kapacitet ndërzonal" është aftësia e sistemit të ndërlidhur për të përballuar transferimin e energjisë midis zonave të ofertimit.

41. "Kapacitet rezervë" është sasia e rezervave të konservuara të frekuencës, e rezervave të rivendosjes së frekuencës ose e rezervave zëvendësuese që duhet të jenë në dispozicion të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

42. "Klerim" është procesi i zbatuar nga operatori i tregut për të vendosur pozicione, duke përfshirë llogaritjen e kredive ose debiteve të anëtarëve të klerimit ndaj operatorit të tregut, si dhe për të siguruar disponueshmërinë e parave për të garantuar ekspozimin ndaj operatorit të tregut, i cili rezulton nga këto pozicione, në përputhje me dispozitat e rregullave të tregut.

43. "Klient" është një klient shumice ose fundor i energjisë elektrike.

44. "Klient aktiv" është klienti fundor ose një grup klientësh fundorë që veprojnë së bashku, i cili konsumon ose depoziton energji elektrike të prodhuar brenda ambienteve të tij të vendosura brenda kufijve të caktuar, ose që shet energji elektrike të vetëprodhuar ose merr pjesë në skemat e fleksibilitetit ose eficiencës së energjisë, me kusht që këto veprimtari të mos përbëjnë veprimtarinë e tij kryesore tregtare ose profesionale.

45. "Klient familjar" është një klient që blen energji elektrike vetëm për konsumin e tij familjar, pa përfshirë konsumin për veprimtari tregtare apo profesionale.

46. "Klient fundor" është një klient që blen energji elektrike vetëm për përdorim vetjak.

47. "Klient jofamiljar" janë personat fizikë ose juridikë që blejnë energji elektrike, e cila nuk shkon për përdorim familjar, prodhuesit dhe klientët e shumicës.

48. "Klient në nevojë" është një klient familjar, i cili për shkak të gjendjes sociale gëzon disa të drejta të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruara në raste përjashtimore, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

49. "Klient shumice" është një person fizik ose juridik që blen energji elektrike, me qëllim rishitjeje brenda ose jashtë sistemit të vendit ku është regjistruar.

50. "Kodet e rrjetit" janë kodi i transmetimit dhe kodi i shpërndarjes; kodet e rrjetit për lidhjen, siç janë përshtatur dhe miratuar me vendimin nr. 2018/04/PHLG të Komunitetit të Energjisë; si dhe

rregulloret dhe udhëzimet: Rregullorja (BE) 2015/1222, që përcakton udhëzimet për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestionit; Rregullorja (BE) 2016/1719, që përcakton udhëzimet për alokimin e kapaciteteve afatgjata; Rregullorja (BE) 2017/2195, që përcakton udhëzimet për balancimin e energjisë elektrike; Rregullorja (BE) 2017/2196, që përcakton kodin e rrjetit për situatat emergjente dhe restaurimin e sistemit elektroenergjetik; Rregullorja (BE) 2017/1485, që përcakton udhëzimet për funksionimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, siç janë përshtatur dhe miratuar me vendimin nr. 2022/15/MC-EnC të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë.

51. "Kodi i shpërndarjes" është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, si dhe vendosin kushtet e shërbimit që ofrohen nga operatorët e sistemit të shpërndarjes për përdoruesit e sistemit të shpërndarjes.

52. "Kodi i transmetimit" është tërësia e rregullave teknike, të cilat rregullojnë operimin e sistemit të transmetimit, si dhe përcaktojnë kushtet e shërbimit që ofrohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ndaj përdoruesve të sistemit të transmetimit, në përputhje me rregullat e ENTSO-E.

53. "Komponentë të rrjetit të integruar plotësisht" janë komponentët e rrjetit që janë të integruar në sistemin e transmetimit ose të shpërndarjes, duke përfshirë hapësirat e depozitimit të energjisë dhe që përdoren me qëllimin e vetëm për të siguruar një funksionim të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes, dhe jo për balancimin ose menaxhimin e kongjestionit.

54. "Komuniteti qytetar i energjisë" është personi juridik që:

a) bazohet në pjesëmarrjen vullnetare dhe të hapur dhe kontrollohet efektivisht nga pjesëtarët ose aksionarët që janë persona fizikë, autoritetet vendore, duke përfshirë bashkitë ose ndërmarrjet e vogla;

b) ka për qëllimin e tij parësor të sigurojë përfitime mjedisore, ekonomike ose sociale për pjesëtarët ose aksionarët e tij ose për zonat lokale ku operon se sa të gjenerojë fitime financiare; dhe

c) mund të angazhohet në prodhimin e energjisë, duke përfshirë nga burimet e rinovueshme, shpërndarjen, furnizimin, konsumin, agregimin, depozitimin e energjisë, shërbimet e eficiencës së energjisë ose operimin e pikës së rikarikimit ose të ofrojë shërbime të tjera energjetike për pjesëtarët ose aksionarët e tij.

55. "Kongjestion" është një situatë në të cilën të gjitha kërkesat e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike për të tregtuar ndërmjet zonave të rrjetit nuk mund të plotësohen, sepse ato do të ndikonin ndjeshëm flukset fizike në elementet e rrjetit që nuk mund t'i plotësojnë ato flukse.

56. "Kongjestion strukturor" është kongjestioni në sistemin e transmetimit që është në gjendje të përcaktohet në mënyrë të qartë, është i parashikueshëm, është gjeografikisht i qëndrueshëm me kalimin e kohës dhe ndodh shpesh në kushte normale të sistemit të energjisë elektrike.

57. "Kontratë e furnizimit" është një kontratë për furnizimin me energji elektrike, por që nuk përfshin derivativët e energjisë elektrike.

58. "Kontratë e furnizimit me ndërprerje" është kontrata e furnizimit, e cila i jep të drejtën Operatorit të Sistemit të Transmetimit apo Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të ndërpresë përkohësisht furnizimin me energji elektrike të klientit fundor, në përputhje me kushtet e shërbimit, të përcaktuara në kodet e rrjetit dhe aktet e tjera rregullatore.

59. "Kontratë e plotë furnizimi" është kontrata e furnizimit, e cila përfshin përgjegjësitë e përdorimit të rrjetit të transmetimit ose shpërndarjes.

60. "Kontratë e çmimit dinamik të energjisë elektrike" është një kontratë furnizimi midis një furnizuesi dhe një klienti fundor që pasqyron ndryshimin e çmimit në tregjet spot, duke përfshirë në tregjet e ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, të paktën në intervale të barabarta me frekuencën e shlyerjes së tregut.

61. "Kontroll" janë të drejtat, kontratat ose çdo mënyrë tjetër, që, veç e veç apo në mënyrë të kombinuar, duke u bazuar në një rrethanë apo në një ligj, i japin një subjekti mundësinë e ushtrimit të një ndikimi përcaktues mbi një shoqëri të caktuar në veçanti nëpërmjet:

a) pronësisë ose së drejtës për të përdorur të gjitha ose pjesë të aseteve të kësaj shoqërie;

b) të drejtave apo kontratave, të cilat japin një ndikim të theksuar në hartimin, votimin apo vendimmarrjen e organeve të asaj shoqërie.

62. "Kushtet e çmimit maksimal" janë rregullat mbi çmimin maksimal të energjisë elektrike, siç

përcaktohen nga ERE-ja, që zbatohen për furnizimin me energji elektrike nga subjektet që kryejnë rishitjen e energjisë elektrike ose ndarjen e energjisë elektrike pa licencë furnizimi me energji elektrike.

63. "Kushtet, afatet dhe metodologjitë" janë rregullat, procedurat, kushtet dhe metodologjitë panevropiane, rajonale dhe kombëtare, siç parashikohen në kodet dhe udhëzimet e rrjetit.

64. "Licencë" është një e drejtë që i jepet një personi për ushtrimin e një veprimtarie në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

65. "Linjë direkte" është një linjë elektrike që lidh një prodhues të veçuar nga rrjeti me një klient të veçuar nga rrjeti, brenda ose jashtë vendit, ose një linjë elektrike që lidh një prodhues me një shoqëri furnizimi, e cila furnizon me energji elektrike drejtpërdrejt ambientet, filialet ose klientët e saj.

66. "Ligji për energjinë e rinovueshme" është ligji nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".

67. "Sistem inteligjent matjeje" nënkupton një sistem elektronik që është i aftë të masë energjinë elektrike të futur në rrjet ose energjinë elektrike të konsumuar nga rrjeti, duke ofruar më shumë informacion sesa një matës konvencional dhe që është i aftë të transmetojë dhe të marrë të dhëna për qëllime informacioni, monitorimi dhe kontrolli, duke përdorur një formë komunikimi elektronik.

68. "Matës konvencional" është një matës analog ose elektronik pa aftësi për të transmetuar dhe për të marrë të dhëna.

69. "Mekanizëm kapaciteti" është një masë e përkohshme për të siguruar arritjen e nivelit të nevojshëm të mjaftueshmërisë së burimeve duke i shpërblyer burimet për disponueshmërinë e tyre, duke përjashtuar masat që lidhen me shërbimet ndihmëse ose menaxhimin e kongjestionit.

70. "Ministria" është ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë.

71. "Ministri" është ministri përgjegjës për sektorin e energjisë.

72. "Model i tregut të energjisë elektrike" është një dokument i përgatitur dhe i miratuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji, i cili përcakton marrëdhëniet ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut të energjisë elektrike.

73. "Ndarje e energjisë elektrike" është furnizimi me energji elektrike i një klienti fundor nga një klient aktiv ose komunitet qytetar i energjisë, ku energjia elektrike e furnizuar është prodhuar nga subjekti që ndan energjinë elektrike si prodhim i një impianti prodhimi, mjediset e të cilit ndodhen në të njëjtën vendndodhje me mjediset ku ndodhet klienti fundor blerës.

74. "Ndërmarrje mikro" është një ndërmarrje që ka më pak se 10 të punësuar dhe xhiroja vjetore dhe/ose totali i bilancit vjetor nuk tejkalon shumën 2 milionë euro.

75. "Ndërmarrje e vogël" është një ndërmarrje që ka më pak se 50 të punësuar dhe xhiroja vjetore dhe/ose totali i bilancit vjetor nuk tejkalon shumën 10 milionë euro.

76. "Ndërveprueshmëria", në kontekstin e matjes inteligjente, është aftësia e dy ose më shumë rrjeteve, sistemeve, pajisjeve, aplikacioneve ose komponentëve të energjisë ose komunikimit për të ndërvepruar, shkëmbyer dhe përdorur informacionin për të kryer funksionet e kërkuara.

77. "Ofrues i shërbimit të balancimit" është një pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike, i cili ofron energji balancuese ose kapacitet balancimi ose të dyja së bashku për Operatorin e Sistemit të Transmetimit.

78. "Operator i pikës së rikarikimit" është personi fizik ose juridik që ushtron operimin e pikës së rimbushjes.

79. "Operator i rrjetit" është operatori i sistemit të transmetimit dhe/ose operatori i sistemit të shpërndarjes.

80. "Operatori i Sistemit të Transmetimit" ose "OST" është personi juridik, përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkoneksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit për plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike.

81. "Operator i emëruar i tregut të energjisë elektrike" ose "NEMO" është operatori i tregut, i caktuar nga ERE-ja për të kryer detyra që lidhen me bashkimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë ose të tregut të energjisë elektrike brenda të njëjtës ditë.

82. "Operatori i pavarur i matjes" është një shoqëri me eksperiencë në matjen e energjisë për kryerjen dhe menaxhimin e sistemit të matjes.

83. "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" ose "OSSH" është një person juridik, përgjegjës për operimin e sigurt, të besueshëm dhe të efektshëm të

rrjetit të shpërndarjes, duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, të shtrirë në një zonë të caktuar dhe, kur është e aplikueshme, lidhjet e tij me sisteme të tjera për të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficiencën e energjisë.

84. "Operator i tregut" është subjekti që jep një shërbim me anën e të cilit ofertat për shitjen e energjisë elektrike njësohen me ofertat për blerjen e energjisë elektrike.

85. "Operim i hapësirës së depozitimit të energjisë" është aktiviteti që mbulon operimin e një hapësire depozitimi energjie.

86. "Operim i tregut" është veprimtaria që kryen operatori i tregut për organizimin dhe operimin e tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë dhe të tregut të energjisë elektrike brenda së njëjtës ditë.

87. "Operim i pikës së rikarikimit" është aktiviteti që mbulon operimin e pikave të rikarikimit.

88. "Pagesa e licencës" është pagesa e përcaktuar nga ERE-ja për dhënien e licencave për ushtrimin e një aktiviteti në sektorin e energjisë elektrike.

89. "Pagesë rregullatore" është pagesa vjetore që të gjitha shoqëritë e licencuara në sektorin e energjisë elektrike paguajnë për llogari të ERE-s për të mbuluar kostot e veprimtarisë rregullatore të tij. Pagesa rregullatore për çdo shoqëri të licencuar miratohet çdo vit nga ana e ERE-s në bazë të një metodologjie të miratuar nga ky institucion.

90. "Palë përgjegjëse për balancimin" është një pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike ose përfaqësuesi i zgjedhur prej tij, përgjegjës përballë Operatorit të Sistemit te Transmetimit për disbalancat e krijuara gjatë operimit të tij.

91. "Palët e Komunitetit të Energjisë" janë palët kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare të tij.

92. "Periudhë e shlyerjes së disbalancës" është njësia kohore për të cilën llogaritet disbalanca e palëve përgjegjëse për balancimin.

93. "Person" është një person fizik ose juridik.

94. "Përdoruesit e sistemit" janë personat fizikë ose juridikë, të cilët i furnizon ose furnizohen me energji elektrike nëpërmjet sistemit të transmetimit ose të shpërndarjes.

95. "Përgjegjësia e balancimit" është një detyrim i pjesëmarrësve të energjisë elektrike të tregut për balancimin e prodhimit, konsumit, proceseve të shitblerjes të energjisë elektrike, në përputhje me programin e pranuar, duke qenë përgjegjës financiarisht kundrejt Operatorit të Sistemit të Transmetimit për sistemimin e disbalancave të krijuara.

96. "Përgjigje ndaj kërkesës" është ndryshimi i ngarkesës së energjisë elektrike nga klientë fundorë nga modelet e tyre normale ose faktike të konsumit në përgjigje të sinjaleve të tregut, duke përfshirë çmimet e energjisë elektrike që ndryshojnë sipas kohës ose pagesat stimuluese, ose në përgjigje të pranimit të ofertës së konsumatorit fundor për të shitur kërkesën e ulur ose të rritur me një çmim në një treg të organizuar të energjisë elektrike, qoftë individual apo përmes agregimit.

97. "Pikë rikarikimi" është një ndërfaqe e aksesueshme nga publiku, që është në gjendje të karikojë njërin automjet elektrik pas tjetrit ose të shkëmbejë baterinë e njërit automjeti elektrik pas tjetrit.

98. "Pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike" është personi juridik pjesëmarrës në çdo treg të energjisë elektrike, përfshirë tregjet për tregtimin e energjisë elektrike, kapaciteteve, balancimit dhe shërbimeve ndihmëse, që përfshin prodhuesit, tregtarët, operatorët e shërbimeve të depozitimit, agreguesit, ofruesit e përgjigjes ndaj kërkesës, furnizuesit, klientët, Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, operatorët e sistemeve të mbyllura të shpërndarjes, operatorin e tregut dhe operatorin e emëruar të tregut të energjisë elektrike (NEMO). Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë elektrike që nevojitet për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.

99. "Planifikim afatgjatë" është planifikimi i nevojave për investime në kapacitetet prodhuese, depozituese, transmetuese dhe shpërndarëse në baza afatgjata, me qëllim përmbushjen e kërkesës së sistemit për energji elektrike dhe sigurinë e furnizimit të klientëve.

100. "Prodhim i energjisë" është procesi i prodhimit të energjisë elektrike nga burime primare të energjisë.

101. "Prodhues" është një person i licencuar për prodhimin e energjisë elektrike.

102. "Prodhues i lidhur në shpërndarje" është një prodhues, centrali i të cilit është i lidhur në sistemin e shpërndarjes.

103. "Prodhues me përparësi i energjisë elektrike" janë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të ligjit për energjitë e rinovueshme të energjisë elektrike.

104. "Projekt demonstrues" është një projekt që demonstron një teknologji si të parën e këtij lloji në Komunitetin e Energjisë dhe përfaqëson një risi të rëndësishme që shkon përtej arritjes teknologjike faktike.

105. "Procesi i parakualifikimit" është procesi i verifikimit të pajtueshmërisë së aktivitetit të një ofruesi të kapacitetit të balancimit me kërkesat e vendosura nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

106. "Qendra Rajonale e Koordinimit" ose "RCC" është qendra rajonale e koordinimit në të cilën do të marrë pjesë Operatori i Sistemit të Transmetimit, siç përcaktohet në aneksin V të rregullores (BE) 2019/943.

107. "Rajoni i llogaritjes së kapacitetit" është zona gjeografike në të cilën zbatohet llogaritja e kapacitetit të koordinuar.

108. "Rajoni i Operacionit të Sistemit" ose "SOR" është rajoni i operimit të sistemit që mbulon Shqipërinë, siç përcaktohet në aneksin V të rregullores (BE) 2019/943.

109. "Ridispeçerim" është një masë, duke përfshirë reduktimin, që aktivizohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nëpërmjet ndryshimit të modelit të prodhimit, të ngarkesës ose të dyja, me qëllim që të ndryshohen flukset fizike në sistemin elektrik dhe të lehtësohet kongjestioni fizik ose të realizojë ndryshe sigurinë e sistemit.

110. "Rishitje e energjisë elektrike" është furnizimi me energji elektrike nga një subjekt brenda mjediseve të tij të vendosura brenda kufijve të kufizuar të një klienti fundor, ku energjia elektrike e furnizuar është blerë nga një furnizues i licencuar dhe ku çmimi maksimal i energjisë elektrike të furnizuar u nënshtrohet kushteve përkatëse të nxjerra nga ERE.

111. "Rregullat e tregut" janë secila prej rregullave të hollësishme, të cilat përcaktojnë mënyrën e operimit dhe menaxhimit të tregjeve të energjisë elektrike, regjistrimin e pjesëmarrësve, përgjegjësinë e balancimit prej pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, rregullat për balancimin e sistemit të energjisë elektrike, rregullat për llogaritjen e disbalancës për palët përgjegjëse të balancimit, rregullat për përgjegjësitë financiare të palëve përgjegjëse të balancimit në rast të disbalancimit, si dhe çështje të tjera lidhur me operimin e tregut të energjisë elektrike.

112. "Rregullorja (BE) 2019/943" është rregullorja (BE) 2019/943 e datës 5 qershor 2019 për tregun e brendshëm të energjisë elektrike, të inkorporuar dhe përshtatur me vendimin e Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë D/2022/03/MC-EnC, i datës 15 dhjetor 2022.

113. "Rrjeti e energjisë elektrike" është tërësia e linjave, nënstacioneve, pajisjeve të transmetimit apo shpërndarjes së energjisë elektrike, përfshirë linjat e interkoneksionit.

114. "Siguri" është siguria e furnizimit dhe garantimit të energjisë elektrike, si dhe sigurimi teknik.

115. "Sistemi i energjisë elektrike" është një sistem i ndërlidhur, i përbërë nga centralet elektrike, linjat elektrike, nënstacionet dhe pajisjet e transmetimit e shpërndarjes, me qëllim transmetimin apo shpërndarjen e energjisë elektrike te klientët.

116. "Sistemi i shpërndarjes" është sistemi i linjave, strukturave mbështetëse, pajisjeve transformuese dhe kyçëse/shkyçëse, të përdorura për shpërndarjen e energjisë elektrike dhe livrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.

117. "Sistemi i transmetimit" është sistemi i përdorur për transmetimin e energjisë elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për livrimin e energjisë elektrike te klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

118. "Shërbim publik" është shërbimi që sigurohet nga një i licencuar që operon në sektorin e energjisë elektrike, që lidhet me sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, çmimet e rregulluara në sektorin e energjisë elektrike, eficiencën e energjisë elektrike, energjinë nga burimet e rinovueshme, mbrojtjen e mjedisit, përmbushja e të cilit nuk cenon konkurrencën, përveç kur është e domosdoshme për të siguruar shërbimin publik në fjalë.

119. "Shërbimi i balancimit" është sigurimi i kapacitetit rezervë i kontraktuar dhe/ose energjia

elektrike balancuese, e përdorur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për të kryer balancimin.

120. "Shërbim universal i furnizimit" është një shërbim publik për furnizimin e klientëve fundorë, i cili siguron të drejtën e tyre për t'u furnizuar me energji elektrike të një cilësie të caktuar, brenda gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese.

121. "Shërbime ndihmëse" janë shërbimet e nevojshme për operimin e qëndrueshëm të sistemit të transmetimit ose shpërndarjes, duke përfshirë shërbimet e balancimit dhe shërbimet ndihmëse jo të lidhura me frekuencën, por pa përfshirë menaxhimin e kongjestionit.

122. "Shërbime ndihmëse jo të lidhura me frekuencën" janë shërbimet e përdorura nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për kontrollin e tensionit në gjendje të qëndrueshme, injektimin e shpejtë të rrymës reaktive, inercinë e stabilitetit të rrjetit lokal, rrymën e qarkut të shkurtër, aftësinë e nisjes së veçuar pa qenë i lidhur me rrjetin e transmetimit dhe aftësinë e funksionimit të izoluar.

123. "Shoqëri elektroenergjetike" është një person juridik që kryen të paktën një nga veprimtaritë: prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, agregimin, përgjigjen ndaj kërkesës, depozitimin e energjisë, operimin e pikave të karikimit, furnizimin ose blerjen e energjisë elektrike, i cili është përgjegjës për detyrimet tregtare, teknike ose të mirëmbajtjes, lidhur me këto veprimtari, pa përfshirë klientët fundorë.

124. "Shoqëri e integruar e energjisë elektrike" është një shoqëri e licencuar në sektorin e energjisë elektrike, e integruar vertikalisht ose horizontalisht.

125. "Shoqëri e integruar horizontalisht" është një shoqëri, e cila kryen të paktën një nga veprimtaritë: prodhimin për shitje, transmetimin, shpërndarjen ose furnizimin e energjisë elektrike, si dhe një aktivitet tjetër jashtë fushës së energjisë elektrike.

126. "Shoqëri ose grup shoqërish të integruara vertikalisht" është një shoqëri ose grup shoqërish të licencuara në sektorin e energjisë elektrike, ku i njëjti person ose persona ushtrojnë kontroll mbi këto shoqëri në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë dhe ku shoqëria ose grupi i shoqërive kryejnë të paktën një prej veprimtarive të transmetimit ose shpërndarjes, si dhe të paktën një prej veprimtarive të prodhimit ose furnizimit me energji elektrike.

127. "Shpërndarje" është transporti i energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes me tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim lëvrimin e saj te klientët, pa përfshirë furnizimin.

128. "Shlyerje" është procesi që kryhet midis operatorit të tregut dhe anëtarëve klerues, përmes të cilit operatori i tregut menaxhon transaksionet monetare për transaksionet e kryera në tregjet e organizuara të energjisë elektrike.

129. "Tarifë e lidhur me ndërrimin" është një tarifë ose gjobë për ndryshimin e furnizuesve ose pjesëmarrësve të tregut të angazhuar në agregim, duke përfshirë tarifat e ndërprerjes së kontratës, që u imponohet drejtpërdrejt ose tërthorazi klientëve nga furnizuesit, pjesëmarrësit e tregut të angazhuar në agregim ose operatorët e sistemit.

130. "Transit i deklaruar" është sasia e energjisë elektrike që vjen nga një vend tjetër, e cila nuk konsumohet në vend, por kalon në një vend të tretë.

131. "Tregtar" është çdo person juridik, i cili kryen veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

132. "Tregtimi i energjisë elektrike" është procesi që kryhet nga një person juridik që blen energji elektrike, me qëllim rishitjen e saj brenda ose jashtë sistemit të vendit ku kryen veprimtarinë.

133. "Tregjet e energjisë elektrike" janë tregjet për energjinë elektrike, duke përfshirë tregun e lirë, tregun e organizuar të energjisë elektrike dhe tregun e derivativëve të energjisë elektrike, tregjet për tregtimin e energjisë, kapaciteteve, balancimit dhe shërbimeve ndihmëse në të gjitha afatet kohore, duke përfshirë kontratat në avancë të shitjes, të ditës në avancë dhe të së njëjtës ditë.

134. "Treg i balancimit" është menaxhimi i bazuar në treg i funksioneve të balancimit të sistemit të energjisë elektrike, i operuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit.

135. "Treg i derivativëve të energjisë elektrike" është tregu i energjisë elektrike ku produktet derivative si kontratat e ardhshme dhe kontratat e opsioneve të energjisë elektrike tregtohen nga pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike si mjete për të fiksuar çmimet e ardhshme, por nuk çojnë në dërgimin fizik të energjisë elektrike.

136. "Treg i ditës në avancë" është tregu i energjisë elektrike, ku paraqitja e porosive për shitje dhe blerje bëhet një ditë para dërgimit, në intervalin

kohor nga koha e hapjes së portës deri në kohën e mbylljes së portës.

137. "Treg i organizuar i energjisë elektrike" është platforma e organizuar për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike në bazë të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë.

138. "Treg brenda së njëjtës ditë" është tregu i energjisë elektrike ku kryhen transaksione për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike me detyrimin e dërgimit fizik, pas mbarimit të afatit kohor për paraqitjen e porosive për transaksion në tregun e ditës në avancë dhe lidhen me ditën e dorëzimit.

139. "Vlerë e ngarkesës së humbur" është një vlerësim në euro/MWh, i çmimit maksimal të energjisë elektrike që klientët janë të gatshëm të paguajnë për të shmangur një ndërprerje.

140. "Zonë ofertash" është zona më e madhe gjeografike brenda së cilës pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike janë në gjendje të shkëmbejnë energji pa alokim kapacitetesh.

141. "Zonë e çmimit të disbalancës" është zona në të cilën llogaritet një çmim disbalance.

142. "Zonë e kontrollit" është një pjesë koherente e sistemit të ndërlidhur, e operuar nga një operator i vetëm sistemi dhe përfshin ngarkesa fizike të lidhura dhe/ose njësi prodhimi, nëse ka.

143. "Zyrtar i pajtueshmërisë" është një person fizik ose juridik, i pavarur, i përcaktuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i ngarkuar me monitorimin dhe raportimin për zbatimin e programit të pajtueshmërisë.

144. "Agregues i pavarur" është pjesëmarrësi në tregun e energjisë elektrike, që ushtron aktivitet agregimi dhe nuk është i lidhur drejtpërdrejt ose tërthorazi me furnizuesin e klientit.

145. "Krizë e energjisë elektrike" nënkupton një situatë ekzistuese ose të afërt në të cilën ka mungesë të konsiderueshme të energjisë elektrike, siç përcaktohet nga shtetet anëtare dhe përshkruhet në planet e tyre të gatishmërisë ndaj rrezikut, ose në të cilën është e pamundur të furnizohen klientët me energji elektrike.

PJESA E DYTË
POLITIKAT E SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 4
Politikat e sektorit të energjisë elektrike

1. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për politikat e përgjithshme të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike të Shqipërisë, në përputhje me politikat e zhvillimit ekonomik dhe sektorët e tjerë të vendit.

2. Ministria:

a) harton Strategjinë Kombëtare të Energjisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe përditësohet të paktën çdo pesë vjet. Strategjia Kombëtare e Energjisë përcakton objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë, si dhe mënyrën e arritjes së tyre, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë kombëtare për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë;

b) harton programet afatmesme për zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë;

c) vlerëson nevojën e ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese dhe hapësirave të depozitimit të energjisë, si dhe fuqizimin e rrjeteve në përputhje me programet afatmesme, duke marrë në konsideratë:

i. bilancet e përgjithshme të pritshme të energjisë elektrike;

ii. sigurinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike;

iii. koston, duke përfshirë çdo mekanizëm të minimizimit të saj, për këto kapacitete të reja prodhuese;

ç) mbikëqyr zbatimin e politikave dhe programeve të zhvillimit të sektorit energjetik në përputhje me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit;

d) stimulon pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike, në mënyrë që të promovohet eficienca e energjisë dhe të fuqizohen klientët fundorë për të optimizuar përdorimin e energjisë elektrike.

3. Ministria brenda kuadrit të përgjegjësisë së saj, të parashikuar në shkronjën "c" të pikës 2 të këtij neni, monitoron mjaftueshmërinë e burimeve në Shqipëri, siç vlerësohet nga ENTSO-E. Me qëllim plotësimin e vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve të kryer nga ENTSO-E, ministria mund

t'i kërkojë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të kryejë një vlerësim kombëtar të mjaftueshmërisë së burimeve, i cili duhet të bazohet në metodologjitë panevropiane për vlerësimin e mjaftueshmërisë së burimeve dhe llogaritjen e kapacitetit maksimal hyrës. Vlerësimi kombëtar i mjaftueshmërisë së burimeve i paraqitet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë nëse identifikon shqetësime që nuk janë identifikuar nga vlerësimi evropian i mjaftueshmërisë së burimeve dhe mendimi i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë merret në konsideratë.

4. Kur vlerësimi i ministrisë sipas pikës 3 të këtij neni identifikon një problem lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve, ministria identifikon çdo deformim të kuadrit rregullator ose dështim të tregut që ka shkaktuar ose kontribuuar në shfaqjen e problemit. Bazuar në gjetjet e identifikuara, ministria harton dhe publikon një plan zbatimi me afat kohor për miratimin e masave për të eliminuar çdo deformim të identifikuar të kuadrit rregullator ose mosrealizim tregu dhe e paraqet atë tek Autoriteti përgjegjës i Ndihmës Shtetërore kur njofton një mekanizëm kapaciteti, si dhe te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për shqyrtim. Bazuar në konsultimet e përfunduara, ministria finalizon planin e zbatimit dhe e publikon në faqen e saj zyrtare.

5. Brenda katër muajve nga marrja e planit të zbatimit, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë jep një opinion mbi të nëse masat janë të mjaftueshme për të eliminuar deformimet e kuadrit rregullator ose dështimet e tregut që janë identifikuar dhe fton ministrinë që ta ndryshojë planin e saj të zbatimit në përputhje me rrethanat.

6. Kur trajton problemet lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve, ministria merr në konsideratë:

a) heqjen e deformimeve të kuadrit rregullator;

b) heqjen e kufijve të çmimeve në përputhje me kufijtë teknikë të ofertimit;

c) futjen e një funksioni të çmimit të mungesës për energjinë e balancimit;

ç) rritjen e kapacitetit të interkoneksionit dhe të rrjetit të brendshëm me synim arritjen të paktën të objektivave të interkoneksionit;

d) mundësimin e vetëprodhimit, ruajtjes së energjisë, masave në anën e kërkesës dhe eficiencës së energjisë duke miratuar masa për të eliminuar çdo deformim të kuadrit rregullator të identifikuar;

dh) sigurimin e prokurimit me kosto efikase dhe të bazuar në treg të shërbimeve të balancimit dhe shërbimeve ndihmëse;

e) heqjen e çmimeve të rregulluara kur kërkohet.

7. Për qëllime të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve evropiane dhe kombëtare, Operatori i Sistemit të Transmetimit do t'i sigurojë ENTSO-E të dhënat që kërkon për të kryer vlerësimet e mjaftueshmërisë së burimeve evropiane, dhe ministrisë të dhënat që kërkon për të kryer vlerësimet e mjaftueshmërisë së burimeve kombëtare. Për qëllimin e mësipërm, të licencuarit i ofrojnë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhëna në lidhje me shfrytëzimin e pritshëm të burimeve gjeneruese, duke marrë në konsideratë disponueshmërinë e burimeve parësore dhe skenarët e projektuar të kërkesës dhe ofertës.

8. Ministria monitoron aplikimin e planit të zbatimit të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni dhe publikon rezultatet e monitorimit në një raport vjetor, i cili i dërgohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

9. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat e detajuara të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve kombëtare të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni.

10. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë jep një opinion nëse planet e zbatimit janë zbatuar në mënyrë të mjaftueshme dhe nëse shqetësimi për mjaftueshmërinë e burimeve është zgjidhur.

11. Ministria vazhdon t'i përmbahet planit të zbatimit edhe pasi shqetësimi i identifikuar për mjaftueshmërinë e burimeve të jetë zgjidhur.

12. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për energjinë, dhe në konsultim me ministrinë përgjegjëse për mjedisin dhe autoritetet përgjegjëse për planifikimin urban, miraton rregullat për ndërtimin e infrastrukturës transevropiane të energjisë. Këto rregulla duhet të transpozojnë dhe zbatojnë dispozitat e Rregullores së BE-së për udhëzimet për infrastrukturën transevropiane të energjisë (TEN-E) dhe në veçanti të adresojnë identifikimin dhe lehtësimin e Projekteve me Interes të Përbashkët dhe të Ndërsjellë (PCI dhe PMI), procedurat e thjeshtuara dhe të reduktuara në kohë të lejeve me një autoritet kompetent të caktuar, forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar dhe kornizat rregullatore dhe financiare që mbështesin investimet në infrastrukturën strategjike të energjisë. Këto rregulla duhet të

sigurojnë transparencë, pjesëmarrjen publike, mbrojtjen e mjedisit dhe përputhshmërinë me objektivat e integrimit të tregut, sigurinë e furnizimit dhe neutralitetin klimatik.

Neni 5
Të dhëna dhe informacione për bilancin e energjisë elektrike

1. Çdo person fizik ose juridik që prodhon, depoziton, transmeton, shpërndan, importon, eksporton, furnizon energji elektrike ose ushtron operimin e agregimit ose të pikës së rikarikimit është i detyruar të paraqesë pranë ministrisë të dhëna për veprimtarinë e tij, me qëllim hartimin e politikave të zhvillimit të sektorit energjetik dhe komunikimin me institucionet e specializuara në kuadrin e angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë, si dhe përgatitjen dhe publikimin e bilancit vjetor energjetik.

2. Ministri miraton mënyrën dhe formatin e raportimit të të dhënave.

3. Ky nen nuk kufizon të drejtat e ERE-s dhe të institucioneve të tjera përgjegjëse për statistikat, për akses ndaj të dhënave, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për statistikat.

PJESA E TRETË
SIGURIA E FURNIZIMIT

Neni 6
Gatishmëria ndaj riskut

1. Ministria vepron si autoriteti kompetent lidhur me planifikimin e gatishmërisë ndaj riskut dhe menaxhimit të tij.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, në bashkëpunim me institucionet apo shoqëritë e tjera përkatëse në sektorin e energjisë elektrike, miraton rregullat për identifikimin e skenarëve kombëtarë të krizës së energjisë elektrike dhe procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe miratimit të planeve të vlerësimit të riskut.

3. Ministria sigurohet që të gjitha risqet përkatëse që lidhen me sigurinë e furnizimit me energji elektrike të vlerësohen në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave sipas këtij neni. Për këtë qëllim ajo bashkëpuno me Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, ENTSO-E, qendrat rajonale të koordinimit (RCC), ERE-n dhe aktorë të tjerë përkatës sipas nevojës.

4. Ministria, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave sipas këtij neni, merr pjesë në mënyrë të rregullt në identifikimin dhe përditësimin e skenarëve kombëtarë të krizës së energjisë elektrike.

5. Mbi bazën e skenarëve rajonalë dhe kombëtarë të krizës së energjisë elektrike të identifikuara dhe në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave sipas këtij neni, ministria harton një plan të gatishmërisë ndaj riskut pasi të konsultohet me ERE-n, Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, prodhuesit, si dhe shoqëritë e tjera të energjisë elektrike dhe gazit natyror, që konsiderohen të domosdoshëm nga ministria dhe organizatat përkatëse që përfaqësojnë interesat e klientëve fundorë industrialë dhe joindustrialë.

6. Plani i gatishmërisë ndaj riskut përbëhet nga masa kombëtare, rajonale dhe, sipas rastit, masa dypalëshe. Të gjitha masat që planifikohen ose ndërmerren për parandalimin, përgatitjen dhe zbutjen e krizave të energjisë elektrike duhet të jenë plotësisht në përputhje me dispozitat e këtij ligji, kodeve të rrjetit dhe akteve të tjera nënligjore të sektorit të energjisë elektrike. Këto masa duhet të jenë të përcaktuara qartë, transparente, proporcionale dhe jodiskriminuese.

7. Për të siguruar qëndrueshmërinë e planeve të gatishmërisë ndaj riskut, ministria, përpara miratimit të planeve të saj të gatishmërisë ndaj riskut, duhet t'ua paraqesë planet e hartuara për konsultim autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese përkatëse në rajon dhe, kur ato nuk janë në të njëjtin rajon, autoriteteve kompetente të palëve kontraktuese të lidhura drejtpërdrejt, si dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Brenda gjashtë muajve nga marrja e planeve të hartuara të gatishmërisë ndaj riskut, autoritetet kompetente të përmendura në këtë pikë dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mund të lëshojnë rekomandime në lidhje me planet e paraqitura.

8. Brenda nëntë muajve nga paraqitja e planeve, ministria miraton planet e gatishmërisë ndaj riskut, duke marrë në konsideratë rezultatet e konsultimit dhe çdo rekomandim të lëshuar në përputhje me pikën 7 të këtij neni. Ministria i njofton pa vonesë planet e gatishmërisë ndaj riskut Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

9. Plani i përgatitjes për riskun përcakton të gjitha masat kombëtare që janë planifikuar ose ndërmarrë për të parandaluar, përgatitur dhe zbutur ndikimin e energjisë elektrike rajonale ose kombëtare, duke përfshirë:

a) një përmbledhje të skenarëve të krizës së energjisë elektrike të përcaktuar për Shqipërinë dhe rajonin në përputhje me procedurat e përcaktuara në identifikimin e skenarëve rajonalë dhe kombëtarë të krizës së energjisë elektrike;

b) përcaktimin e rolit dhe përgjegjësisë së ministrisë dhe përshkrimin se cilat detyra, nëse ka, u janë deleguar organeve të tjera;

c) përshkrimin e masave kombëtare të hartuara për të parandaluar ose përgatitur risqet e identifikuara;

ç) caktimin e një koordinatori kombëtar për kriza dhe përcaktimin e detyrave të tij;

d) përcaktimin e procedurave të hollësishme që duhen ndjekur në krizat e energjisë elektrike, duke përfshirë skemat përkatëse mbi rrjedhat e informacionit;

dh)identifikimin e masave të mundshme të bazuara në treg në përballimin e krizave të energjisë elektrike, në veçanti masat nga ana e kërkesës dhe nga ana e ofertës;

e) identifikimin e masave të mundshme jo të bazuara në treg që duhen zbatuar në krizat e energjisë elektrike, duke specifikuar shkaktarët, kushtet dhe procedurat për zbatimin e tyre, dhe duke treguar se si ato përputhen me rregullat e tregut dhe me masat rajonale e dypalëshe;

ë) ofrimin e një kornize për ndërprerjen manuale të ngarkesës, duke përcaktuar rrethanat në të cilat do të ndërpriten ngarkesat dhe në lidhje me sigurinë publike dhe personale, duke specifikuar se cilat kategori të përdoruesve të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin kombëtar, kanë të drejtë të marrin mbrojtje të veçantë kundër shkyçjes, duke justifikuar nevojën për një mbrojtje të tillë dhe duke specifikuar se si Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të ulin konsumin;

f) përshkrimin e mekanizmave të përdorur për të informuar publikun rreth krizave të energjisë elektrike;

g) përshkrimin e masave kombëtare të nevojshme për të zbatuar, masat rajonale dhe, kur është e aplikueshme, masat dypalëshe të dakordësuara;

gj) informacionin për planet përkatëse dhe të nevojshme për zhvillimin e rrjetit të ardhshëm, që do të ndihmojnë në përballimin e pasojave të skenarëve të identifikuar të krizës së energjisë elektrike.

10. Masat kombëtare duhet të marrin plotësisht në konsideratë masat rajonale dhe, kur është e aplikueshme, masat dypalëshe të dakordësuara dhe nuk duhet të rrezikojnë sigurinë operative ose mbrojtjen e sistemit të transmetimit dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike të palëve të tjera kontraktuese.

11. Ministria publikon planin e gatishmërisë ndaj riskut në faqen e saj zyrtare të internetit, duke siguruar njëkohësisht ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit të ndjeshëm, në veçanti informacionin që lidhet me masat për parandalimin ose zbutjen e pasojave të sulmeve keqdashëse.

12. Ministria miraton dhe publikon planin e saj të parë të gatishmërisë ndaj riskut deri më 31 dhjetor 2027. Më pas ministria përditëson planin e gatishmërisë ndaj riskut çdo katër vjet, përveç rasteve kur rrethanat kërkojnë përditësime më të shpeshta.

13. Me kërkesë të ministrisë, të licencuarit i ofrojnë asaj të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm për të kryer detyrat e saj të përcaktuara në këtë nen.

Neni 7

Siguria e rrjetit dhe cilësia e furnizimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes hartojnë rregulla specifike që përcaktojnë kërkesat minimale për sigurinë dhe operimin e rrjetit, përfshirë kushtet për cilësinë e furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit. Gjatë hartimit të tyre operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes konsultohen me grupet e interesit, vendase dhe të huaja. Rregullat e cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit miratohen dhe monitorohen nga ERE-ja.

2. ERE-ja mbikëqyr mbajtjen e një niveli të përshtatshëm të kapacitetit rezervë teknik të transmetimit prej Operatorit të Sistemit të Transmetimit, i cili bashkëpunon edhe me operatorët e transmetimit të vendeve fqinje që është i ndërlidhur, me qëllim garantimin e sigurisë së rrjetit.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes shkëmbejnë informacion për funksionimin e rrjetit në mënyrë efektive, në kohën e duhur dhe në përputhje me kërkesat operative të përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe me operatorët e huaj të sistemeve të ndërlidhura të transmetimit.

Neni 8
Balanca midis kërkesës dhe prodhimit

1. Me qëllim ruajtjen e balancës midis kërkesës për energji elektrike dhe sasisë së disponueshme të energjisë, merren masat si më poshtë:

a) ERE-ja përcakton rregulla që mundësojnë dhe nxitin funksionimin e një tregu të hapur, konkurrues dhe jodiskriminues për prodhimin, shitjen me shumicë dhe furnizimin e energjisë elektrike.

b) Operatori i Sistemit të Transmetimit siguron një kapacitet rezervë.

2. Me qëllim ruajtjen e balancës ndërmjet kërkesës për energji elektrike dhe kapacitetit të disponueshëm prodhues, Këshilli i Ministrave me vendim merr masa të tjera shtesë, përfshirë, por pa u kufizuar në masat e mëposhtme:

a) përfshirjen e dispozitave në aktet përkatëse nënligjore, që ndihmojnë në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese dhe kapaciteteve depozituese të energjisë dhe futjen e shoqërive të reja prodhuese dhe depozituese në treg;

b) eliminimin e pengesave që ndalojnë përdorimin e kontratave të furnizimit me ndërprerje, sipas praktikave më të mira evropiane;

c) eliminimin e pengesave që ndalojnë përfundimin dhe lidhjen e kontratave me afate të ndryshueshme si për prodhuesit, ashtu edhe për klientët;

ç) nxitjen e përdorimit të teknologjive të përgjigjes në kohë reale të kërkesës nëpërmjet sistemeve të avancuara të matjes, sipas kërkesës së konsumatorëve;

d) nxitjen e përdorimit të kapaciteteve të depozitimit të energjisë pas pikës së matjes;

dh) nxitjen e masave të përdorimit eficient të energjisë elektrike;

e) zbatimin e procedurave konkurruese, transparente dhe jodiskriminuese për investimet e reja në kapacitetet prodhuese dhe të depozitimit të energjisë, sipas parashikimeve të nenit 53 të këtij ligji.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit përgatit një parashikim të përgjithshëm afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të kërkesës për energji elektrike dhe burimeve të mundshme të furnizimit, duke marrë parasysh kriteret dhe kërkesat e sigurisë së furnizimit.

PJESA E KATËRT
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
(ERE)

KREU I
ORGANIZIMI

Neni 9
Organizimi i ERE-s

1. ERE-ja është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit në Shqipëri që drejtohet nga bordi. Bordi përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë.

2. Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e ERE-s hartohet e miratohet nga bordi dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit.

Neni 10
Pavarësia e ERE-s

1. ERE-ja është një person juridik publik, i pavarur nga çdo institucion tjetër publik ose privat. Bordi dhe personeli teknik i ERE-s:

a) i ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme dhe transparente;

b) veprojnë në mënyrë të pavarur nga interesat e tregut, nga çdo institucion apo subjekt publik ose privat.

c) marrin vendime autonome, në mënyrë të pavarur nga çdo organ politik.

2. ERE-ja bashkëpunon me ministrinë dhe me institucionet e tjera publike për sa u takon çështjeve objekt të këtij ligji që janë në fushën e përgjegjësisë së tyre.

Neni 11
Përzgjedhja dhe emërimi i kryetarit dhe anëtarëve të bordit

1. Kryetari dhe anëtarët e bordit zgjidhen nga Kuvendi i Shqipërisë, me propozim të ekipit

përzgjedhës, në përputhje me pikat 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni.

2. Kryetari dhe anëtarët e bordit zgjidhen për një mandat prej 5 vjetësh, i cili mund të rinovohet vetëm një herë. Kur një anëtar i Bordit zgjidhet për të plotësuar një vend vakant që krijohet përpara përfundimit të mandatit për të cilin ishte zgjedhur paraardhësi, ai anëtar i Bordit zgjidhet vetëm për pjesën e mbetur të mandatit të paraardhësit.

3. Komisioni Përzgjedhës i Bordit përbëhet nga tri anëtarë: dy përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë, përkatësisht kryetari i komisionit përgjegjës për energjinë dhe kryetari i komisionit përgjegjës për ekonominë dhe ministri përgjegjës për energjinë. Komisioni Përzgjedhës i Bordit është përgjegjës për zhvillimin e procesit të vlerësimit.

4. Jo më vonë se tre muaj përpara mbarimit të mandatit të kryetarit apo njërit prej anëtarëve të bordit, Kuvendi publikon njoftimin për vendin vakant. Njoftimi duhet të përcaktojë qartë kriteret e pranimit, përzgjedhjes, procedurat dhe afatet e aplikimit, duke siguruar transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët e kualifikuar. Komisioni Përzgjedhës i Bordit përzgjedh paraprakisht dy kandidatë bazuar në kritere objektive, transparente dhe të publikuara, përmes një procedure të pavarur dhe të paanshme, e cila siguron që kandidatët të kenë aftësitë dhe përvojën e nevojshme sipas kërkesave të pikës 5 të këtij neni dhe ia propozon Kuvendit të Shqipërisë.

5. Kryetari dhe anëtarët e bordit janë persona që duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) kryetari është një person i shquar në fushën e energjisë. Ai/ajo duhet të ketë të paktën 15 vjet eksperiencë pune në sektorin e energjisë;

b) një nga anëtarët duhet të ketë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune në sektorin e energjisë elektrike dhe të jetë me profesion inxhinier elektrik;

c) një nga anëtarët duhet të ketë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune në sektorin e hidrokarbureve dhe të jetë me profesion inxhinier në sektorin e naftës dhe/ose gazit;

ç) dy anëtarët e tjerë, përkatësisht njëri me profesion jurist dhe tjetri ekonomist, duhet të kenë jo më pak se 10 vjet eksperiencë pune, prej të cilave të paktën 5 vjet duhet të jetë eksperiencë në sektorin energjetik.

6. Kur vendi i kryetarit të bordit mbetet vakant, anëtari i bordit me kohën më të gjatë në detyrë kryen funksionet e kryetarit deri në zgjedhjen e kryetarit të ri. Vjetërsia llogaritet nga data kur është zgjedhur si anëtar bordi.

7. Kur mandati i kryetarit apo një anëtari bordi ka përfunduar dhe zgjedhja e një anëtari të ri të Bordit është vonuar, mandati ekzistues i kryetarit ose i një anëtari të Bordit zgjatet automatikisht deri në momentin kur një kryetar ose anëtar i ri i Bordit zgjidhet nga Kuvendi i Shqipërisë për ta zëvendësuar atë.

8. Përpara zgjedhjes, çdo anëtar i Bordit jep dorëheqjen nga çdo pozicion punësimi, konsulence ose angazhim tjetër profesional dhe heqë dorë nga çdo interes i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në çdo shoqëri të angazhuar në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen, furnizimin me energji elektrike, ose që bien nën përgjegjësitë e ERE-s, duke përfshirë prodhimin, furnizimin, ose dhënien me qira të pajisjeve për sektorin e energjisë elektrike ose gazit, ose ofrimin e shërbimeve të konsulencës për shoqëri të tilla.

9. Bordi përcakton strukturën organizative të ERE-s dhe numrin e punonjësve, pagën e tyre dhe trajtimin financiar të kryetarit dhe anëtarëve të bordit, si dhe personelit teknik. Në përcaktimin e pagave dhe trajtimit financiar apo jofinanciar të personelit teknik, bordi merr në konsideratë kushtet e tregut dhe nivelin e pagave të shoqërive që kontrollohen nga sektori që mbulon.

Neni 12

Shkarkimi dhe lirimi nga detyra i kryetarit dhe anëtarëve të bordit

1. Kryetari dhe anëtarët e bordit shkarkohen nga Kuvendi vetëm në rast se:

a) veprojnë në kundërshtim me parimin e pavarësisë bazuar në kriteret transparente në fuqi ose janë në konflikt interesi;

b) dënohen për kryerjen e një vepre penale me vendim gjyqësor të formës së prerë.

c) japin dorëheqjen;

ç) kandidojnë për t'u zgjedhur anëtarë të Kuvendit;

d) kandidojnë për t'u zgjedhur në organet e një njësie vendore;

dh) bëhen të paaftë për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e ERE-s për një periudhë mbi 6 muaj;

e) mungojnë në detyrë pa shkak për një periudhë mbi një muaj;

ë) marrin përsipër çdo funksion në qeverisjen qendrore ose vendore ose në çdo institucion tjetër qeveritar përveç ERE-s.

2. Kuvendi fillon zyrtarisht procedurën nëpërmjet një vendimi të arsyetuar që specifikon bazën ligjore, rrethanat faktike dhe dokumentacionin mbështetës. Anëtari përkatës i Bordit njoftohet me shkrim brenda 10 ditëve.

3. Përpara shkarkimit të tyre, kryetari i ERE-s dhe anëtarët e bordit kanë të drejtë të paraqesin arsyet dhe provat në mbrojtje të tyre para komisioneve parlamentare brenda një afati të arsyeshëm kohor. Nëse është e nevojshme, një seancë dëgjimore mund të organizohet për të siguruar barazi dhe procedurë të drejtë.

4. Vendimi për shkarkimin ose lirimin e kryetarit ose të ndonjë anëtari të bordit duhet të bazohet në ligj dhe të jetë i arsyetuar për shkaqet që çojnë në shkarkimin e tij.

5. Kryetari dhe anëtarët e bordit, të cilët shkarkohen sipas përcaktimeve të pikës 1, shkronjat "a" dhe "b", të këtij neni, nuk kanë të drejtë të rizgjidhen në bordin e ERE-s.

6. Shkarkimi i kryetarit dhe anëtarëve të bordit, sipas pikës 1 të këtij neni, i nënshtrohet miratimit të Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës.

Neni 13
Kryetari i bordit

1. Kryetari i bordit është administratori i përgjithshëm i ERE-s. Ai është përgjegjës për administrimin e institucionit dhe drejtimin e mbledhjeve të bordit.

2. Në rastet kur kryetari i bordit mungon në detyrë, ai autorizon një nga anëtarët e bordit të ushtrojë funksionin e kryetarit gjatë kësaj periudhe.

Neni 14
Personeli teknik dhe këshilltarët

1. Personeli teknik ndihmon bordin në kryerjen e detyrave të tij. Personeli përzgjidhet, emërohet, ngrihet në detyrë dhe largohet nga detyra sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e miratuar nga bordi.

2. Përveç personelit teknik të përhershëm, bordi, kur e sheh të arsyeshme, ndihmohet nga këshilltarë apo ekspertë në përmbushjen e funksioneve të tij.

3. Kostot për këshilltarët apo ekspertët, sipas pikës 2 të këtij neni, mbulohen nga buxheti i ERE-s.

Neni 15
Konflikti i interesit

1. Kryetari, anëtarët e bordit, këshilltarët ose personeli teknik i ERE-s nuk mund:

a) të jenë pronarë, aksionarë ose zotërues të pasurisë ose të një pjese të saj të një të licencuari që mban një licencë sipas kushteve të këtij ligji;

b) të jenë të punësuar ose nënkontraktorë të një të licencuari, që mban një licencë sipas kushteve të këtij ligji;

c) të jenë anëtarë të këshillit mbikëqyrës apo organeve të tjera drejtuese të një të licencuari që mban një licencë sipas kushteve të këtij ligji;

ç) të jenë drejtues, administratorë ose në një pozicion tjetër drejtues te një i licencuar që ka një licencë sipas kushteve të këtij ligji ose çdo shoqërie tjetër, subjekt i kompetencave të ERE-s.

2. Nëse gjatë procedurave aplikuese për dhënien e një licence sipas këtij ligji ose gjatë një procedure në të cilën përfshihen interesa financiarë të një të licencuari, përfshirë, por pa u kufizuar vetëm në çështje të tarifave, kryetari, anëtari i bordit, këshilltari dhe/ose personeli teknik gjendet në një situatë konflikti interesi, përveç atyre të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, por që përfshihet në përcaktimet e legjislacionit përkatës për parandalimin e konfliktit të interesave, ai nuk merr pjesë në vendimmarrjen përkatëse.

3. Kryetari i bordit, anëtari, këshilltari dhe/ose personeli teknik mund të jetë klient i një të licencuari, por në asnjë rast i licencuari nuk i ofron anëtarit të bordit apo personelit teknik një shërbim favorizues, të ndryshëm nga shërbimi i përgjithshëm i ofruar për publikun.

4. Kryetari i bordit, anëtari dhe/ose personeli teknik i ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesit.

5. Pas përfundimit të mandatit të tyre, kryetari dhe anëtarët e bordit u nënshtrohen kufizimeve të mëposhtme:

a) për një periudhë deri në 2 vjet pas përfundimit të mandatit të tyre ata nuk do të punësohen në pozicione drejtuese, ekzekutive ose mbikëqyrëse në institucione publike ose private, përfshirë subjektet në varësi të tyre, të cilat kanë pasur marrëdhënie me

institucionin ku kanë ushtruar funksionet e tyre dhe gjatë 2 vjetëve të fundit të mandatit të tyre kanë pasur përgjegjësi të drejtpërdrejta për mbikëqyrjen ose auditimin e tyre;

b) për një periudhë deri në 1 vit pas përfundimit të mandatit të tyre, ata nuk duhet të hyjnë në marrëdhënie kontraktuale shërbimesh me institucionin ku ushtruan funksionet e tyre, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi, duke përfshirë edhe nëpërmjet personave të lidhur ose ndërmjetësve të besuar.

c) për një periudhë deri në 1 vit pas përfundimit të mandatit të tyre, ata nuk do të përfaqësojnë asnjë palë në çështjet që lidhen me institucionin ku ushtrojnë funksionet e tyre, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi, duke përfshirë edhe nëpërmjet personave të lidhur ose ndërmjetësve të besuar.

Neni 16
Mbledhjet dhe vendimet e bordit

1. Mbledhjet vendimmarrëse dhe seancat dëgjimore të bordit janë të hapura. Në raste të veçanta, që kanë të bëjnë me trajtimin e çështjeve me karakter të brendshëm, bordi mund të zhvillojë mbledhje me dyer të mbyllura në përputhje me përcaktimet e rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s.

2. Mbledhjet e bordit zhvillohen me pjesëmarrjen e jo më pak se tre anëtarëve dhe vendimet merren me shumicën e të gjithë anëtarëve të bordit.

3. Të gjitha vendimet e bordit shoqërohen me relacion argumentues.

4. Të gjitha vendimet e bordit, përveç atyre me karakter të brendshëm organizativ të ERE-s, botohen në Fletoren Zyrtare. ERE-ja publikon në faqen zyrtare të internetit vendimet e marra dhe njoftimin për shtyp për çdo vendim.

5. Vendimet e ERE-s hyjnë në fuqi në datën e specifikuar në to. Kur nuk parashikohet një datë specifike, ato hyjnë në fuqi në ditën e publikimit të tyre, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi sipas Kodit të Procedurave Administrative.

6. Çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t'i kërkojë ERE-s brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara.

7. Vendimet e bordit të ERE-s ankimohen në Gjykatën Administrative, Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga data e publikimit të vendimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 17
Financimi i ERE-s

1. Buxheti i ERE-s miratohet nga bordi. ERE-ja ka autonomi në përdorimin e buxhetit të tij.

2. Burimet financiare të ERE-s përbëhen nga tarifat rregullatore, tarifat e licencës dhe tarifa të tjera, në përputhje me dispozitat për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe me ligjet e sektorit të gazit natyror, siç miratohen nga ERE-ja.

3. ERE-ja mban llogari të plota për shpenzimet e kryera, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin.

4. ERE-ja përcakton dhe miraton pagesën rregullatore që paguhet prej të licencuarve, në përputhje me rregulloren përkatëse.

5. ERE-ja njofton të licencuarin për vlerën dhe afatet e pagesës rregullatore. Nëse i licencuari nuk e bën pagesën brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, ERE-ja ka të drejtë të aplikojë masat administrative në përputhje me nenin 133 të këtij ligji.

6. Pagesat rregullatore depozitohen në një llogari të veçantë në një nga bankat që operojnë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Çdo fond në llogarinë e ERE-s, që nuk shpenzohet gjatë një viti, transferohet për vitin pasardhës, duke reduktuar proporcionalisht pagesat rregullatore për vitin pasardhës.

7. ERE-ja zgjedh një ekspert nga regjistri publik i ekspertëve kontabël të miratuar për të kryer auditimin e veprimtarisë së saj financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU II
OBJEKTIVAT, PËRGJEGJËSITË DHE TË DREJTAT E ERE-S

Neni 18
Objektivat e përgjithshëm të ERE-s

1. Objektivat e ERE-s gjatë kryerjes së funksioneve të saj rregullatore të përcaktuara në këtë ligj janë si më poshtë:

a) promovimi i funksionimit të një tregu të brendshëm konkurrues, fleksibël, të sigurt dhe të qëndrueshëm nga ana mjedisore të energjisë elektrike, si dhe hapja efektive e tregut për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e përshtatshme për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë objektivat afatgjatë në bashkëpunim të ngushtë me palët e Komunitetit të Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera;

b) vendosja e kushteve lehtësuese për akses në rrjet për kapacitete të reja gjeneruese, objekteve të depozitimit të energjisë dhe pikave të rikarikimit, si dhe heqja e barrierave që mund të pengojnë aksesin e pjesëmarrësve të rinj në treg dhe të atyre që gjenerojnë energji elektrike nga burime të rinovueshme, agreguesve dhe operatorëve të angazhuar në përgjigjen ndaj kërkesës

c) angazhimi për zhvillimin dhe funksionimin e një tregu rajonal konkurrues në Komunitetin e Energjisë, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuar në shkronjën "a" të këtij neni;

ç) eliminimi i kufizimeve në tregtimin e energjisë elektrike me palët e Komunitetit, duke përfshirë zhvillimin e kapaciteteve të transmetimit ndërkufitar për të përmbushur kërkesën dhe rritjen e integrimit të tregjeve kombëtare, të cilat mund të lehtësojnë rrjedhjen e flukseve të energjisë elektrike në të gjithë Komunitetin e Energjisë;

d) angazhimi për të zhvilluar në mënyrën më efektive nga ana e kostos një sistem të besueshëm, të sigurt, të qëndrueshëm dhe jodiskriminues, të orientuar drejt klientit dhe në përputhje me objektivat e zhvillimit të sistemit të energjisë për të promovuar mjaftueshmërinë e sistemit dhe efikasitetin e energjisë elektrike, si dhe integrimin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme dhe gjenerimin e shpërndarë si në rrjetet e transmetimit, ashtu edhe në ato të shpërndarjes, duke lehtësuar njëkohësisht funksionimin e tyre në lidhje me rrjetet e tjera të energjisë së gazit ose nxehtësisë;

dh) sigurimi që klientët të përfitojnë nga funksionimi i tregut të brendshëm, duke nxitur konkurrencën dhe duke ndihmuar në sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së konsumatorit, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet përkatëse të mbrojtjes së konsumatorit;

e) garantimi i standardeve të larta për përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik në furnizimin me energji elektrike, mbrojtja e klientëve në nevojë dhe sigurimi i përputhshmërisë gjatë procesit të shkëmbimit të të dhënave në lidhje me ndërrimin e furnizuesit;

ë) sigurimi që operatorëve të sistemit dhe përdoruesve të sistemit t'u jepen stimuj të përshtatshëm si për periudhë afatshkurtër, ashtu edhe afatgjatë për të rritur efikasitetin, veçanërisht eficiencën e energjisë në performancën e sistemit dhe për të nxitur integrimin e tregut.

2. ERE-ja bashkëpunon me institucione të tjera qeveritare dhe të pavarura, si dhe me autoritete të tjera, përfshirë autoritetet rregullatore kombëtare të palëve të tjera të Komunitetit të Energjisë, për të përmbushur objektivat e saj të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 19
Përgjegjësitë e ERE-s

ERE-ja ka këto përgjegjësi në aktivitetin e saj:

a) miraton rregullat e tregut;

b) miraton dhe publikon, në përputhje me parimin e transparencës, metodologjitë për tarifat e transmetimit e të shpërndarjes, lidhjen dhe aksesin në rrjetet kombëtare, procedurat për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestionit, si dhe metodologji të tjera të zbatueshme;

c) siguron pajtueshmërinë e operatorëve të sistemit të transmetimit dhe operatorëve të sistemit të shpërndarjes dhe, kur është e nevojshme, të pronarëve të sistemit, si dhe pajtueshmërinë e çdo shoqërie që operojnë në tregun e energjisë elektrike dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut, me detyrimet e tyre sipas paketës së integrimit të energjisë elektrike, duke përfshirë çështjet ndërkufitare, si dhe me vendimet e ACER-së ose Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë;

ç) miraton në përputhje me parimet e tarifave të përcaktuara në nenin 21 të këtij ligji dhe publikon tarifat për:

i. lidhjet dhe aksesin në rrjetet kombëtare, duke përfshirë tarifat për transmetimin dhe shpërndarjen;

ii. aktivitete të licencuara për të cilat është vendosur një detyrim shërbimi publik në përputhje me nenin 108 të këtij ligji.

d) siguron aksesin në infrastrukturën ndërkufitare, duke përfshirë procedurat për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kapaciteteve të kufizuara;

dh) u imponon licencuesve detyrimin e shërbimit publik, duke përfshirë shërbimin universal të furnizimit, sipas neneve 49 dhe 108 të këtij ligji;

e) siguron ndarjen e detyrimeve për operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ë) bashkëpunon me autoritetet rregullatore të vendeve fqinje, me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë, Agjencinë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) dhe organe të tjera përkatëse evropiane, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë rregullatore dhe integrimin efektiv të tregut kombëtar të energjisë elektrike në tregjet rajonale dhe evropiane të energjisë elektrike. Në veçanti kontribuon në zhvillimin dhe zbatimin e rregullave, kodeve të rrjetit dhe udhëzimeve të harmonizuara, lehtëson shkëmbimet ndërkufitare jodiskriminuese të energjisë elektrike, siguron ndarjen dhe menaxhimin transparent, objektiv dhe efikas të kapaciteteve të interkoneksionit, si dhe mbështet funksionimin e koordinuar të tregut rajonal dhe në të gjithë Bashkimin Evropian në përputhje me Paketën e Integrimit të Energjisë (EIP) dhe *acquis*-in përkatës të Bashkimit Evropian;

f) merr masa për të shmangur ndërsubvencionimin midis aktiviteteve të transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit ose aktiviteteve të tjera të energjisë elektrike ose joelektrike, si dhe midis kategorive të klientëve;

g) siguron në bashkëpunim me institucione të tjera zbatimin efektiv të masave mbrojtëse për klientët fundorë, duke përfshirë ato të parashikuara në nenet 109, 111 dhe 119 të këtij ligji;

gj) bashkëpunon me Autoritetin e Konkurrencës dhe autoritetin e mbikëqyrjes së tregut për të shqyrtuar sjelljet ose aktet e mundshme antikonkurruese të pjesëmarrësve në treg;

h) nëse i delegohet nga ministria në përputhje me nenin 28 të këtij ligji, siguron akses jodiskriminues në të dhënat e konsumit të klientëve, si dhe garanton për përdorim opsional një format të harmonizuar dhe të kuptueshëm në nivel kombëtar, duke mundësuar akses të shpejtë për të gjithë klientët në këto të dhëna;

i) miraton rregulla të hollësishme për cilësinë e shërbimit dhe furnizimit dhe sigurinë e performancës së rrjetit, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 7 të këtij ligji, monitoron pajtueshmërinë me këto rregulla dhe shqyrton performancën e mëparshme të cilësisë së furnizimit dhe performancën e rrjetit në lidhje me rregulla të tilla;

j) kontribuon në pajtueshmërinë e proceseve të shkëmbimit të të dhënave për procese të rëndësishme të tregut në nivel rajonal;

k) merr masa për të nxitur përgjigjen ndaj kërkesës, si dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimit në sektorin e energjisë elektrike;

l) publikon në faqen zyrtare të internetit të dhëna tremujore për funksionimin e tregut të energjisë elektrike;

ll) miraton, me propozimin e të licencuarit, rregullat për shitjen, blerjen dhe shkëmbimin e energjisë elektrike, të kryer nga prodhuesit dhe furnizuesit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik;

m) miraton dhe publikon rregullat për kërkesat e ndërveprimit;

n) siguron ofrimin e pikave të vetme të kontaktit për t'u ofruar klientëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me të drejtat e tyre, legjislacionin në fuqi dhe mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të disponueshme në rast të një konflikti;

nj) siguron që klientët fundorë të kenë akses në mekanizma jashtëgjyqësorë të thjeshtë, të drejtë, transparentë, të pavarur, efektivë dhe efikas për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidhen me të drejtat dhe detyrimet e tyre;

o) siguron përputhshmërinë e të licencuarve me detyrimet e tyre sipas këtij ligji, kodeve të rrjetit, duke përfshirë çështjet ndërkufitare, si dhe me vendimet e Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe vendimet përkatëse të ACER-it;

p) miraton produktet dhe proceset e prokurimit për shërbimet ndihmëse;

q) miraton dhe zbaton kodet e rrjetit dhe udhëzimet e miratuara në nivel të Komunitetit të

Energjisë nëpërmjet masave kombëtare ose, kur kërkohet, masave të koordinuara rajonale ose në të gjithë Komunitetin e Energjisë. Gjithashtu, njeh dhe miraton termat dhe kushtet ose metodologjitë përkatëse, të zhvilluara në përputhje me ato kode rrjeti, të propozuara nga OST-ja.

r) përmbush dhe zbaton çdo vendim përkatës ligjërisht të detyrueshëm të Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER), si dhe vendimet e Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë, të miratuara në përputhje me acquis të Komunitetit të Energjisë.

rr) miraton rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit dhe siguron që Operatori i Sistemit të Transmetimit të vërë në dispozicion kapacitetet e interkoneksionit në masën maksimale të parashikuar në nenin 74 të këtij ligji;

s) raporton çdo vit për aktivitetin e tij dhe përmbushjen e detyrave ndaj autoriteteve përkatëse kombëtare të palëve të Komunitetit të Energjisë, Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë, përfshirë hapat e ndërmarrë dhe rezultatet e arritura në lidhje me secilën nga detyrat e listuara në këtë nen;

sh) publikon rekomandime, të paktën çdo vit, në lidhje me përputhshmërinë e çmimeve të furnizimit me kërkesën për çmime furnizimi të bazuara në treg dhe ia paraqet këto rekomandime Autoritetit të Konkurrencës sipas nevojës;

t) operon një platformë publike për krahasimin e ofertave të furnizuesve, në përputhje me dispozitat e nenit 100 të këtij ligji;

th) bashkëpunon me ACER-in, ECRB-në dhe zbaton vendimet individuale të tyre, merr në konsideratë opinionet dhe rekomandimet, si dhe i ofron informacion sipas kërkesës;

u) bën përcaktimin dhe heqjen e NEMO-s nga ERE-ja në përputhje me procedurat e parashikuara në rregulloren CACM-së;

v) bashkëpunon me ECRB-në dhe ACER-in, si dhe autoritetet rregullatore kombëtare të rajonit në miratimin e kushteve, termave dhe metodologjive rajonale;

x) bashkëpunon për çështjet ndërkufitare me autoritetin rregullator ose autoritetet e shteteve anëtare përkatëse dhe palët e tjera kontraktore të Komunitetit të Energjisë, si dhe me ACER-in;

xh) miraton dhe ndryshon kushtet, termat dhe metodologjitë rajonale dhe kombëtare në përputhje me kodet e rrjetit dhe udhëzimet;

y) vlerëson kostot e OST-së që lindin nga detyrimet sipas kodeve të rrjetit dhe udhëzimeve përkatëse.

Neni 20
Të drejtat e ERE-s

ERE-ja ka të drejtat e mëposhtme:

a) merr vendime, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë të licencuarit që veprojnë në sektorin e energjisë elektrike;

b) përcakton rregullat dhe kërkesat për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike;

c) miraton tarifa të përkohshme transmetimi në rastet kur operatorët e transmetimit ose shpërndarjes krijojnë vonesa në ndryshimin e tarifave. Në këtë rast, kur tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE-ja vendos masat e përshtatshme kompensuese;

ç) monitoron dhe kontrollon funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe i detyron pjesëmarrësit e tregut të ndërmarrin masa të nevojshme për nxitjen e konkurrencës efektive dhe sigurinë e funksionimit të tregut;

d) kërkon informacion prej të licencuarve, pjesëmarrësve të tregut dhe institucioneve përkatëse në kuadër të realizimit të detyrave të tyre, duke përfshirë arsyetimin për çdo refuzim për t'u dhënë akses palëve të treta, si dhe çdo informacion mbi masat e nevojshme për forcimin e rrjetit;

dh) vendos masa administrative efektive, proporcionale dhe parandaluese ndaj të licencuarve;

e) shqyrton dhe miraton në përputhje me parimin e planifikimit me koston më të ulët planet e investimeve të operatorëve të transmetimit dhe shpërndarjes dhe monitoron zbatimin e tyre;

ë) zgjidh mosmarrëveshjet për ankesat e paraqitura nga klientët dhe mosmarrëveshjet e lindura midis të licencuarve, sipas parashikimeve të këtij ligji;

f) monitoron zbatimin e kontratave të lidhura midis të licencuarve duke ushtruar të drejtën e aksesit mbi dokumentacionin dhe informacionin e të licencuarit dhe duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të marrë;

g) kontrollon nëse shërbimi i siguruar nga të licencuarit është kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kushtet e licencës apo rregulloret e miratuara nga ERE-ja;

gj) raporton në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi në institucionet e Komunitetit të Energjisë dhe institucionet e tjera përkatëse ndërkombëtare;

h) miraton kontratat tip ose kushtet e përgjithshme të kontratave për shërbimet e rregulluara, të ofruara nga pjesëmarrësit e tregut, të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

i) kryen hetime për funksionimin e tregjeve të energjisë elektrike dhe vendos e zbaton çdo masë të nevojshme e proporcionale për të promovuar konkurrencën efektive dhe për të siguruar funksionimin e duhur të tregut. Kur është e nevojshme, ERE-ja bashkëpunon me autoritetin kombëtar të konkurrencës dhe rregullatorët e tregut financiar ose me Komisionin në kryerjen e një hetimi që lidhet me legjislacionin në fuqi për konkurrencën.

Neni 21

Parimet e vendosjes së tarifave për operimin dhe shërbimet e rrjetit

1. Për tarifat e aplikueshme për aksesin në rrjet, duke përfshirë tarifat për lidhjen me rrjetin, tarifat për përdorimin e rrjetit dhe, kur është e aplikueshme, tarifat e lidhura me fuqizimet e rrjetit, ndiqen këto kritere:

a) të reflektojnë kostot duke ofruar sinjale çmimi që pasqyrojnë kostot faktike të shpenzuara për aq sa përputhen me ato të një operatori rrjeti eficient dhe të krahasueshëm nga pikëpamja strukturore dhe që të mbulojnë këto kosto;

b) të jenë transparente për të qenë lehtësisht të kuptueshme nga përdoruesit e sistemit;

c) të marrin në konsideratë nevojën për siguri dhe fleksibilitet rrjeti;

ç) të jenë të aplikueshme në mënyrë jodiskriminuese, të cilat minimizojnë ndërsubvencionimin ndërmjet përdoruesve të sistemit;

d) të jenë të qëndrueshme duke ndjekur një model të parashikueshëm që pasqyron aplikimin e një metodologjie transparente, duke i qëndruar reflektimit të kostos sipas shkronjës "a" të kësaj pike;

dh) të mos përfshijnë kosto që nuk lidhen për këtë qëllim dhe që shërbejnë për objektivat e tjerë të politikave.

2. Metoda e përdorur për përcaktimin e tarifave të aplikueshme për aksesin në rrjet duhet të mbështetesë në mënyrë neutrale eficiencën e përgjithshme të sistemit për një periudhë afatgjatë përmes sinjaleve të çmimeve për klientët dhe prodhuesit dhe në veçanti të zbatohet në një mënyrë që nuk diskriminon pozitivisht ose negativisht midis prodhuesve dhe hapësirave depozituese të energjisë të lidhura në nivelin e shpërndarjes, si dhe prodhimit të lidhur në nivelin e transmetimit. Tarifat e zbatueshme për aksesin në rrjet nuk diskriminojnë depozitimin e energjisë ose agregimit, as pozitivisht as negativisht, në një mënyrë që nuk pasqyron kostot, si dhe nuk duhet të krijojnë dekurajime për vetëprodhimin, vetëkonsumimin ose për pjesëmarrjen në përgjigjen ndaj kërkesës.

3. Kur është e nevojshme, niveli i tarifave të aplikuara për prodhuesit ose klientët fundorë ose të dy së bashku duhet të japë sinjale vendndodhjeje në nivelin e palëve të Komunitetit të Energjisë dhe merr në konsideratë sasinë e humbjeve të rrjetit dhe kongjestionit të shkaktuar, si dhe kostot e investimit për infrastrukturën.

4. Pa cenuar pikën 2 të këtij neni, tarifa e aplikueshme për aksesin në rrjet nuk duhet të jetë e lidhur me distancën.

5. Tarifat e aksesit në rrjet të përcaktuara në këtë nen zbatohen pavarësisht nga detyrimet për eksportet dhe importet e deklaruara, që rrjedhin nga menaxhimi i kapacitetit të kufizuar të interkoneksioneve, sipas nenit 76 të këtij ligji.

6. Tarifat e miratuara dhe metodologjitë e llogaritjes së tyre duhet të mundësojnë realizimin e investimeve të nevojshme në rrjet për të garantuar që këto investime sigurojnë qëndrueshmërinë e sistemit. Në përcaktimin e tarifave të aksesit në rrjet duhet të merren në konsideratë edhe sa vijon:

a) pagesat dhe arkëtimet që rrjedhin nga mekanizmi i kompensimit ndërkufitar të operatorëve të sistemit të transmetimit;

b) pagesat e ekzekutuara dhe të arkëtuara, përfshirë pagesat e pritshme për periudha të ardhshme kohore, të aksesueshme sipas periudhave të mëparshme.

7. Nuk zbatohen tarifa të aksesit në rrjet për transaksione individuale të eksportit të deklaruar dhe/ose tranziteve.

8. Gjatë miratimit të tarifave të aksesit në rrjet ose të metodologjive të tyre, ERE-ja siguron që të reflektohen kostot fikse të OST-së dhe OSSH-së, si dhe stimujt e duhur afatshkurtër dhe afatgjatë për operatorët e sistemit të transmetimit dhe

shpërndarjes për rritjen e efektivitetit, rritjen e integrimit në treg, sigurinë e furnizimit dhe mbështetjen e aktiviteteve kërkimore, dhe për të lehtësuar inovacionin në interes të klientëve në fusha si digjitalizimi, shërbimet e fleksibilitetit dhe interkoneksioni.

9. ERE-ja publikon metodologjinë e detajuar dhe kostot bazë të përdorura për llogaritjen e tarifave përkatëse të rrjetit, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar.

Neni 22
Tarifat e transmetimit

1. ERE-ja, kur miraton tarifat e transmetimit dhe tarifat e shpërndarjes ose metodologjitë e tyre, merr në konsideratë në mënyrën e duhur raportin e praktikës më të mirë të zhvilluar dhe të lëshuar nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë.

2. Metodologjia që shërben si bazë për llogaritjen e tarifave të transmetimit merr në konsideratë kostot e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, siç përcaktohet nga rregullorja e BE 2019/943, direktiva e BE 2019/944 dhe kodet e rrjetit, por jo të kufizuara vetëm në:

a) kostot e aktiviteteve të ENTSO-E që duhet të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;

b) kostot e vendosura mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit në përputhje me rregulloren (BE) 2015/1222 për krijimin e udhëzimeve për alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionit (siç është përshtatur dhe miratuar nga Komuniteti i Energjisë);

c) kostot e vendosura mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit në përputhje me rregulloren (BE) 2017/2195 për krijimin e udhëzimeve për balancimin e energjisë elektrike (siç është përshtatur dhe miratuar nga Komuniteti i Energjisë);

ç) kostot që lidhen me aktivitetet e:

i. ridispeçrrimit dhe tregtimit me kah të kundërt;

ii. krijimit, ndryshimit dhe operimit të platformave evropiane për procesin e netimit të disbalancave, si dhe mundësimit të shkëmbimit të energjisë balancuese nga rezervat e rivendosjes së frekuencës dhe rezervat zëvendësuese;

d) kostot që rrjedhin nga detyrimet e rregullores për alokimin e kapaciteteve afatgjata;

dh) mekanizmin e kompensimit të transmetimit ndërkufitar (ITC).

3. ERE-ja i miraton këto kosto vetëm nëse ato janë të arsyeshme dhe proporcionale.

Neni 23
Tarifat e shpërndarjes

1. Tarifat e shpërndarjes duhet të reflektojnë koston duke marrë parasysh përdorimin e rrjetit të shpërndarjes nga përdoruesit, përfshirë klientët aktivë. Tarifat e shpërndarjes mund të përmbajnë elemente të kapacitetit të lidhjes së rrjetit dhe mund të diferencohen bazuar në konsumin e përdoruesve të sistemit ose në profilet e prodhimit.

2. Metodologjia që shërben si bazë për llogaritjen e tarifave të shpërndarjes ofron stimuj për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes për operimin dhe zhvillimin me kosto sa më eficiente të rrjeteve të tij, përfshi edhe prokurimin e shërbimeve. Për këtë qëllim, ERE-ja njeh kostot përkatëse si të lejueshme, i përfshin ato në tarifat e shpërndarjes dhe mund të parashikojë objektiva të performancës në mënyrë që të ofrojë stimuj për operatorët e sistemit të shpërndarjes për të rritur efikasitetin në rrjetet e tyre, duke përfshirë eficiencën e energjisë, fleksibilitetin dhe zhvillimin e rrjeteve inteligjente dhe sistemeve matëse inteligjente.

Neni 24
Monitorimi nga ERE-ja

ERE-ja monitoron:

a) zbatimin e rregullave të tregut;

b) zbatimin e detyrimit të transparencës prej të licencuarve;

c) nivelin dhe efektivitetin e hapjes së tregut dhe konkurrencës në nivelet e shitjes me shumicë dhe pakicë, përfshirë shkëmbimet e energjisë elektrike, çmimet për klientët familjarë, sistemet e parapagimit, ndikimin e kontratave dinamike të çmimeve të energjisë elektrike dhe të përdorimit të sistemeve të matjes inteligjente, tarifat e ndryshimit të furnizuesit, tarifat e ndërprerjes, detyrimet për shërbimet e mirëmbajtjes, ekzekutimin e shërbimeve të mirëmbajtjes, marrëdhëniet midis çmimeve për klientët familjarë dhe atyre të shitjes me shumicë, përditësimin e tarifave të rrjetit dhe ankesave nga klientët, si dhe çdo shtrembërim ose kufizim të konkurrencës, përfshirë sigurimin e çdo informacioni përkatës dhe dërgimin e çdo rasti përkatës pranë Autoritetit të Konkurrencës;

ç) nënshkrimin e kontratave kushtëzuese, përfshirë këtu edhe kontrata me kushte të veçanta përjashtuese, të cilat mund të pengojnë klientët të kontraktojnë njëkohësisht më tepër se një furnizues apo të kushtëzojnë zgjedhjen e kësaj mundësie prej tyre. Në këto raste ERE-ja duhet të informojë Autoritetin e Konkurrencës;

d) afatet brenda të cilave operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes përfundojnë lidhjen në rrjet të klientëve të rinj apo kryejnë riparimet në rrjete;

dh) zbatimin e rregullave për rolet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, furnizuesve, klientëve dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut;

e) investimet në kapacitetet e reja prodhuese dhe kapacitetet e reja depozituese për sigurinë e furnizimit;

ë) zbatimin e masave të sigurisë së furnizimit në përputhje me parashikimin e nenit të këtij ligji;

f) sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit;

g) bashkëpunimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit me operatorët e transmetimit të vendeve fqinje apo operatorët e rrjeteve evropiane të transmetimit të energjisë elektrike, përfshirë monitorimin e zbatimit të Mekanizmit të Kompensimit Ndërtransmetues (ITC) të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, vendosur në kuadër të këtij bashkëpunimi;

gj) zbatimin e rregullave për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve të interkoneksioneve, në bashkëpunim me autoritetet rregullatore ose autoritetet përgjegjëse të vendeve të tjera fqinje me të cilat është vendosur interkoneksioni;

h) menaxhimin e kapacitetit të kufizuar në rrjetin e transmetimit, përfshirë interkoneksionet dhe zbatimin e rregullave të menaxhimit të kapacitetit të kufizuar;

i) publikimin e informacionit të duhur prej Operatorit të Sistemit të Transmetimit për interkonektorët, përdorimin e rrjetit dhe alokimin e kapaciteteve ndaj palëve të interesuara, duke ruajtur konfidencialitetin për informacionin e marrë;

j) ndarjen efektive të llogarive, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për të shmangur ndërsubvencionimet midis aktiviteteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit;

k) kushtet dhe tarifat e lidhjes së prodhuesve të rinj të hapësirave depozituese të energjisë dhe pikave të rikarikimit.

l) zbatimin e rregullave për menaxhimin e të dhënave dhe kërkesat e ndërveprueshmërisë kur caktohet nga ministria sipas nenit 28 të këtij ligji;

ll) planet e investimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;

m) performancën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për zhvillimin e një rrjeti inteligjent që promovon eficiencën e energjisë dhe integrimin e energjisë nga burimet e rinovueshme, bazuar në treguesit përkatës, dhe publikon një raport kombëtar çdo dy vjet, përfshirë rekomandimet;

n) zbatimin e kontratave dinamike të çmimeve të energjisë elektrike sipas zhvillimeve përkatëse të tregut;

nj) heqjen e pengesave të pajustifikuara dhe kufizimeve në zhvillimin e konsumit të energjisë elektrike të vetëprodhuar dhe të komuniteteve qytetare të energjisë;

o) monitorimin e nivelit të transparencës, përfshirë çmimet me shumicë, dhe sigurimin e pajtueshmërisë së shoqëri elektroenergjetike me detyrimet e transparencës.

Neni 25

Regjimi rregullator për çështjet ndërkufitare

1. ERE-ja bashkëpunon me autoritetet e tjera rregullatore fqinje të rajonit dhe me Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë për:

a) hartimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve operative për menaxhimin optimal të rrjetit, promovimin e shkëmbimeve të ndërsjella dhe ndarjen e kapaciteteve ndërkufitare, si dhe rritjen e kapaciteteve të interkoneksionit nëpërmjet ndërlidhjeve të reja, duke mundësuar rritjen e konkurrencës efektive, përmirësimin e sigurisë së furnizimit pa diskriminim ndaj licencuesve dhe tregtarëve të vendeve të ndryshme, palë të Komunitetit të Energjisë;

b) koordinimin e hartimit dhe zbatimit të kodeve të rrjetit nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe palët e tjera të interesit të tregut;

c) koordinimin e hartimit të rregullave për menaxhimin e kapaciteteve të kufizuara;

ç) koordinimin e mbikëqyrjes së përbashkët të subjekteve që kryejnë funksione në nivel rajonal;

d) koordinimin në bashkëpunim me ministrinë të mbikëqyrjes së përbashkët të vlerësimeve kombëtare, rajonale dhe evropiane të mjaftueshmërisë së burimeve.

2. ERE-ja ka të drejtë të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi me autoritetet rregullatore të vendeve të rajonit për të forcuar bashkëpunimin rregullator rajonal.

3. ERE-ja bashkëpunon me autoritetet e tjera rregullatore brenda rajonit të operimit të sistemit, siç është përcaktuar në përputhje me rregulloren (BE) 2019/943, me qëllim sigurimin e koordinimit efektiv të funksionimit të sistemit, zbatimin e qëndrueshëm të kodeve dhe udhëzimeve të rrjetit, si dhe funksionimin e integrimin efikas të tregjeve rajonale dhe evropiane të energjisë elektrike:

a) për miratimin e propozimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit për të krijuar, për t'iu bashkuar ose për të marrë shërbime në Qendrën Rajonale të Koordinimit (RCC), në përputhje me rregulloren (BE) 2019/943, dhe pas miratimit të sigurojë zbatimin e tij duke monitoruar përputhshmërinë, duke miratuar vendimet e nevojshme rregullatore dhe duke mbikëqyrur që operatorët përkatës të sistemit të transmetimit të marrin të gjitha masat e nevojshme për të krijuar dhe për të vënë në funksionim RCC-në në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi;

b) për miratimin e kostove që lidhen me aktivitetet e Qendrës Rajonale të Koordinimit (RCC), të cilat do të mbulohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe do të merren në konsideratë në llogaritjen e tarifave, me kusht që ato të jenë të arsyeshme dhe të përshtatshme;

c) për miratimin e proceseve bashkëpunuese të vendimmarrjes;

ç) për t'u siguruar që Qendra Rajonale e Koordinimit (RCC) të jetë e pajisur me të gjitha burimet e nevojshme njerëzore, teknike, fizike dhe financiare për përmbushjen e detyrimeve dhe kryerjen e detyrave të saj në mënyrë të pavarur dhe të paanshme;

d) për të propozuar së bashku me autoritetet e tjera rregullatore të Rajonit të Operimit të Sistemit (SOR) detyra të mundshme shtesë dhe kompetenca shtesë që do t'i caktohen Qendrës Rajonale e Koordinimit (RCC) nga palët e Komunitetit të Energjisë të Rajonit të Operimit të Sistemit (SOR);

dh) për sigurimin e pajtueshmërisë me detyrimet e Qendrës Rajonale të Koordinimit (RCC), veçanërisht në lidhje me çështjet ndërkufitare, dhe për të identifikuar bashkërisht mosrespektimin e detyrimeve të Qendrës Rajonale të Koordinimit (RCC) kur autoritetet rregullatore nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë një marrëveshje brenda një periudhe prej katër muajsh pas fillimit të konsultimeve. Për qëllim të identifikimit të përbashkët të mospërputhshmërisë, çështja do t'i referohet Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe, në masën që preken shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, te ACER-i;

e) për monitorimin e performancës së koordinimit të sistemit dhe për raportimin çdo vit te Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rastet kur preken shtetet anëtare, te Bashkimi Evropian dhe ERE është anëtare, te ACER-i.

4. Në lidhje me Qendrën Rajonale të Koordinimit (RCC), ERE-ja ka të drejtë:

a) të kërkojë informacion nga Qendra Rajonale e Koordinimit (RCC);

b) të kryejë inspektime duke përfshirë inspektime të paparalajmëruara në ambientet e Qendrës Rajonale të Koordinimit (RCC);

c) të nxjerrë vendime të përbashkëta detyruese për Qendrën Rajonale të Koordinimit (RCC).

5. ERE-ja ka të drejtë të kërkojë nga ACER-i ose nga ECRB-ja, kur është e aplikueshme, opinion të arsyetuar, si dhe rekomandim lidhur me pajtueshmërinë e Qendrës Rajonale të Koordinimit (RCC) brenda detyrimeve të saj.

6. ERE-ja i referon një propozim mbi TCM-të ACER-it ose ECRB-së kur është e aplikueshme, kur nuk arrihet marrëveshja unanime mes autoriteteve kombëtare rregullatore ose nëse ACER-i kërkon referimin, me detyrimin për të paraqitur propozimin e TCM tek ACER-i ose ECRB-ja, kur është e aplikueshme, brenda një jave nga dorëzimi.

7. ERE-ja mund t'i kërkojë ACER-it ose ECBR-së, kur është e aplikueshme, të miratojë një vendim për çështje rregullatore që kanë ndikim në tregtinë ndërkufitare ose në sigurinë e sistemit ndërkufitar, së bashku me autoritetet e tjera kombëtare rregullatore të përfshira, ose individualisht, nëse janë të përfshira vetëm dy autoritete kombëtare rregullatore.

8. ERE-ja dhe çdo person fizik/juridik mund të ankimojë një vendim të përmendur në shkronjën "d" të nenit 2 të Rregullores (BE) 2019/942, i cili i drejtohet ERE-së, edhe nëse është në formën e një

vendimi që i drejtohet një personi tjetër, por që ka interes të drejtpërdrejtë dhe individual për ERE-n. Ankesa duhet të përmbajë shkaqet e ankimit dhe paraqitet me shkrim pranë ACER-it brenda dy muajve nga njoftimi i vendimit personit të interesuar ose, në mungesë të tij, brenda dy muajve nga data në të cilën ACER-i ka publikuar vendimin e tij.

Neni 26
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve nga ERE-ja

1. ERE-ja vepron si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me ankesat kundër të licencuarve në përputhje me rregulloren përkatëse të shqyrtimit të mosmarrëveshjeve dhe trajtimit të ankesave.

2. Çdo palë e interesuar, që ka ankesa ndaj operatorit të transmetimit apo shpërndarjes, si dhe ndaj të licencuarve të tjerë për zbatimin e detyrimeve të tyre, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji apo akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike, mund t'i paraqesë për zgjidhje pranë ERE-s. ERE-ja merr vendim brenda një afati prej 30 ditësh nga marrja e ankesës. Kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë të tjera në rastet kur ERE-s i nevojitet informacion shtesë.

3. ERE-ja mund të vendosë mospranimin e ankesës nëse bazuar në legjislacionin në fuqi konstaton se shqyrtimi i ankesës nuk është kompetencë e saj.

4. Paraqitja e ankesës, sipas parashikimeve të këtij neni, nuk i heq të drejtën palës së interesuar për t'u drejtuar pranë organeve të tjera kompetente në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

5. ERE-ja siguron që klientët fundorë të kenë akses në mekanizma të thjeshtë, të drejtë, transparentë, të pavarur, efektivë dhe efikas jashtëgjyqësorë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që lidhen me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara sipas këtij ligji.

6. Pjesëmarrja e shoqërive elektroenergjetike në mekanizmat jashtëgjyqësorë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për klientët familjarë është e detyrueshme, përveçse kur Shqipëria i demonstron Komisionit se mekanizma të tjerë kombëtarë janë po aq efektivë.

Neni 27
Raportimi i ERE-s

1. ERE-ja deri më 31 mars të çdo viti i paraqet Kuvendit një raport vjetor për situatën në sektorin e energjisë elektrike dhe aktivitetet e ERE-s për vitin paraprak, i cili publikohet në faqen zyrtare të internetit dhe në Fletoren Zyrtare, si dhe i dorëzohet Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

2. Raporti i përgatitur nga ERE-ja në përputhje me pikën 1 të këtij neni përshkruan situatën e përgjithshme të sektorit të energjisë elektrike, duke përfshirë në veçanti:

a) sigurinë e rrjetit operativ;

b) bilancin e parashikuar të furnizimit dhe kërkesës për energji elektrike në tregun e brendshëm për një periudhë pesëvjeçare;

c) nivelin e pritshëm të kërkesës dhe perspektivat e sigurisë së furnizimit për një periudhë pesë deri në pesëmbëdhjetëvjeçare nga data e raportit;

ç) kapacitetin shtesë gjenerues të propozuar, të planifikuar ose në fazë ndërtimi;

d) parashikimin e investimeve për jo më pak se pesë vjetët e ardhshëm, të planifikuara për t'u realizuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose çdo palë tjetër lidhur me rritjen e kapacitetit të interkoneksionit ndërkufitar;

dh) cilësinë dhe nivelin e mirëmbajtjes së rrjeteve;

e) masat për të menaxhuar kërkesën maksimale dhe ndërprerjet në furnizimin me energji elektrike;

ë) masat e duhura, nëse është e nevojshme, për të rritur sigurinë e furnizimit;

f) rregullimin dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike;

g) tarifat dhe mbikëqyrjen rregullatore;

gj) integrimin e tregut rajonal dhe evropian;

h) mbrojtjen e konsumatorit dhe cilësinë e shërbimit;

i) monitorimin e konkurrencës dhe tregut;

j) sigurinë e furnizimit dhe funksionimin e sistemit;

k) zbatimin e detyrimeve të BE-së dhe komunitetit të energjisë.

3. Informacioni i raportit vjetor të përmendur në shkronjën "d" të pikës 2 të këtij neni duhet të bazohet në:

a) parimet e menaxhimit të kufizimit të kapacitetit për linjat ekzistuese dhe të planifikuara të transmetimit;

b) modelet e pritshme të prodhimit, furnizimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit, duke mundësuar marrjen e masave për menaxhimin e kërkesës;

c) objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian;

ç) informacionin e hollësishëm të Operatorit të Sistemit të Transmetimit për investimet e parashikuara në linjat e interkoneksionit dhe për ndërtimin e linjave të transmetimit të rrjetit të brendshëm, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në linjat e interkoneksionit ndërkufitar.

Neni 28
Menaxhimi i të dhënave

1. Ministri përcakton rregullat për menaxhimin dhe shkëmbimin e të dhënave të klientëve fundorë në përputhje me këtë nen dhe legjislacionin në fuqi për të dhënat personale. Për qëllimet e këtij neni, të dhënat do të kuptohen se përfshijnë të dhënat e matjes dhe konsumit, si dhe të dhënat e kërkuara për ndryshimin e klientit, përgjigjen ndaj kërkesës dhe shërbime të tjera.

2. Ministria specifikon rregullat për menaxhimin e të dhënave në mënyrë që të sigurohet se:

a) aksesi dhe shkëmbimi i të dhënave, si dhe mbrojtja e të dhënave dhe siguria e të dhënave janë eficiente dhe të sigurta;

b) palët përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave i sigurojnë çdo pale që kualifikohet akses në të dhënat e klientëve fundorë në përputhje me pikën 1 të këtij neni;

c) palët që kualifikohen kanë në dispozicion të dhënat e kërkuara njëkohësisht dhe në mënyrë jodiskriminuese;

ç) aksesi në të dhënat është i lehtë dhe procedurat përkatëse për marrjen e aksesit në të dhëna do të bëhen publike;

d) rregullat për aksesin në të dhënat dhe ruajtjen e të dhënave, si dhe përpunimin e të dhënave personale për qëllimet e këtij neni janë në përputhje me legjislacionin në fuqi për të dhënat personale;

dh) rregullat për aksesin në të dhëna dhe ruajtjen e të dhënave lehtësojnë ndërveprimin e plotë të shërbimeve të energjisë brenda palëve të Komunitetit të Energjisë;

e) palët përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave zbatojnë kërkesat dhe procedurat e ndërveprimit për aksesin në të dhëna.

3. Ministri mund të caktojë një autoritet kompetent për zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të këtyre rregullave.

4. Ministri ose autoriteti kompetent i caktuar autorizon dhe certifikon ose, kur është e aplikueshme, mbikëqyr palët përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave, në mënyrë që të sigurohet se ato janë në përputhje me kërkesat e këtij neni.

5. Ministri ose autoriteti kompetent i caktuar është përgjegjës për caktimin e tarifave përkatëse për aksesin në të dhënat nga palët që kualifikohen për akses. Ministri ose autoriteti kompetent i caktuar siguron që çdo tarifë e vendosur nga subjektet e rregulluara, që ofrojnë shërbime të të dhënave, të jetë e arsyeshme dhe e argumentuar në mënyrë të përshtatshme. Asnjë kosto shtesë nuk u ngarkohet klientëve fundorë për aksesin në të dhënat e tyre ose për një kërkesë për t'i bërë të dhënat e tyre të disponueshme.

PJESA E PESTË
SISTEMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 29
Funksionimi i integruar i sistemit të energjisë elektrike

Sistemi i energjisë elektrike operon si një sistem i integruar me procese të vazhdueshme prodhimi, transmetimi, shpërndarjeje dhe konsumi të energjisë elektrike.

Neni 30
Lidhja me rrjetin

1. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes duhet të sigurojnë lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes mbi kushte jodiskriminuese. ERE-ja, në bashkëpunim me operatorët e rrjeteve, miraton rregullat që përcaktojnë kostot që do t'i ngarkohen përdoruesit në lidhje me kushtet e veçanta të pikës së lidhjes.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka të drejtë të refuzojë lidhjen në rrjet të një përdoruesi të rrjetit me arsyetimin e kufizimeve të mundshme në të ardhmen të kapaciteteve aktuale të rrjetit apo krijimit të një kufizimi të kapacitetit në pjesë të

largëta të sistemit të transmetimit. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka të drejtë të refuzojë një pikë lidhjeje të re, bazuar në arsyetimin se do të krijojë kosto shtesë lidhur me nevojën e krijimit të kapaciteteve shtesë të elementeve të sistemit në zonën përreth pikës së lidhjes.

3. ERE-ja miraton rregulloren për procedurat për lidhjet e reja, të propozuara nga i licencuari, ku përfshihet edhe metodologjia e llogaritjes së kostove dhe marrëveshja standarde e lidhjes, të cilat janë transparente dhe eficiente për të siguruar lidhjen në mënyrë jodiskriminuese të çdo përdoruesi në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes. Këto rregulla e procedura specifikojnë edhe të drejtat dhe detyrimet e operatorit të rrjetit përkatës dhe të palës që kërkon lidhjen, në veçanti, kushtet për lidhjen, afatet, pikat e matjes, si dhe kufijtë e pronësisë midis sistemit dhe përdoruesit të sistemit.

4. Rregullorja merr në konsideratë kostot dhe përfitimet që shoqërojnë lidhjen në rrjet të përdoruesve, si dhe rrethanat e veçanta të prodhuesve të ndodhur në zona të largëta dhe zona me dendësi të ulët të popullsisë, në masën që këto konsiderata janë në linjë me parimet e tarifimit, kur është e përshtatshme, të parashikuara në nenin 21 të këtij ligji.

5. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes i japin çdo përdoruesi të ri që dëshiron të lidhet me rrjetin informacion të plotë, përfshirë:

a) një vlerësim të plotë dhe të hollësishëm të kostove për realizimin e lidhjes së kërkuar;

b) afatin e nevojshëm e të arsyeshëm për përpunimin e kërkesës dhe të realizimit të lidhjes me rrjetin.

6. Përdoruesit e rinj që dëshirojnë të lidhen në rrjet, pas miratimit të kërkesës për lidhjen e tyre nga ana e operatorit përkatës të sistemit, mund të kontraktojnë operatorë të miratuar nga organet kompetente për kryerjen e punimeve të nevojshme për lidhjen në rrjet, në përputhje me dispozitat dhe specifikimet e përcaktuara në marrëveshjen e lidhjes, të nënshkruar ndërmjet përdoruesit të ri dhe operatorit të sistemit. Operatori i sistemit përcakton kriteret dhe kushtet teknike që duhet të plotësohen për lidhjen me rrjetin.

Neni 31
Kostot për lidhjen me rrjetin

1. Kostot e plota për lidhjen me rrjetin ekzistues mbulohen nga pala që kërkon të lidhet në rrjet.

2. Në llogaritjen e kostos së lidhjes merren në konsideratë pika e lidhjes dhe kapaciteti i saj, qëllimi i synuar, modeli i konsumit, kostot që lidhen me përforcimin ose përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese ose përmirësimin e operimit të rrjetit që mund të nevojitet për lidhjen, statusi i përdoruesit të rrjetit, si dhe karakteristika të tjera të lidhjes.

3. Kur lidhja realizohet prej operatorit të sistemit, kostot e lidhjes parapaguhen nga pala kërkuese, bazuar në rregulloren për procedurat e lidhjeve të reja.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në rast mungese të kapaciteteve të nevojshme për lidhjen e përdoruesve të rinj, mund të hyjë në marrëveshje me palën kërkuese për përmirësimin e sistemit, në mënyrë që të bëhet e mundur lidhja e kërkuar, me kusht që kostot të përballohen nga pala kërkuese. Kjo marrëveshje duhet të miratohet nga ERE-ja pas propozimit nga operatorët e rrjetit.

5. Lidhjet operohen prej operatorëve të rrjetit, të cilët kanë përgjegjësi për mirëmbajtjen e tyre. Kostoja për mirëmbajtjet paguhet prej përdoruesit.

6. Operatori i Sistemit të Transmetimit, bazuar në kushtet teknike të rrjetit, autorizon lidhjen e një përdoruesi të ri në sistemin e transmetimit, nëpërmjet aseteve të lidhjes së re të realizuar nga një përdorues i mëparshëm. Përdoruesi i ri përgjigjet për kompensimin e drejtë të kostove ndaj përdoruesit që ka kryer investimin, në përputhje me rregulloren e lidhjeve të reja.

7. Operatori i Sistemit të Transmetimit, bazuar në kushtet teknike të rrjetit, autorizon lidhjen e disa përdoruesve të rinj në të njëjtin seksion të rrjetit të transmetimit nëpërmjet aseteve të reja të lidhjes, të cilat do të zbatohen pjesërisht ose tërësisht si një investim i përbashkët i miratuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit në përputhje me rregulloren për lidhjet e reja në rrjetin e transmetimit. Ndarja e kostove të investimit të përbashkët midis përdoruesve përcaktohet me marrëveshje midis tyre.

Neni 32
Aksesi i palëve të treta

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe komunitetet qytetare të energjisë, që menaxhojnë rrjete shpërndarjeje, garantojnë aksesin në rrjet për të gjithë klientët dhe përdoruesit e sistemit mbi baza transparente, jodiskriminuese dhe bazuar në tarifat e miratuara dhe të publikuara nga ERE-ja.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe komunitetet qytetare të energjisë, që menaxhojnë rrjete shpërndarjeje, mund ta refuzojnë aksesin në rrjetin e tyre në rast se mungon kapaciteti i nevojshëm. Vendimi për refuzimin e aksesit në rrjet duhet të jetë i arsyetuar, të bazohet në kushte teknike dhe ekonomike objektive dhe duhet të marrë në konsideratë detyrimin e shërbimit publik, si dhe detyrimet për mbrojtjen e klientëve fundorë, të përcaktuara nga ky ligj. Vendimi për refuzimin e aksesit i njoftohet palës së interesuar.

3. Në rast se një pale të interesuar i është refuzuar aksesi në rrjet, ajo mund të kërkojë fillimin e procedurës për zgjidhje të mosmarrëveshjes pranë ERE-s.

4. Në rast refuzimi të aksesit, ERE-ja nëpërmjet operatorit të rrjetit i siguron palës së interesuar informacionin shtesë të nevojshëm duke përfshirë masat e nevojshme për forcimin e rrjetit.

5. Me qëllim garantimin e aksesit transparent dhe jodiskriminues, si dhe për të mundësuar koordinimin efikas të projekteve të infrastrukturës, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes publikojnë dhe përditësojnë në faqet e tyre zyrtare informacion për punimet e planifikuara në rrjet, kapacitetet e disponueshme, si dhe planet e zhvillimit të rrjetit duke u mundësuar ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme planifikimin e investimeve të tyre në përputhje me projektet infrastrukturore.

Neni 33
Interkoneksioni me sistemet e tjera elektroenergjetike

1. Sistemi kombëtar i transmetimit lidhet me sistemet e transmetimit të vendeve të tjera nëpërmjet linjave ekzistuese të interkoneksionit, atyre që do të ndërtohen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, në përputhje me planin e investimit të rrjetit, të miratuar nga ERE-ja, apo që do të ndërtohen prej palëve të treta, sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Operimi i sistemit të transmetimit, në paralel me sistemet e ndërlidhura të vendeve të tjera, kryhet në përputhje me marrëveshjet dy ose shumëpalëshe midis operatorëve të sistemeve të ndërlidhura të transmetimit, duke respektuar kërkesat teknike, kërkesat e operimit të sigurt dhe standarde të tjera për interkoneksionet, të përcaktuara nga ERE-ja.

Neni 34
Ndërtimi i interkonektorëve të rinj

1. Linjat e reja të interkoneksionit, që ndërtohen nga investitorët privatë, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e ministrit.

2. Kushtet dhe procedurat për ndërtimin e interkonektorëve të rinj, sipas parashikimeve të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e ministrit.

Neni 35
Përjashtimi nga detyrimi për akses

1. Interkonektorët e rinj me rrymë të vazhduar, me kërkesën e investitorit, mund të përjashtohen për një periudhë të kufizuar nga neni 19(2) dhe (3) i rregullores (BE) 2019/943 dhe nga nenet 6 dhe 43, neni 59(7) dhe neni 60(1) i direktivës (BE) 2019/944, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) investimi përmirëson konkurrencën në furnizimin e energjisë elektrike;

b) niveli i riskut lidhur me investimin është i tillë që investimi nuk do të mund të kryhej nëse nuk do të jepej një përjashtim;

c) interkonektori është në pronësi të një personi fizik ose juridik që është i ndarë, të paktën për sa i përket formës së tij juridike, nga operatorët e sistemeve në sistemet e të cilëve do të ndërtohet ai interkonektor;

ç) tarifat u ngarkohen përdoruesve të atij interkonektori;

d) që prej 1 korrikut 2007 asnjë pjesë e kapitalit ose kostove operacionale të interkonektorit nuk është mbuluar prej ndonjë komponent tarifash, të aplikuara ndaj përdorimit të rrjetit të transmetimit apo shpërndarjes, të lidhur nga interkonektori;

dh) përjashtimi nuk dëmton konkurrencën ose funksionimin efektiv të tregut të brendshëm apo të

funksionimit efikas të sistemit të rregulluar me të cilin është lidhur interkonektori.

2. Në raste të veçanta, pika 1 është e zbatueshme edhe për interkonektorët me rrymë alternative, me kushtin që kostot dhe rreziqet e investimit në fjalë të jenë veçanërisht të larta krahasuar me kostot dhe risqet e hasura normalisht gjatë lidhjes së dy sistemeve kombëtare fqinje të transmetimit përmes një interkonektori të rrymës alternative.

3. Pika 1 e këtij neni zbatohet edhe për rritje të konsiderueshme të kapacitetit në interkonektorët ekzistues.

4. Vendimi për dhënien e një përjashtimi, siç parashikohet në pikat 1, 2 dhe 3, merret rast pas rasti dhe në përputhje me vendimin e autoriteteve rregullatore të shteteve anëtare dhe palëve kontraktuese përkatëse. Një përjashtim përfshin një pjesë ose të gjithë kapacitetin e interkonektorit të ri ose të interkonektorit ekzistues, me kapacitet të rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Brenda dy muajve nga marrja e kërkesës për përjashtim nga autoriteti i fundit rregullator përkatës, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, ACER-i që vepron në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr.2022/01/MC-EnC, mund t'u japë autoriteteve rregullatore një opinion. Autoritetet rregullatore mund ta bazojnë vendimin e tyre mbi atë opinion.

Gjatë marrjes së vendimit për dhënien e një përjashtimi, ERE-ja merr në konsideratë rast pas rasti nevojën për të vendosur kushte për kohëzgjatjen e përjashtimit dhe aksesin jodiskriminues në interkonektor. Kur vendos për këto kushte, ERE-ja duhet të marrë parasysh, në veçanti, kapacitetin shtesë që duhet të ndërtohet ose ndryshimet e kapacitetit ekzistues, afatin kohor të projektit dhe rrethanat kombëtare.

Kur të gjitha autoritetet rregullatore përkatëse kanë arritur marrëveshje mbi vendimin për përjashtim brenda gjashtë muajve nga marrja e kërkesës, ato do të informojnë Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, ACER-in për atë vendim.

Vendimi për përjashtim, duke përfshirë çdo kusht të përmendur në nënparagrafin e tretë të kësaj pike, duhet të jetë i arsyetuar siç duhet dhe të publikohet.

5. Vendimi i përmendur në pikën 4 merret nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, nga ACER-i, duke vepruar në përputhje me nenin 2 të aktit procedural nr.2022/01/MC-EnC, në rastet:

a) kur autoritetet rregullatore përkatëse nuk kanë qenë në gjendje të arrijnë një marrëveshje brenda gjashtë muajve nga data në të cilën autoriteti i fundit rregullator ka marrë kërkesën për përjashtim; ose

b) me kërkesë të përbashkët të autoriteteve rregullatore përkatëse.

Përpara marrjes së një vendimi të tillë, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, ACER-i konsulton autoritetet rregullatore përkatëse dhe aplikantët.

6. Pavarësisht pikave 4 dhe 5 të këtij neni, shtetet anëtare mund të parashikojnë që autoriteti rregullator ose Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë, ose në rastet kur preken shtetet anëtare, ACER, sipas rastit, të paraqesë për një vendim formal tek organi përkatës në shtetin anëtar mendimin e tij për kërkesën për përjashtim. Ky mendim publikohet së bashku me vendimin.

7. Një kopje e çdo kërkese për përjashtim duhet t'i dërgohet menjëherë nga ERE-ja për informim pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë. Në rastet kur preken shtetet anëtare, kopja u dërgohet gjithashtu Komisionit Evropian dhe Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) menjëherë pas marrjes së saj.

Vendimi i komunikohet pa vonesë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë nga autoritetet rregullatore përkatëse ose nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë. Kur preken shtetet anëtare, njoftimin e kryen edhe Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë dhe vendimi i dërgohet gjithashtu Komisionit Evropian. Njoftimi shoqërohet me të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me vendimin.

Këto informacione mund të paraqiten në formë të përmbledhur, me qëllim që Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, Komisioni Evropian, të jetë në gjendje të marrë një vendim të mirinformuar dhe të bazuar. Në veçanti informacioni duhet të përmbajë:

a) arsyet e detajuara në bazë të të cilave është dhënë ose refuzuar përjashtimi, përfshirë informacionin financiar që justifikon nevojën për përjashtim;

b) analizën e bërë për efektin mbi konkurrencën dhe funksionimin efektiv të tregut të brendshëm të

energjisë elektrike që rezulton nga dhënia e përjashtimit;

c) arsyet për periudhën kohore dhe përqindjen e kapacitetit total të interkonektorit në fjalë për të cilin jepet përjashtimi;

ç) rezultatet e procesit të konsultimit të ERE-s.

8. Brenda 50 ditëve punë nga dita pas marrjes së njoftimit sipas pikës 7 të këtij neni, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ose, ose në rastet kur preken shtetet anëtare, Komisioni Evropian mund të lëshojë një opinion duke ftuar organet njoftuese të ndryshojnë ose të tërheqin vendimin për dhënien e përjashtimit. Ky afat mund të zgjatet me 50 ditë pune shtesë kur kërkohet informacion i mëtejshëm nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, nga Komisioni Evropian. Periudha shtesë fillon ditën pas marrjes së informacionit të plotë. Periudha fillestare mund të zgjatet gjithashtu me pëlqimin e përbashkët të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, të Komisionit Evropian dhe organeve njoftuese (ACER).

Kur informacioni i kërkuar nuk jepet brenda periudhës së përcaktuar në kërkesën e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, të Komisionit Evropian, njoftimi konsiderohet i tërhequr, përveç nëse para skadimit të asaj periudhe afati zgjatet me pëlqimin e përbashkët të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, Komisionit Evropian dhe organeve njoftuese, ose organet njoftuese, me një deklaratë të arsyetuar, informojnë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe, në rastet kur preken shtetet anëtare, Komisionin Evropian se e konsiderojnë njoftimin të plotë.

Organet njoftuese duhet të marrin në konsideratë sa më shumë opinionin e Sekretariatit ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, të Komisionit Evropian, që rekomandon ndryshimin ose tërheqjen e vendimit për përjashtim. Kur vendimi përfundimtar devijon nga opinioni i Sekretariatit ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, i Komisionit Evropian, autoriteti rregullator përkatës duhet të japë dhe të publikojë së bashku me atë vendim arsyetimin mbi të cilin bazohet vendimi. Vendimet devijuese përfshihen në agjendën e mbledhjes së parë të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë pas datës së vendimit për informacion dhe diskutim.

Opinioni i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, i Komisionit Evropian për një vendim për përjashtim shuhet dy vjet pas datës së miratimit të tij në rast se ndërtimi i interkonektorit nuk ka filluar deri në atë datë, dhe pesë vjet pas datës së miratimit nëse interkonektori nuk është bërë operacional deri në atë datë, përveç nëse Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, Komisioni Evropian vendos mbi bazën e një kërkese të arsyetuar nga organet njoftuese se çdo vonesë është për shkak të pengesave të mëdha përtej kontrollit të personit të cilit i është dhënë përjashtimi,

9. Kur autoritetet rregullatore të shteteve anëtare dhe palëve kontraktuese përkatëse vendosin të modifikojnë një vendim për përjashtim, ato duhet ta njoftojnë vendimin e tyre te Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, te Komisioni Evropian pa vonesë së bashku me të gjitha informacionet përkatëse lidhur me vendimin. Pikat 1 deri në 8 të këtij neni zbatohen për vendimin për modifikimin e një vendimi për përjashtim, duke marrë parasysh veçoritë e përjashtimit ekzistues.

10. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur preken shtetet anëtare, Komisioni Evropian mund, me kërkesë ose me nismën e vet, të rihapë procedurat që lidhen me një kërkesë për përjashtim kur:

a) duke marrë parasysh pritshmëritë legjitime të palëve dhe ekuilibrin ekonomik të arritur në vendimin fillestar për përjashtim, ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në ndonjë nga faktet mbi të cilat është bazuar vendimi;

b) ndërmarrjet e përfshira veprojnë në kundërshtim me angazhimet e tyre; ose

c) vendimi është bazuar në informacion të paplotë, të pasaktë ose të gabuar, i cili është dhënë nga palët.

Neni 36

Linjat direkte

1. Të gjithë prodhuesit dhe furnizuesit e energjisë elektrike brenda një territori të caktuar mund të furnizojnë mjediset e tyre, filialet dhe klientët e tyre nëpërmjet një linje direkte. Të gjithë konsumatorët fundorë kanë të drejtën, individualisht ose së

bashku, të furnizohen përmes një linje direkte nga prodhuesit ose furnizuesit e energjisë elektrike.

2. Linjat direkte që ndërtohen për eksportimin e energjisë elektrike nga prodhuesi vendas drejt një konsumatori jashtë vendit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit, pas marrjes së mendimit nga ana e ERE-s.

3. Linjat direkte që ndërtohen për lidhjen e një prodhuesi brenda vendit me një klient fundor brenda vendit apo një shoqëri furnizimi që furnizon mjediset e veta apo klientët e vet të kualifikuar, miratohen nga ministri pas marrjes së mendimit nga ana e ERE-s.

4. Kushtet dhe procedurat për ndërtimin e linjave direkte miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit, bazuar në kritere objektive dhe jodiskriminuese dhe duke përfshirë procedurën e ERE-s që jep opinionet e saj përkatëse në lidhje me pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Ministri miraton ndërtimin e një linje direkte edhe në rastet kur aplikuesit i është refuzuar aksesi në rrjet për rastet e parashikuara në nenin 32 të këtij ligji, ose nëse është iniciuar një procedurë për zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje sipas parashikimeve të nenit 26 të këtij ligji.

6. Ministri refuzon ndërtimin e një linje direkte në rast se dhënia e një autorizimi të tillë pengon përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik dhe mbrojtjen e klientit, të përcaktuara sipas dispozitave të këtij ligji. Argumentet për një refuzim të tillë duhet të jenë të arsyetuara dhe i njoftohen aplikuesit.

7. Mundësia e furnizimit me energji elektrike nëpërmjet një linje direkte nuk pengon të drejtën e klientit për të lidhur marrëveshje furnizimi me energji elektrike nga një furnizues tjetër i zgjedhur prej tij.

8. Shpenzimet për ndërtimin dhe operimin e linjave direkte përballohen nga mbajtësi i autorizimit.

9. Për krijimin, ushtrimin dhe përfundimin e të drejtave lidhur me ndërtimin dhe operimin e linjave direkte që kalojnë nëpërmjet pasurisë së një pale të tretë zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

Neni 37

Standardet teknike dhe të sigurisë në sektorin e energjisë elektrike

1. Rregullat teknike për projektimin, ndërtimin dhe operimin e centraleve të prodhimit të energjisë elektrike, sistemit të transmetimit, sistemit të shpërndarjes, linjave të interkoneksionit ose linjave direkte në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe rregullat e sigurimit teknik, hartohen nga ministria në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardeve dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

2. Rregullat e përmendura në pikën 1 të këtij neni duhet të jenë objektive, jodiskriminuese dhe të sigurojnë një operim të qëndrueshëm e të sigurt të sistemit të energjisë elektrike, përfshirë edhe ndërveprimin me sistemet e energjisë elektrike të vendeve fqinje, si dhe të sigurojnë një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

3. Projektimi, ndërtimi dhe operimi i centraleve të prodhimit të energjisë elektrike, sistemit të transmetimit, sistemit të shpërndarjes, linjave të interkoneksionit ose linjave direkte bëhet në përputhje me rregullat teknike të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni dhe në përputhje me standardet teknike të harmonizuara shqiptare në fuqi.

4. Kontrolli i zbatimit dhe mbikëqyrja e rregullave teknike të parashikuara në pikën 1 të këtij neni për sektorin e energjisë elektrike kryhen nga inspektorati përgjegjës në varësi të ministrit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 38

Ndarja e llogarive të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike

1. Çdo i licencuar mban llogari të veçanta për secilën nga veprimtaritë e licencuara që ushtron, si dhe për çdo aktivitet tjetër që nuk lidhet me sektorin e energjisë elektrike, me qëllim shmangien e ndërsubvencionimit dhe cenimit të konkurrencës. Këto llogari mund të paraqiten të konsoliduara, përveç rastit kur aktivitetet e kryera lidhen me shpërndarjen apo transmetimin e energjisë elektrike.

2. Të ardhurat që siguron i licencuari nga çdo e drejtë mbi rrjetin e transmetimit ose shpërndarjes duhet të specifikohen në llogaritë e të licencuarit.

3. Çdo i licencuar paraqet për auditim dhe publikon pasqyrat financiare vjetore në përputhje me legjislacionin në fuqi për standardet e kontabilitetit. Auditimi verifikon edhe nëse është respektuar detyrimi për shmangien e ndërsubvencionimit ndërmjet veprimtarive të licencuara.

4. Të licencuarit duhet të bëjnë të disponueshme për palët e interesuara pasqyrat financiare vjetore të tyre.

Neni 39
Zonat e sigurisë

Për mbrojtjen dhe operimin normal të objekteve elektrike dhe të aseteve të tyre ndihmëse, si dhe për shmangien e rrezikut ndaj njerëzve, pasurisë dhe mjedisit, Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton kushtet për përcaktimin e zonave të sigurisë, si dhe kufizimet e zbatueshme për këto zona.

KREU II
LICENCIMI

Neni 40
Veprimtaritë e licencuara dhe përjashtimet

1. Çdo person juridik, i cili kryen një aktivitet në sektorin e energjisë elektrike, sipas pikës 2 të këtij neni, duhet të jetë i pajisur me licencën përkatëse të lëshuar nga ERE-ja në përputhje me përkufizimet e këtij ligji.

2. ERE-ja lëshon licenca për veprimtaritë e mëposhtme:

a) prodhimi i energjisë elektrike;

b) operimi i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike;

c) operimi i sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike;

ç) furnizimi me energji elektrike;

d) tregtimi i energjisë elektrike;

dh) operimi i tregut të energjisë elektrike;

e) operimi i impiantit të depozitimit të energjisë;

ë) agregimi.

3. Për kryerjen e çdo aktiviteti, i cili i nënshtrohet licencimit nga ERE-ja, lëshohen licenca të veçanta edhe në rastin kur ato i jepen së njëjtës shoqëri.

4. ERE-ja ka të drejtë të monitorojë, të kërkojë informacion, të vendosë udhëzime ose detyrime raportimi, të kryejë inspektime e hetime dhe të vendosë gjoba ndaj subjekteve që kryejnë ndonjë nga aktivitetet e listuara në pikën 2 të këtij neni, pavarësisht nëse atyre u kërkohet apo jo licencë, me qëllim kryerjen e detyrave të saj, siç përcaktohet në këtë ligj.

5. Njësitë e qeverisjes vendore mund të kryejnë secilën nga veprimtaritë e përcaktuara në pikat 2, 7, 8 dhe 9 të këtij neni nëse janë të pajisura me licencën përkatëse nga ERE-ja, me përjashtim të veprimtarive të përcaktuara në shkronjat "b" dhe "ë" të pikës 2 të këtij neni.

6. Për funksionimin e një linje direkte, nuk kërkohet licencë transmetimi ose shpërndarjeje.

7. Subjektet e mëposhtme nuk janë të detyruara të marrin licencë për prodhimin e energjisë elektrike:

a) klientë aktivë që nuk janë të lidhur me rrjetin kombëtar ose kur lidhja me rrjetin kombëtar lidhet me mirëmbajtjen e njësisë së tij gjeneruese;

b) prodhuesit, përfshirë edhe klientët aktivë të lidhur me rrjetin kombëtar, me kapacitet të instaluar deri në 1 MW.

8. Operatorët e impianteve të depozitimit të energjisë me një kapacitet të instaluar të fuqisë nominale deri në 1 MW nuk janë të detyruar të pajisen me licencë për depozitimin e energjisë.

9. Subjektet e angazhuara në aktivitetet e mëposhtme nuk janë të detyruara të pajisen me licencë në furnizimin me energji elektrike:

a) rishitja e energjisë elektrike, siç përcaktohet në pikën 110 të nenit 3 të këtij ligji;

b) ndarja e energjisë elektrike, siç përcaktohet në pikën 73 të nenit 3 të këtij ligji.

10. ERE-ja përcakton kushtet maksimale të çmimeve, të cilat specifikojnë çmimin maksimal të energjisë elektrike të furnizuar në rastin e rishitjes së energjisë elektrike dhe ndarjes së energjisë elektrike. Vetëm pas përcaktimit të kushteve maksimale të çmimit nga ERE-ja, subjektet mund të angazhohen në rishitje ose ndarje të energjisë elektrike sipas një përjashtimi nga licenca e furnizimit dhe pasi të kenë njoftuar ERE-n.

11. Subjektet e parashikuara në pikën 2, shkronja "ë", pikat 7, 8 dhe 9 të këtij neni, në çdo rast janë të detyruara të respektojnë rregullat e tregut dhe kodet e rrjetit. ERE-ja do të ketë të njëjtat të drejta në lidhje me subjektet e parashikuara në pikat 2, 7, 8 dhe 9 të këtij neni, siç ka në lidhje me të licencuarit.

Neni 41
Kushtet e licencimit

1. ERE-ja përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e çdo licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera:

a) afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili për veprimtaritë e prodhimit, operimit të hapësirës depozituese të energjisë, agregimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;

b) vendndodhjet dhe zonat në të cilat do të kryhen veprimtaritë e licencuara të energjisë elektrike;

c) sigurinë operative dhe qëndrueshmërinë e objekteve, pajisjeve apo rrjetit, në përputhje me rregullat teknike të përcaktuara në nenin 37 të këtij ligji;

ç) kërkesat për natyrën e burimeve parësore të energjisë;

d) kërkesat lidhur me sigurinë kombëtare, mbrojtjen e jetës, pasurisë, shëndetit të qytetarëve, si dhe rendin publik;

dh) kërkesat financiare;

e) mbrojtjen e mjedisit;

ë) nxitjen e eficiencës së energjisë në sektorin e energjisë elektrike;

f) detyrimet e shërbimit publik, siç parashikohet në këtë ligj;

g) nxitjen e një tregu konkurrues të energjisë elektrike;

gj) nëse aplikuesi është i organizuar në përputhje me parimin e ndarjes së veprimtarive dhe ndarjes strukturore, të përcaktuara në këtë ligj.

h) kërkesat për licencim nga furnizues të huaj.

2. Licenca për operimin e sistemit të transmetimit i jepet vetëm një subjekti, i cili certifikohet në përputhje me parashikimet e nenit 65 të këtij ligji.

Neni 42
Procedurat e licencimit

1. ERE-ja miraton rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave, pagesat e aplikimeve për licencë, si dhe informacionin që duhet paraqitur në kërkesën për aplikim për çdo licencë.

2. ERE-ja mund të miratojë procedura të thjeshtuara licencimi për prodhuesit dhe operatorët e hapësirave depozituese të energjisë, të cilët janë lidhur në rrjetin e shpërndarjes dhe veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

3. ERE-ja duhet të sigurojë që çdo procedurë administrative të mos diskriminojë furnizuesit që tashmë janë të regjistruar në një palë kontraktuese tjetër të Komunitetit të Energjisë.

Neni 43
Publikimi për aplikimet për licencë

1. ERE-ja publikon brenda 14 ditëve nga data e kryerjes së aplikimit për marrjen e një licence njoftimin për aplikimin e bërë, në përputhje me procedurën e përcaktuar në rregulloren për procedurat e licencimit.

2. Gjatë marrjes së vendimit, ERE-ja duhet të marrë në shqyrtim dhe të vlerësojë vërejtjet ose kundërshtimet e arsyeshme e të bazuara, të paraqitura nga institucionet publike apo palët e tjera të interesuara, në lidhje me kërkesën për licencë, duke arsyetuar në vendim pranimin ose jo të tyre.

Neni 44
Refuzimi i një licence

1. ERE-ja refuzon dhënien e një licence nëse:

a) aplikuesi nuk përmbush një nga kushtet e përcaktuara në nenin 41 të këtij ligji ose kushtet e përcaktuara në rregulloren përkatëse të saj;

b) aplikuesi është në proces falimentimi ose likuidimi, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi për falimentimin;

c) aplikuesit i është revokuar ose hequr licenca dhe nuk ka përfunduar periudha brenda së cilës është i ndaluar riaplikimi për licencë, siç është përcaktuar në vendimin përkatës të ERE-s për heqjen e licencës.

2. Vendimi i ERE-s arsyeton shkaqet për refuzimin e licencës.

Neni 45
Heqja e një licence

1. ERE-ja heq një licencë kur i licencuari:

a) nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë sipas këtij ligji;

b) shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së aktivitetit të tij;

c) rrezikon shëndetin, jetën dhe pronën e njerëzve;

ç) nuk kryen pagesat e rregullimit të vendosura nga ERE-ja sipas përcaktimeve të nenit 17 të këtij ligji;

d) bëhet financiarisht i paaftë ose kërkon shpalljen e falimentimit;

dh) kërkon revokimin e licencës;

e) pushon së kryeri funksionet e specifikuara në licencë.

2. Kur ERE-ja merr vendimin për heqjen e licencës së të licencuarit që ushtron aktivitete të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike ose furnizimit me energji elektrike, në varësi të detyrimit të shërbimit publik, me qëllim që asetet në pronësi të të licencuarit të vazhdojnë të përdoren për të siguruar furnizimin me energji elektrike të klientëve, ERE-ja, sipas rregullores përkatëse për procedurat e heqjes së licencës, vendos një nga masat e përkohshme si më poshtë:

a) merr vendim për të vendosur nën administrim të kufizuar për një periudhë të caktuar kohore shoqërinë së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohet ushtrimi i aktivitetit dhe operimi i aseteve të saj deri në marrjen e masave sipas pikës 7 të këtij neni;

b) cakton një shoqëri tjetër për kryerjen e veprimtarisë së shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, e cila duhet të përmbushë kushtet përkatëse të licencimit;

c) merr vendim për të vendosur një administrator të përkohshëm të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca, në mënyrë që të sigurohet ushtrimi i aktivitetit dhe operimi i aseteve të saj deri në marrjen e masave, sipas pikës 7 të këtij neni. Në këtë rast, ERE-ja, me propozimin e ministrit, emëron një administrator, i cili është përgjegjës për të siguruar një aktivitet normal, përfshirë edhe operimin e aseteve të shoqërisë, së cilës i është hequr licenca sipas kushteve përkatëse.

3. Për rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, ERE-ja përcakton kushtet dhe detyrimet që duhet të zbatohen nga shoqëria së cilës i hiqet licenca gjatë periudhës së zbatimit të masave të përkohshme.

4. Kur OST-ja nuk arrin të përmbushë kërkesat e ndarjes së pronësisë, ERE-ja vendos masa korrigjuese ndaj OST-së dhe, nëse shkelja vazhdon, ERE-ja mund të hapë procedurën për shqyrtimin e certifikimit.

5. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton procedurën dhe kriteret për emërimin e administratorit përgjegjës për administrimin e përkohshëm të shoqërisë, sipas shkronjës "c" të pikës 2 të këtij neni.

6. Masat e përkohshme të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni zbatohen për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj nga data e heqjes së licencës, zbatimi i të cilave monitorohet nga ERE-ja.

7. Kur ERE-ja heq licencën e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, operimit të depozitimit, operimit të pikës së rikarikimit ose furnizimit të energjisë elektrike, për rastet e parashikuara në shkronjën "b" të pikës 2 të këtij neni, ministria brenda 12 muajve nga data e heqjes së licencës, inicion procedurat e shpronësimit, të cilat realizohen sipas legjislacionit në fuqi të shpronësimit për interes publik.

Neni 46
Transferimi i licencës ose aseteve

1. Transferimi i licencës ose i aseteve të të licencuarit, të cilat shërbejnë për kryerjen e veprimtarive të licencuara, bëhet me miratimin paraprak të ERE-s bazuar në rregulloren e miratuar nga ERE-ja dhe të specifikuar në pikën 2 të këtij neni. Miratimi i ERE-s nuk është i nevojshëm në rastet e transferimit të aseteve me vlerë minimale ose aseteve që nuk janë të lidhura ngushtë me veprimtarinë e licencuar, të specifikuar nga një rregullore e tillë.

2. ERE-ja miraton rregulloren për procedurat e transferimit të aseteve nga shitja, qiraja, transferimi, hipoteka, barrës ose çfarëdolloj disponimi tjetër të objekteve ose aseteve fikse të të licencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, operimit të depozitimit, operimit të pikave të rikarikimit, transmetimit dhe shpërndarjes, duke përfshirë përjashtimet nga miratimi i aseteve me vlerë minimale. Kur miraton një rregullore të tillë, ERE-ja përcakton përjashtime specifike nga detyrimi përkatës për miratim nga ERE-ja, me qëllim lehtësimin e licencimit dhe financimit të projekteve për kapacitete të reja të prodhimit dhe depozitimit të energjisë, me kusht që këto përjashtime të mos cenojnë objektivat e këtij ligji.

Neni 47
Standardet e njësuara të llogarive

1. ERE-ja harton dhe miraton një sistem të njësuar dhe standard të llogarive për të gjithë të licencuarit që veprojnë në tregun e energjisë elektrike, mbështetur në legjislacionin në fuqi dhe

standardet e pranuara ndërkombëtare për kontabilitetin.

2. Raportimi vjetor financiar i të licencuarve tek ERE bëhet sipas këtij sistemi.

Neni 48
Akses ndaj llogarive të licencuarve

1. ERE-ja ka të drejtë të hyjë në llogaritë e shoqërive të energjisë elektrike për aq sa një akses i tillë është i domosdoshëm për kryerjen efektive të funksioneve të saj rregullatore dhe mbikëqyrëse.

2. ERE-ja është e detyruar të ruajë konfidencialitetin e të gjitha informacioneve të ndjeshme tregtare të marra gjatë ushtrimit të detyrave të saj.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, ERE-ja mund ta shpërndajë këtë informacion kur ai është i domosdoshëm për ushtrimin e funksioneve të saj dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Shoqëritë që operojnë në sektorin e energjisë elektrike janë të detyruara të mbajnë llogaritë e tyre në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë nen.

5. Shoqëritë që operojnë në sektorin e energjisë elektrike, pavarësisht nga struktura e tyre e pronësisë ose forma ligjore, janë të detyruara të përgatisin, t'i nënshtrohen auditimit të pavarur dhe të publikojnë llogaritë e tyre vjetore në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon pasqyrat financiare vjetore. Shoqëritë që nuk janë të detyruara ligjërisht të publikojnë llogaritë e tyre vjetore, sipas legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, janë të detyruara të mbajnë një kopje në dispozicion të publikut në selinë e tyre qendrore.

6. Shoqëritë që operojnë në sektorin e energjisë elektrike janë të detyruara, në kontabilitetin e tyre të brendshëm, të mbajnë llogari të ndara për secilën nga aktivitetet e tyre të transmetimit dhe shpërndarjes sikur këto aktivitete të kryheshin nga shoqëri të ndara, me qëllim që të sigurohet mosdiskriminimi, ndërsubvencionimi dhe shtrembërimi i konkurrencës.

7. Shoqëritë që operojnë në sektorin e energjisë elektrike janë të detyruara të mbajnë llogari, të cilat mund të jenë të konsoliduara, për aktivitetet e energjisë elektrike që nuk lidhen me transmetimin ose shpërndarjen, dhe duhet të specifikojnë të ardhurat që rrjedhin nga pronësia e sistemeve të transmetimit ose shpërndarjes. Kur është e përshtatshme, ato duhet të mbajnë edhe llogari të konsoliduara për veprimtaritë që nuk lidhen me sektorin e energjisë elektrike.

8. Llogaritë e brendshme të përmendura në pikën 6 të këtij neni duhet të përfshijnë për çdo aktivitet një bilanc dhe një pasqyrë të ardhurash dhe shpenzimesh.

9. Auditimi i pavarur i përmendur në pikën 5 të këtij neni duhet në veçanti të verifikojë pajtueshmërinë me detyrimin për të shmangur diskriminimin dhe ndërsubvencionimin, siç përcaktohet në pikën 6 të këtij neni.

Neni 49
Detyrimi i shërbimit publik

1. Pa cenuar pikën 2 të këtij neni, shoqëritë elektroenergjetike që operojnë në Republikën e Shqipërisë e ushtrojnë aktivitetin e tyre bazuar në parimet e këtij ligji, me qëllim për të arritur një treg të energjisë elektrike konkurrues, të sigurt dhe të qëndrueshëm nga pikëpamja mjedisore, si dhe jodiskriminues ndërmjet shoqërive përkatëse për sa u përket të drejtave ose detyrimeve, në përputhje me organizimin institucional të shtetit dhe parimin e subsidiaritetit.

2. Duke marrë në konsideratë dispozitat përkatëse të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, duke marrë në konsideratë interesin publik, përcakton kushtet për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik që zbatohen për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike që kryejnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, operimit të impianteve të depozitimit të energjisë dhe furnizimit me energji elektrike, të cilat lidhen me:

a) sigurinë e furnizimit;
b) rregullsinë dhe cilësinë e furnizimit;
c) çmimin e furnizimit;
ç) mbrojtjen e mjedisit;
d) mbrojtjen e konkurrencës;
dh)burimet e rinovueshme të energjisë;
e) eficiencën e energjisë;
ë) mbrojtjen e klimës.

3. ERE-ja vendos ndaj një të licencuari, që ushtron aktivitet në sektorin e energjisë elektrike, për detyrimin e shërbimit publik sipas kushteve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni. Çdo detyrim i shërbimit publik i vendosur nga ERE-ja duhet të përfshihet në licencën e të licencuarit, duke ndjekur

procedurën për lëshimin e një licence të re ose një modifikim të licencës ekzistuese të të licencuarit.

4. Vendosja e një detyrimi shërbimi publik për një të licencuar, sipas pikës 3 të këtij neni, kryhet në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, duke mos penguar hapjen e tregut të energjisë elektrike dhe duhet të garantojë barazinë e aksesit për shoqëritë që operojnë në sektorin e energjisë elektrike të Bashkimit Evropian ndaj klientëve vendas. Për furnizimin në kuadër të shërbimit universal, ky detyrim vendoset përmes një procedure konkurruese.

5. Detyrimet e shërbimit publik, që kanë të bëjnë me përcaktimin e çmimeve për furnizimin me energji elektrike, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në nenin 104 të këtij ligji.

6. Në vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj një të licencuari, ERE-ja merr në konsideratë kapacitetet teknike, financiare dhe organizative të të licencuarit dhe nëse ky i fundit ka ofruar një shërbim publik për të njëjtën zonë ose kategori klientësh, përpara se të vendoset ky detyrim.

7. Të licencuarit nuk do t'i vendoset si detyrim shërbimi publik ndërtimi i një rrjeti ose zone specifike në të cilën nuk ka rrjet para datës së vendosjes së këtij detyrimi, me përjashtim të zonave, objekt i planit rregullues të miratuar sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

8. Vendimi i ERE-s nëpërmjet të cilit detyrimi i shërbimit publik i vendoset të licencuarit duhet:

a) të përcaktojë në mënyrë të qartë detyrimin e shërbimit publik;

b) të identifikojë në mënyrë të qartë të licencuarin në sektorin e energjisë elektrike, i cili do të ngarkohet me detyrimin e shërbimit publik;

c) të marrë në konsideratë mbulimin e kostove të të licencuarit të ngarkuar me këtë detyrim;

ç) të specifikojë natyrën e çdo të drejte ekskluzive ose të veçantë që i është caktuar të licencuarit në fjalë;

d) të përcaktojë kategorinë e klientëve, zonën dhe periudhën për të cilën vendoset detyrimi i shërbimit publik;

dh) të përcaktojë qartësisht mënyrën e financimit dhe përllogaritjes së kompensimit që do të merret nga i licencuari të cilit i është ngarkuar realizimi i detyrimit të shërbimit publik;

e) të përcaktojë dhe të argumentojë në mënyrë të qartë se detyrimi i vendosur përbën kufizimin më të vogël dhe se është proporcional dhe i domosdoshëm për sigurimin e shërbimit publik në fjalë.

9. Kostot e shkaktuara për realizimin e detyrimit të shërbimit publik nga i licencuari njihen nga ERE-ja në miratimin e tarifave për shërbimet e kryera, në përputhje me dispozitat e këtij ligji. ERE-ja përcakton alokimin e kostove të përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik tek klientët fundorë në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese.

10. Për çdo kosto shtesë të shkaktuar nga i licencuari si rezultat i përmbushjes së detyrimit të shërbimit publik, të cilat nuk përfshihen në tarifën e përcaktuar nga ERE-ja, sipas pikës 8 të këtij neni, bëhet kompensim financiar ose forma të tjera kompensimi, të përcaktuara në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese. Kompensimi për këto kosto shtesë përfshin kostot e shkaktuara për kryerjen e detyrimit të shërbimit publik, për shkak të të cilit të licencuarit i ulen të ardhurat që do të siguronte. Çdo kompensim që i bëhet të licencuarit për përmbushjen e detyrimit të shërbimit publik, sipas kësaj pike, vlerësohet nga komisioni i ndihmës shtetërore në bashkëpunim me ERE-n, Ministrinë e Financave dhe Autoritetin e Konkurrencës dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

11. Nëse një pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, refuzon të nënshkruajë një kontratë të miratuar nga ERE-ja, atëherë ERE-ja e vendos hyrjen në fuqi të kontratës dhe detyrimin e palëve për zbatimin e saj brenda një afati 30-ditor.

12. Të licencuarit, të cilëve u vendoset detyrimi i shërbimit publik gjatë kryerjes së veprimtarive të tyre, monitorohen nga ERE-ja për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara.

13. ERE-ja pas vendosjes së detyrimit të shërbimit publik ndaj një të licencuari të sektorit të energjisë elektrike informon Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për të gjitha masat e marra për të plotësuar detyrimet e shërbimit publik, për mbrojtjen e klientëve e të mjedisit, si dhe efektet e mundshme të këtyre masave për konkurrencën, nëse këto masa kërkojnë ose jo një derogim nga Direktiva (BE) 2019/944.

14. ERE-ja njofton Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë periodikisht, çdo dy vjet, për çdo ndryshim në masat e marra në përputhje me pikën 13 të këtij neni.

KREU III
PRODHIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE
DHE DEPOZITIMI I ENERGJISË

Neni 50
Të licencuarit në prodhimin e energjisë elektrike

1. Prodhimi i energjisë elektrike mund të kryhet vetëm nga persona fizikë ose juridikë që janë të pajisur me licencën e prodhimit të energjisë elektrike, përveç kur përcaktohet ndryshe nga dispozitat e tjera të këtij ligji.

2. Në rastin kur prodhuesi i energjisë elektrike është një shoqëri që kontrollohet plotësisht ose pjesërisht nga shteti, Këshilli i Ministrave me vendim përcakton autoritetin publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të tij, i cili duhet të jetë i pavarur nga pronari i sistemit të transmetimit, në kuptimin e nenit 59 të ligjit.

Neni 51
Të licencuarit për depozitimin e energjisë elektrike

1. Depozitimi i energjisë mund të kryhet vetëm nga persona fizikë ose juridikë, të cilët janë të pajisur me licencë për operimin e impiantit të depozitimit të energjisë, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga dispozita të tjera të këtij ligji.

2. Në rastet kur operatori i impiantit të depozitimit të energjisë është një kompani e kontrolluar plotësisht ose pjesërisht nga shteti, Këshilli i Ministrave me vendim përcakton autoritetin publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të tyre, i cili do të jetë i pavarur nga pronari i sistemit të transmetimit, sipas kuptimit të nenit 55 të këtij ligji.

3. Çdo impiant depozitimi energjie që është në zhvillim e sipër ose në operim pa pasur licencë për operimin e impiantit të depozitimit të energjisë në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të njihet dhe do të lejohet të vazhdojë operimin e tij sipas licencës ekzistuese.

4. Operatorët e impianteve të depozitimit të energjisë, të njohura sipas pikës 3 të këtij neni, duhet të aplikojnë për licencë për operimin e impiantit të depozitimit të energjisë brenda 12 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. ERE-ja mund të miratojë procedura të thjeshtuara licencimi për aplikime për licencën për operimin e impianteve të depozitimit të energjisë.

5. Operatori i impiantit të depozitimit të energjisë, i njohur sipas pikës 3 të këtij neni, duhet të njoftojë dhe të regjistrohet në ERE brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

6. Operatori i impiantit të depozitimit të energjisë duhet të përmbushë të gjitha standardet ligjore, teknike, të sigurisë dhe operacionale që zbatohen për të licencuarit për operimin e impianteve të depozitimit të energjisë.

Neni 52
Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese dhe depozituese të energjisë

1. Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese dhe të depozitimit të energjisë, të cilat nuk janë objekt koncesioni ose çdo kapaciteti të ri prodhues deri në 10 MW dhe kapaciteti për depozitimin e energjisë me kapacitet të fuqisë nominale deri në 5 MW miratohet nga ministri. Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese mbi 10 MW dhe i depozitimit të energjisë me kapacitet të fuqisë nominale mbi 5 MW, të cilët nuk janë objekt koncesioni, miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit.

2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton rregullat dhe procedurat për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese dhe të depozitimit të energjisë në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese bazuar në:

a) sigurinë e sistemit të energjisë elektrike, të instalimeve dhe të pajisjeve përkatëse;

b) mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë publike;

c) mbrojtjen e mjedisit;

ç) përdorimin e tokës dhe vendndodhjen;

d) eficiencën e energjisë;

dh) natyrën e burimeve parësore të energjisë;

e) karakteristikat e veçanta të aplikuesit, të tilla si kapacitetet teknike, ekonomike dhe financiare;

ë) pajtueshmërinë me masat për shërbimin publik dhe mbrojtjen e klientëve;

f) kontributin e kapacitetit prodhues për të ulur objektivin për energjinë që do të prodhohet nga burimet e rinovueshme, sipas legjislacionit në fuqi dhe Strategjinë Kombëtare të Energjisë në lidhje me pjesën e energjisë nga burimet e rinovueshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë;

g) kontributin e kapacitetit prodhues për të ulur emetimet e gazrave serrë;

gj) shitjen e energjisë elektrike;

h) vlerën e tarifës që duhet t'i paguhet shtetit nga aplikuesi;

i) vlerën e tarifës "*royalty*" që do të paguajë në favor të shtetit nga mbajtësi i autorizimit;

j) kryerjen e procesit konkurrues për miratimin e ndërtimit të kapaciteteve të prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet dhe centralet gjeotermale;

k) alternativat për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të përcaktuara mbi bazën e vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve ose vlerësimit të fleksibilitetit, të tilla si përgjigjja ndaj kërkesës dhe depozitimi i energjisë.

3. Në rast të refuzimit të lëshimit të autorizimit, arsyet e refuzimit duhet të jenë të justifikuara, objektive dhe jodiskriminuese si dhe duhet t'i njoftohen palës së interesuar. Procedurat e apelimit duhet të jenë të disponueshme për aplikuesit.

4. Ndërtimi i kapaciteteve të reja të prodhimit dhe depozitimit të energjisë elektrike, sipas legjislacionit në fuqi për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, mund t'i nënshtrohet një procedure konkurruese për ndarjen e mbështetjes. Ministri hap procedurat për mbështetjen e kapaciteteve të reja të prodhimit dhe depozitimit të energjisë elektrike.

5. Dispozita e pikës 1 të këtij neni nuk zbatohet për klientët aktivë dhe objektet e depozitimit të energjisë të lidhura me rrjetin kombëtar, me një kapacitet të instaluar deri në 1 MW.

Neni 53

Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese dhe depozituese për menaxhimin e kërkesës dhe eficiencës së energjisë

1. Bazuar në vlerësimin e mjaftueshmërisë të përmendur në pikën 3 të nenit 4 të këtij ligji, për të përmbushur objektivat kombëtarë për menaxhimin e kërkesës dhe eficiencës së energjisë, kur kapaciteti i instaluar është i pamjaftueshëm për të garantuar sigurinë e furnizimit me energji dhe alternativat ndaj kapaciteteve të reja prodhuese dhe depozituese janë vlerësuar në mënyrë të përshtatshme në bazë të vlerësimit të mjaftueshmërisë së burimeve ose vlerësimit të fleksibilitetit, ministri hap procedurat për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese dhe depozituese. Për të adresuar shqetësimet e mbetura lidhur me mjaftueshmërinë e burimeve, ministria mund të vendosë mekanizma kapaciteti vetëm si mjet i fundit.

2. Përpara se sa të hapë procedurat e përmendura në pikën 1 të këtij neni, ministria kryen një studim gjithëpërfshirës të efekteve të mundshme të mekanizmave të tillë tek palët fqinje të Komunitetit të Energjisë, duke u konsultuar të paktën me ta dhe palët e interesit të tyre.

3. Ministria vlerëson nëse një mekanizëm kapaciteti në formën e rezervës strategjike është i aftë të adresojë shqetësimet për mjaftueshmërinë e burimeve. Kur kjo nuk është e mundur, ministria zbaton një lloj tjetër mekanizmi kapaciteti.

4. Ministria nuk vendos mekanizma kapaciteti kur vlerësimi evropian i mjaftueshmërisë së burimeve dhe vlerësimi kombëtar i mjaftueshmërisë së burimeve ose, në mungesë të një vlerësimi kombëtar, vlerësimi evropian, nuk kanë identifikuar shqetësime për mjaftueshmërinë e burimeve.

5. Ministria nuk vendos mekanizma kapaciteti para se plani i zbatimit, në përputhje me pikën 4 të nenit 4 të këtij ligji, të ketë marrë një opinion nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në përputhje me pikën 5 të nenit 4 të këtij ligji.

6. Kur ministria zbaton një mekanizëm kapaciteti, ajo duhet ta rishikojë atë mekanizëm dhe të sigurojë që të mos lidhen kontrata të reja sipas atij mekanizmi kur si vlerësimi evropian i mjaftueshmërisë së burimeve, ashtu edhe vlerësimi kombëtar, ose, në mungesë të një vlerësimi kombëtar, vlerësimi evropian, nuk kanë identifikuar shqetësime për mjaftueshmërinë e burimeve, ose kur plani i zbatimit, në përputhje me pikën 4 të nenit 4 të këtij ligji, nuk ka marrë opinion nga Komisioni, në përputhje me pikën 5 të nenit 4 të këtij ligji.

7. Kur harton mekanizma kapaciteti, ministria përfshin një dispozitë që lejon një fazë të administruar në mënyrë efikase për përfundimin e mekanizmit të kapacitetit, kur nuk lidhen kontrata të reja sipas pikës 6 të këtij neni për tre vjet radhazi.

8. Mekanizmat e kapacitetit duhet të jenë të përkohshëm. Ata duhet të miratohen nga autoriteti kompetent kombëtar për ndihmën shtetërore, pasi të informohet Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, për jo më shumë se 10 vjet. Ata duhet të hiqen gradualisht ose të reduktohet sasia e kapaciteteve të angazhuara mbi bazën e planeve të zbatimit të përmendura në nenin 4 të këtij ligji. Ministria duhet të vazhdojë të zbatojë planin e

zbatimit pas prezantimit të mekanizmit të kapacitetit.

9. Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhet nëpërmjet një procedure konkurruese të bazuar në legjislacionin në fuqi.

10. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton rregullat dhe procedurat për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese dhe të depozitimit, për menaxhimin e kërkesës dhe eficiencës së energjisë, mbështetur në parashikimet e pikës 2 të nenit 52 të këtij ligji, të cilat duhet të përfshijnë parimet e mekanizmit të kapacitetit, parimet e projektimit të tij, standardin e besueshmërisë dhe pjesëmarrjen ndërkufitare.

11. Çdo mekanizëm kapaciteti duhet:

a) të jetë i përkohshëm;

b) të mos krijojë shtrembërime të panevojshme të tregut dhe të mos kufizojë tregtinë ndërzonale;

c) të mos shkojë përtej asaj që është e nevojshme për të adresuar shqetësimet për mjaftueshmërinë e burimeve, siç përmendet në nenin 4 të këtij ligji;

ç) të zgjedhë ofruesit e kapacitetit përmes një procesi transparent, jodiskriminues dhe konkurrues;

d) të ofrojë stimuj për ofruesit e kapacitetit që të jenë të disponueshëm në kohë stresi të pritur të sistemit;

dh) të sigurojë që shpërblimi të përcaktohet përmes procesit konkurrues;

e) të përcaktojë kushtet teknike për pjesëmarrjen e ofruesve të kapacitetit përpara procesit të përzgjedhjes;

ë) të jetë i hapur për pjesëmarrjen e të gjitha burimeve që janë të afta të ofrojnë performancën teknike të kërkuar, përfshirë ruajtjen e energjisë dhe menaxhimin e anës së kërkesës;

f) të aplikojë penalitete të përshtatshme për ofruesit e kapacitetit që nuk janë të disponueshëm në kohë stresi të sistemit.

12. Ministria është autoriteti përgjegjës që përcakton një vlerësim të vetëm të vlerës së ngarkesës së humbur për zonën e ofertimit, jo më vonë se data 31 dhjetor 2027. Ky vlerësim publikohet në faqen zyrtare të ministrisë.

13. Kur një zonë ofertimi përbëhet nga territore të më shumë se një pale kontraktuese, ministria dhe autoriteti tjetër përgjegjës i palës përkatëse përcaktojnë një vlerësim të vetëm të vlerës së ngarkesës së humbur për atë zonë ofertimi. Në përcaktimin e vlerës së vetme të ngarkesës së humbur, autoritetet rregullatore ose autoritetet e tjera kompetente të caktuara duhet të zbatojnë metodologjinë e ACER-it për vlerën e ngarkesës së humbur. Një vlerësim i tillë do të rishikohet periodikisht çdo pesë vjet ose më herët kur ata vërejnë një ndryshim të rëndësishëm.

14. Kur zbatohen mekanizmat e kapacitetit, duhet të jetë në fuqi një standard besueshmërie, i cili tregon nivelin e nevojshëm të sigurisë së furnizimit në mënyrë transparente. Në rastin e zonave të ofertimit ndërkufitar, këto standarde besueshmërie duhet të vendosen bashkërisht nga autoritetet përkatëse.

15. Standardi i besueshmërisë përcaktohet nga ministria pas propozimit nga ERE-ja. Standardi i besueshmërisë bazohet në metodologjinë e zhvilluar nga ENTSO-E në përputhje me nenin 23(6) të rregullores (BE) 2019/943 dhe të miratuar nga ACER-i.

Neni 54

Pjesëmarrja ndërkufitare në mekanizmat e kapacitetit

1. Mekanizmat e kapacitetit, përveç rezervave strategjike dhe, kur është teknikisht e mundur, edhe rezervat strategjike, janë të hapura për pjesëmarrje të drejtpërdrejtë ndërkufitare të ofruesve të kapacitetit të vendosur në një shtet anëtar ose palë kontraktuese tjetër, në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë nen.

2. Shtetet anëtare dhe palët kontraktuese sigurojnë që kapaciteti i huaj, i aftë të ofrojë performancë teknike të barasvlershme me kapacitetet vendase, të ketë mundësinë të marrë pjesë në të njëjtin proces konkurrues si kapaciteti vendas. Palët kontraktuese kërkojnë që kapaciteti i huaj të jetë i vendosur në një shtet anëtar ose palë kontraktuese që ka lidhje të drejtpërdrejtë rrjeti me palën kontraktuese që zbaton mekanizmin.

3. Ministria nuk duhet të pengojë kapacitetin që ndodhet në territorin e saj të marrë pjesë në mekanizmat e kapacitetit të shteteve anëtare ose palëve kontraktuese të tjera.

4. Pjesëmarrja ndërkufitare në mekanizmat e kapacitetit nuk duhet të ndryshojë, të modifikojë ose të ndikojë oraret ndërzonale ose flukset fizike midis shteteve anëtare ose palëve kontraktuese. Këto orare dhe flukse duhet të përcaktohen vetëm nga rezultatet e alokimit të kapacitetit, në përputhje me

parimet e përgjithshme të alokimit të kapacitetit dhe menaxhimit të ngarkesës.

5. Ofruesit e kapacitetit duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë në më shumë se një mekanizëm kapaciteti. Kur ofruesit e kapacitetit marrin pjesë në më shumë se një mekanizëm kapaciteti për të njëjtën periudhë dorëzimi, ata duhet të marrin pjesë deri në nivelin e pritshëm të disponueshmërisë së ndërlidhjes dhe përputhjes së mundshme të stresit të sistemit midis sistemit ku zbatohet mekanizmi dhe sistemit ku ndodhet kapaciteti i huaj, në përputhje me metodologjinë e zhvilluar nga ENTSO-E, sipas shkronjës "a" të pikës 11 të nenit 26 të rregullores (BE) 2019/943, dhe të miratuar nga ACER-i.

6. Ofruesit e kapacitetit duhet të paguajnë penalitete për padisponueshmëri kur kapaciteti i tyre nuk është i disponueshëm. Kur ofruesit e kapacitetit marrin pjesë në më shumë se një mekanizëm kapaciteti për të njëjtën periudhë dorëzimi, ata duhet të paguajnë penalitete të shumëfishta për padisponueshmëri kur nuk janë në gjendje të përmbushin angazhimet e shumëfishta.

7. Për qëllimin e dhënies së rekomandimeve ndaj operatorëve të sistemeve të transmetimit, qendrat rajonale të koordinimit të krijuara sipas nenit 35 të rregullores (BE) 2019/943 duhet të llogarisin çdo vit kapacitetin maksimal hyrës të disponueshëm për pjesëmarrjen e kapacitetit të huaj. Kjo llogaritje duhet të marrë parasysh disponueshmërinë e pritshme të ndërlidhjes dhe përputhjen e mundshme të stresit të sistemit në sistemin ku zbatohet mekanizmi dhe sistemin ku ndodhet kapaciteti i huaj. Një llogaritje e tillë është e detyrueshme për çdo kufi zone ofertimi.

8. Ministria duhet të sigurojë që kapaciteti hyrës i përmendur në pikën 7 të këtij neni të alokohet tek ofruesit e kapacitetit të kualifikuar në mënyrë transparente, jodiskriminuese dhe të bazuar në treg.

9. Kur mekanizmat e kapacitetit lejojnë pjesëmarrje ndërkufitare në dy shtete anëtare ose palë kontraktuese fqinje, çdo e ardhur që rrjedh nga alokimi i përmendur në pikën 8 të këtij neni, duhet t'u takojë operatorëve të sistemeve të transmetimit përkatës dhe të ndahet midis tyre, në përputhje me metodologjinë e zhvilluar nga ENTSO-E sipas shkronjës "b" të nenit 26(11) të rregullores (BE) 2019/943 dhe të miratuar nga ACER-i ose në përputhje me një metodologji të përbashkët të miratuar nga të dy autoritetet rregullatore përkatëse. Nëse shteti anëtar ose pala kontraktuese fqinje nuk zbaton një mekanizëm kapaciteti ose zbaton një mekanizëm kapaciteti që nuk është i hapur për pjesëmarrje ndërkufitare, pjesa e të ardhurave duhet të miratohet nga autoriteti kompetent kombëtar i shtetit anëtar ose palës kontraktuese ku zbatohet mekanizmi i kapacitetit, pasi të ketë kërkuar opinionin e autoriteteve rregullatore të shteteve anëtare ose palës kontraktuese fqinje. Operatorët e sistemeve të transmetimit duhet t'i përdorin këto të ardhura për qëllimet e përcaktuara në nenin 19(2) të rregullores (BE) 2019/943.

10. Operatori i Sistemit të Transmetimit ku ndodhet kapaciteti i huaj duhet:

a) të përcaktojë nëse ofruesit e interesuar të kapacitetit mund të ofrojnë performancën teknike të kërkuar nga mekanizmi i kapacitetit në të cilin synojnë të marrin pjesë dhe të regjistrojë atë ofrues kapaciteti si të kualifikuar në një regjistër të ngritur për këtë qëllim nga ENTSO-E, në përputhje me nenin 26 të rregullores (BE) 2019/943;

b) të kryejë kontrolle të disponueshmërisë;

c) të njoftojë operatorin e sistemit të transmetimit në shtetin anëtar ose palën kontraktuese që zbaton mekanizmin e kapacitetit për informacionin e marrë sipas pikës 2 të këtij neni dhe shkronjave "a" dhe "b" të kësaj pike;

Ofruesi përkatës i kapacitetit duhet të njoftojë pa vonesë operatorin e sistemit të transmetimit për pjesëmarrjen e tij në një mekanizëm kapaciteti të huaj.

11. Autoritetet rregullatore përkatëse duhet të verifikojnë nëse kapacitetet janë llogaritur në përputhje me metodologjinë e zhvilluar nga ENTSO-E, sipas shkronjës "a" të nenit 26(11) të rregullores (BE) 2019/943 dhe të miratuar nga ACER-i.

12. Autoritetet rregullatore duhet të sigurojnë që pjesëmarrja ndërkufitare në mekanizmat e kapacitetit të organizohet në mënyrë efektive dhe jodiskriminuese. Ato duhet të parashikojnë veçanërisht rregullime administrative të përshtatshme për zbatimin e pagesave për mosdisponueshmëri ndërkufitare.

13. Kapacitetet e alokuara sipas pikës 8 të këtij neni duhet të jenë të transferueshme midis ofruesve të kualifikuar të kapacitetit. Ofruesit e kualifikuar të kapacitetit duhet të njoftojnë regjistrin e përmendur në shkronjën "a" të pikës 10 të këtij neni për çdo transferim të tillë.

14. Regjistri i përmendur në shkronjës "a" të pikës 10 të këtij neni duhet të jetë i hapur për të gjithë ofruesit e kualifikuar të kapacitetit, sistemet që zbatojnë mekanizma kapaciteti dhe operatorët e sistemeve të tyre të transmetimit.

Neni 55
Të drejtat dhe përgjegjësitë e prodhuesit

1. Prodhuesit kanë të drejtë:

a) të përdorin në centralet e tyre elektrike burimet parësore të energjisë në përputhje me teknologjinë e prodhimit, karakteristikat teknike dhe kushtet e mbrojtjes së mjedisit, të cilat përcaktohen në licencat e tyre dhe legjislacionin në fuqi;

b) të kryejnë aktivitete të depozitimit të energjisë dhe të zotërojnë, të zhvillojnë, të menaxhojnë ose të operojnë objekte të depozitimit të energjisë në përputhje me kushtet e licencës së tyre, pavarësisht dispozitave të nenit 40 të këtij ligji;

c) të shesin energji elektrike dhe të sigurojnë shërbimet ndihmëse dhe balancuese në tregun e energjisë elektrike sipas rregullave të tregut dhe rregulloreve të tjera të ERE-s;

ç) të sigurojnë komunikime në kohë reale me objektet e tyre prodhuese, klientët ose nivelet operative të kontrollit;

d) të kenë akses në rrjetet e transmetimit dhe të shpërndarjes, duke paguar tarifat përkatëse të miratuara nga ERE-ja;

dh) të ofrojnë shërbime ndihmëse

2. Prodhuesit janë të detyruar:

a) të përmbushin kushtet e licencës, përkufizimet e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

b) të veprojnë në përputhje me urdhrat e lëshuar nga operatori i sistemit;

c) të njoftojnë menjëherë operatorin e sistemit për çdo situatë që rrezikon ose mund të rrezikojë sigurinë e furnizimit ose përmbushjen e çdo detyrimi tjetër kontraktual;

ç) t'u ofrojnë kapacitetin e tyre, sipas parimeve të tregut, të gjithë klientëve të tregut me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike, përfshirë ata që janë të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik;

d) të japin të dhëna në përputhje me detyrimin për transparencë dhe monitorim të tregut.

3. Të gjithë prodhuesit që operojnë në zbatim të ligjit për sektorin e energjisë elektrike ose ligjit për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, me përjashtim të atyre që janë objekt koncesioni ose që janë dhënë nëpërmjet procedurave konkurruese, janë të detyruar të paguajnë një tarifë "*royalty*" jo më pak se 2% të prodhimit vjetor ose të paguajnë shumën ekuivalente të saj.

4. Në rastet kur prodhuesi do të përmbushë ose duhet të përmbushë detyrimin për tarifën "*royalty*" nëpërmjet pagesës, këto të ardhura arkëtohen në një llogari të veçantë buxhetore.

5. Tarifat e mbledhura nga "*royalty*" derdhen në buxhetin e shtetit dhe menaxhohen sipas procedurave të parashikuara në legjislacionin në fuqi.

6. Rregullat e përdorimit të të ardhurave, të përcaktuara në pikën 5 të këtij neni, miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për energjinë pas marrjes së mendimit nga ministri përgjegjës për financat.

Neni 56
Rezerva e lëndës djegëse ose e kapacitetit prodhues

1. Prodhuesit e energjisë elektrike janë të detyruar të mbajnë rezerva të veçanta të lëndëve djegëse ose kapacitete rezervë prodhuese të energjisë elektrike, në mënyrë që të sigurojnë një furnizim të qëndrueshëm të klientëve.

2. Lloji dhe sasia e rezervës së lëndës djegëse ose e kapacitetit rezervë për tipa të ndryshëm të centraleve prodhuese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Kostot e rezervës së lëndës djegëse dhe të kapacitetit rezervë të një prodhuesi konsiderohen si kosto operimi.

Neni 57
Të drejtat dhe përgjegjësitë e operatorit të hapësirës së depozitimit të energjisë elektrike

1. Operatorët e hapësirave depozituese të energjisë kanë të drejtë:

a) të kryejnë aktivitetin e depozitimit të energjisë dhe të kenë në pronësi, të zhvillojnë, të menaxhojnë ose të operojnë hapësira të depozitimit të energjisë elektrike, në varësi të kushteve të licencës së tyre, nëse aplikohet, dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;

b) të shesin energji elektrike dhe të sigurojnë shërbimet ndihmëse dhe balancuese në tregun e energjisë elektrike, sipas rregullave të tregut dhe rregulloreve të tjera të ERE-s;

c) të sigurojnë komunikime në kohë reale me hapësirat e tyre të depozitimit të energjisë, me klientët ose me nivelet operative të kontrollit;

ç) të kenë akses në rrjetet e transmetimit dhe të shpërndarjes, duke paguar tarifat përkatëse të miratuara nga ERE-ja.

2. Operatorët e hapësirave depozituese të energjisë janë të detyruar:

a) t'u përmbahen kushteve të licencës, dispozitave të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) të veprojnë në përputhje me urdhrat e marrë nga operatori i sistemit;

c) të njoftojnë menjëherë operatorin e sistemit për çdo situatë që rrezikon ose mund të rrezikojë sigurinë e furnizimit ose përmbushjen e ndonjë detyrimi tjetër kontraktual;

ç) të japin të dhëna në përputhje me detyrimin e transparencës dhe monitorimit të tregut.

KREU IV
TRANSMETIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 58
Operatori i Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit është personi juridik i licencuar për kryerjen e veprimtarisë së transmetimit të energjisë elektrike, i cili ka në pronësi sistemin e transmetimit dhe respekton parimin e pavarësisë, të përcaktuar në nenin 59 të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim autoritetin publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, i cili duhet të jetë i pavarur nga aktivitetet e prodhimit ose furnizimit, në kuptim të nenit 59 të këtij ligji.

Neni 59
Ndarja e pronësisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit e ushtron veprimtarinë e tij të ndarë nga aktivitetet e tjera në sektorin e energjisë elektrike, si: prodhimi, shpërndarja, tregtimi dhe furnizimi me energji elektrike, agregimi dhe pikat e rikarikimit, në përputhje me parimet dhe kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk do të ketë në pronësi, nuk do të zhvillojë, nuk do të menaxhojë ose nuk do të operojë hapësira depozituese energjie, përveç rasteve kur zbatohen përjashtimet e përcaktuara në nenin 91 të këtij ligji.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit ka në pronësi sistemin e transmetimit të energjisë elektrike, i cili përfshin linjat 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, nënstacionet e transformimit të energjisë me nivele të transformimit të tensionit të lartë 400 kV, 220 kV dhe 110 kV, zbarrat në të gjitha nënstacionet 110/TM kV, deri në pikën e matjes së energjisë në anën 110 kV të transformatorëve 110/TM kV, duke përfshirë pajisjet kyçëse/shkyçëse të linjave 110 kV.

3. I njëjti individ nuk ka të drejtë që në të njëjtën kohë:

a) të ushtrojë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një të licencuar, që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike e të gazit natyror dhe të ushtrojë kontroll ose ndonjë të drejtë tjetër ndaj Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit;

b) të ushtrojë kontroll në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe të ushtrojë kontroll ose të ushtrojë ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike e të gazit natyror;

c) të emërojë anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit apo rrjetin e transmetimit dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ushtrojë kontroll apo ndonjë të drejtë mbi një të licencuar që kryen ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit të energjisë elektrike dhe të gazit natyror;

ç) të jetë anëtar i këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve të tjera që përfaqësojnë të licencuarin pranë të licencuarve që kryejnë veprimtarinë e prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike e të gazit natyror dhe veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose rrjetit të transmetimit.

Për qëllime të këtij neni, termi "prodhimi ose furnizimi me energji elektrike dhe gaz natyror" do të mbulojë edhe operimin e hapësirës depozituese të energjisë, operimin e pikës së rikarikimit dhe agregimit, siç përcaktohet në këtë ligj.

4. Ndalimet e parashikuara në shkronjat "a", "b" dhe c" të pikës 3 të këtij neni zbatohen për:

a) kompetencën për të ushtruar të drejtën e votës;

b) kompetencën për të emëruar anëtarët e këshillit mbikëqyrës, bordit drejtues ose organeve që përfaqësojnë të licencuarin;

c) të drejtën e mbajtjes së një pjese të shumicës së aksioneve.

5. Detyrimi i parashikuar në pikën 3 të këtij neni konsiderohet i përmbushur nëse dy ose më shumë shoqëri që kanë rrjetet e tyre të transmetimit kanë krijuar një sipërmarrje të përbashkët, e cila vepron si operator i sistemit të transmetimit në dy ose më shumë vende. Asnjë shoqëri tjetër nuk mund të jetë pjesë e kësaj sipërmarrjeje të përbashkët, përveç nëse kompania përcaktohet si operator i sistemit të transmetimit i pavarur dhe është e certifikuar sipas kushteve të parashikuara në këtë ligj.

6. Kur individi i përcaktuar në pikën 3 të këtij neni është një organ publik që kontrollohet nga shteti, dy organe të veçanta publike që ushtrojnë kontroll, njëri mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit ose mbi rrjetin e transmetimit dhe tjetri mbi të licencuarin që kryen funksionin e prodhimit ose të furnizimit të energjisë elektrike, do të konsiderohen sikur nuk janë i njëjti individ.

7. Operatori i Sistemit të Transmetimit, i cili ka qenë pjesë e një shoqërie të integruar vertikalisht, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, merr masat që të mos përhapë apo të mos transferojë informacione të ndjeshme tregtare te njësitë e tjera të shoqërisë së mëparshme të integruar vertikalisht, që kryejnë ndonjë nga veprimtaritë e prodhimit apo furnizimit me energji elektrike dhe të gazit natyror.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit harton një program pajtueshmërie që përcakton masat që do të ndërmerren për të garantuar ndalimin e veprimeve diskriminuese, si dhe për të siguruar që respektimi i programit të monitorohet siç duhet. Programi i pajtueshmërisë përcakton detyrimet specifike të punonjësve për përmbushjen e këtij objektivi. Operatori i Sistemit të Transmetimit paraqet tek ERE brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji për miratim programin e pajtueshmërisë. Pa cenuar kompetencat e ERE-s, pajtueshmëria me programin do të monitorohet në mënyrë të pavarur nga një zyrtar i pajtueshmërisë (në vijim referuar për qëllime të këtij neni: Zyrtari i pajtueshmërisë).

9. Këshilli Mbikëqyrës i Operatorit të Sistemit të Transmetimit emëron një zyrtar të pajtueshmërisë, me miratimin e ERE-s. ERE-ja mund ta refuzojë miratimin e zyrtarit të pajtueshmërisë vetëm për arsye të mungesës së pavarësisë ose aftësisë profesionale. Zyrtari i pajtueshmërisë mund të jetë person fizik ose juridik.

10. ERE në lidhje me Operatorin e Sistemit të Transmetimit miraton rregulloren për rregullat dhe procedurat e detajuara të emërimit të zyrtarit të pajtueshmërisë, duke përfshirë kriteret përkatëse të pavarësisë, sjelljen e zyrtarit të pajtueshmërisë, përgjegjësitë dhe detyrimet e raportimit dhe aksesin e zyrtarit të pajtueshmërisë në të dhënat e nevojshme për të kryer detyrën e tij.

Neni 60

Të drejtat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit ka të drejtë të faturojë dhe të arkëtojë tarifën e transmetimit, të miratuar më parë nga ERE-ja, sipas metodologjisë së tarifave.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka të drejtë të blejë dhe të shesë energji elektrike, përveçse për të mbuluar humbjet e energjisë në rrjetin e transmetimit dhe për të ofruar shërbime ndihmëse dhe balancuese.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit shkëmben ose ndan shërbimet e balancimit me operatorët e sistemit të transmetimit të vendeve fqinje për të rregulluar frekuencën brenda rrjetit, sipas marrëveshjeve operative midis operatorit të sistemit të transmetimit të rajonit dhe dispozitave të këtij ligji për promovimin e bashkëpunimit rajonal.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit instalon dhe përpunon të gjitha llojet e informacionit, komunikimeve dhe sistemeve, duke përfshirë edhe sistemin e internetit *wireless*, të nevojshëm për sistemin e transmetimit. Në varësi të mundësive, një pjesë e infrastrukturës së fibrave optike dhe/ose kapaciteteve të rrjetit të komunikimit me shpejtësi të lartë mund të jepen për përdorim pa dëmtuar dhe rrezikuar aktivitetet dhe rrjetet e tjera brenda kuadrit ligjor përkatës, në përputhje me opinionin e ERE-s.

5. ERE-ja, me kërkesë të operatorëve të sistemit të transmetimit, mund të lejojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit të kryejë aktivitete të tjera nga ato të parashikuara nga ky ligj, kur aktivitete të tilla janë të nevojshme që Operatori i Sistemit të Transmetimit të përmbushë detyrimet e tij sipas këtij ligji, me kusht që ERE të ketë vlerësuar domosdoshmërinë e një përjashtimi të tillë, duke marrë parasysh se:

a) aktiviteti është i nevojshëm për kryerjen e detyrimeve ligjore të OST-së;

b) asnjë palë tjetër në treg nuk ka shprehur interes për të ofruar shërbimin, i konfirmuar nëpërmjet një procedure tenderimi transparente dhe jodiskriminuese;

c) ERE kryen një vlerësim paraprak dhe miraton zyrtarisht aktivitetin bazuar në kriteret e publikuara;

ç) aktiviteti nuk është i bazuar në treg dhe nuk duhet të shtrembërojë konkurrencën ose të krijojë konflikte interesi;

d) sigurohet kontabilitet i veçantë i kostos dhe transparencë e plotë financiare, duke përfshirë detyrimet e publikimit kur është e përshtatshme.

6. Parashikimet e pikës 5 të këtij neni nuk cenojnë të drejtën e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për të zotëruar, për të zhvilluar, për të menaxhuar ose për të operuar rrjete të tjera përveç rrjeteve të energjisë elektrike, kur Operatorit të Sistemit të Transmetimit i është dhënë një e drejtë e tillë.

7. Në rastet kur palët e treta kërkojnë spostimin e shtyllave ose të linjave të transmetimit në rrjetin e transmetimit 110 kV, 220 kV dhe 400 kV, kërkesat e tilla duhet të shqyrtohen, të miratohen dhe të zbatohen në përputhje me rregulloren e Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Pala e tretë kërkuese merr përsipër kostot e plota të spostimit.

Neni 61

Detyrat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit ka këto detyra kryesore:

a) siguron aftësinë afatgjatë të sistemit për të plotësuar kërkesën e arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike, duke operuar, ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase sistemin e transmetimit, në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, në bashkëpunim të ngushtë me operatorët fqinjë të sistemit të transmetimit dhe të sistemit të shpërndarjes;

b) kontribuon në sigurinë e furnizimit nëpërmjet sigurisë së sistemit dhe kapaciteteve të qëndrueshme të transmetimit, kontribuon në sigurinë e furnizimit nëpërmjet kapacitetit të mjaftueshëm adekuat të transmetimit dhe besueshmërisë së sistemit;

c) përdor rrjetin e transmetimit në përputhje me rregullat dhe standardet teknike;

ç) siguron ofrimin e shërbimeve të sistemit në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, në bazë të parimit të kostos dhe ndikimit mjedisor më të ulët;

d) menaxhon flukset e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, duke marrë parasysh shkëmbimet e energjisë elektrike me sisteme të tjera të ndërlidhura. Për këtë qëllim, Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për sigurimin e një sistemi të sigurt, të besueshëm dhe efikas të energjisë elektrike dhe, në këtë kontekst, për sigurimin e disponueshmërisë së të gjitha shërbimeve të nevojshme ndihmëse, duke përfshirë ato që ofrohen nga reagimi i kërkesës dhe pajisjet e depozitimit të energjisë, për aq sa një disponueshmëri e tillë është e pavarur nga çdo sistem tjetër transmetimi me të cilin sistemi i tij është i ndërlidhur;

dh) ofron ndaj përdoruesve të sistemit të gjithë informacionin e nevojshëm për përdorimin efektiv të rrjetit;

e) siguron lidhjen e përdoruesve të sistemit me rrjetin e transmetimit, në bazë të parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në fuqi që rregullojnë procesin e lidhjes në rrjet;

ë) harton dhe publikon procedura transparente, të efektshme dhe jodiskriminuese për lidhjen e përdoruesve dhe të centraleve të reja të prodhimit të energjisë dhe hapësirave depozituese të energjisë me sistemin e transmetimit;

f) lidh kontrata me qëllim sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe për rezervën e energjisë dhe shërbimet e tjera ndihmëse, të kërkuara për operimin e sigurt të sistemit, bazuar në parimet e transparencës, mosdiskriminimit, rregullave të tregut dhe kostos minimale;

g) harton dhe publikon kodin e transmetimit;

gj) kryen balancimin e sistemit, mbështetur në parime objektive, transparente e jodiskriminuese, në përputhje me kodin e transmetimit dhe rregullat e tregut;

h) zbaton rregulla objektive, transparente dhe jodiskriminuese për alokimin e kapaciteteve transmetuese ndërkufitare;

i) shkëmben informacionin e kërkuar me operatorët e transmetimit të sistemeve fqinje, me qëllim funksionimin e sigurt dhe efikas, zhvillimin e koordinuar dhe ndërveprueshmërinë e sistemit të ndërlidhur;

j) krijon një mekanizëm të trajtimit të ankesave për çështjet që kanë të bëjnë me aksesin dhe përdorimin e rrjetit të transmetimit;

k) menaxhon kapacitetin e kufizuar me operatorët e rrjeteve të transmetimit fqinje, në bazë të kritereve objektive, transparente e jodiskriminuese dhe publikon informacionin për kapacitetet ndërkufitare në përputhje me dispozitat e nenit 76 të këtij ligji;

l) ruan informacionin e nevojshëm për vlerësimin e parametrave të cilësisë së furnizimit me energji elektrike në sistemin e transmetimit, bazuar në rregullat për cilësinë e furnizimit me energji elektrike, përfshirë informacionin për sigurimin e furnizimit, cilësinë e tensionit, cilësinë e shërbimit dhe informacione të tjera, të përcaktuara nga ERE-ja;

ll) kryen një analizë vjetore të humbjeve në rrjetin e transmetimit, si dhe harton e zbaton masat e reduktimit të humbjeve dhe masa të tjera të eficiencës së energjisë;

m) mbledh pagesat që lidhen me kapacitetet e kufizuara dhe pagesat që lidhen me mekanizmin e kompensimit ndërmjet OST-ve të shteteve fqinje;

n) raporton çdo katër muaj në ERE për:

i. ndërprerjet e planifikuara, të nevojshme për mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit;

ii. kërkesat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të përdoruesve të sistemit për zhvillimin e rrjetit të transmetimit;

iii. funksionimin e sistemit të transmetimit;

iv. alokimin dhe përdorimin e kapaciteteve ndërkufitar, në përputhje me detyrimet kontraktuale me OST-të e vendeve fqinje;

v. përdorimin e të ardhurave të siguruara nga kufizimet e kapaciteteve ndërkufitare;

vi. kontratat për sigurinë e shërbimeve ndihmëse, të lidhura me ofruesit e këtij shërbimi;

vii. kontratat e energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit.

nj) organizon menaxhimin e të dhënave, duke përfshirë zhvillimin e sistemeve të menaxhimit të të dhënave, sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave, në përputhje me rregullat në fuqi dhe pa cenuar kompetencat e autoriteteve të tjera;

o) prokuron shërbime ndihmëse për të garantuar sigurinë operacionale, duke iu nënshtruar dispozitave të detajuara në nenin 70 të këtij ligji;

p) miraton dhe zbaton një kornizë për bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet qendrave rajonale të koordinimit;

q) merr pjesë në vlerësimet evropiane dhe kombëtare të mjaftueshmërisë së burimeve;

r) ngre mekanizma koordinimi dhe shkëmbimi informacioni për të garantuar sigurinë e rrjeteve në kontekstin e menaxhimit të kongjestionit;

rr) bashkëpunon me ministrinë si autoritet kompetent i caktuar për planifikimin e gatishmërisë ndaj riskut dhe menaxhimin e tij, siç parashikohet në nenin 6 të këtij ligji;

s) bashkëpunon me ACER-in, u përmbahet vendimeve të tij, merr parasysh rekomandimet dhe opinionet e tij, si dhe i jep informacion sipas kërkesës;

sh) bashkëpunon me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe të licencuarit e tjerë për aq sa i kërkohet të kryejë detyrat e tij sipas këtij ligji;

t) kryen digjitalizimin e sistemit të transmetimit;

th) siguron mosdiskriminim ndërmjet përdoruesve të sistemit ose klasave të përdoruesve të sistemit, veçanërisht në favor të ndërmarrjeve të lidhura me të.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit paraqet raporte vjetore pranë ERE-s në përputhje me rregulloren për cilësinë e furnizimit me energji elektrike.

Neni 62
Dhënia e informacionit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit vendos mekanizma koordinimi dhe shkëmbimi informacioni për të siguruar sigurinë e rrjeteve në kontekstin e menaxhimit të ngarkesës.

2. Standardet e sigurisë, operimit dhe planifikimit, të përdorura nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, duhet të bëhen publike. Informacioni i publikuar përfshin një skemë të përgjithshme për llogaritjen e kapacitetit total të transferimit dhe marzhit të besueshmërisë së transmetimit, bazuar në karakteristikat elektrike dhe fizike të rrjetit. Këto skema miratohen nga autoriteti rregullator.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit publikon vlerësime të kapacitetit të disponueshëm të transferimit për çdo ditë, duke treguar çdo kapacitet

të disponueshëm tashmë të rezervuar. Publikimet bëhen në intervale të caktuara para ditës së transferimit dhe përfshijnë në çdo rast vlerësime për javën dhe muajin e ardhshëm, si dhe një tregues sasior të besueshmërisë së pritshme të kapacitetit të disponueshëm.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit publikon të dhëna relevante për parashikimin e agreguar dhe kërkesën aktuale mbi disponueshmërinë dhe përdorimin aktual të aseteve gjeneruese dhe të ngarkesës, për disponueshmërinë dhe përdorimin e rrjeteve e të ndërlidhjeve mbi fuqinë balancuese dhe kapacitetin rezervë, si dhe për disponueshmërinë e fleksibilitetit. Për disponueshmërinë dhe përdorimin aktual të aseteve të vogla gjeneruese e të ngarkesës përdoren të dhëna të vlerësuara të agreguara.

5. Pjesëmarrësit e tregut përkatës i sigurojnë Operatorit të Sistemit të Transmetimit të dhënat relevante.

6. Shoqëritë elektroenergjetike gjeneruese, që zotërojnë ose operojnë asete gjeneruese, ku të paktën një aset gjenerues ka një kapacitet të instaluar prej të paktën 250 MW, ose që kanë një portofol që përfshin të paktën 400 MW asete gjeneruese, duhet t'i mbajnë në dispozicion të autoritetit rregullator, autoritetit kombëtar të konkurrencës dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për pesë vjet të gjitha të dhënat orare për çdo impiant, që janë të nevojshme për të verifikuar të gjitha vendimet operacionale të dispeçerimit dhe sjelljen e ofertimit në bursat e energjisë, ankandet e ndërlidhjes, tregjet e rezervës dhe tregjet jashtë bursës. Informacioni për çdo impiant dhe çdo orë që ruhet përfshin, por i pakufizuar vetëm në, të dhëna mbi kapacitetin gjenerues të disponueshëm dhe rezervat e angazhuara, përfshirë alokimin e atyre rezervave të angazhuara në nivel impianti, në kohën kur kryhen ofertimet dhe kur ndodh prodhimi.

7. Operatori i Sistemit të Transmetimit shkëmben rregullisht një set të dhënash të mjaftueshme dhe të sakta për rrjetin dhe flukset e ngarkesës për të mundësuar llogaritjet e fluksit të ngarkesës për çdo operator të sistemit të transmetimit në zonën përkatëse. I njëjti set të dhënash, sipas kërkesës, vihet në dispozicion të autoriteteve rregullatore, Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, shteteve anëtare dhe palëve kontraktuese. Autoritetet rregullatore, shtetet anëtare, palët kontraktuese dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë e trajtojnë setin e të dhënave në mënyrë konfidenciale dhe sigurojnë që trajtimi konfidencial të zbatohet edhe nga çdo konsulent që kryen punë analitike me kërkesën e tyre, mbi bazën e atyre të dhënave.

Neni 63

Bashkëpunimi rajonal i Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit krijon dhe mirëmban në një masë të mundshme bashkëpunimin rajonal së bashku me ENTSO-E. Në veçanti merr pjesë në përgatitjen e një plani 2-vjeçar investimesh rajonale dhe mund të marrë vendime bazuar në këtë plan investimi rajonal.

2. Kur merr pjesë në bashkëpunime rajonale, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të promovojë marrëveshje operacionale për të siguruar menaxhimin optimal të rrjetit dhe të nxisë zhvillimin e shkëmbimeve të energjisë, alokimin e koordinuar të kapaciteteve ndërkufitare përmes zgjidhjeve të bazuara në treg dhe jodiskriminuese, duke u kushtuar vëmendjen e duhur avantazheve specifike të ankandeve implicite për alokimet afatshkurtra, si dhe integrimin e mekanizmave të balancimit të energjisë dhe të rezervës së energjisë.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit së bashku me operatorë të tjerë përkatës të sistemeve të transmetimit në të njëjtin rajon operativ të sistemit SOR marrin pjesë në krijimin dhe operimin e RCC sipas rregullores EU 2019/43 ose, kur është e përshtatshme, mund të bashkohet ose të marrë shërbime nga një RCC tashmë i krijuar. RCC-ja do të plotësojë rolin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, duke kryer detyrat me rëndësi rajonale që i janë caktuar.

4. ERE-ja miraton rregullat e detajuara për pjesëmarrjen e Operatorit të Sistemit të Transmetimit në bashkëpunimin rajonal dhe në veçanti në funksionimin e RCC-së bazuar në parimet e mëposhtme:

a) mosdiskriminimin dhe transparencën, duke siguruar trajtim të barabartë të operatorëve të sistemit dhe akses të përshtatshëm në informacionin përkatës në përputhje me kërkesat e konfidencialitetit.

b) sigurinë dhe besueshmërinë e sistemit duke siguruar që bashkëpunimi rajonal të kontribuojë në funksionimin e sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të sistemit të energjisë elektrike.

c) eficiencën dhe efektivitetin e kostos duke siguruar përdorimin optimal të burimeve dhe minimizimin e kostove për sistemin dhe përdoruesit e tij.

ç) integrimin e tregut rajonal duke siguruar përputhshmëri me zhvillimin e një tregu konkurrues dhe të integruar të energjisë elektrike.

d) mbikëqyrjen rregullatore dhe përgjegjshmërinë duke siguruar që Operatori i Sistemit të Transmetimit të mbetet subjekt i mbikëqyrjes së ERE-s dhe të përputhet me rregullat e miratuara.

5. Operatorët e sistemit të transmetimit duhet t'u ofrojnë qendrave të tyre rajonale të koordinimit informacionin e nevojshëm për të kryer detyrat e tyre.

6. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të zbatojë veprimet e koordinuara të lëshuara nga RCC-ja, përveç rasteve kur zbatimi i veprimeve të koordinuara do të rezultonte në shkelje të kufijve të sigurisë operative në lidhje me detyrën e RCC-së që ka të bëjë me:

a) kryerjen e llogaritjes së koordinuar të kapacitetit;

b) kryerjen e analizave të koordinuara të sigurisë.

7. Kur Operatori i Sistemit të Transmetimit vendos të mos zbatojë një veprim të koordinuar për arsyet e përcaktuara në këtë pikë, ai duhet t'ia raportojë në mënyrë transparente arsyet e detajuara RCC-së dhe operatorëve të sistemit të transmetimit të SOR-it pa vonesa të panevojshme.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet t'u përmbahet rekomandimeve të lëshuara nga RCC-ja në lidhje me:

a) krijimin e modeleve të përbashkëta të rrjetit;

b) mbështetjen për vlerësimin e qëndrueshmërisë së planeve mbrojtëse e të planeve të rivendosjes të operatorëve të sistemit të transmetimit;

c) kryerjen e parashikimeve rajonale të mjaftueshmërisë së sistemit nga një javë në avancë deri të paktën një ditë në avancë dhe përgatitjen e veprimeve për uljen e riskut;

ç) kryerjen e koordinimit të planifikimit rajonal të ndërprerjeve;

d) trajnimin dhe certifikimin e stafit që punon për RCC-në;

dh) mbështetjen e koordinimit dhe optimizimit të rivendosjes rajonale;

e) kryerjen e analizave dhe raportimeve pas operimit dhe pas çrregullimeve;

ë) përcaktimin rajonal të kapacitetit rezervë;

f) lehtësimin e prokurimit rajonal të kapacitetit balancues;

g) mbështetjen për operatorët e sistemit të transmetimit, me kërkesën e tyre, në optimizimin e marrëveshjeve ndëroperatore të sistemit të transmetimit;

gj) kryerjen e detyrave që lidhen me identifikimin e skenarëve rajonalë të krizave të energjisë elektrike;

h) kryerjen e detyrave që lidhen me vlerësimet e mjaftueshmërisë sezonale;

i) llogaritjen e vlerës për kapacitetin maksimal të hyrjes në dispozicion për pjesëmarrjen e kapacitetit të huaj në mekanizmat e kapacitetit;

j) mbështetjen për operatorët e sistemit të transmetimit në identifikimin e nevojave për kapacitet të ri transmetimi, për përmirësimin e kapacitetit ekzistues të transmetimit ose alternativat e tyre.

9. Kur Operatori i Sistemit të Transmetimit vendos të devijojë nga një rekomandim i RCC-së, ai duhet të paraqesë një arsyetim për vendimin e tij te RCC-ja dhe tek operatorët e tjerë të sistemit të transmetimit të SOR-it pa vonesë të panevojshme.

10. Kur merr pjesë në funksionimin e RCC-së, në përputhje pikën 3 të këtij neni, Operatori i Sistemit të Transmetimit, së bashku me operatorët e tjerë përkatës të sistemit të transmetimit në SOR, duhet të marrë masat e nevojshme për të mbuluar përgjegjësinë që lidhet me ekzekutimin e detyrave të RCC-së.

Neni 64

Miratimi dhe rishikimi i veprimeve dhe rekomandimeve të koordinuara

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit, në bashkëpunim me operatorët e tjerë të sistemeve të transmetimit në rajonin e operimit të sistemit, zhvillon një procedurë për miratimin e rishikimin e veprimeve e të rekomandimeve të koordinuara të lëshuara nga qendrat rajonale të koordinimit.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit zbaton aktivitetet e koordinuara ose rekomandimet e propozuara nga qendrat rajonale të koordinimit, përveç rasteve kur zbatimi i tyre do të cenonte kriteret e sigurisë ose do të sillte pasoja të papranueshme për operatorin.

3. Nëse Operatori i Sistemit të Transmetimit vendos të mos zbatojë një aktivitet ose rekomandim

të koordinuar, ai njofton menjëherë dhe në mënyrë transparente qendrën rajonale të koordinimit kompetente dhe operatorët e tjerë të sistemeve të transmetimit në rajonin e operimit të sistemit, duke dhënë arsyet e justifikuara për vendimin e tij.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit nis një rishikim të aktiviteteve dhe rekomandimeve të koordinuara të propozuara nga qendrat rajonale të koordinimit ose me nismën e tij ose në bashkëpunim me operatorët e tjerë të sistemeve të transmetimit në rajonin e operimit të sistemit.

5. Në rastin e përmendur në pikën 4 të këtij neni, operatori i sistemit të transmetimit nuk pezullon zbatimin e aktivitetit ose rekomandimit të koordinuar deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, përveç rasteve kur zbatimi do të cenonte kriteret e sigurisë ose do të sillte pasoja të papranueshme për operatorin.

Neni 65

Certifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Para se të licencohet për kryerjen e veprimtarisë së operimit të sistemit të transmetimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të certifikohet sipas procedurës së përcaktuar në këtë nen.

2. ERE-ja përcakton kërkesat për aplikim për certifikim të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, përfshirë dokumentacionin e nevojshëm që provon përmbushjen e kushteve sipas nenit 58 të këtij ligji. Aplikimi për certifikim paraqitet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit në përputhje me kërkesat e miratuara nga ERE.

3. ERE-ja merr një vendim për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit brenda 4 muajve nga data e aplikimit dhe dorëzimit të të gjithë dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar. Pas përfundimit të kësaj periudhe, certifikimi konsiderohet i dhënë. Vendimi i shprehur ose i nënkuptuar i ERE-s bëhet efektiv vetëm pas përfundimit të procedurës së përcaktuar në pikën 7 të këtij neni.

4. ERE-ja mund të kërkojë nga Operatori i Sistemit të Transmetimit çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e këtij detyrimi. ERE-ja ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar.

5. ERE-ja njofton Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për fillimin e procedurave për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe merr vendim brenda 2 muajve nga data e njoftimit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, duke marrë në konsideratë rekomandimet e tij.

6. Nëse vendimi përfundimtar i ERE-s është i ndryshëm nga rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ERE-ja duhet të publikojë dhe të arsyetojë shkaqet e mospranimit të tyre, duke informuar Sekretariatin për këtë vendim.

7. Vendimi i shprehur ose i nënkuptuar për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit i njoftohet pa vonesë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë nga ERE së bashku me të gjithë informacionin përkatës në lidhje me atë vendim dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit njofton ERE-n për çdo veprim që planifikon të kryejë për të cilin mund të kërkohet një rivlerësim lidhur me pajtueshmërinë e tij me kushtet e parashikuara në nenin 59 të këtij ligji.

9. ERE-ja monitoron përputhshmërinë e veprimtarisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj. ERE-ja rishikon procedurën e certifikimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni në rastet e mëposhtme:

a) pas njoftimit nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmetimit në përputhje me pikën 8 të këtij neni;

b) me nismën e tij kur ka një dyshim të arsyeshëm se një ndryshim i planifikuar ndikon në të drejtat ose në kontrollin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe mund të çojë në shkelje të dispozitave të nenit 72 të këtij ligji, ose në rastet kur një shkelje e tillë mund të ketë ndodhur.

c) me një kërkesë të arsyetuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

10. ERE-ja dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë kërkojnë nga operatorët e sistemeve të transmetimit dhe shoqëritë që kryejnë funksione gjenerimi ose furnizimi çdo informacion të rëndësishëm për përmbushjen e detyrave të tyre sipas këtij neni.

11. ERE-ja dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë garantojnë ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit tregtar të ndjeshëm.

Neni 66
Certifikimi në lidhje me shtetet e treta

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit njofton ERE-n në rastet kur një person ose disa persona të një vendi të tretë, që nuk është anëtar i Komunitetit të Energjisë, marrin kontrollin e këtij operatori.

2. ERE-ja njofton Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë në rastet e mëposhtme:

a) kur kërkohet certifikimi nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, i cili kontrollohet nga një person ose persona nga një vend i tretë;

b) për çdo rrethanë që do të rezultojë nëse një ose disa persona nga një vend i tretë marrin kontrollin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

3. ERE-ja shqyrton kërkesën për certifikimin brenda 4 muajve nga data e njoftimit nga Operatori i Sistemit të Transmetimit. ERE-ja ka të drejtë të refuzojë certifikimin nëse:

a) Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk përmbush kërkesat për pavarësinë dhe ndarjen e përcaktuar në këtë ligj;

b) dhënia e certifikimit vë në rrezik sigurinë e furnizimit me energji elektrike të vendit apo vendeve anëtare të Komunitetit të Energjisë. Kur ERE-ja gjykon mbi këtë bazë, merr në konsideratë:

i. të drejtat dhe detyrimet e Komunitetit të Energjisë në lidhje me atë vend të tretë, që rrjedhin sipas së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të gjitha marrëveshjet e lidhura me një ose më shumë vende të treta, ku Komuniteti i Energjisë është palë dhe që adreson çështjet e sigurisë së furnizimit me energji;

ii. të drejtat dhe detyrimet e Shqipërisë lidhur me atë vend të tretë, që rrjedhin nga marrëveshjet e lidhura me të, për aq sa ato janë në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë;

iii. fakte dhe rrethana të tjera specifike të lidhura me vendin e tretë në fjalë.

4. Para marrjes së vendimit ERE-ja kërkon mendim nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë nëse:

a) subjekti i interesuar përmbush kërkesat e pavarësisë;

b) dhënia e certifikimit nuk vë në rrezik sigurinë e furnizimit me energji të vendeve të Komunitetit të Energjisë.

5. Në përgatitjen e opinionit, Sekretariati mund të kërkojë qëndrimin e ERE-s, ministrisë dhe palëve të interesuara. Sekretariati e jep mendimin e tij brenda 4 muajve pas marrjes së kërkesës në përputhje me pikën 4 të këtij neni. Në mungesë të opinionit të Sekretariatit, brenda këtij afati ERE-ja vijon procedurat për marrjen e vendimit.

6. Vendimi përkatës i ERE-s për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose refuzimin për dhënien e certifikimit i njoftohet menjëherë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë së bashku me të gjitha informacionet e nevojshme.

7. Vendimi përfundimtar për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, kontrolli i të cilit merret nga një ose disa persona të një vendi të tretë, miratohet dhe publikohet në përputhje me nenin 65 të këtij ligji.

Neni 67
Zhvillimi i rrjetit të transmetimit

1. OST-ja duhet të paraqesë për miratim në ERE një plan dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, i cili është hartuar pas konsultimeve me palët e interesuara, duke përfshirë modelimin e rrjetit të integruar, zhvillimin e skenarëve dhe një vlerësim të qëndrueshmërisë së sistemit. Pasi të miratohet nga ERE-ja, Operatori i Sistemit të Transmetimit publikon planin 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit në faqen e tij zyrtare të internetit.

2. Plani i zhvillimit të rrjetit duhet të përfshijë:

a) kërkesën dhe ngarkesën ekzistuese dhe atë të parashikuar, si dhe kapacitetet e transmetimit ekzistuese dhe të parashikuara;

b) planifikimin urban dhe rajonal të zonës ku do të vendosen instalimet e transmetimit;

c) planet e investimeve për rrjetet rajonale në nivel të palëve të Komunitetit të Energjisë;

ç) legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit;

d) potencialin për përdorimin e përgjigjes ndaj kërkesës, hapësirave depozituese të energjisë ose burimeve të tjera si alternativa ndaj zgjerimit të sistemit, si dhe konsumit të pritshëm, tregtisë me vendet e tjera dhe investimeve për rrjetet në mbarë Bashkimin Evropian dhe në rajon.

3. Plani i zhvillimit të rrjetit duhet të përmbajë:

a) masa efikase, në mënyrë që të garantojë përshtatshmërinë e sistemit dhe sigurinë e furnizimit;

b) mjetet financiare të parashikuara për investimet në sistemin e transmetimit;

c) të gjitha investimet e miratuara dhe të identifikojë investimet e reja, të cilat duhet të zbatohen në tre vjetët e ardhshëm;

ç) afate të përcaktuara për të gjitha projektet e investimeve;

d) informacion për pjesëmarrësit e tregut për infrastrukturën transmetuese kryesore që duhet të ndërtohet ose të përmirësohet gjatë dhjetë vjetëve të ardhshëm.

4. Të paktën çdo dy vjet, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të rishikojë planin 10-vjeçar të zhvillimit dhe ta paraqesë atë për miratim tek ERE. ERE-ja duhet të rishikojë planin 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit dhe duhet të konsultohet me përdoruesit përkatës aktualë ose potencialë të sistemit në një mënyrë të hapur dhe transparente. ERE-ja është e lirë të përcaktojë fushëveprimin e përdoruesve përkatës aktualë ose potencialë të sistemit. Personat ose shoqëritë që pretendojnë të jenë përdorues përkatës aktualë ose potencialë të sistemit kanë të drejtë të kërkojnë pjesëmarrjen e tyre në konsultime me ERE-n pasi të mbështesin pretendimet e tyre. ERE-ja duhet të publikojë rezultatin e procesit të konsultimit, në veçanti nevojat e mundshme për investime. ERE-ja gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse plani 10-vjeçar i zhvillimit të rrjetit i mbulon të gjitha nevojat e investimeve të identifikuara gjatë procesit të konsultimit dhe nëse është në përputhje me planin jodetyrues 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit në të gjithë Bashkimin Evropian. Nëse lind ndonjë dyshim në lidhje me përputhshmërinë me planin e zhvillimit të rrjetit në të gjithë Bashkimin Evropian, ERE-ja duhet të konsultohet me ACER-in. Nëse ERE-ja, si rezultat i shqyrtimit të saj, vëren se nuk janë përmbushur kushtet e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të këtij neni, i kërkon Operatorit të Sistemit të Transmetimit të plotësojë dhe/ose të ndryshojë planin 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit.

5. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet t'i paraqesë ERE-s, së bashku me kërkesën për miratimin e tarifës, planin e përditësuar të investimeve për vitin pasardhës. Nëse Operatori i Sistemit të Transmetimit aplikon për një tarifë për periudhën rregullatore më të gjatë se 1 vit, programi i investimeve duhet të përmbajë një analizë të investimeve të planifikuara për periudhën rregullatore përkatëse.

6. Kur ERE-ja vëren se Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk ka kryer një investim, përveç arsyeve mbizotëruese përtej kontrollit të tij, i cili sipas planit 10-vjeçar të zhvillimit të rrjetit duhej të kryhej në tre vjetët në vijim dhe ERE-ja gjykon se investimi është ende i nevojshëm dhe mund të financohet pa penguar funksionimin normal të rrjetit, atëherë ERE kërkon të marrë të paktën një nga masat e mëposhtme:

a) që Operatori i Sistemit të Transmetimit të kryejë dhe të realizojë investimin në fjalë;

b) organizon një procedurë konkurruese për të realizuar investimin në fjalë, të hapur për çdo investitor;

c) e detyron Operatorin e Sistemit të Transmetimit të pranojë një rritje të kapitalit për të financuar investimet e nevojshme dhe u lejon investitorëve të pavarur të marrin pjesë në kapital.

7. Kur ERE-ja merr masat sipas shkronjës "b" të pikës 6, të këtij neni, ajo mund ta detyrojë Operatorin e Sistemit të Transmetimit të zbatojë një nga masat e mëposhtme:

a) siguron financim nga çdo palë e tretë;

b) kërkon ndërtimin nga çdo palë e tretë;

c) ndërton asete të reja;

ç) menaxhon asetet e reja pas ndërtimit.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet t'u ofrojë investitorëve të gjithë informacionin e nevojshëm për të realizuar investimin, duhet të lidhë asete të reja me rrjetin e transmetimit dhe në përgjithësi duhet të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të lehtësuar zbatimin e projektit të investimit. Marrëveshjet financiare përkatëse do të jenë objekt miratimi nga ERE-ja.

9. ERE-ja harton dhe miraton rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të zhvillimit.

10. Kur ERE-ja prezanton ndonjë nga masat e listuara në pikën 6 të këtij neni, tarifat përkatëse mbulojnë kostot e investimeve në fjalë.

Neni 68

Dispeçerimi i energjisë elektrike

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për harmonizimin e dispeçerimit të energjisë elektrike nga impiantet e prodhimit, impiantet e depozitimit të energjisë, ofruesit e shërbimit të përgjigjes ndaj kërkesës dhe përdorimin e linjave të interkoneksionit, pa ndikuar në detyrimet kontraktuale të furnizimit me energji elektrike.

2. Dispeçerimi i energjisë elektrike nga impiantet gjeneruese të energjisë dhe ofruesit e shërbimit të përgjigjes ndaj kërkesës duhet të jetë jodiskriminues, transparent dhe në bazë të tregut, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe, në përputhje me rregulloren e BE-së 2019/943.

3. Dispeçerimi i energjisë elektrike nga impiantet e prodhimit, impiantet e depozitimit të energjisë, ofruesit e përgjigjes ndaj kërkesës dhe përdorimi i linjave të interkoneksionit bëhet në mbështetje të kodit të transmetimit, rregullave të tregut, siç referohen në nenin 122 të këtij ligji dhe rregulloreve të tjera në fuqi të miratuara nga ERE-ja.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet t'i japë përparësi energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet që përdorin burime të rinovueshme të energjisë, për aq sa mund të lejojë siguria e operimit të rrjetit kombëtar të energjisë, bazuar në kritere transparente dhe jodiskriminuese dhe kur këto impiante prodhimi janë:

a) impiante të prodhimit që përdorin burime të rinovueshme të energjisë dhe kanë një kapacitet të instaluar elektrik më të vogël se 200 kW;

b) projekte demonstruese për teknologji inovative, që i nënshtrohen miratimit nga ERE-ja, me kusht që një përparësi e tillë të jetë e kufizuar në kohën dhe masën e nevojshme për arritjen e qëllimeve të demonstrimit; ose

c) impiante prodhimi që përdorin koogjenerim me eficiencë të lartë, me një kapacitet të instaluar elektrik më të vogël se 400 kW.

5. Pa cenuar kontratat e lidhura para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, impiantet e prodhimit që përdorin burime të rinovueshme të energjisë ose koogjenerim me eficiencë të lartë dhe që janë vënë në punë deri më 31 dhjetor 2025 dhe në momentin e vënies në punë kanë qenë subjekt i dispeçerimit me përparësi, do të vazhdojnë të përfitojnë nga dispeçerimi me përparësi. Dispeçerimi me përparësi nuk do të zbatohet më për këto impiante prodhimi nga data në të cilën impianti i prodhimit u nënshtrohet modifikimeve të rëndësishme, të cilat konsiderohen se ndodhin të paktën kur kërkohet një marrëveshje e re lidhjeje ose kur rritet kapaciteti prodhues i impiantit.

6. Dispeçerimi me përparësi nuk duhet të rrezikojë operimin e sigurt të sistemit të energjisë elektrike dhe nuk duhet të përdoret si justifikim për reduktimin e kapaciteteve ndërzonale përtej asaj që parashikohet në pikën 4 të nenit 74 të këtij ligji, si dhe do të bazohet në kritere transparente dhe jodiskriminuese.

7. Në rastet kur Operatori i Sistemit të Transmetimit apo Operatori i Sistemit të Shpërndarjes merr masa për të reduktuar kapacitetin prodhues nga impiantet që përdorin burimet e rinovueshme të energjisë, për të garantuar sigurinë e operimit të sistemit elektroenergjetik dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike të klientëve, informon ERE-n për masat e marra dhe propozon masa të tjera korrigjuese që do të ndërmarrë në të ardhmen, në mënyrë që të parandalojë reduktimet e panevojshme të kapaciteteve prodhuese.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të përmbushë kërkesat për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit, përfshirë edhe kapacitetet e interkoneksionit, në përputhje me parashikimet e kodeve të rrjetit.

9. Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të vendosë të mos aplikojë dispeçerimin me përparësi në impiantet e prodhimit, të referuara në shkronjën "a" të pikës 4 të këtij neni, me një fillim të operimit të paktën gjashtë muaj pas këtij vendimi, ose të zbatojë një kapacitet minimal më të ulët se ai i përcaktuar në shkronjën "a" të pikës 4 të këtij neni, me kusht që:

a) ERE-ja të ketë përcaktuar se në vend ka një mirëfunksionim të tregut brenda të njëjtës ditë, shitjes me shumicë dhe atij të balancimit, të cilët janë plotësisht të aksesueshëm për të gjithë pjesëmarrësit e tregut, bazuar në kritere objektive dhe jodiskriminuese. Për përcaktimin e sa më sipër, ERE-ja merr parasysh, ndër të tjera, nëse vëllimet e tregtuara në tregun brenda së njëjtës ditë në lidhje me madhësinë fizike të tregut janë në një nivel të krahasueshëm me ato që vërehen në tregjet brenda së njëjtës ditë të vendeve të Bashkimit Evropian. Për këtë qëllim, ERE-ja ka të drejtë të zgjedhë një ose më shumë tregje brenda së njëjtës ditë të Bashkimit Evropian për të kryer një vlerësim të përshtatshëm krahasues;

b) rregullat e dispeçerimit dhe menaxhimit të kongjestionit janë transparente për të gjithë pjesëmarrësit e tregut;

c) pjesa e energjisë nga burimet e rinovueshme në vend në konsumin final bruto është të paktën 50%;

ç) ministria njofton derogimin e planifikuar në Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë, duke paraqitur në detaje mënyrën sesi plotësohen kushtet

e përcaktuara në shkronjat "a", "b" dhe "c" të kësaj pike;

d) ERE-ja publikon derogimin e planifikuar, përfshirë arsyetimin e detajuar për dhënien e këtij derogimi, duke marrë parasysh në mënyrë të duhur mbrojtjen e informacionit me ndjeshmëri tregtare, kur është e nevojshme.

Neni 69
Ridispeçerimi i energjisë elektrike

1. Ridispeçerimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe ridispeçerimi i përgjigjes ndaj kërkesës do të bazohen në kritere objektive, transparente dhe jodiskriminuese. Ata do të jenë të hapur për të gjitha teknologjitë e prodhimit të energjisë elektrike, për të gjitha format e depozitimit të energjisë dhe për të gjithë përgjigjen ndaj kërkesës, përfshirë edhe ato të vendosura në palë të tjera të Komunitetit të Energjisë, përveç rasteve kur kjo nuk është teknikisht e realizueshme.

2. Burimet që i nënshtrohen ridispeçerimit përzgjidhen ndërmjet impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, depozitimit të energjisë ose përgjigjes ndaj kërkesës, duke përdorur mekanizma të bazuar në treg dhe kompensohen financiarisht. Ofertat për energjinë balancuese të përdorura për ridispeçerim nuk përdoren për përcaktimin e çmimit të energjisë balancuese.

3. Ridispeçerimi jashtë mekanizmave të tregut për prodhimin e energjisë elektrike, depozitimin e energjisë dhe përgjigjen ndaj kërkesës mund të përdoret vetëm kur:

a) nuk ekziston një alternativë e bazuar në treg;

b) janë përdorur të gjitha burimet e disponueshme të bazuara në treg;

c) numri i impianteve të disponueshme të prodhimit të energjisë elektrike, të depozitimit të energjisë ose të përgjigjes ndaj kërkesës është shumë i ulët për të garantuar konkurrencë efektive në zonën ku ndodhen objektet e përshtatshme për ofrimin e shërbimit;

ç) situata aktuale e rrjetit çon në kongjestion në mënyrë të rregullt dhe të parashikueshme, në mënyrë që ridispeçerimi i bazuar në treg do të çonte në oferta strategjike të përsëritura, duke rritur nivelin e kongjestionit të brendshëm, dhe është miratuar një plan veprimi për adresimin e këtij kongjestioni, sipas pikës 2 të nenit 74 të këtij ligji, ose kapaciteti minimal i disponueshëm për tregtinë ndërzonale është në përputhje me pikën 4 të nenit 74 të këtij ligji.

4. Operatorët e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes i raportojnë të paktën një herë në vit ERE-s për:

a) nivelin e zhvillimit dhe efektivitetin e mekanizmave të ridispeçerimit të bazuar në treg;

b) arsyet, volumet në MWh dhe llojin e burimeve të prodhimit të prekur nga ridispeçerimi;

c) masat e marra për të reduktuar nevojën për ridispeçerim në ulje, veçanërisht për energjinë nga burime të rinovueshme ose koogjenerim me efikasitet të lartë.

ERE-ja ia paraqesë raportin ECRB-së dhe publikon një përmbledhje të të dhënave, së bashku me rekomandime për përmirësim, kur është e nevojshme.

5. Në përputhje me kërkesat që lidhen me ruajtjen e besueshmërisë dhe sigurisë së rrjetit dhe mbi bazën e kritereve transparente dhe jodiskriminuese të përcaktuara nga ERE-ja, OST-ja dhe OSSH-ja:

a) garantojnë aftësinë e rrjeteve të transmetimit e të shpërndarjes për të transmetuar energjinë elektrike të prodhuar nga burime të rinovueshme ose nga koogjenerimi me efikasitet të lartë, me ridispeçerim sa më minimal të mundshëm, pa penguar planifikimin e rrjetit që të marrë në konsideratë një nivel të kufizuar ridispeçerimi, kur operatori i sistemit të transmetimit ose i shpërndarjes është në gjendje të demonstrojë në mënyrë transparente se kjo është më efikase nga pikëpamja ekonomike;

b) marrin masa të përshtatshme operacionale që lidhen me rrjetin dhe tregun, me qëllim minimizimin e ridispeçerimit në ulje të energjisë elektrike të prodhuar nga burime të rinovueshme ose nga koogjenerimi me efikasitet të lartë;

c) sigurojnë që rrjetet e tyre të jenë mjaftueshëm fleksibël, në mënyrë që të jenë në gjendje t'i menaxhojnë ato.

6. Kur përdoret ridispeçerimi në ulje jashtë mekanizmave të tregut, zbatohen këto parime:

a) impiantet e prodhimit që përdorin burime të rinovueshme i nënshtrohen ridispeçerimit në ulje vetëm nëse nuk ekziston asnjë alternativë tjetër ose nëse zgjidhje të tjera do të çonin në kosto joproporcionale ose në rreziqe serioze për sigurinë e rrjetit;

b) energjia elektrike e prodhuar nga koogjenerimi me efikasitet të lartë i nënshtrohet ridispeçerimit në ulje vetëm nëse, përveç ridispeçerimit në ulje të impianteve që përdorin burime të rinovueshme, nuk ekziston asnjë alternativë tjetër ose nëse zgjidhje të tjera do të çonin në kosto joproporcionale ose rreziqe serioze për sigurinë e rrjetit;

c) energjia e vetëprodhuar nga impiantet që përdorin burime të rinovueshme ose koogjenerim me efikasitet të lartë, e cila nuk injektohet në rrjetin e transmetimit ose të shpërndarjes, nuk i nënshtrohet ridispeçerimit në ulje, përveç nëse asnjë zgjidhje tjetër nuk do të mund të zgjidhte problematikat e sigurisë së rrjetit;

ç) ridispeçerimi në ulje sipas shkronjave "a", "b" dhe "c" të kësaj pike duhet të jetë i arsyetuar në mënyrë të plotë dhe transparente. Arsyetimi përfshihet në raportin sipas pikës 4 të këtij neni.

7. Kur përdoret ridispeçerimi jashtë mekanizmave të tregut, ai i nënshtrohet kompensimit financiar nga operatori i sistemit që kërkon ridispeçerimin, në favor të operatorit të impiantit të prodhimit, depozitimit të energjisë ose përgjigjes ndaj kërkesës që i nënshtrohet ridispeçerimit, përveç rasteve të prodhuesve që kanë pranuar një marrëveshje lidhjeje sipas së cilës nuk ekziston garanci për furnizim të qëndrueshëm të energjisë.

Ky kompensim financiar do të jetë të paktën i barabartë me elementin më të lartë ndër elementet e mëposhtme ose me një kombinim të tyre nëse zbatimi vetëm i elementit më të lartë do të çonte në një kompensim të pajustifikueshëm të ulët ose të lartë:

a) kostot shtesë operative të shkaktuara nga ridispeçerimi, si p.sh. kostot shtesë të karburantit në rastin e ridispeçerimit në rritje, ose sigurimi i nxehtësisë rezervë në rastin e ridispeçerimit në ulje të impianteve që përdorin koogjenerim me efikasitet të lartë;

b) të ardhurat neto nga shitja e energjisë elektrike në tregun e ditës në avancë që impianti i prodhimit, magazinimit të energjisë ose përgjigjes ndaj kërkesës do të kishte gjeneruar në mungesë të kërkesës për ridispeçerim.

Kur jepet mbështetje financiare për impiantet e prodhimit, depozitimit të energjisë ose përgjigjes ndaj kërkesës mbi bazën e sasisë së energjisë së prodhuar ose të konsumuar, mbështetja financiare që do të ishte përfituar në mungesë të kërkesës për ridispeçerim do të konsiderohet pjesë e të ardhurave neto.

Neni 70

Prokurimi i humbjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit, shërbimet e balancimit dhe shërbimet ndihmëse

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit prokuron energjinë elektrike për të mbuluar humbjet në rrjet, shërbimet e balancimit ose ato ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit. Prokurimi nuk i nënshtrohet legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, por i nënshtrohet:

a) prokurimit të energjisë për mbulimin e humbjeve nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, që kryhet përmes procedurës konkurruese, jodiskriminuese dhe transparente, duke përfshirë tregun e ditës në avancë dhe tregun brenda të nëjtës ditë;

b) prokurimit të shërbimeve të balancimit nëpërmjet procedurave transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg;

c) lejimit të pjesëmarrjes të të gjitha shoqërive elektroenergjetike të kualifikuara dhe pjesëmarrësve të tregut, duke përfshirë pjesëmarrësit e tregut që ofrojnë energji nga burimet e rinovueshme, pjesëmarrësit e tregut të angazhuar në përgjigjen ndaj kërkesës, operatorët e objekteve të depozitimit të energjisë dhe pjesëmarrësit e tregut të përfshirë në agregim.

Për qëllime të shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, ERE-ja dhe Operatori i Sistemit të Transmemetimit, në bashkëpunim me pjesëmarrësit përkatës të tregut të energjisë elektrike, përcaktojnë kërkesat teknike për pjesëmarrjen në këto tregje.

2. Shkronja "b" e pikës 1 të këtij neni zbatohet për sigurimin e shërbimeve ndihmëse jo të lidhura me frekuencën nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, përveç rasteve kur ERE-ja ka vlerësuar se ofrimi i këtyre shërbimeve mbi bazë tregu nuk është ekonomikisht eficient dhe ka dhënë një derogim. Në veçanti, kuadri rregullator duhet të garantojë që Operatori i Sistemit të Transmetimit të jetë në gjendje të sigurojë këto shërbime nga ofruesit e përgjigjes së kërkesës ose nga depozitimi i energjisë, si dhe të nxisë përdorimin e masave të eficiencës së energjisë kur këto shërbime reduktojnë në mënyrë kosto-efektive nevojën për rritje ose zëvendësim të kapaciteteve elektrike dhe

mbështesin funksionimin eficient dhe të sigurt të sistemit të transmetimit.

3. OST, me miratimin e ERE-s, ose vetë ERE, nëpërmjet një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës që përfshin të gjithë përdoruesit përkatës të sistemit dhe operatorët e sistemit të shpërndarjes, përcakton specifikimet për shërbimet ndihmëse jo të lidhura me frekuencën që prokurohen dhe, kur është e përshtatshme, produkte të standardizuara tregu për këto shërbime, të paktën në nivel kombëtar.

Specifikimet garantojnë pjesëmarrjen efektive dhe jodiskriminuese të të gjithë pjesëmarrësve në treg, përfshirë pjesëmarrësit që ofrojnë energji nga burime të rinovueshme, ata që angazhohen në përgjigjen ndaj kërkesës, operatorët e impianteve të depozitimit të energjisë dhe pjesëmarrësit që veprojnë përmes agregimit.

Operatori i Sistemit të Transmetimit shkëmben të gjithë informacionin e nevojshëm dhe koordinohet me operatorët e sistemit të shpërndarjes për të garantuar shfrytëzimin optimal të burimeve, funksionimin e sigurt dhe eficient të sistemit dhe zhvillimin e tregut. Ai kompensohet në mënyrë të përshtatshme për prokurimin e këtyre shërbimeve, në mënyrë që të mbulojë të paktën kostot e arsyeshme përkatëse, përfshirë shpenzimet për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, si dhe kostot e infrastrukturës.

4. Detyrimi për të prokuruar shërbimet ndihmëse jo të lidhura me frekuencën sipas pikës 2 të këtij neni nuk zbatohet për komponentët plotësisht të integruar të rrjetit.

5. ERE-ja është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të procedurës së parashikuar në pikën 1 të këtij neni.

Neni 71
Kodi i transmetimit

1. Operimi i sistemit të transmetimit kryhet në përputhje me dispozitat e kodeve dhe udhëzimeve të rrjetit, termat dhe kushtet e metodologjive (TCM) të transmetimit dhe kodit të transmetimit, i cili hartohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian dhe miratohet nga ERE-ja.

2. Kodi i transmetimit parashikon:

a) metodat dhe kriteret për planifikimin dhe zhvillimin e sistemit;

b) kushtet dhe dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin për akses në sistemin e transmetimit;

c) specifikimet minimale teknike dhe funksionale për dhënien e aksesit dhe lidhjen me sistemin e transmetimit të centraleve prodhuese, impianteve depozituese të energjisë, shoqërive shpërndarëse, klientëve fundorë, si dhe linjave të interkoneksionit;

ç) afatin në të cilin Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet t'i përgjigjet aplikimit të paraqitur, si dhe pasojat në rast se përgjigjja nuk jepet brenda afatit të parashikuar;

d) shërbimet e balancimit dhe ato ndihmëse;

dh) planin operacional dhe rregullat e planifikimit;

e) administrimin dhe kontrollin e sistemit në kushtet normale dhe emergjente të operimit;

ë) rregullat e matjes;

f) kriteret e aplikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit për dispeçerimin e instalimeve prodhuese në dispozicion dhe impianteve depozituese të energjisë, si dhe për përdorimin e linjave të interkoneksionit;

g) mënyrën, afatin, kushtet dhe detyrimet, sipas të cilave Operatori i Sistemit të Transmetimit dispeçeron energjinë e prodhuar prej burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike;

gj) çdo veprimtari tjetër të nevojshme për administrimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të sistemit të transmetimit;

h) mënyrën e funksionimit dhe të operimit të operatorit të tregut;

i) zbatimin e rregullave për identifikimin dhe zbutjen e kongjestioneve strukturore.

Neni 72
Konfidencialiteti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit, duke respektuar në çdo rast përcaktimet e nenit 49 të këtij ligji ose ndonjë detyrim tjetër ligjor për dhënien e informacionit, ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar të siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë, dhe parandalon përhapjen në mënyrë diskriminuese të informacionit për veprimtarinë e tij, me qëllim që të krijojë avantazh tregtar te një palë tjetër.

2. OST-ja nuk shpërndan të dhënat e ndjeshme tregtare te çdo i licencuar tjetër, përveçse kur kjo është e nevojshme për kryerjen e një transaksioni

tregtar. Për të siguruar respektimin e plotë të rregullave të shpërndarjes së informacionit dhe ndarjes së veprimtarive, ERE-ja merr masa që Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe çdo i licencuar tjetër të mos përdorin shërbime të përbashkëta, të tilla si shërbime të përbashkëta ligjore, përveç funksioneve të thjeshta administrative apo të teknologjisë së informacionit.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij nuk keqpërdor informacionin e ndjeshëm tregtar të siguruar nga palët e treta, në kuadër të ofrimit apo negociimit të aksesit në sistem.

4. Informacioni i nevojshëm që garanton konkurrencën dhe funksionimin normal të tregut bëhet publik.

5. Dispozitat e këtij neni zbatohen në përputhje me dispozitat për menaxhimin e të dhënave, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji.

Neni 73

Alokimi i kapaciteteve të interkoneksionit

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit harton rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit, e cila miratohet nga ERE-ja.

2. Rregullorja për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit parashikon:

a) publikimin e informacionit për kapacitetet e interkoneksionit;

b) shkëmbimin e informacionit për kapacitetet e interkoneksionit me operatorët e vendeve fqinje;

c) menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve transmetuese disponibël të interkoneksionit;

ç) të dhëna për tregun sekondar të tregtimit të kapaciteteve të interkoneksionit;

d) parime të përgjithshme dhe procedura për menaxhimin e kapacitetit të kufizuar;

dh) përdorimin e të ardhurave nga alokimi i kapaciteteve të linjave të interkoneksionit dhe nga menaxhimi i kapacitetit të kufizuar;

e) detyrimin e pjesëmarrësit të tregut për të njoftuar paraprakisht Operatorin e Sistemit të Transmetimit nëse do të përdorin kapacitetin e alokuar dhe periudhën e përdorimit të tij;

ë) rialokimin në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese të çdo kapaciteti të alokuar që nuk do të përdoret prej pjesëmarrësit të tregut;

f) rillogaritjen e kapacitetit të disponueshëm të interkoneksionit të paktën pas orarit të mbylljes së portës së ditës në avancë dhe pas mbylljes së portës të së njëjtës ditë;

g) alokimin e kapacitetit të disponueshëm të interkoneksionit dhe çdo kapacitet të mbetur të interkoneksionit të pashpërndarë më parë dhe të çdo kapaciteti interkoneksioni të lëshuar nga mbajtësit e të drejtave fizike të transmetimit nga alokimet e mëparshme në procesin pasardhës të alokimit të kapacitetit të interkoneksionit.

3. Alokimi i kapaciteteve nuk duhet të diskriminojë pjesëmarrësit e tregut që dëshirojnë të ushtrojnë të drejtat e tyre për zbatimin e kontratave dypalëshe të furnizimit apo për të ofertuar në tregun e hapur të energjisë elektrike.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit së bashku me operatorët përkatës të vendeve fqinje publikojnë kapacitetet e disponueshme që do të alokohen, duke përfshirë, sipas rastit, edhe kapacitetet e çliruara nga të drejtat e transmetimit të siguruara më parë, si dhe periudhën kohore gjatë së cilës kapaciteti do të reduktohet ose nuk do të jetë i disponueshëm.

5. Në procedurat e alokimit të kapaciteteve mund të marrin pjesë të gjithë pjesëmarrësit e tregut. Për të shmangur problemet në treg, që lidhen me krijimin apo forcimin e pozitës dominuese të një apo disa pjesëmarrësve, ERE-ja dhe/ose Autoriteti i Konkurrencës, sipas rastit, mund të vendosin kufizime të përgjithshme ose të veçanta ndaj një pjesëmarrësi të tregut për shkak të pozitës dominuese të tij.

6. Ndalohen procedurat për alokimin e kapaciteteve që vendosin çmime rezervë, me përjashtim të rasteve të linjave të reja të interkoneksionit, të cilat përjashtohen sipas nenit 36 të këtij ligji.

7. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të pranojë të gjitha transaksionet e mundshme tregtare, përfshirë edhe ato që rrjedhin prej tregtisë me vendet kufitare.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk zbaton masa që kufizojnë aksesin e pjesëmarrësve të tregut në linjat e interkoneksionit, përveç rastit të kapacitetit të kufizuar.

9. Procedura e alokimit të kapaciteteve të disponueshme të transmetimit zhvillohet në afate të arsyeshme, përpara momentit të fillimit të shfrytëzimit të kapaciteteve.

10. Të drejtat e aksesit për alokimin e kapaciteteve konsiderohen si të drejta të fituara,

bazuar në parimet e përcaktuara në rregulloren e alokimit të kapaciteteve.

Neni 74
Identifikimi dhe adresimi i kongjestioneve strukturore në lidhje me kapacitetet e interkoneksionit

1. Kufijtë e zonave të ofertimit bazohen në kongjestion afatgjatë dhe strukturor në rrjetin e transmetimit.

2. Nuk duhet të ekzistojë kongjestion strukturor brenda një zone ofertimi, përveç rasteve kur ai ndikon zonat fqinje. Nëse ndodh kjo, një kongjestion i tillë mund të tolerohet përkohësisht, me kusht që masat korrigjuese të zbusin ndikimin dhe të mos reduktojnë përdorimin e kapacitetit të transmetimit midis zonave sipas nenit 76 të këtij ligji.

3. Zonat e ofertimit duhet të rishikohen për të maksimizuar eficiencën ekonomike dhe tregtinë ndërkufitare brenda të njëjtit rajon të llogaritjes së kapacitetit, duke ruajtur sigurinë e furnizimit.

4. Nëse ENTSO-E ose një autoritet rregullator për një ose më shumë operatorë të sistemeve të transmetimit në zona të tjera kontrolli paraqet një raport që identifikon kongjestion strukturor, OST-ja duhet të njoftojë menjëherë ERE-n.

5. Brenda gjashtë muajve dhe në bashkëpunim me OST-në, ERE, bazuar në metodologjinë e nivelit të BE-së, mund të vendosë:

a) për të ndryshuar zonën e ofertimit; ose

b) për t'i kërkuar operatorit të zbatojë një plan veprimi për reduktimin e kongjestionit.

6. ERE-ja duhet të njoftojë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe Bordin Rregullator për vendimin e saj.

7. Nëse ERE-ja vendos të ndryshojë zonën e ofertimit, ajo duhet të informojë të gjitha autoritetet përkatëse në shtetet anëtare të BE-së dhe në palët e Komunitetit të Energjisë brenda të njëjtit rajon të llogaritjes së kapacitetit për të kërkuar një marrëveshje unanime.

8. Para nxjerrjes së vendimit, ERE-ja duhet të konsultohet me palët e interesuara dhe të përcaktojë datën e zbatimit dhe çdo periudhë kalimtare.

9. Nëse nuk arrihet marrëveshje unanime, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë merr vendimin përfundimtar.

10. Nëse ERE-ja vlerëson se një plan veprimi është më efektiv se rishikimi dhe ndryshimi i konfigurimit të zonës së ofertimit, OST-ja duhet të hartojë një plan 4-vjeçar.

11. Pavarësisht progresit të zbatimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të sigurojë rritje vjetore të kapacitetit të transmetimit sipas një trajektoreje lineare, derisa kapaciteti minimal i përcaktuar në nenin 76 të këtij ligji të arrihet deri më 31 dhjetor 2027.

12. Vlera fillestare e trajektores lineare është më e larta ndër:

a) kapacitetin e alokuar në kufirin e zonës ose në elementin kritik të rrjetit në vitin para planit të veprimit;

b) mesataren e kapacitetit të alokuar gjatë tre vjetëve paraardhës.

13. OST-ja përballon kostot e masave korrigjuese të nevojshme për të përmbushur trajektoren lineare ose për të mundësuar kapacitetin në kufijtë e zonës ose në elementet kritike.

14. Çdo vit gjatë planit të veprimit dhe gjashtë muaj pas përfundimit të tij, OST-ja duhet t'i raportojë ERE-s dhe Bordit Rregullator nëse rritja e kapacitetit është në përputhje me trajektoren dhe nëse kapaciteti minimal sipas nenit 76 të këtij ligji është arritur deri më 1 janar 2028.

15. Para paraqitjes së raportit, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet t'i vërë në dispozicion ERE-s të gjitha të dhënat përkatëse për miratim.

16. Nëse raporti tregon se kapaciteti nuk është rritur sipas kërkesës, ERE-ja duhet të fillojë brenda gjashtë muajve procedurën për ndryshimin ose ruajtjen e zonës së ofertimit.

17. Gjashtë muaj para përfundimit të planit të veprimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të zgjidhë kongjestionin e mbetur përmes masave korrigjuese me shpenzimet e veta ose të fillojë procesin e ndryshimit të zonës sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

18. Nëse operatori nuk miraton një plan veprimi, ai brenda 12 muajve nga identifikimi i kongjestionit strukturor duhet t'u raportojë ERE-s dhe Bordit Rregullator nëse kapaciteti minimal sipas nenit 76 të këtij ligji është arritur gjatë vitit paraardhës. Të gjitha të dhënat përkatëse duhet t'i paraqiten ERE-s për miratim.

19. Plani i veprimit duhet të paraqitet në ERE për miratim.

20. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe ERE sigurojnë që rregullat e hollësishme për

identifikimin dhe zbutjen e bllokimeve strukturore të zbatohen në kodin e transmetimit në përputhje me rregulloren (BE) 2019/943 dhe udhëzimin CACM dhe në përputhje me dispozitat e tyre për tregun e brendshëm të energjisë elektrike.

Neni 75
Shfrytëzimi i të ardhurave nga alokimi i kapaciteteve të interkoneksionit

1. Procedurat e menaxhimit të kongjestioneve, që lidhen me një afat kohor të paracaktuar, mund të gjenerojnë të ardhura vetëm në rast të kongjestionit që lind për atë afat kohor, përveç në rastin e interkoneksioneve të reja që përfitojnë nga një përjashtim i dhënë nga Këshilli i Ministrave, në vendimin e miratimit të ndërtimit. Procedura për shpërndarjen e këtyre të ardhurave i nënshtrohet shqyrtimit nga ERE-ja dhe nuk duhet të shtrembërojë procesin e ndarjes në favor të ndonjë pale që kërkon kapacitet ose energji, as të ofrojë një dekurajim për të zvogëluar kongjestionin.

2. Çdo e ardhur, që rezulton nga ndarja e kapacitetit ndërzonal, përdoret për qëllimet e mëposhtme:

a) sigurimin e disponueshmërisë së kapacitetit të alokuar, duke përfshirë kompensim të qëndrueshëm; dhe/ose

b) mirëmbajtjen dhe rritjen e kapaciteteve ndërzonale nëpërmjet optimizimit të përdorimit të interkoneksionëve ekzistuese me anë të veprimeve të koordinuara korrigjuese ose duke realizuar investimet në rrjet, që janë të rëndësishme për të zvogëluar kongjestionin e interkoneksioneve.

OST dhe ERE marrin në konsideratë metodologjinë e ACER-it për përdorimin e të ardhurave nga kongjestioni.

3. Kur objektivat prioritarë, të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, janë përmbushur në mënyrë adekuate, atëherë me miratimin paraprak të ERE-s, ato mund të konsiderohen si fitim deri në një vlerë të caktuar dhe të merren parasysh në llogaritjen e tarifës së rrjetit, në përputhje me metodologjitë përkatëse. Të ardhurat e mbetura vendosen në një llogari të veçantë të brendshme deri në kohën kur të mund të shpenzohen për qëllimet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të përcaktojë qartë, paraprakisht, se si do të përdoren të ardhurat nga kongjestionet dhe duhet t'i raportojë ERE-s për përdorimin aktual të këtyre të ardhurave. Përdorimi i të ardhurave në përputhje me shkronjën "a" ose "b" të pikës 2 të këtij neni i nënshtrohet një metodologjie të propozuar nga OST-ja pas konsultimit me ERE-n dhe palët e interesuara përkatëse dhe pas miratimit nga ACER-i. Metodologjia duhet të përcaktojë të paktën kushtet sipas të cilave të ardhurat mund të përdoren për qëllimet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, kushtet sipas të cilave këto të ardhura mund të vendosen në një llogari të veçantë të brendshme për përdorim në të ardhmen për ato qëllime dhe për sa kohë këto të ardhura mund të vendosen në këtë llogarie.

5. Deri më 1 mars të çdo viti, ERE-ja informon Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe publikon një raport që përcakton:

a) shumën e të ardhurave të mbledhura për periudhën 12-mujore që përfundon më 31 dhjetor të vitit të kaluar;

b) se si janë përdorur këto të ardhura në përputhje me pikën 2 të këtij neni, duke përfshirë projektet specifike për të cilat janë përdorur të ardhurat dhe shumën e vendosur në një llogari të veçantë;

c) shumën që është përdorur gjatë llogaritjes së tarifave të rrjetit; dhe

ç) verifikimin se shuma e përmendur në shkronjën "c" të kësaj pike është në përputhje me këtë nen dhe metodologjinë përkatëse të zhvilluar nga ACER-i dhe vendimin përkatës të ERE-s.

6. Kur disa nga të ardhurat nga kongjestionet përdoren gjatë llogaritjes së tarifave të rrjetit, raporti duhet të përcaktojë se si Operatori i Sistemit të Transmetimit i ka përmbushur objektivat prioritarë të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Neni 76
Menaxhimi i kapacitetit të kufizuar

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit harton rregulloren për menaxhimin e kapacitetit të kufizuar, e cila miratohet nga ERE-ja.

2. Rastet e kapacitetit të kufizuar të rrjetit duhet të trajtohen me zgjidhje jodiskriminuese të bazuara në treg, të cilat u japin sinjale ekonomike efikase pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike dhe operatorëve të sistemit të transmetimit të përfshirë. Problemet e kongjestioneve të rrjetit duhet të zgjidhen me anë të metodave jo të bazuara në

transaksione, përkatësisht metodave që nuk përfshijnë një përzgjedhje midis kontratave të pjesëmarrësve individualë të tregut të energjisë elektrike. Kur merr masa operative për të siguruar që sistemi i tij i transmetimit të mbetet në gjendje normale, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të marrë parasysh efektin e këtyre masave në zonat fqinje të kontrollit dhe t'i koordinojë këto masa me sistemet e tjera të transmetimit të prekura.

3. Rregullorja për menaxhimin e kapacitetit të kufizuar duhet të bazohet në parimet e mëposhtme:

a) procedurat e kufizimit të transaksioneve duhet të kryhen në rast të situatave emergjente ku Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të veprojë shpejt dhe kur rishpërndarja ose shkëmbimi i rrjedhjes së energjisë nuk është i mundur. Çdo procedurë e tillë duhet të zbatohet në mënyrë jodiskriminuese;

b) përveç rasteve të forcës madhore, pjesëmarrësit e tregut do të kompensohen për çdo kufizim të aplikuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit në lidhje me kapacitetet e alokuara.

c) kapaciteti maksimal i linjave të interkoneksionit dhe/ose rrjetit të transmetimit, i cili ndikon në rrjedhjet ndërkufitare, është në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut, në përputhje me standardet e sigurisë së funksionimit të sistemit. Tregtimi me kah të kundërt dhe ridispeçerimi, duke përfshirë ridispeçerimin ndërkufitar, do të përdoren për të maksimizuar kapacitetet e disponueshme. Një proces i koordinuar dhe jodiskriminues për veprimet korrigjuese ndërkufitare do të zbatohet për të mundësuar një maksimizim të tillë, pas zbatimit të një metodologjie të ndarjes së kostos së ridispeçerimi dhe tregtimit me kah të kundërt;

ç) operatori i Sistemit të Transmetimit, në masën që është teknikisht e realizueshme, balancon rrjedhjet e energjisë në rrjedhën e sipërme, për të përdorur kapacitetin e tij maksimal;

d) në funksion të sigurisë së rrjetit, Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk duhet të pengojë transaksionet, të cilat zvogëlojnë mundësinë e kapacitetit të kufizuar;

dh) kapaciteti do të alokohet me anë të ankandeve eksplicite të kapacitetit ose ankandeve implicite që përfshijnë si kapacitetin ashtu edhe energjinë. Të dyja metodat mund të qëndrojnë në të njëjtin interkoneksion. Për tregtinë brenda së njëjtës ditë do të përdoret tregtimi i vazhdueshëm, i cili mund të plotësohet nga ankandet;

e) në rastin e kongjestionit, ofertat e vlefshme me vlerën më të lartë për kapacitetin e rrjetit, qofshin eksplicite ose implicite, që ofrojnë vlerën më të lartë për kapacitetin e kufizuar të transmetimit në një afat kohor të caktuar, do të jenë të suksesshme. Përveç rastit të interkonektorëve të rinj që përfitojnë nga një përjashtim sipas nenit 35 të këtij ligji, vendosja e çmimeve rezervë në metodat e alokimit të kapaciteteteve do të ndalohet;

ë) kapaciteti do të jetë i tregtueshëm lirisht në bazë dytësore, me kusht që Operatori i Sistemit të Transmetimit të informohet mjaftueshëm paraprakisht. Kur Operatori i Sistemit të Transmetimit refuzon çdo tregti (transaksion) dytësor, kjo do t'u komunikohet dhe do t'u shpjegohet në mënyrë të qartë dhe transparente të gjithë pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe do t'i njoftohet ERE-s.

f) operatorët e sistemeve të transmetimit nuk kufizojnë vëllimin e kapacitetit të interkonjeksionit që vihet në dispozicion të pjesëmarrësve në treg si mjet për zgjidhjen e kongjestionit brenda zonës së tyre të ofertimit ose si mjet për menaxhimin e flukseve që rrjedhin nga transaksionet brenda zonave të ofertimit. Pa cenuar zbatimin e derogimeve sipas pikave 4 dhe 5 të këtij neni, kjo pikë konsiderohet e përmbushur kur arrihen nivelet minimale të mëposhtme të kapacitetit të disponueshëm për tregtinë ndërzonale:

i. për kufijtë që përdorin qasjen e koordinuar të kapacitetit neto të transmetimit, kapaciteti minimal do të jetë 70% e kapacitetit të transmetimit, duke respektuar kufijtë e sigurisë operacionale pas zbritjes së kontingjencave, siç përcaktohet në përputhje me udhëzimin për alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionit, të miratuar në bazë të nenit 18(5) të rregullores (KE) nr.714/2009;

ii. për kufijtë që përdorin qasjen "*flow-based*", kapaciteti minimal do të jetë një marzh i përcaktuar në procesin e llogaritjes së kapacitetit si i disponueshëm për flukset e krijuara nga shkëmbimet ndërzonale. Ky marzh do të jetë 70% e kapacitetit që respekton kufijtë e sigurisë operacionale të elementeve kritike të rrjetit, të brendshme dhe ndërzonale, duke marrë në konsideratë kontingjencat, siç përcaktohet në përputhje me udhëzimin për alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionit, të miratuar në bazë të nenit 18(5) të rregullores (KE) nr.714/2009.

4. OST-ja mund të kërkojë përjashtim nga kërkesa për përqindjen minimale për arsye sigurie, me kusht që ky përjashtim të mos lidhet me kufizime mbi kapacitetin e alokuar. Përjashtimet mund të jepen për një vit, të rinovueshme edhe për një vit tjetër, dhe duhet të jenë të nevojshme për sigurinë e sistemit, pa diskriminuar ndërmjet tregtisë së brendshme dhe asaj ndërkufitare. Para dhënies së përjashtimit, Enti Rregullator i Energjisë duhet të konsultohet me autoritetet rregullatore në rajonin përkatës të llogaritjes së kapacitetit, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare. Nëse rregullatorët rajonalë nuk bien dakord, vendimi përfundimtar merret nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose ACER-i, sipas rastit. Pas marrjes së përjashtimit, Operatori i Sistemit të Transmetimit duhet të zhvillojë dhe të miratojë metodologji dhe projekte për të zgjidhur problematikat themelore. Përjashtimi skadon ose në fund të afatit të tij ose me zgjidhjen e problematikës, cilado që ndodh më parë.

5. Pjesëmarrësit në treg duhet të informojnë operatorët e sistemeve të transmetimit përkatës brenda një afati të arsyeshëm para periudhës përkatëse operacionale, nëse synojnë të përdorin kapacitetin e alokuar. Çdo kapacitet i alokuar që nuk do të përdoret duhet të vihet sërish në dispozicion të tregut në mënyrë të hapur, transparente dhe jodiskriminuese.

6. Për aq sa është teknikisht e mundur, operatorët e sistemeve të transmetimit duhet të bëjnë netimin e kërkesave për kapacitet për flukset e energjisë në drejtime të kundërta në linjat e interkonjeksionit me kongjestion, me qëllim përdorimin maksimal të kapacitetit të tyre. Duke marrë plotësisht parasysh sigurinë e rrjetit, transaksionet që lehtësojnë kongjestionin nuk duhet të refuzohen.

7. Pasojat financiare të mosrespektimit të detyrimeve që lidhen me alokimin e kapacitetit do t'u atribuohen operatorëve të sistemeve të transmetimit ose NEMO-ve që janë përgjegjës për këtë mosrespektim. Kur pjesëmarrësit në treg nuk përdorin kapacitetin që kanë marrë përsipër të përdorin ose, në rastin e kapacitetit të ankanduar në mënyrë eksplicite, nuk e tregtojnë atë në tregun sekondar ose nuk e kthejnë në kohën e duhur, ata humbasin të drejtat mbi këtë kapacitet dhe paguajnë një tarifë që pasqyron kostot. Çdo tarifë e tillë duhet të jetë e justifikuar dhe proporcionale. Nëse operatori i sistemit të transmetimit nuk përmbush detyrimin e tij për të garantuar kapacitet të sigurt transmetimi, ai është i detyruar të kompensojë pjesëmarrësin në treg për humbjen e të drejtave të kapacitetit. Humbjet pasuese nuk merren në konsideratë për këtë qëllim. Parimet dhe metodat kryesore për përcaktimin e përgjegjësive që lindin nga mosrespektimi i detyrimeve duhet të përcaktohen paraprakisht në lidhje me pasojat financiare dhe t'i nënshtrohen rishikimit nga ERE.

Neni 77

Bashkëpunimi ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në planifikimin dhe operimin e rrjeteve të tyre. Në veçanti, Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes shkëmbejnë të gjithë informacionin dhe të dhënat e nevojshme në lidhje me performancën e aseteve të prodhimit, të hapësirave të depozitimit të energjisë dhe përgjigjen ndaj kërkesës, operimin ditor të rrjeteve të tyre dhe planifikimin afatgjatë të investimeve në rrjet, me synimin për të siguruar zhvillimin dhe operimin e rrjeteve të tyre me kosto efektive, të sigurt dhe të besueshëm.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të arritur akses të koordinuar në burime të tilla si prodhimi i shpërndarë, depozitimi i energjisë ose përgjigjja ndaj kërkesës që mund të mbështesë nevoja të veçanta si të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, ashtu edhe të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Neni 78

Pronësia e Operatorit të Sistemit të Transmetimit mbi impiantet e depozitimit të energjisë

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk do të zotërojë, nuk do të zhvillojë, nuk do të menaxhojë ose nuk do të operojë impiantet e depozitimit të energjisë, përveç impianteve të depozitimit të energjisë që janë komponentë plotësisht të integruar të rrjetit të sistemit të transmetimit, siç parashikohet në pikën 2 të këtij neni, ose kur të gjitha kushtet e përcaktuara në pikën 3 të këtij neni të përmbushen.

2. Përjashtimisht nga pika 1, Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të zotërojë, të zhvillojë, të menaxhojë ose të operojë impiantet e depozitimit të energjisë, atëherë kur ato janë komponente të integruara plotësisht të rrjetit të kërkuar për qëllimin e vetëm për të garantuar operimin e sigurt dhe të besueshëm të rrjetit të transmetimit në përputhje me parimin e kostos më të ulët të mundshme dhe të jenë objekt i miratimit nga ERE-ja. ERE-ja refuzon të japë miratimin nëse impianti i depozitimit të energjisë nuk është i nevojshëm për kryerjen nga Operatori i Sistemit të Transmetimit të detyrave të tij të përcaktuara në këtë ligj.

3. Operatori i Sistemit të Transmetimit mund të zotërojë, të zhvillojë, të menaxhojë ose të operojë objekte të depozitimit të energjisë në përputhje me parimin e kostos më të ulët të mundshme, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) palët e tjera, në bazë tregu ose duke ndjekur një procedurë tenderimi të hapur, transparente dhe jodiskriminuese që i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit nga ERE-ja, nuk kanë zhvilluar ose nuk u është dhënë e drejta për të zotëruar, për të zhvilluar, për të menaxhuar ose për të operuar objekte të tilla, ose nuk kanë mundur t'i ofrojnë këto shërbime me një kosto të arsyeshme dhe në kohën e duhur;

b) impiante ose shërbime ndihmëse jo të lidhura me frekuencën të tilla janë të nevojshme që Operatori i Sistemit të Transmetimit të përmbushë detyrimet e tij për funksionimin efikas, të besueshëm dhe të sigurt të sistemit të transmetimit dhe ato nuk përdoren për të blerë ose për të shitur energji në tregjet e energjisë elektrike; dhe

c) ERE-ja ka vlerësuar nevojën e një përjashtimi të tillë dhe ka kryer një shqyrtim paraprak të zbatueshmërisë së një procedure tenderimi, duke përfshirë kushtet e procedurës së tenderimit, dhe ka dhënë miratimin e saj.

4. Rregulloret e detajuara për procedurat e ERE-s për dhënien e miratimeve të përmendura në pikat 2 dhe 3 të këtij neni hartohen dhe miratohen nga ERE-ja.

5. Vendimi për të dhënë një derogim duhet t'u njoftohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë së bashku me informacionin përkatës në lidhje me kërkesën dhe arsyet e dhënies së derogimit.

6. ERE-ja kryen të paktën çdo pesë vjet një konsultim publik për impiantet ekzistuese të depozitimit së energjisë, me qëllim vlerësimin e disponueshmërisë dhe interesit të mundshëm të palëve të tjera për të investuar në objekte të tilla. Kur konsultimi publik, siç vlerësohet nga autoriteti rregullator, tregon se palët e tjera janë në gjendje të zotërojnë, të zhvillojnë, të operojnë ose të menaxhojnë objekte të tilla në një mënyrë efektive nga ana e kostos, ERE-ja duhet të sigurojë që aktivitetet e operatorëve të sistemit të transmetimit në këtë drejtim të hiqen gradualisht brenda 18 muajve.

KREU V
SHPËRNDARJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 79
Shpërndarja e energjisë elektrike

1. Shpërndarja e energjisë elektrike kryhet nga operatorë të sistemit të shpërndarjes, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE-ja sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension të lartë, të mesëm dhe të ulët, me qëllim livrimin e saj te klientët, ku kufiri i tij me sistemin e transmetimit është ai i përcaktuar në pikën 2 të nenit 59 të këtij ligji.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për:

a) sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes;

b) përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike;

c) mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në të gjithë territorin për të cilin është licencuar.

4. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ofron pa diskriminim shërbimin e shpërndarjes së energjisë elektrike për të gjithë përdoruesit e rrjetit, që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet e tjera nënligjore. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes respekton treguesit e cilësisë së shërbimit dhe kërkesat e parashikuara nga rregulloret teknike.

5. Rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike zhvillohet mbi parimin e kostos më të ulët, në përputhje me legjislacionin për planifikimin urban, të drejtat e pronësisë, mbrojtjen e mjedisit,

mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njerëzve dhe përdorimin me eficiencë të energjisë.

6. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes instalon dhe përpunon të gjitha llojet e informacionit, komunikimeve dhe sistemeve teknologjike. Në varësi të mundësive, pjesë të infrastrukturës së komunikimeve dhe/ose kapaciteteve të rrjetit të komunikimit të shpejtësive të larta mund të jepen në përdorim pa dëmtuar dhe rrezikuar veprimtaritë dhe rrjetet e veta brenda kuadrit të legjislacionit përkatës, në përputhje me opinionin e ERE-s.

7. ERE-ja, me kërkesë të operatorëve të sistemit të shpërndarjes, mund të lejojë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes të kryejë aktivitete të ndryshme nga ato të parashikuara në këtë ligj, kur këto aktivitete janë të nevojshme që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të përmbushë detyrimet e tij sipas këtij ligji, me kusht që ERE-ja të ketë vlerësuar nevojën e një derogimi të tillë. Kjo pikë nuk cenon të drejtën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për të zotëruar, për të zhvilluar, menaxhuar ose për të operuar rrjete të ndryshme nga rrjetet e energjisë elektrike ku Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes i është dhënë kjo e drejtë.

8. ERE-ja siguron mbikëqyrje rregullatore efektive të aktiviteteve të sistemit të shpërndarjes, duke përfshirë monitorimin, verifikimin e përputhshmërisë dhe zbatimin e të gjitha detyrimeve që lidhen me ndarjen, menaxhimin e të dhënave, prokurimin e shërbimeve, zhvillimin e rrjetit dhe zbatimin e derogimeve. ERE-ja miraton të gjitha aktet rregullatore dhe vendimet e nevojshme për të siguruar funksionimin e duhur të sistemit të shpërndarjes në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e direktivës (BE) 2019/944.

Neni 80

Detyrat e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes:

a) operon një sistem shpërndarjeje të sigurt, të qëndrueshëm dhe të efektshëm;

b) zhvillon rrjetin e shpërndarjes në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe parashikimet e kërkesës për shpërndarjen e energjisë elektrike;

c) mirëmban dhe riparon kabinat elektrike në mënyrë periodike ose sipas nevojës, të cilat janë në bashkëpronësi, apo në pronësi të të tretëve. Përjashtimisht, janë përgjegjës vetë për mirëmbajtjen dhe riparimin e kabinave elektrike klientët jofamiljarë privatë që shprehin vullnetin për kryerjen vetë të mirëmbajtjes dhe riparimit, si dhe kur kabina elektrike është me një përdorues;

ç) lidh në rrjetin e shpërndarjes të gjithë klientët dhe/ose prodhuesit, bazuar në kushte jodiskriminuese, transparente, të parashikuara në rregulloret në fuqi;

d) siguron akses jodiskriminues të klientëve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi;

dh) u siguron përdoruesve të rrjetit informacionin për akses dhe përdorim të efektshëm të rrjetit të shpërndarjes;

e) mbledh dhe paraqet tek Operatori i Sistemit të Transmetimit të dhënat e nevojshme për funksionimin e tregut të energjisë elektrike, në përputhje me këtë ligj, rregullat e tregut dhe rregullat për ndryshimin e furnizuesit;

ë) ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të siguruar gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij;

f) prokuron energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, duke vepruar si lehtësues neutral i tregut, në përputhje me procedura transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg;

g) harton profile të standardizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh, në rast se të dhënat e matjeve, të nevojshme për llogaritjen e disbalancave, nuk janë të disponueshme;

gj) mban evidencën e shoqërive të licencuara që furnizojnë me energji elektrike në të gjitha pikat e lidhjes dhe pikat e matjes së rrjetit respektiv shpërndarës;

h) i siguron, pa pagesë dhe mbi bazën e një marrëveshjeje, çdo furnizuesi të energjisë elektrike akses në të dhënat e matjes për klientët, me të cilët furnizuesi ka nënshkruar një kontratë furnizimi, objekt i parashikimeve të nenit 28 të këtij ligji;

i) ofron shërbime të tjera të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve sipas këtij neni;

j) siguron akses jodiskriminues, transparent dhe në kohë në të dhëna për të gjithë pjesëmarrësit e kualifikuar të tregut, përfshirë furnizuesit, agregatorët, operatorët e objekteve të impianteve të depozitimit të energjisë dhe palë të tjera përkatëse, në kushte të barabarta, në përputhje me nenin 28 të këtij ligji;

k) pavarësisht shkronjës "i" të kësaj pike, merr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që anëtarët

e së njëjtës shoqëri të integruar vertikalisht të mos kenë akses të privilegjuar në të dhëna për kryerjen e aktiviteteve të tyre të furnizimit;

l) vepron si një menaxher neutral i të dhënave dhe nuk përdor të dhëna të ndjeshme tregtare për të fituar avantazh konkurrues ose për të favorizuar shoqëritë e ndërlidhura;

ll) bashkëpunon me ministrinë si autoritet kompetent i caktuar në lidhje me planifikimin e gatishmërisë ndaj riskut dhe menaxhimin e riskut sipas nenit 6 të këtij ligji;

m) merr pjesë në krijimin dhe funksionimin e Grupit Koordinues të Operatorëve të Sistemit të Shpërndarjes së Komunitetit të Energjisë me qëllim për të promovuar plotësimin dhe funksionimin e tregut të vetëm për energjinë elektrike dhe për të promovuar menaxhimin optimal dhe operimin e koordinuar të sistemeve të shpërndarjes e të transmetimit.

Neni 81

Prokurimi i produkteve dhe shërbimeve nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

1. Kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për prokurimin e produkteve dhe shërbimeve të nevojshme për funksionimin efikas, të besueshëm dhe të sigurt të sistemit të shpërndarjes, rregullat e miratuara nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes për këtë qëllim duhet të jenë objektive, transparente dhe jodiskriminuese, si dhe duhet të zhvillohen në koordinim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit dhe pjesëmarrësit e tjerë përkatës në tregun e energjisë elektrike. Kushtet dhe afatet, duke përfshirë rregullat dhe tarifat, kur është e aplikueshme, për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të tilla për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes duhet të përcaktohen në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 21 dhe duhet të publikohen. Prokurimi i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, sipas këtij neni, nuk i nënshtrohet legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.

2. Në lidhje me prokurimin e produkteve dhe shërbimeve të përshkruara në pikën 1 të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të prokurojë shërbimet ndihmëse jo të lidhura me frekuencën, të nevojshme për sistemin e tij, në përputhje me procedurat transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg, përveç rasteve kur ERE-ja ka vlerësuar se ofrimi i shërbimeve ndihmëse jo të lidhura me frekuencën, të bazuara në treg, nuk është ekonomikisht efikas dhe ka dhënë një derogim. Detyrimi për të prokuruar shërbime ndihmëse jo të lidhura me frekuencën nuk zbatohet për komponentët e rrjetit të integruar plotësisht.

3. Prokurimi i produkteve dhe shërbimeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni do të sigurojë pjesëmarrjen efektive të të gjithë pjesëmarrësve të kualifikuar të tregut të energjisë elektrike, duke përfshirë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike që ofrojnë energji nga burimet e rinovueshme, pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike të angazhuar në përgjigjen ndaj kërkesës, operatorët e impianteve të depozitimit të energjisë dhe agregatorëve.

4. ERE-ja në bashkërendim me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike, si dhe me Operatorin e Sistemit të Transmetimit përcaktojnë kërkesat teknike për pjesëmarrjen në këto tregje, në bazë të karakteristikave teknike të këtyre tregjeve e të aftësive të pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike.

5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes bashkëpunon me Operatorin e Sistemit të Transmetimit për pjesëmarrjen efektive të pjesëmarrësve të tregut të lidhur me rrjetin e tyre në tregjet me shumicë, me pakicë dhe atë të balancimit. Ofrimi i shërbimeve të balancimit që rrjedhin nga burimet e lidhura në sistemin e shpërndarjes duhet të dakordësohet me Operatorin e Sistemit të Transmetimit në përputhje me nenin 77 të këtij ligji.

Neni 82

Prokurimi i shërbimeve të fleksibilitetit nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes prokuron shërbime fleksibiliteti, duke përfshirë menaxhimin e kongjestionit në zonën e tij me qëllim përmirësimin e efikasitetit në operimin dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes, në përputhje me procedura transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg, përveç rasteve kur ERE-ja ka vendosur se prokurimi i këtyre shërbimeve nuk është ekonomikisht efikas ose se një prokurim i tillë do të çonte në deformim të tregut ose në kongjestion më të lartë. Kuadri rregullator duhet të garantojë që operatorët e sistemeve të shpërndarjes të jenë në gjendje të

sigurojnë këto shërbime nga ofruesit e prodhimit të shpërndarë, ato të përgjigjes ndaj kërkesës ose depozitimit të energjisë dhe të nxisë përdorimin e masave të eficiencës së energjisë, kur këto shërbime reduktojnë në mënyrë kosto-efektive nevojën për rritje ose zëvendësim të kapaciteteve elektrike dhe mbështesin operimin efikas dhe të sigurt të sistemit të shpërndarjes.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, me miratimin e ERE-s, përcakton nëpërmjet një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës, i cili përfshin të gjithë përdoruesit e kualifikuar të sistemit dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit, specifikimet për shërbimet e fleksibilitetit që do të prokurohen dhe, kur është e përshtatshme, produktet e standardizuara të tregut për këto shërbime. Specifikimet sigurojnë pjesëmarrjen efektive dhe jodiskriminuese të të gjithë pjesëmarrësve të tregut, duke përfshirë pjesëmarrësit e tregut që ofrojnë energji nga burimet e rinovueshme, pjesëmarrësit e tregut të angazhuar në përgjigjen ndaj kërkesës, operatorët e impianteve të depozitimit të energjisë dhe pjesëmarrësit e tregut të përfshirë në agregim. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes shkëmben të gjithë informacionin e nevojshëm dhe koordinohet me Operatorin e Sistemit të Transmetimit me qëllim sigurimin e përdorimit optimal të burimeve, garantimin e operimit të sigurt dhe efikas të sistemit dhe lehtësimin e zhvillimit të tregut. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kompensohet në mënyrë të përshtatshme për prokurimin e këtyre shërbimeve, në mënyrë që të rikuperojë të paktën kostot e tij të arsyeshme, përfshirë shpenzimet e nevojshme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si dhe kostot e infrastrukturës.

Neni 83

Integrimi i elektromobilitetit në rrjetin elektrik

1. Ministri, me propozimin e OSSH-së, miraton dhe publikon rregulloret e detajuara për të lehtësuar lidhjen e pikave të karikimit publike dhe private në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Këto rregullore sigurojnë bashkëpunimin mbi baza jodiskriminuese të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes me çdo shoqëri që zotëron, zhvillon, operon ose menaxhon pika rikarikimi për automjetet elektrike, përfshirë edhe lidhjen në rrjet.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk do të zotërojë, nuk do të zhvillojë, nuk do të menaxhojë ose nuk do të operojë pika rikarikimi, përveç rasteve kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në në pronësi pika private rikarikimi për përdorim vetjak dhe sipas parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të ketë në pronësi, të zhvillojë, të menaxhojë ose të operojë në përputhje me parimin e kostos më të ulët të mundshme një pikë rikarikimi nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) palëve të tjera, pas një procedure tenderimi të hapur, transparente dhe jodiskriminuese, që i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit nga ERE-ja, nuk u është dhënë e drejta të zotërojnë, të zhvillojnë, të menaxhojnë ose të operojnë pika rikarikimi për automjetet elektrike, ose ato nuk mund t'i ofrojnë këto shërbime me një kosto të arsyeshme dhe brenda një kohe të përshtatshme;

b) ERE-ja ka kryer një shqyrtim paraparak të kushteve të procedurës së tenderit të përcaktuar në shkronjën "a" të kësaj pike dhe ka dhënë miratimin e saj;

c) Operatori i Sistemit të Shpërndarjes operon pikat e rikarikimit mbi bazën e së drejtës së aksesit të palëve të treta dhe nuk bën diskriminim midis përdoruesve të sistemit ose kategorive të tyre, veçanërisht në favor të shoqërive të lidhura me të.

4. Rregullat e detajuara për procedurat e ERE-s, të përmendura në pikën 3 të këtij neni, hartohen dhe miratohen nga ERE-ja.

5. ERE-ja zhvillon të paktën çdo pesë vjet një konsultim publik për të rivlerësuar interesin potencial të palëve të tjera për të zotëruar, për të zhvilluar, për të operuar ose për të menaxhuar pika rikarikimi për automjetet elektrike. Kur konsultimi publik tregon se palët e tjera janë në gjendje të zotërojnë, të zhvillojnë, të operojnë ose të menaxhojnë pika të tilla dhe procedura e tenderimit, e parashikuar në shkronjën "a" të pikës 3 të këtij neni, është përfunduar me sukses, ERE-ja njofton ministrinë përkatëse dhe nis rishikimin e kuadrit rregullator në fuqi me qëllim heqjen graduale të veprimtarive të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në lidhje me operimin e pikave të rikarikimit. Si pjesë e kushteve të kësaj procedure, ERE-ja e lejon Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes të rikuperojë vlerën e mbetur të investimit të tij në infrastrukturën e rikarikimit.

Neni 84
Të drejtat e OSSH-së lidhur me burimet dytësore të energjisë

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes harton kushtet teknike që miratohen nga ERE për instalimin e një burimi dytësor të furnizimit me energji elektrike për klientët që kërkojnë këtë shërbim, përfshirë edhe kushtet që duhet të përmbushë burimi dytësor, me qëllim që të parandalohen çrregullimet në rrjet.

2. Çdo klient që kërkon të instalojë burimin dytësor dërgon paraprakisht një njoftim me shkrim pranë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe njëkohësisht u siguron përfaqësuesve të furnizuesit, me të cilin ka kontratë furnizimi, akses në burimin dytësor, me qëllim inspektimin e këtij instalimi.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me energji elektrike për një klient në rast se nuk përmbush detyrimet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

Neni 85
Të drejtat lidhur me sistemet e mbyllura të shpërndarjes

1. ERE-ja klasifikon si një sistem të mbyllur shpërndarjeje atë sistem që shpërndan energji elektrike brenda një zone gjeografikisht të kufizuar, industriale, tregtare apo shërbimesh të përbashkëta dhe që pa cenuar pikën 4 të këtij neni nuk furnizon konsumatorë familjarë, nëse:

a) për arsye të veçanta teknike apo të sigurisë, veprimtaritë ose proceset e prodhimit të përdoruesve të këtij sistemi janë të integruara; ose,

b) ky sistem shpërndan energji elektrike kryesisht te pronari, tek operatori i sistemit të mbyllur apo shoqëri të lidhura me të.

2. ERE-ja mund të përjashtojë operatorin e një sistemi të mbyllur shpërndarjeje nga:

a) detyrimi i përcaktuar në nenin 83 të këtij ligji për të prokuruar energjinë që përdor për të mbuluar humbjet e energjisë dhe shërbimet ndihmëse jo të lidhura me frekuencën në sistemin e tij, në përputhje me procedurat transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg;

b) detyrimi që tarifat ose metodologjitë e llogaritjes së tyre të jenë sipas parashikimeve të nenit 21 të këtij ligji, të miratuara nga ERE-ja para hyrjes në fuqi të tyre;

c) detyrimi për të prokuruar shërbimet e fleksibilitetit të përcaktuara në nenin 82 të këtij ligji dhe detyrimi për të zhvilluar sistemin e operatorit në bazë të planeve të zhvillimit të rrjetit, të përcaktuara në nenin 90 të këtij ligji;

ç) kërkesa për të mos pasur në pronësi, për të mos zhvilluar, për të mos menaxhuar ose për të mos operuar pika rikarikimi, sipas përcaktimeve të nenit 83 të këtij ligji;

d) kërkesa për të mos zotëruar, për të mos zhvilluar, për të mos menaxhuar ose për të mos operuar impiante të depozitimit të energjisë, të përcaktuara në nenin 91 të këtij ligji.

3. Kur është dhënë një përjashtim sipas pikës 2 të këtij neni, tarifat e aplikueshme ose metodologjitë për llogaritjen e tyre, me kërkesë të një përdoruesi të sistemit të mbyllur të shpërndarjes, do të shqyrtohen dhe do të miratohen nga ERE-ja në përputhje me nenin 21 të këtij ligji.

4. Përdorimi rastësor nga një numër i vogël familjesh, të cilët kanë marrëdhënie pune ose lidhje të ngjashme me pronarin e sistemit të shpërndarjes dhe ndodhen brenda zonës së shërbyer nga një sistem shpërndarjeje i mbyllur, nuk përbën pengesë për dhënien e një përjashtimi sipas pikës 2 të këtij neni.

5. Operatori i sistemit të mbyllur të shpërndarjes ushtron aktivitetin sipas licencës për sistemin e mbyllur të shpërndarjes dhe rregullave përkatëse të funksionimit të miratuara nga ERE-ja.

Neni 86
Kabinat elektrike

1. Kushtet teknike për ndërtimin dhe instalimin e pajisjeve në kabinat e reja elektrike, si dhe kriteret që duhet të plotësojnë subjektet që i ndërtojnë ato përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit, të cilat harmonizohen me rregullat dhe kushtet teknike ndërkombëtare.

2. Vlerësimi i konformitetit të ndërtimit të kabinave elektrike kryhet nga organe të miratuara për këtë qëllim nga ministri. Rregullat dhe procedurat për miratimin e këtyre organeve miratohen me udhëzim të ministrit.

3. Çmimi i punimeve të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së kabinave elektrike përditësohet në mënyrë periodike në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të

tyre, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 87
Ndarja e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të jetë i ndarë dhe i pavarur nga aktivitetet e tjera që nuk kanë të bëjnë me shpërndarjen e energjisë elektrike. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk do të zotërojë, nuk do të zhvillojë, nuk do të menaxhojë ose nuk do të operojë impiantet e depozitimit të energjisë, me përjashtim të rasteve kur zbatohen përjashtimet e përcaktuara në nenin 91 të këtij ligji. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk do të zotërojë, nuk do të zhvillojë, nuk do të menaxhojë ose nuk do të operojë pika rikarikimi, me përjashtim të rasteve siç përcaktohet në nenin 97 të këtij ligji.

2. Kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një shoqërie vertikalisht të integruar, në mënyrë që të provojë organizimin dhe funksionimin ligjor, të ndarë nga aktivitetet e tjera, duhet të mbajë një emër tregtar dhe markë tregtare, të ndryshme nga emrat dhe markat tregtare të aktiviteteve të tjera që nuk lidhen me shpërndarjen e energjisë elektrike.

3. Kur Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është pjesë e një shoqërie vertikalisht të integruar, me qëllim që të jetë i pavarur në aspektin organizativ dhe të vendimmarrjes nga aktivitetet e tjera që nuk lidhen me shpërndarjen e energjisë elektrike, ai duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar e energjisë elektrike lidhur me asetet e nevojshme për funksionimin, mirëmbajtjen ose zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes. Për të përmbushur këto detyra, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, përfshirë burimet njerëzore, teknike, fizike dhe financiare. Shoqëria mëmë (kontrolluese) ka të drejtën e mbikëqyrjes ekonomike dhe menaxheriale në lidhje me kthimin e aktiveve, miratimin e planit ekonomiko-financiar ose çdo instrument tjetër të barasvlershëm të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe të vendosë kufijtë e përgjithshëm në nivelet e borxhit të shoqërisë bijë (të kontrolluar). Shoqëria mëmë (kontrolluese) nuk mund të japë udhëzime për veprimtarinë e përditshme operacionale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë dhe nuk ka të drejtë të marrë vendime për ndërtimin apo rikonstruksionin e linjave të shpërndarjes, vlera e investimit të të cilave nuk tejkalon nivelet e planeve financiare të miratuara apo vlerat e përcaktuara në statutin e shoqërisë apo legjislacionin në fuqi;

b) të hartojë një program pajtueshmërie që përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, si dhe të sigurojë që respektimi i programit të monitorohet në mënyrën e duhur. Programi i pajtueshmërisë përcakton detyrimet specifike të punonjësve për përmbushjen e këtij objektivi.

Personi ose organi përgjegjës për monitorimin e programit të pajtueshmërisë (zyrtari i pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes) paraqet çdo vit në ERE një raport vjetor, i cili përcakton masat e marra në kuadër të programit të pajtueshmërisë. Ky raport publikohet në faqen zyrtare të ERE-s.

Zyrtari i pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes është plotësisht i pavarur dhe ka akses në të gjitha informacionet e nevojshme të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe çdo shoqërie të lidhur për të përmbushur detyrën e tij.

c) personat përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nuk duhet të marrin pjesë në strukturat përgjegjëse të shoqërisë së integruar, në mënyrë direkte ose indirekte, lidhur me veprimtarinë e përditshme operacionale të prodhimit, transmetimit, furnizimit me energji elektrike dhe operimin e impiantit të depozitimit të energjisë, operimin e pikës së rikarikimit dhe agregimin;

ç) personat përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të jenë të aftë profesionalisht dhe të veprojnë në mënyrë të pavarur për përmbushjen e detyrave dhe objektivave të shoqërisë. Trajtimi financiar i personave përgjegjës për menaxhimin dhe personat përgjegjës për organet mbikëqyrëse të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes që kontrollohet nga shteti, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

d) në shoqërinë e integruar vertikalisht, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të marrë masa që të shmangë krijimin e paqartësive te palët e interesuara lidhur me emrin dhe markën tregtare të përdorur, në mënyrë që të demonstrohet identiteti i veçantë i tij në raport me shoqërinë e furnizimit.

dh) aktivitetet e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të monitorohen nga ERE-ja, e cila, në

bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës, siguron shmangien e përfitimeve të mundshme nga operatori që cenon konkurrencën.

4. ERE-ja, në lidhje me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, miraton rregulloren dhe procedurat e detajuara të emërimit të zyrtarit të pajtueshmërisë, përfshirë kriteret përkatëse të pavarësisë, sjelljen, përgjegjësitë dhe detyrimet e raportimit të zyrtarit të pajtueshmërisë, si dhe aksesin e zyrtarit të pajtueshmërisë në të dhënat e nevojshme për të kryer detyrën e tij.

5. ERE-ja siguron monitorim dhe zbatim të vazhdueshëm të pavarësisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, duke përfshirë zbatimin efektiv të programit të pajtueshmërisë, pavarësinë e zyrtarit të pajtueshmërisë dhe mungesën e sjelljes diskriminuese, në përputhje me kërkesat e direktivës (BE) 2019/944.

Neni 88
Kodi i shpërndarjes

1. Kodi i shpërndarjes përcakton kërkesat teknike për planifikimin, zgjerimin, funksionimin, kontrollin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes dhe rregullat specifike për lidhjen dhe aksesin në rrjetin e shpërndarjes, si dhe rregullat e matjes.

2. Kodi i shpërndarjes miratohet nga ERE-ja, me propozim të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, i cili bashkëpunon me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, me qëllim hartimin, rishikimin apo përshtatjen e tij.

3. Funksionimi i rrjetit të shpërndarjes duhet të jetë në përputhje me dispozitat e kodit të shpërndarjes.

Neni 89
Konfidencialiteti i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, duke respektuar në çdo rast përcaktimet e këtij ligji apo ndonjë detyrim tjetër ligjor për dhënien e informacionit, ruan konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar, të siguruar gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe parandalon përhapjen në mënyrë diskriminuese të informacionit për veprimtarinë e tij, me qëllim që të krijojë avantazh tregtar te një palë tjetër.

Neni 90
Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes paraqet për miratim në ERE planin e investimit për zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes për 5 vjetët e ardhshëm kalendarikë. Plani i zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes siguron transparencë për shërbimet e fleksibilitetit afatmesëm dhe afatgjatë dhe përcakton investimet e planifikuara për 5 deri në 10 vjetët e ardhshëm, me theks të veçantë në infrastrukturën kryesore të shpërndarjes që kërkohet për lidhjen e kapaciteteve të reja gjeneruese dhe ngarkesat e reja, përfshirë pikat e rikarikimit për automjetet elektrike. Plani i zhvillimit të rrjetit përfshin gjithashtu përdorimin e përgjigjes së kërkesës, eficiencën e energjisë, impiantet e depozitimit të energjisë ose burime të tjera që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet t'i përdorë si alternativë ndaj zgjerimit të sistemit.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes konsultohet me të gjithë përdoruesit përkatës të sistemit dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit për planin e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes publikon rezultatet e procesit të konsultimeve dhe e dorëzon në ERE së bashku me planin e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes. ERE-ja mund të kërkojë ndryshime në planin e paraqitur. Pasi miratohet nga ERE-ja, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes publikon planin e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes.

3. ERE-ja mund të vendosë të mos zbatojë detyrimin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni për operatorët e sistemit të shpërndarjes që u shërbejnë më pak se 100 000 klientëve ose sistemeve të vogla të izoluara.

4. Plani i zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes përmban masat që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes planifikon të ndërmarrë për:

a) eficiencën e energjisë;

b) menaxhimin e kërkesës;

c) zhvillimin apo përmirësimin e sistemit të shpërndarjes;

ç) informacionin për mjetet financiare të siguruara për investimet në sistemin e shpërndarjes.

5. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes gjatë hartimit të planit merr në konsideratë zhvillimin e rrjetit të transmetimit, si dhe planifikimin urban e rajonal për zonën ku do të zhvillohet sistemi i shpërndarjes.

6. Pavarësisht parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kur aplikon për tarifa ose të paktën çdo 2 vjet paraqet pranë ERE-s planin e përditësuar të investimeve, që i korrespondon periudhës përkatëse rregullatore.

7. Kur ERE-ja zbulon se Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk ka kryer një investim, përveç se për arsye thelbësore jashtë kontrollit të saj, i cili sipas planit 5-vjeçar duhej të realizohej në tre vjetët në vijim dhe ERE vlerëson se investimi është ende i nevojshëm dhe mund të realizohet pa penguar funksionimin normal të rrjetit, atëherë ERE-ja mund të marrë të paktën një nga masat e mëposhtme:

a) të kërkojë që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të kryejë investimin në fjalë;

b) të organizojë një procedurë të hapur konkurruese për realizimin e investimit në fjalë, e hapur për çdo investitor.

8. Kur ERE-ja merr masa sipas shkronjës "b" të pikës 7 të këtij neni, mund ta detyrojë Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes të zbatojë një ose më shumë nga alternativat e mëposhtme:

a) të sigurojë financimin nga ndonjë palë e tretë;

b) të kërkojë ndërtimin nga ndonjë palë e tretë;

c) të administrojë asetet e reja pas ndërtimit.

9. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet t'u ofrojë investitorëve të gjithë informacionin e nevojshëm për të realizuar investimin, duhet të lidhë asete të reja me rrjetin e shpërndarjes dhe në përgjithësi duhet të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të lehtësuar zbatimin e projektit të investimit.

10. ERE-ja përpara se të ushtrojë kompetencat e saj të parashikuara në pikat 1, 2, 7 dhe 8 të këtij neni, kërkon mendimin e ministrisë.

11. Kur ERE-ja prezanton ndonjë nga masat e listuara në pikën 7 të këtij neni, tarifat përkatëse mbulojnë kostot e investimeve në fjalë.

12. ERE-ja harton dhe miraton rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planeve të investimit.

Neni 91

Pronësia e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes mbi impiantet e depozitimit të energjisë

1. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk do të zotërojë, nuk do të zhvillojë, nuk do të menaxhojë ose nuk do të operojë impiantet e depozitimit të energjisë, përveç sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të zotërojë, të zhvillojë, të menaxhojë ose të operojë impiantet e depozitimit të energjisë aty ku ato janë komponentë plotësisht të integruar të rrjetit të sistemit të shpërndarjes, në përputhje me parimin e kostos më të ulët të mundshme, që i nënshtrohen miratimit nga ERE-ja. ERE-ja do të refuzojë të japë miratimin nëse impianti i depozitimit të energjisë nuk është i nevojshëm për kryerjen nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të detyrave të tij të përcaktuara në këtë ligj.

3. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të zotërojë, të zhvillojë, të menaxhojë ose të operojë impiantet e depozitimit të energjisë në përputhje me parimin e kostos më të ulët të mundshme, nëse plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) palët e tjera, pas një procedure tenderimi të hapur, transparente dhe jodiskriminuese, që i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit nga ERE-ja, nuk u është dhënë e drejta për të zotëruar, për të zhvilluar, për të menaxhuar ose për të operuar objekte të tilla, ose nuk mund t'i ofrojnë këto shërbime në një kosto me nivel të arsyeshëm dhe brenda një kohe të përshtatshme;

b) impiante ose shërbime ndihmëse jo të lidhura me frekuencën të tilla janë të nevojshme që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes të përmbushë detyrimet e tij për funksionimin eficient, të besueshëm dhe të sigurt të sistemit të shpërndarjes dhe ato nuk përdoren për të blerë ose për të shitur energji elektrike në tregjet e energjisë elektrike; dhe

c) ERE-ja ka vlerësuar domosdoshmërinë e një përjashtimi të tillë dhe ka kryer një vlerësim paraprak të zbatueshmërisë së një procedure tenderimi, duke përfshirë kushtet e procedurës së tenderit, si dhe ka dhënë miratimin e tij.

4. Rregulloret e detajuara për procedurat e ERE-s për dhënien e miratimeve të përmendura në pikat 2 dhe 3 të këtij neni miratohen me vendim të Bordit të ERE-s.

5. ERE-ja duhet të kryejë të paktën çdo pesë vjet një konsultim publik mbi impiantet ekzistuese të depozitimit të energjisë, me qëllim vlerësimin e disponueshmërisë dhe interesit potencial për të investuar në impiante të tilla. Kur konsultimi publik, siç vlerësohet nga ERE-ja, tregon se palët e treta janë në gjendje të zotërojnë, të zhvillojnë, të operojnë ose të menaxhojnë impiante të tilla në një mënyrë me

kosto efektive, ERE-ja duhet të sigurojë që brenda 18 muajve operatorët e sistemit të shpërndarjes të tërhiqen gradualisht nga ky aktivitet.

KREU VI
MATJA E ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 92
Matja e energjisë elektrike

1. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes janë përgjegjës për veprimtarinë e matjes dhe shërbimin e leximit të matësve në rrjetet e tyre përkatëse.

2. Pavarësisht dispozitave të nenit 94 të këtij ligji, të gjithë klientët fundorë kanë të drejtë të pajisen me matës konvencionalë individualë që masin saktë konsumin e tyre aktual. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të sigurojnë që të gjithë klientët fundorë të jenë në gjendje të lexojnë me lehtësi matësat e tyre konvencionalë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, përmes një ndërfaqeje në internet ose përmes një ndërfaqe tjetër të përshtatshme.

3. Me miratim të ERE-s, në përputhje me kodin e shpërndarjes, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mund të kontraktojë operatorë të pavarur për kryerjen e veprimtarisë së matjes dhe/ose shërbimeve të leximit të matësve në rrjetin e tij përkatës.

4. Energjia elektrike e hedhur në rrjet ose e furnizuar te klientët fundorë matet nëpërmjet pajisjeve matëse në përputhje me parashikimet e kodeve të rrjetit, si dhe me legjislacionin në fuqi për metrologjinë. Klientët kanë të drejtë të instalojnë njësi matëse shtesë me kërkesën dhe shpenzimet e tyre.

5. Në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE-ja. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.

6. Matësi dhe/ose sistemi matës duhet të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për metrologjinë dhe pas instalimit duhet të bashkëvulosen nga operatori i sistemit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë ose nga personi juridik i autorizuar prej saj. Vula miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë. Klasa e saktësisë së matësve të energjisë elektrike përcaktohet në kodet e rrjetit.

Neni 93
Verifikimi i matësve

1. Verifikimi i matësve të energjisë elektrike kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) ose nga një person juridik i autorizuar prej saj. Personi juridik i autorizuar për këtë qëllim akreditohet sipas legjislacionit në fuqi.

2. Aparatet matëse verifikohen përpara vënies në përdorim nëpërmjet metodës së kampionit, në bazë të përzgjedhjes rastësore dhe në mënyrë periodike.

3. Verifikimi i matësve mund të realizohet me kërkesë të operatorit të sistemit. Verifikimi mund të realizohet në terren, aty ku matësi është i instaluar, pranë laboratorit të DPM-së apo personit juridik të autorizuar. Periodiciteti i verifikimit të matësve të instaluar te klienti përcaktohet në kodet e rrjetit. Në çdo rast duhet të jetë i pranishëm edhe përfaqësuesi i operatorit të sistemit.

4. Gjatë procesit të verifikimit të matësve të energjisë elektrike nga DPM-ja ose nga personi juridik i autorizuar, përfaqësuesi i operatorit të sistemit duhet të jetë i pranishëm në çdo rast. DPM-ja miraton procedurat përkatëse të verifikimit të matësve në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet ndërkombëtare.

5. Kostot financiare për verifikimin përpara vënies në përdorim dhe verifikimin periodik të matësit apo verifikime të iniciuara nga operatori i sistemit përballohen nga ky i fundit. ERE-ja merr në konsideratë këto kosto të shkaktuara operatorit gjatë miratimit të tarifave përkatëse.

6. Kur klienti dyshon në saktësinë e aparatit matës, paraqet një kërkesë me shkrim pranë operatorit të rrjetit, si dhe çdo institucioni tjetër përgjegjës për verifikimin e aparatit matës. Procedura për paraqitjen e një kërkese, shqyrtimin e saj dhe afatet e njoftimit të kërkuesit miratohen me vendim të ERE-s në përputhje me afatet e parashikuara sipas Kodit të Procedurave Administrative. Kur verifikimi i matësit është bërë me kërkesë të klientit dhe gjatë verifikimit të matësit nuk konstatohen pasaktësi, shpenzimet e verifikimit paguhen nga klienti që ka paraqitur ankesën.

7. Kur pas verifikimit konstatohen pasaktësi në matës dhe nuk ka prova të dëmtimeve me dashje të

bëra nga klienti, bëhen përllogaritjet përkatëse të sasisë së energjisë së faturuar më shumë ose më pak, si rezultat i pasaktësisë në matës dhe mënyrës së rimbursimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në kodin e rrjetit.

8. Tarifat tavan për verifikimin e matësve miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për energjinë.

9. Operatori i sistemit, nëse konstaton ndërhyrje të paligjshme, merr masa të menjëhershme për riparimin dhe zëvendësimin e pajisjeve në të cilat është ndërhyrë, përllogarit dëmin ekonomik të shkaktuar nga ndërhyrjet e paligjshme dhe zbaton procedurat përkatëse sipas legjislacionit në fuqi. ERE-ja miraton rregulloren dhe metodologjinë përkatëse për vendosjen dhe përllogaritjen e dëmit ekonomik nga ana e operatorit të sistemit.

10. ERE-ja miraton kontratën tip ndërmjet operatorit të sistemit dhe DPM-së ose subjektit të autorizuar nga ana e saj për verifikimin e matësve.

Neni 94
Sistemet matëse inteligjente

1. Në veprimtarinë e matjes së energjisë elektrike mund të zbatohen sisteme matëse inteligjente për klientët fundorë. ERE-ja miraton dhe publikon rregulloren e detajuar për kërkesat minimale funksionale dhe teknike të sistemeve matëse inteligjente që mund të instalohen.

2. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përgatit vlerësimin ekonomik, i cili duhet të marrë në konsideratë të gjitha kostot afatgjata dhe përfitimet që do të ketë tregu dhe klientët, duke përfshirë gjithashtu edhe formën e matjes inteligjente që do të përzgjidhet, e cila duhet të jetë ekonomikisht më efektive dhe me afatin kohor më të përshtatshëm për implementimin e këtij sistemi matjeje. Një vlerësim i tillë do të marrë gjithashtu në konsideratë metodologjinë për analizën kosto-përfitim dhe funksionalitetet minimale për sistemet inteligjente matëse të parashikuara në rekomandimin e Komisionit 2012/148/BE të Komisionit Evropian, si dhe teknikat më të mira të disponueshme për të siguruar nivelin më të lartë të sigurisë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave. Në këtë kontekst, teknikat më të mira të disponueshme do të nënkuptojnë teknikat më efektive, më të avancuara dhe praktikisht të përshtatshme.

3. Në bazë të vlerësimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes përgatit një kalendar për implementimin brenda një periudhë 10-vjeçare të sistemeve inteligjente të matjes, i cili miratohet nga ministri.

4. Nëse promovimi i shtrirjes sistematike të sistemeve inteligjente të matjes vlerësohet pozitivisht si rezultat i vlerësimit të përmendur në pikën 2 të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të kryejë vendosjen e matësve inteligjentë në përputhje me kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara nga ERE-ja. Si rezultat i një vendosjeje të tillë, të paktën 80% e klientëve fundorë do të pajisen me matës inteligjentë brenda shtatë vjetëve nga data e vlerësimit pozitiv.

5. Në rast të një vendosjeje sistematike sipas pikës 4 të këtij neni, ERE-ja do të sigurojë që klientët fundorë të kontribuojnë në kostot e lidhura me vendosjen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese nëpërmjet tarifave të rrjetit, duke marrë parasysh përfitime për të gjithë zinxhirin e vlerës.

6. Në rast të një vendosjeje sistematike sipas pikës 4 të këtij neni, ERE-ja do të monitorojë rregullisht këtë vendosje për të gjurmuar dhënien e përfitimeve për konsumatorët.

7. Nëse promovimi i vendosjes sistematike të sistemeve inteligjente të matjes vlerësohet negativisht si rezultat i vlerësimit të përmendur në pikën 2 të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të sigurojë që çdo klient fundor të ketë të drejtë sipas kërkesës, duke përballuar kostot përkatëse, të ketë instaluar ose, sipas rastit, të ketë përmirësuar, në kushte të drejta, të arsyeshme dhe me kosto efektive dhe me specifikat teknike të përcaktuara nga ERE.

8. Nëse promovimi i vendosjes sistematike të sistemeve inteligjente të matjes vlerësohet negativisht si rezultat i vlerësimit të përmendur në pikën 2 të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do ta rishikojë këtë vlerësim çdo katër vjet ose më shpesh, në përgjigje të ndryshimeve të rëndësishme në vlerësimet kryesore dhe në përgjigje të zhvillimeve teknologjike dhe të tregut. ERE-ja do t'i njoftojë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë rezultatin e këtij vlerësimi kosto-përfitim të përditësuar, sapo të jetë i disponueshëm.

9. ERE-ja siguron ndërveprueshmërinë e sistemeve të ndryshme matëse që do të zbatohen në të gjithë territorin e vendit, si dhe aftësinë e tyre për

të ofruar *output* për sistemet e menaxhimit të energjisë së klientit. Në këtë drejtim, ERE-ja do të ketë parasysh përdorimin e standardeve përkatëse të disponueshme, duke përfshirë ato që mundësojnë ndërveprim ndaj praktikave më të mira, dhe rëndësinë e zhvillimit të rrjeteve inteligjente dhe zhvillimit të tregut të brendshëm për energjinë elektrike.

10. Kur vendosja e sistemeve të matjes inteligjente vlerësohet pozitivisht si rezultat i analizës kosto përfitim sipas pikës 2 të këtij neni, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes do të vendosë këto sisteme në përputhje me standardet evropiane dhe kërkesat e mëposhtme:

a) sistemet e matjes inteligjente duhet të matin në mënyrë të saktë konsumin real të energjisë elektrike dhe të jenë të afta t'u ofrojnë klientëve fundorë informacion për kohën e përdorimit. Të dhënat historike të verifikuara të konsumit duhet të jenë lehtësisht dhe në mënyrë të sigurt të aksesueshme dhe të vizualizueshme për klientët fundorë me kërkesë dhe pa kosto shtesë. Të dhënat e paverifikuara të konsumit, pranë kohës reale, gjithashtu duhet të jenë të aksesueshme lehtësisht dhe në mënyrë të sigurt për klientët fundorë pa kosto shtesë, përmes një ndërfaqeje të standardizuar ose përmes aksesit në distancë, me qëllim mbështetjen e programeve të automatizuara për eficiencën e energjisë, përgjigjen e kërkesës dhe shërbime të tjera;

b) siguria e sistemeve të matjes inteligjente dhe e komunikimit të të dhënave duhet të jetë në përputhje me rregullat përkatëse të BE-së për sigurinë, duke marrë në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme për të garantuar nivelin më të lartë të mbrojtjes kibernetike, duke pasur parasysh kostot dhe parimin e proporcionalitetit;

c) privatësia e klientëve fundorë dhe mbrojtja e të dhënave të tyre duhet të jenë në përputhje me rregullat përkatëse të BE-së për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë;

ç) operatorët e matjes duhet të sigurojnë që matësit e klientëve aktivë që injektojnë energji elektrike në rrjet të mund të regjistrojnë energjinë e dhënë në rrjet nga ambientet e këtyre klientëve;

d) nëse klientët fundorë e kërkojnë, të dhënat mbi energjinë që ata kanë injektuar në rrjet dhe të dhënat e konsumit të tyre duhet t'u vihen në dispozicion në përputhje me aktet zbatuese të miratuara sipas nenit 28 të këtij ligji përmes një ndërfaqeje komunikimi të standardizuar ose përmes aksesit në distancë, ose një pale të tretë që vepron në emër të tyre, në një format të kuptueshëm që u mundëson krahasimin e ofertave në kushte të barabarta;

dh) klientëve fundorë duhet t'u jepen këshillime dhe informacion i përshtatshëm para ose në momentin e instalimit të matësve inteligjentë, veçanërisht lidhur me potencialin e tyre të plotë në menaxhimin e leximit të matësit dhe monitorimin e konsumit të energjisë, si dhe lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me rregullat përkatëse të BE-së për mbrojtjen e të dhënave;

e) sistemet e matjes inteligjente duhet t'u mundësojnë klientëve fundorë që matja dhe shlyerja të kryhen me të njëjtën rezolucion kohor si periudha e shlyerjes së disbalancës.

11. Për qëllimet e shkronjës "e" të pikës 5 të këtij neni, klientët fundorë duhet të kenë mundësi të marrin të dhënat e tyre të matjes ose t'ia transmetojnë ato një pale tjetër pa kosto shtesë dhe në përputhje me të drejtën e tyre për portabilitetin e të dhënave, sipas rregullave të BE-së për mbrojtjen e të dhënave.

12. Dispozitat e këtij ligji në lidhje me sistemet inteligjente të matjes do të zbatohen për instalimet e ardhshme dhe për instalimet që zëvendësojnë matësit më të vjetër inteligjentë. Sistemet matëse inteligjente, që janë instaluar tashmë ose për të cilat fillimi i procesit të instalimit ka filluar përpara datës 30 nëntor 2021, mund të qëndrojnë në funksion gjatë gjithë jetës së tyre, por, në rastin e sistemeve matëse inteligjente që nuk plotësojnë kërkesat e këtij ligji, nuk do të jenë më të operueshme pas datës 5 korrik 2031.

13. Në kontekstin e një kërkese të klientit për një matës inteligjent sipas pikës 7 të këtij neni, ERE-ja:

a) sigurohet që oferta për klientin fundor që kërkon instalimin e një matësi inteligjent të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të përshkruajë:

i. funksionet dhe ndërveprueshmërinë që mund të mbështesë matësi inteligjent dhe shërbimet që janë të realizueshme, si dhe përfitimet që mund të arrihen realisht nga përdorimi i këtij matësi në atë moment;

ii. çdo kosto të lidhur që do të përballohet nga klienti fundor;

b) sigurohet që instalimi të kryhet brenda një afati të arsyeshëm, jo më vonë se katër muaj nga kërkesa e klientit;

c) rishikon në mënyrë periodike dhe të paktën çdo dy vjet kostot përkatëse, t'i bëjë ato publike dhe të ndjekë evolucionin e tyre si rezultat i zhvillimeve teknologjike dhe përmirësimeve të mundshme të sistemit të matjes.

PJESA E GJASHTË
FURNIZIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

KREU I

Neni 95
Veprimtaritë e furnizimit

1. Pavarësisht përjashtimeve të parashikuara në nenin 40 të këtij ligji, furnizimi me energji elektrike i klientëve fundorë mund të bëhet nga çdo i licencuar, i cili është i pajisur me licencë për furnizim me energji elektrike, të lëshuar nga ERE-ja.

2. Furnizuesit blejnë energji elektrike për furnizimin e klientëve fundorë në tregun e brendshëm dhe/ose nëpërmjet importit.

3. Furnizimi me energji elektrike i klientëve fundorë bëhet me çmime të parregulluara, i cili përcaktohet në bazë të kontratave të negociuara ndërmjet furnizuesit dhe klientit fundor.

4. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 2 dhe 3 të këtij neni, ERE-ja mund të përcaktojë çmime të rregulluara për kategori të caktuara klientësh në kuadrin e vendosjes së detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve, sikurse përcaktohet në nenet 49 dhe 106 të këtij ligji.

Neni 96
Klientët aktivë

1. Klientët fundorë që kualifikohen si klientë aktivë do të kenë të drejtë të veprojnë si të tillë pa iu nënshtruar kërkesave teknike disproporcionale ose diskriminuese, kërkesave administrative, procedurave dhe tarifave, si dhe tarifave të rrjetit që nuk pasqyrojnë koston.

2. Të drejtat dhe përgjegjësitë e klientëve aktivë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim nga ministri. Vendimi i Këshillit të Ministrave mund të parashikojë dispozita të ndryshme të zbatueshme për klientët aktivë individualë dhe për klientët aktivë që veprojnë së bashku, me kusht që të gjitha të drejtat dhe detyrimet e këtij neni të zbatohen për të gjithë klientët aktivë. Çdo ndryshim në trajtimin e klientëve aktivë që veprojnë së bashku duhet të jetë proporcional dhe i justifikuar në mënyrën e duhur.

3. Klientët aktivë:

a) kanë të drejtë të operojnë drejtpërdrejt ose përmes agregimit;

b) kanë të drejtë ta shesin energjinë elektrike të vetëprodhuar, duke përfshirë edhe marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike;

c) kanë të drejtë të ofrojnë shërbime të përgjigjes ndaj kërkesës, të marrin pjesë në skemat e fleksibilitetit dhe skemat e eficiencës së energjisë;

ç) kanë të drejtë të kenë në pronësi dhe të operojnë një impiant të depozitimit të energjisë, pavarësisht nga përcaktimet e nenit 40 të këtij ligji;

d) kanë të drejtë t'i delegojnë një pale të tretë menaxhimin e instalimeve të kërkuara për aktivitetet e tyre, duke përfshirë instalimin, funksionimin, trajtimin dhe mirëmbajtjen e të dhënave, ku kjo palë e tretë nuk do të konsiderohet si një klient aktiv;

dh) janë subjekt i tarifave të rrjetit që pasqyrojnë kostot reale, transparente dhe jodiskriminuese, që llogariten veçmas për energjinë elektrike të futur në rrjet dhe energjinë elektrike të konsumuar nga rrjeti, duke siguruar që ato të kontribuojnë në mënyrë të përshtatshme dhe të balancuar në ndarjen e përgjithshme të kostos së sistemit;

e) janë financiarisht përgjegjës për disbalancat që shkaktojnë në rrjetin elektrik. Në atë masë ata do të jenë palë përgjegjëse për balancimin ose do të delegojnë përgjegjësinë e tyre balancuese.

4. Klientët aktivë nuk do të kenë të drejtë të përfshihen në skema vetëprodhimi që nuk llogarisin veçmas energjinë elektrike të injektuar në rrjet dhe atë të konsumuar nga rrjeti (faturim neto) pas 31 dhjetorit 2026. Në çdo rast, klientët që janë të përfshirë në skema ekzistuese të faturimit neto do të kenë mundësinë që në çdo kohë të zgjedhin një skemë të re, e cila bën ndarjen e veçantë të energjisë elektrike të injektuar në rrjet dhe asaj të konsumuar nga rrjeti, si bazë për llogaritjen e tarifave të rrjetit.

5. Klientët aktivë që zotërojnë një impiant të depozitimit të energjisë:

a) do të kenë të drejtën për lidhje në rrjet brenda një afati të arsyeshëm pas kërkesës, me kusht që të përmbushen të gjitha kushtet e nevojshme, si përgjegjësia për balancim dhe matja e duhur;

b) nuk do t'i nënshtrohen asnjë tarife të dyfishtë, përfshirë tarifat e rrjetit, për energjinë elektrike të depozituar që mbetet brenda ambienteve të tyre ose kur ofrojnë shërbime fleksibiliteti për operatorët e sistemit;

c) nuk do t'u nënshtrohen kërkesave ose tarifave joproporcionale të licencimit;

ç) lejohet të ofrojnë disa shërbime njëkohësisht, nëse është teknikisht e mundur.

Neni 97

Kontrata e furnizimit me energji elektrike

1. Të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit dhe klientit të energjisë elektrike përcaktohen në kontratën e nënshkruar nga të dyja palët.

2. Kontrata, përveç kushteve të përcaktuara në nenin 96 dhe atyre të përcaktuara në legjislacionin civil, mund të përmbajë edhe kushte të tjera, në varësi të natyrës specifike dhe llojit të shërbimit të ofruar nga furnizuesi, si më poshtë:

a) kohën e lidhjes së klientit me rrjetin, si dhe nivelet e cilësisë së shërbimit të ofruar;

b) dispozitat për kompensimin dhe rimbursimin në rast të mosrespektimit të nivelit të kontraktuar të cilësisë së shërbimit, përfshirë faturimin e pasaktë dhe të vonuar;

c) çmimin dhe mënyrën e informimit për ndryshimet e çmimit dhe ndryshimin e kushteve të tjera për furnizimin me energji elektrike;

ç) mënyrën e trajtimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

3. Klientët fundorë kanë të drejtë të nënshkruajnë një kontratë me furnizuesin e tyre që specifikon:

a) emrin dhe adresën e furnizuesit;

b) shërbimet e ofruara, nivelet e cilësisë së shërbimit të ofruar, si dhe kohën për lidhjen fillestare me rrjetin;

c) llojet e shërbimit të mirëmbajtjes së ofruar;

ç) çmimin dhe mënyrën e njoftimit të ndryshimit të çmimit dhe kushteve të tjera të furnizimit me energji elektrike

d) mjetet me anë të të cilave mund të merret informacion i përditësuar për të gjitha tarifat e zbatueshme, tarifat e mirëmbajtjes dhe paketat e produkteve ose shërbimeve;

dh) kohëzgjatjen e kontratës, kushtet për rinovimin dhe përfundimin e kontratës dhe shërbimeve, duke përfshirë paketat e produkteve ose shërbimeve që janë të përfshirë me këto shërbime dhe, nëse lejohet, përfundimi i kontratës pa pagesë;

e) çdo mekanizëm kompensimi dhe rimbursimi, i cili zbatohet nëse nuk përmbushen nivelet e cilësisë së shërbimit të kontraktuar, duke përfshirë faturimin e pasaktë ose të vonuar;

ë) metodën e fillimit të një procedure jashtëgjyqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 26 të këtij ligji;

f) informacionin për të drejtat e konsumatorit, duke përfshirë informacionin për trajtimin e ankesave dhe të gjithë informacionin e përmendur në këtë pikë, që komunikohet qartë në faturë ose në faqen e internetit të shoqërisë së energjisë elektrike.

4. Kushtet e kontratës duhet të jenë të drejta dhe duhet të balancojnë interesat e palëve. Kontrata duhet të ketë kushte dhe terma të përgjithshëm të drejta dhe transparente, të cilat duhet të paraqiten në një gjuhë të thjeshtë dhe të qartë, pa paqartësi, dhe nuk duhet të përfshijnë pengesa jokontraktuale për ushtrimin e të drejtave të klientëve, si p.sh. dokumentacion kontraktor të tepërt. Klientët duhet të mbrohen nga praktikat e padrejta ose mashtruese të shitjes.

5. Përpara nënshkrimit të kontratës, klientëve fundorë duhet t'u vihet në dispozicion, në mënyrë të dukshme dhe në gjuhë të përmbledhur e të thjeshtë, një përmbledhje e kushteve kryesore kontraktore. Kur kontratat lidhen përmes ndërmjetësve, informacioni për çështjet e përcaktuara në këtë pikë duhet të ofrohet gjithashtu përpara lidhjes së kontratës.

Neni 98

E drejta për një kontratë të energjisë elektrike me çmim dinamik

1. Furnizuesi i ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit dhe çdo furnizues, që ka më shumë se 200 000 klientë fundorë, do t'i ofrojë çdo klienti fundor të pajisur me matës inteligjent mundësinë për të lidhur një kontratë me çmim dinamik të energjisë elektrike.

2. Furnizuesit duhet të sigurojnë që klientët fundorë që kërkojnë të kalojnë në një kontratë me çmim dinamik të energjisë elektrike janë plotësisht të informuar prej tyre për mundësitë, kostot dhe rreziqet e një kontrate të tillë dinamike të çmimit të energjisë elektrike dhe duhet t'u ofrojnë informacion

klientëve fundorë në përputhje me rrethanat, duke përfshirë edhe ato në lidhje me nevojën për të instaluar një matës të energjisë elektrike të përshatshëm.

3. Furnizuesit duhet të marrin pëlqimin e çdo klienti fundor përpara se ky klient fundor të kalojë në një kontratë të energjisë elektrike me çmim dinamik.

4. ERE-ja monitoron dhe publikon një raport vjetor për të paktën një periudhë 10-vjeçare për zhvillimet kryesore të kontratave dinamike të çmimeve të energjisë elektrike, duke përfshirë ofertat e tregut dhe ndikimin në faturat e klientëve, si dhe veçanërisht nivelin e luhatshmërisë së çmimeve. Në veçanti, ERE-ja në raportin e saj vjetor vlerëson rreziqet që mund të sjellin produktet dhe shërbimet e reja dhe përballet me praktika abuzive. Raporti i parë vjetor i ERE-s do të mbulojë vitin kalendarik kur ofrohet kontrata e parë e çmimit dinamik të energjisë elektrike nga një furnizues.

Neni 99
Agregimi

1. ERE-ja përgatit dhe publikon rregulloret e detajuara në lidhje me agregimin, marrjen e licencës për agregim dhe zbatimin e kontratave të agregimit. Të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike që kryejnë agregim do të veprojnë në përputhje me këtë rregullore.

2. Klientët do të jenë në gjendje të blejnë dhe të shesin shërbime të energjisë elektrike, përfshirë agregimin, përveç furnizimit, në mënyrë të pavarur nga kontrata e furnizimit me energji elektrike dhe nga një shoqëri elektroenergjetike, sipas zgjedhjes së tyre. Kur lidh një kontratë agregimi, agreguesi njofton menjëherë furnizuesin me të cilin klienti ka një kontratë, ofruesin e shërbimit të balancimit të klientit dhe operatorin e tij përkatës të rrjetit.

3. Furnizuesi i kontraktuar i klientit nuk mund të ndërmarrë asnjë veprim të dëmshëm ndaj klientit për shkak të kontratës së agregimit të lidhur midis klientit dhe agreguesit. Në veçanti, furnizuesi i klientit nuk do të zbatojë tarifa apo kërkesa dhe procedura teknike e administrative diskriminuese.

4. Përpara lidhjes së kontratës së agregimit, agreguesi duhet të informojë plotësisht klientin, prodhuesin dhe pronarin ose operatorin e impiantit të depozitimit të energjisë për termat dhe kushtet kontraktuale të shërbimeve të ofruara.

5. Agreguesi duhet t'i vendosë në dispozicion klientit, pa pagesë, të gjitha të dhënat përkatëse të përgjigjes ndaj kërkesës ose të dhënat për energjinë elektrike të furnizuar dhe të shitur, të paktën një herë në çdo periudhë faturimi, nëse kërkohet nga klienti.

6. ERE-ja siguron që të drejtat e përmendura në pikat 2, 4 dhe 5 të këtij neni t'u jepen klientëve fundorë në mënyrë jodiskriminuese për sa i përket kostos, përpjekjes ose kohës. Në veçanti, ERE-ja siguron që klientët të mos u nënshtrohen tarifave apo kërkesave dhe procedurave teknike e administrative diskriminuese nga furnizuesi i tyre, për shkak të faktit nëse ata kanë një kontratë me një pjesëmarrës tregu të angazhuar në agregim.

Neni 100
Mjetet e krahasimit

1. ERE-ja siguron që klientët të kenë akses pa pagesë në një mjet krahasimi *online* të pavarur, të operuar nga ERE-ja. Një mjet i tillë krahasimi mbulon të gjithë tregun dhe krahason ofertat e furnizuesve, duke përfshirë ofertat për kontrata të çmimeve dinamike të energjisë elektrike, sipas kritereve të qarta dhe objektive për informimin e konsumatorëve.

2. Mjeti i krahasimit duhet të përmbushë të paktën kërkesat e mëposhtme:

a) të jetë i pavarur nga pjesëmarrësit e tregut dhe të sigurojë që shoqërive të energjisë elektrike t'u jepet trajtim i barabartë në rezultatet e kërkimit;

b) të zbulojë qartë pronarët e mjetit dhe personin fizik ose juridik që operon dhe kontrollon mjetin, si dhe informacionin se si financohet ky mjet;

c) të përcaktojë kritere të qarta dhe objektive mbi të cilat do të bazohet krahasimi, duke përfshirë shërbimet, dhe t'i publikojë ato;

ç) të përdorë gjuhë të thjeshtë dhe të qartë;

d) të japë informacion të saktë dhe të përditësuar, si dhe të deklarojë kohën e përditësimit të fundit;

dh) të jetë i aksesueshëm nga personat me aftësi të kufizuara, duke qenë i perceptueshëm, i përdorshëm, i kuptueshëm dhe i qëndrueshëm;

e) të sigurojë një procedurë efektive për raportimin e informacionit të pasaktë për ofertat e publikuara; dhe

ë) të kryejë krahasime duke kufizuar të dhënat personale të kërkuara në ato që janë rreptësisht të nevojshme për krahasimin.

3. Furnizuesit duhet të përfshijnë në faturat e tyre të lëshuara, si dhe të publikojnë në faqen e tyre të internetit informacionin për disponueshmërinë dhe mënyrën e aksesit në mjetin e krahasimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, i cili administrohet nga ERE-ja.

Neni 101
Faturat dhe informacioni mbi faturimin

1. ERE-ja siguron që faturat dhe informacioni i faturimit, të lëshuara nga furnizuesit, të jenë të sakta, të lehta për t'u kuptuar, të qarta, koncize, të përshtatshme për përdoruesit dhe të paraqitura në një mënyrë që lehtëson krahasimin nga klientët fundorë. Sipas kërkesës, klientët fundorë marrin një shpjegim të qartë dhe të kuptueshëm se si është bërë fatura e tyre.

2. Klientët fundorë kanë të drejtë të marrin të gjitha faturat dhe informacionin e faturimit të tyre, pa pagesë.

3. ERE-ja siguron që klientëve fundorë t'u ofrohet opsioni i faturave dhe informacionit të faturimit në mënyrë elektronike, si dhe t'u ofrohen marrëveshje fleksibël për kryerjen e pagesës të faturave.

4. Nëse kontrata e furnizimit parashikon një ndryshim të ardhshëm të produktit ose çmimit ose për një ulje të tyre, kjo duhet të tregohet në faturë së bashku me datën në të cilën ndodh ndryshimi.

5. ERE-ja pas konsultimit me organizatat e mbrojtjes së klientëve përgatit dhe publikon kërkesat e detajuara për informacionin minimal që duhet të përmbajnë faturat dhe informacioni i faturimit, përfshirë gjithashtu përbërjen e përzierjes energjetike dhe ndikimin mjedisor.

6. Informacioni kryesor i mëposhtëm duhet t'u shfaqet dukshëm klientëve fundorë në faturat dhe në informacionin e faturimit, qartësisht i ndarë nga pjesët e tjera të faturës:

a) çmimi që duhet paguar dhe një ndarje e çmimit, kur është e mundur, së bashku me një deklaratë të qartë se të gjitha burimet e energjisë mund të përfitojnë gjithashtu nga stimujt që nuk janë financuar përmes taksave të treguara në ndarjen e çmimit;

b) data në të cilën duhet të bëhet pagesa;

c) konsumi i energjisë elektrike për periudhën e faturimit;

ç) emri dhe të dhënat e kontaktit të furnizuesit, duke përfshirë një linjë telefonike për kujdesin ndaj klientit dhe adresën e *e-mail*-it;

d) emri i tarifës;

dh) data e përfundimit të kontratës, nëse është e aplikueshme;

e) informacioni për disponueshmërinë dhe përfitimet e ndryshimit të furnizuesit;

ë) kodi i klientit fundor për ndryshimin e furnizuesit ose kodi unik i identifikimit për pikën e furnizimit të klientit fundor;

f) informacioni për të drejtat e klientëve fundorë në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës, duke përfshirë të dhënat e kontaktit të subjektit përgjegjës;

g) pika e vetme e kontaktit e përmendur në nenin 19 të këtij ligji;

gj) një lidhje ose referencë për vendin ku mund të gjenden mjetet e krahasimit të përmendura në nenin 100 të këtij ligji.

7. Furnizuesit duhet të specifikojnë në fatura kontributin e secilit burim energjie në energjinë elektrike të blerë nga klienti fundor në përputhje me kontratën e furnizimit me energji elektrike. Informacioni i mëposhtëm vendoset në dispozicion të klientëve fundorë së bashku me ose i referuar brenda faturave dhe informacionit të faturimit:

a) kontributi i secilit burim energjie në përzierjen e përgjithshme të energjisë së furnizuesit gjatë vitit paraardhës, në mënyrë të kuptueshme dhe lehtësisht të krahasueshme;

b) informacioni për ndikimin mjedisor të paktën në terma të emetimeve të CO^2 dhe mbetjeve radioaktive që rrjedhin nga energjia elektrike e prodhuar nga përzierja e përgjithshme e furnizuesit gjatë vitit paraardhës.

Për sa i përket shkronjës "a" të pikës 7 të këtij neni, për energjinë elektrike të siguruar nëpërmjet një burse energjie ose të importuar nga një ndërmarrje jashtë Bashkimit Evropian mund të përdoren të dhëna të agreguara, të ofruara nga bursa ose ndërmarrja përkatëse për vitin paraardhës.

8. Deklarimi i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme do të bëhet duke përdorur garancitë e origjinës, përveç rasteve:

a) për pjesën e përzierjes së energjisë që korrespondon me oferta tregtare që nuk gjurmohen, nëse ka të tilla, për të cilat furnizuesi mund të përdorë përzierjen reziduale; ose

b) kur është vendosur të mos lëshohen garanci të origjinës për një prodhues që përfiton mbështetje financiare nga një skemë mbështetëse.

9. ERE-ja merr masat e nevojshme për të siguruar që informacioni i ofruar nga furnizuesit për klientët fundorë, sipas pikës 6 të këtij neni, të jetë i besueshëm dhe të jepet në nivel kombëtar në mënyrë qartësisht të krahasueshme.

Neni 102
Komunitetet energjetike të qytetarëve

1. Një komunitet energjetik i qytetarëve ka të drejtë:

a) të prodhojë, të konsumojë, të depozitojë, të ndajë, të shesë energji elektrike dhe të ofrojë agregim, edhe përmes marrëveshjeve të blerjes së energjisë;

b) të hyjë në të gjitha tregjet e përshtatshme të energjisë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet agregimit, në mënyrë jodiskriminuese;

c) në lidhje me konsumin e energjisë elektrike të vetëprodhuar, të trajtohet si klient aktiv;

ç) të organizojë brenda komunitetit energjetik të qytetarëve ndarjen e energjisë elektrike që prodhohet nga njësitë e prodhimit në pronësi të komunitetit, në përputhje me kërkesat e tjera të përcaktuara në këtë nen dhe duke ruajtur të drejtat e detyrimet si klientë fundorë të anëtarëve të komunitetit.

2. Komuniteti energjetik i qytetarëve është i detyruar të mbajë përgjegjësi financiare për disbalancat që shkakton në sistemin elektroenergjetik në masën që do të jetë palë përgjegjëse për balancim ose do të delegojë përgjegjësinë e tij të balancimit.

3. Çdo komunitet energjetik i qytetarëve mundëson dhe stimulon familjet me të ardhura të ulëta ose në nevojë që të bëhen anëtare.

4. Një shoqëri private mund të jetë anëtare e një komuniteti energjetik të qytetarëve, me kusht që pjesëmarrja e saj të mos përfaqësojë veprimtarinë e saj kryesore tregtare ose profesionale.

5. Çdo klient fundor ka të drejtë të bëhet anëtar i një komuniteti energjetik të qytetarëve dhe të ruajë statusin e klientit fundor, si dhe statusin e konsumatorit aktiv me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër përkatës. Klienti fundor nuk duhet t'u nënshtrohet kushteve ose procedurave të pajustifikueshme ose diskriminuese, që do të pengonin pjesëmarrjen e tij në një komunitet energjetik të qytetarëve, me kusht për shoqëritë private që pjesëmarrja e tyre në një komunitet të tillë të mos përbëjë veprimtarinë e tyre kryesore tregtare ose profesionale.

6. ERE-ja siguron një kuadër rregullator mundësues për komunitetet energjetike të qytetarëve, duke garantuar që:

a) pjesëmarrja në një komunitet energjetik të qytetarëve është e hapur dhe vullnetare;

b) anëtarët ose aksionarët e një komuniteti energjetik të qytetarëve kanë të drejtë të largohen nga komuniteti;

c) anëtarët ose aksionarët e një komuniteti energjetik të qytetarëve nuk humbasin të drejtat dhe detyrimet e tyre si klientë familjarë ose klientë aktivë;

ç) kundrejt një kompensimi të drejtë të vlerësuar nga ERE-ja, operatorët përkatës të sistemit të shpërndarjes të bashkëpunojnë me komunitetet energjetike të qytetarëve për të lehtësuar transferimet e energjisë elektrike brenda këtyre komuniteteve;

d) komunitetet energjetike të qytetarëve u nënshtrohen procedurave dhe tarifave të drejta, proporcionale, transparente dhe jodiskriminuese, përfshirë sa i përket regjistrimit dhe licencimit, si dhe tarifave të rrjetit transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në kosto, duke siguruar që ato të kontribuojnë në mënyrë të përshtatshme, të drejtë dhe të balancuar në ndarjen e përgjithshme të kostove të sistemit.

7. Ministri nxjerr udhëzim që përcakton:

a) format ligjore në të cilat mund të krijohet një komunitet energjetik i qytetarëve;

b) kushtet për një pjesëmarrje të hapur dhe vullnetare;

c) organizimin e kontrollit efektiv të masave të komunitetit energjetik të qytetarëve për lehtësimin e aksesit te financat dhe informacioni;

ç) ofrimin e mbështetjes rregullatore dhe ngritjen e kapaciteteve për të mundësuar autoritetet publike për krijimin dhe ngritjen e komuniteteve energjetike të qytetarëve dhe për të ndihmuar autoritetet që të marrin pjesë drejtpërdrejt;

d) çështje të tjera të rëndësishme.

8. Ministri në udhëzimin e përmendur në pikën 7 të këtij neni mund t'u japë komuniteteve energjetike të qytetarëve të drejtën për të menaxhuar rrjetet e shpërndarjes në zonën e tyre të operimit dhe të

vendosë procedurat përkatëse, pa cenuar rregullat që zbatohen për operatorët e sistemit të shpërndarjes. Nëse jepet një e drejtë e tillë, komunitetet qytetare të energjisë:

a) do të kenë të drejtë të lidhin marrëveshje për funksionimin e rrjetit të tyre me operatorin përkatës të rrjetit me të cilin është lidhur rrjeti i tyre;

b) do t'u nënshtrohen tarifave të përshtatshme të rrjetit në pikat e lidhjes ndërmjet rrjetit të tyre dhe rrjetit të shpërndarjes jashtë komunitetit energjetik të qytetarëve dhe këto tarifa rrjeti për energjinë elektrike të injektuar në rrjetin e shpërndarjes do të llogariten në mënyrë të ndarë nga energjia elektrike e konsumuar nga rrjeti i shpërndarjes jashtë komunitetit energjetik të qytetarëve.

c) nuk duhet të diskriminojnë apo të dëmtojnë klientët që mbeten të lidhur me sistemin e shpërndarjes.

9. Për qëllimet e shkronjës "ç" të pikës 1 të këtij neni, kur energjia elektrike ndahet, kjo do të bëhet pa cenuar tarifat e aplikueshme të rrjetit, tarifat dhe taksat, në përputhje me një analizë transparente kosto-përfitim të burimeve të shpërndara të energjisë, të zhvilluar nga ERE-ja.

Neni 103
Pjesëmarrja e përgjigjes ndaj kërkesës përmes agregimit

1. Pjesëmarrja e përgjigjes ndaj kërkesës përmes agregimit do të lejohet dhe do të nxitet. Klientët fundorë, përfshirë ata që ofrojnë përgjigje të kërkesës përmes agregimit, duhet të jenë në gjendje të marrin pjesë krahas prodhuesve në mënyrë jodiskriminuese në të gjitha tregjet e energjisë elektrike.

2. Operatori i sistemit të transmetimit dhe operatorët e sistemit të shpërndarjes, gjatë sigurimit të shërbimeve ndihmëse, duhet t'i trajtojnë pjesëmarrësit e tregut që angazhohen në agregimin e përgjigjes së kërkesës në mënyrë jodiskriminuese, krahas prodhuesve dhe mbi bazën e aftësive të tyre teknike.

3. ERE-ja siguron që kuadri përkatës rregullator të përmbajë të paktën elementet e mëposhtme:

a) të drejtën për çdo pjesëmarrës tregu të angazhuar në agregim, përfshirë agregatorët e pavarur, për të hyrë në tregjet e energjisë elektrike pa pëlqimin e pjesëmarrësve të tjerë të tregut;

b) rregulla jodiskriminuese dhe transparente që përcaktojnë qartë rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha ndërmarrjeve të energjisë elektrike dhe të klientëve;

c) rregulla dhe procedura jodiskriminuese dhe transparente për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet pjesëmarrësve të tregut të angazhuar në agregim dhe ndërmarrjeve të tjera të energjisë elektrike, duke garantuar akses të lehtë në të dhëna në kushte të barabarta dhe jodiskriminuese, duke mbrojtur plotësisht informacionin me ndjeshmëri tregtare dhe të dhënat personale të klientëve;

ç) një detyrim për pjesëmarrësit e tregut të angazhuar në agregim që të mbajnë përgjegjësi financiare për disbalancat që shkaktojnë në sistemin e energjisë elektrike. Në këtë drejtim, ata duhet të jenë palë përgjegjëse për balancimin ose ta delegojnë këtë përgjegjësi në përputhje me parimet përkatëse të rregullores (BE) 2019/943;

d) dispozita që klientët fundorë që kanë kontratë me agregatorë të pavarur të mos u nënshtrohen pagesave të pajustifikuara, penaliteteve ose kufizimeve të tjera kontraktore të pajustifikuara nga furnizuesit e tyre;

dh) një mekanizëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pjesëmarrësve të tregut të angazhuar në agregim dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut, përfshirë përgjegjësinë për disbalancat.

4. ERE-ja në bashkëpunim të ngushtë me pjesëmarrësit e tregut dhe klientët fundorë përcakton kërkesat teknike për pjesëmarrjen e përgjigjes ndaj kërkesës në të gjitha tregjet e energjisë elektrike mbi bazën e karakteristikave teknike të këtyre tregjeve dhe kapaciteteve të përgjigjes së kërkesës. Këto kërkesa do të mbulojnë edhe pjesëmarrjen përmes ngarkesave të agreguara.

Neni 104
Detyrimet e furnizuesve

1. Furnizuesi, në zbatim të këtij ligji, ka detyrimin të furnizojë klientët me energji elektrike në përputhje me kontratën e nënshkruar, në mënyrë të sigurt, të besueshme dhe efikase.

2. Furnizuesi është përgjegjës përballë Operatorit të Sistemit të Transmetimit për çdo disbalancë të shkaktuar. Klientët fundorë janë përgjegjës përballë furnizuesit për disbalancat e shkaktuara. ERE-ja vendos përjashtimin nga përgjegjësia për disbalancat për kategori të caktuara të klientëve fundorë, të cilët

furnizohen mbi bazën e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik.

3. Furnizuesi, përveç detyrimeve të përgjithshme të përcaktuara në kontratë, informon klientët e tij drejtpërdrejt, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente për:

a) të drejtën e tyre për të zgjedhur, pavarësisht parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji, për të ndryshuar pa pagesë furnizuesin, pasi kanë ekzekutuar të gjitha detyrimet e mëparshme të energjisë elektrike;

b) konsumin dhe kostot aktuale të energjisë elektrike, me qëllim mundësimin e menaxhimit të konsumit të energjisë nga ana e klientëve;

c) mënyrat e ndryshme të pagesës, të cilat nuk duhet të jenë diskriminuese midis klientëve. Sistemet e parapagimit, nëse do të aplikohen, duhet të jenë të drejta dhe të reflektojnë konsumin e pritshëm;

ç) mundësinë e përdorimit të procedurave të thjeshta për ndjekjen e ankesave të tyre;

d) ndryshimin e kushteve të kontratës ose çdo rregullim të çmimit të furnizimit, duke përfshirë arsyet dhe kushtet për këto rregullime të paktën 14 ditë përpara zbatimit të tyre, informacionin në lidhje me të drejtën e klientëve për të zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontratën e furnizimit pa kosto shtesë, me lëshimin e njoftimit. Në rastin e klientëve familjarë, njoftimi për çdo rregullim duhet të bëhet të paktën një muaj përpara se rregullimi të hyjë në fuqi;

dh) të dhënat e konsumit të tij, duke i mundësuar çdo klienti akses ndaj të dhënave të matjes, në bazë të një marrëveshjeje të qartë dhe pa pagesë;

e) të drejtat e tyre në përputhje me udhëzuesin e miratuar nga Komuniteti i Energjisë.

4. Furnizuesit nëpërmjet faturës së konsumit të energjisë elektrike dhe/apo materialeve promovuese informojnë në mënyrë të qartë klientët për:

a) të dhëna për çdo burim energjie të siguruar nga furnizuesi gjatë vitit të mëparshëm;

b) elementet përbërëse të çmimit dhe kostot përkatëse;

c) të dhënat për ndikimin në mjedis të dioksidit të karbonit dhe mbeturinave radioaktive të emetuara gjatë prodhimit të energjisë elektrike, të siguruara nga furnizuesi në vitin e mëparshëm.

5. Furnizuesit do t'u ofrojnë klientëve fundorë një zgjedhje të gjerë të mënyrave të pagesës. Këto mënyra pagese nuk duhet të bëjnë dallime të padrejta midis klientëve. Çdo ndryshim në kosto në lidhje me mënyrat e pagesës ose sistemet e parapagimit duhet të jetë objektiv, jodiskriminues dhe proporcional dhe nuk duhet të tejkalojë kostot direkte të kryera nga klientët fundorë për përdorimin e një mënyre specifike pagese ose një sistemi parapagimi. Klientët familjarë që kanë akses në sistemet e parapagimit nuk do të vihen në kushte të pafavorshme nga sistemet e parapagimit.

6. Furnizuesit duhet t'i trajtojnë ankesat në mënyrë të thjeshtë, të drejtë dhe të shpejtë, për të siguruar që klientët fundorë të përfitojnë një standard të mirë shërbimi dhe trajtimi të ankesave nga furnizuesit e tyre.

7. Furnizuesit duhet t'u ofrojnë klientëve familjarë informacion të mjaftueshëm për masat alternative ndaj ndërprerjes së furnizimit, në kohë të mjaftueshme përpara çdo ndërprerjeje të planifikuar. Këto masa alternative mund të përfshijnë burime mbështetjeje për të shmangur ndërprerjen, sisteme parapagimi, auditime energjie, shërbime këshillimi për energjinë, plane alternative pagese, këshillim për menaxhimin e borxhit ose moratoriume për ndërprerjen dhe nuk duhet të përbëjnë kosto shtesë për klientët që përballen me ndërprerje.

Neni 105
Të drejtat e furnizuesit

Furnizuesit, përveç të drejtave të përcaktuara në kontratë, sipas nenit 117 të këtij ligji, kanë këto të drejta:

a) të përdorin, sipas kushteve të rregulluara, shërbimet e operatorit të tregut, Operatorit të Sistemit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, në bazë të rregullave të tregut, kodeve të rrjetit dhe kontratave përkatëse;

b) të kenë akses në sistemin e transmetimit dhe sistemin e shpërndarjes, në përputhje me dispozitat për aksesin e palëve të treta, të përcaktuara në nenin 32 të këtij ligji.

c) të kërkojnë ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike nga Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kur klienti nuk përmbush detyrimet kontraktore dhe rilidhjen e energjisë elektrike kur klienti ka përmbushur detyrimet, të cilat shkaktuan ndërprerjen e furnizimit.

Neni 106
Shërbimi universal i furnizimit si detyrim i shërbimit publik

1. Furnizuesit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik, duhet të garantojnë që të gjithë klientët familjarë dhe ndërmarrjet e vogla dhe mikro të gëzojnë shërbimin universal dhe të drejtën për t'u furnizuar me energji elektrike të një cilësie të përcaktuar brenda territorit të tyre me çmime konkurruese, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese.

2. Furnizuesit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit, si detyrim i shërbimit publik, blejnë energji elektrike sipas procedurave transparente, jodiskriminuese, bazuar në çmimet e tregut, pavarësisht nëse blerja bëhet në tregun bilateral apo të organizuar.

Neni 107
Kushtet e përgjithshme të kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit si detyrim i shërbimit publik

1. ERE-ja miraton kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike, që lidhet ndërmjet klientit fundor dhe furnizuesit të ngarkuar me Shërbimin Universal të Furnizimit, si një detyrim i shërbimit publik.

2. Furnizuesi universal, përveç kushteve të kontratës të parashikuara në nenin 97 të këtij ligji, duhet:

a) të informojë klientët për të drejtat e tyre dhe për kushtet e furnizimit sipas shërbimit universal;

b) të njoftojë klientët për kushtet e furnizimit dhe çmimin e energjisë elektrike, përfshirë informimin për të drejtën e tyre për të zgjedhur një furnizues tjetër;

c) të furnizojë me energji elektrike, në kushtet e shërbimit universal, kategori të caktuara të klientëve brenda territorit për të cilin janë licencuar, për të kryer shërbimin universal sipas parashikimeve të neneve 106 dhe 108 të këtij ligji;

ç) të njoftojë klientin për marrjen e masave për ekzekutimin e detyrueshëm për detyrimet e papaguara;

d) të furnizojë klientët në nevojë, duke respektuar kushtet e përcaktuara në nenin 119 të këtij ligji;

dh) të paguajë për energjinë e livruar, sipas Shërbimit Universal të Furnizimit, në përputhje me çmimet e miratuara nga ERE-ja, sipas metodologjisë së përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji;

e) të publikojë në faqen e internetit çmimet e furnizimit në kushtet e shërbimit universal të miratuara nga ERE-ja.

3. Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit publikohen në faqen e internetit të ERE-s, si dhe në faqet e internetit të furnizuesit.

Neni 108
Kushtet për çmimet e rregulluara

1. ERE-ja përcakton çmimet e rregulluara vetëm për klientët fundorë që furnizohen sipas Shërbimit Universal të Furnizimit dhe klasifikohen si klientë familjarë në varfëri energjetike ose si klientë familjarë në nevojë sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji.

2. Çmimet e energjisë elektrike, që i nënshtrohen rregullimit për Shërbimin Universal të Furnizimit, duhet të përcaktohen në përputhje me metodologjitë përkatëse.

3. ERE-ja përcakton afatin e zbatimit të çmimeve të rregulluara për kategori specifike klientësh dhe rishikon çdo vit nivelin e miratuar të çmimit.

4. Zbatimi i çmimeve të rregulluara gjatë përcaktimit të detyrimeve të shërbimit universal në lidhje me furnizimin me energji elektrike të klientëve në nevojë ose në varfëri energjetike duhet të jetë në përputhje me kriteret e mëposhtme:

a) duhet të ndjekë një interes të përgjithshëm ekonomik dhe të mos shkojë përtej asaj që është e nevojshme për të arritur atë interes të përgjithshëm ekonomik;

b) duhet të jetë i përcaktuar qartë, transparent, jodiskriminues dhe i verifikueshëm;

c) duhet të garantojë akses të barabartë për shoqëritë që ushtrojnë aktivitet në sektorin e energjisë elektrike të palëve të Komunitetit të Energjisë te klientët;

ç) duhet të jetë i kufizuar në kohë dhe proporcional në lidhje me përfituesit e tij;

d) nuk duhet të rezultojë në kosto shtesë për pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike në mënyrë diskriminuese.

5. Për efekt të një periudhe tranzitore, me qëllim vendosjen e një konkurrence efektive për kontratat e furnizimit me energji elektrike midis furnizuesve

dhe për të arritur çmime me pakicë të energjisë elektrike plotësisht efektive të bazuara në treg, ERE-ja përcakton çmimet e rregulluara edhe për klientët familjarë dhe ndërmarrjet mikro, të cilat furnizohen si pjesë e shërbimit universal, të përcaktuar në pikën 1 të nenit 106 të këtij ligji.

6. Zbatimi i çmimeve të rregulluara gjatë përcaktimit të detyrimeve të shërbimit universal në lidhje me furnizimin me energji elektrike të klientëve familjarë dhe ndërmarrjeve mikro, të cilat furnizohen në kuadër të shërbimit universal dhe nuk klasifikohen si në varfëri energjetike ose klientë në nevojë, duhet të jetë në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni dhe duhet:

a) të shoqërohet nga një sërë masash për të arritur konkurrencë efektive dhe një metodologji për vlerësimin e progresit në lidhje me këto masa;

b) të përcaktohet duke përdorur një metodologji që siguron trajtim jodiskriminues të furnizuesve;

c) të vendoset me një çmim mbi koston, në një nivel ku mund të ndodhë konkurrencë efektive në çmime;

ç) të jetë i hartuar për të zbutur çdo ndikim negativ në tregun me shumicë të energjisë elektrike;

d) të sigurojë që të gjithë përfituesit e masave të tilla të përcaktimit të çmimeve të kenë mundësinë të zgjedhin oferta konkurruese të tregut dhe të informohen drejtpërdrejt të paktën çdo tremujor për disponueshmërinë e ofertave dhe kursimeve në tregun e liberalizuar, në veçanti të kontratave dinamike të çmimeve të energjisë elektrike, dhe të sigurojë që atyre t'u ofrohet ndihmë për të kaluar në një ofertë të bazuar në treg;

dh) të sigurojë se, me kusht që promovimi i vendosjes sistematike të sistemeve inteligjente të matjes të vlerësohet pozitivisht sipas pikës 4 të nenit 94 të këtij ligji, të gjithë përfituesit e masave të tilla të përcaktimit të çmimeve të kenë të drejtë dhe t'u ofrohet instalimi i matësve inteligjentë pa asnjë kosto paraprake shtesë për klientin, të informohen drejtpërdrejt për mundësinë e instalimit të matësve inteligjentë dhe t'u ofrohet ndihma e nevojshme;

e) të mos çojë në ndërsubvencionim të drejtpërdrejtë midis klientëve të furnizuar në treg të lirë dhe atyre të furnizuar me çmime të rregulluara.

7. Ministria duhet të njoftojë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për masat e marra në përputhje me pikat 4 dhe 6 të këtij neni brenda një muaji pas miratimit të tyre. Njoftimi duhet të shoqërohet me një shpjegim se pse instrumente të tjera nuk ishin të mjaftueshme për të arritur objektivin e synuar, se si përmbushen kërkesat e përcaktuara në pikat 4 dhe 6 të këtij neni, dhe për efektet e masave të njoftuara për konkurrencën. Njoftimi duhet të përshkruajë gamën e përfituesve, kohëzgjatjen e masave dhe numrin e klientëve familjarë të prekur nga masat, si dhe duhet të shpjegojë se si janë përcaktuar çmimet e rregulluara.

8. Ministria deri më 1 janar 2028 duhet t'i paraqesë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë raporte për zbatimin e dispozitave të këtij neni, domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e masave të përcaktimit të çmimeve, si dhe një vlerësim të progresit drejt arritjes së konkurrencës efektive midis furnizuesve dhe kalimit në çmime të bazuara në treg. Raporti, në veçanti, duhet të mbulojë përputhshmërinë e masave të përcaktuara në pikën 6 të këtij neni, me kushtet e përcaktuara aty nga furnizuesi që kërkohet të zbatojë një masë të tillë, si dhe mbi ndikimin e çmimeve të rregulluara në gjendjen financiare të furnizuesit të prekur.

9. Në lidhje me ndërhyrjen publike në përcaktimin e çmimeve për klientët vulnerabël dhe familjet e prekura nga varfëria energjetike, autoritetet kompetente, të përcaktuara në nenin 118 të këtij ligji, sigurojnë vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e vazhdueshëm të numrit të familjeve në varfëri energjetike në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga ligji për eficiencën e energjisë, me Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës dhe me nenin 118 të këtij ligji. Kuadri i vlerësimit dhe raportimit shërben si bazë për justifikimin, zbatimin, monitorimin dhe rishikimin periodik të masave të ndërhyrjes publike në përcaktimin e çmimeve të energjisë elektrike, duke garantuar që këto masa të jenë të targetuara, proporcionale, transparente dhe të kufizuara në masën e nevojshme për adresimin e varfërisë energjetike dhe mbrojtjen e klientëve vulnerabël.

Neni 109

Furnizuesi i mundësisë së fundit

1. Furnizuesi i mundësisë së fundit është i detyruar të furnizojë klientët të cilët mbeten pa furnizues në rastet kur:

a) furnizuesi i mëparshëm është në kushtet e paaftësisë paguese ose është në proces falimentimi;

b) furnizuesit të mëparshëm i është hequr ose i është pezulluar përkohësisht licenca;

c) klienti nuk ka arritur të gjejë një furnizues në treg.

2. ERE-ja miraton rregulloren që përcakton kriteret e vlerësimit e të përzgjedhjes së furnizuesit të mundësisë së fundit, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, të përmendur në nenin 90 të këtij neni, detyrimet e tij, transferimin e klientëve drejt dhe nga furnizuesi i fundit, si dhe të drejtat e klientëve fundorë për t'u furnizuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

Neni 110
Përcaktimi i furnizuesit të mundësisë së fundit

1. Këshilli i Ministrave miraton kushtet dhe procedurat për caktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit bazuar në kritere konkurruese, transparente dhe jodiskriminuese.

2. ERE-ja bazuar në kushtet e përcaktuara sipas pikës 1 të këtij neni cakton furnizuesin e mundësisë së fundit.

3. Furnizuesi i mundësisë së fundit caktohet për një periudhë prej tre vjetësh. Vendimi i caktimit përmban kushtet e shërbimit të furnizimit të mundësisë së fundit, informacion në lidhje me përcaktimin e çmimeve dhe ndryshimet e tij, si dhe kushtet kontraktore.

4. Çmimi me të cilin furnizuesi i mundësisë së fundit furnizon me energji elektrike përcaktohet nga ERE-ja sipas metodologjisë së miratuar prej saj, në përputhje me përcaktimet e nenit 21 të këtij ligji.

Neni 111
Ndryshimi i furnizuesit

1. Ndërrimi i furnizuesve bëhet me kërkesë të klientit fundor dhe pa kosto shtesë për të, përveç rasteve të parashikuara në pikën 3 të këtij neni. Furnizuesi aktual është i detyruar ta furnizojë klientin fundor deri në përfundim të procedurës për ndryshimin e furnizuesit.

2. Klientët familjarë dhe ndërmarrjet e vogla dhe mikro duhet të sigurohen që nuk do të ngarkohen me tarifa të lidhura me ndryshimin e furnizuesit.

3. Furnizuesit mund të kenë të drejtë t'i ngarkojnë klientët, përveç atyre të përshkruar në pikën 2 të këtij neni, me tarifa të përfundimit të kontratës, kur këta klientë i ndërpresin vullnetarisht përpara skadimit të afatit të tyre kontratat e furnizimit me energji elektrike me çmim fiks dhe afat të caktuar, me kusht që tarifa të tilla të jenë pjesë e një kontrate që klienti e ka lidhur vullnetarisht dhe t'i jenë komunikuar qartë klientit para se të lidhet kontrata. Tarifa të tilla duhet të jenë proporcionale dhe nuk duhet të tejkalojnë humbjen e drejtpërdrejtë ekonomike për furnizuesin që rezulton nga ndërprerja e kontratës nga klienti, duke përfshirë kostot e çdo investimi ose shërbimi të paketuar që i është ofruar tashmë klientit si pjesë e kontratës. Barra e provës së humbjes së drejtpërdrejtë ekonomike i takon furnizuesit ose pjesëmarrësit të tregut të angazhuar në agregim, i cili duhet ta llogarisë atë mbi bazën e një metodologjie transparente, të miratuar paraprakisht nga ERE-ja. Lejueshmëria e këtyre tarifave monitorohet nga ERE-ja.

4. Rregullat për ndryshimin e furnizuesve të energjisë elektrike miratohen nga ERE-ja dhe përfshijnë:

a) periudhën maksimale, sipas rregullave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni;

b) kushtet që duhet të përmbushë furnizuesi i ri në lidhje me rregullat e balancimit;

c) detyrimet e operatorit të sistemit me të cilin është i lidhur klienti fundor;

ç) detyrimet e klientëve fundorë:

i. për të ekzekutuar të gjitha detyrimet në raport me furnizuesin e parë;

ii. për të pasur një marrëveshje për shlyerjen me këste të borxhit me furnizuesin e mëparshëm; ose

iii. për të pasur një marrëveshje të lidhur midis furnizuesve, ku furnizuesi i ri merr përsipër borxhin e mëparshëm të klientit.

5. Pavarësisht dispozitave të pikave 1, 2 dhe 3 të këtij neni, rregullat për ndryshimin e furnizuesve të energjisë elektrike duhet të sigurojnë që e drejta për të ndërruar furnizuesin t'u jepet të gjithë klientëve në mënyrë jodiskriminuese për sa u përket kostos, përpjekjes dhe kohës.

6. Klientët familjarë, si dhe ndërmarrjet mikro dhe të vogla kanë të drejtë të marrin pjesë në skemat kolektive të ndryshimit të furnizuesve të energjisë elektrike. Rregullat për këto skema duhet të garantojnë mbrojtjen maksimale të konsumatorit dhe të biznesit, duke shmangur praktikat abuzive dhe barrierat administrative të pajustifikuara.

7. Ndërrimi i furnizuesve duhet të kryhet brenda kohës më të shkurtër të mundshme. Çdo klient, që dëshiron të ndryshojë furnizues, duke respektuar

kushtet kontraktuale, ka të drejtë për një ndryshim të tillë brenda një maksimumi prej tre javësh nga data e kërkesës. Procesi teknik i ndryshimit të furnizuesit nuk duhet të zgjasë më shumë se 24 orë.

8. Çdo ankesë në lidhje me procedurën e ndryshimit të furnizuesit i paraqitet ERE-s. Ankesa nuk pezullon afatin për ndryshimin e furnizuesit dhe/ose hyrjen në fuqi të kontratës së re të furnizimit.

9. Për qëllimet e këtij neni, ndryshimi i furnizuesve mbulon edhe ndryshimin e agreguesve.

Neni 112
Ruajtja e të dhënave

1. Të licencuarit për furnizimin e energjisë elektrike ruajnë të dhëna për kontratat e furnizimit me energji elektrike, për kontratat me operatorët e shitjes me shumicë dhe operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes për një periudhë të paktën 5-vjeçare. Këto të dhëna, nëse kërkohet, mund t'i vihen në dispozicion ERE-s dhe/ose Autoritetit të Konkurrencës.

2. Të dhënat përfshijnë detaje për karakteristikat e transaksioneve, të tilla si: kohëzgjatja, rregullat e shpërndarjes dhe të shlyerjes, sasia, afatet e ekzekutimit, çmimet e transaksionit, mjetet e identifikimit të operatorit të shitjes me shumicë në fjalë, detajet e specifikuara për të gjitha kontratat e pashlyera të furnizimit me energji elektrike, si dhe derivativët e energjisë elektrike.

3. ERE-ja mund të vërë në dispozicion të pjesëmarrësve të tregut pjesë të këtij informacioni, duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar.

Neni 113
Situatat emergjente në furnizimin me energji elektrike

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, mund të shpallë gjendjen e emergjencës në furnizimin me energji elektrike në rast të:

a) një force madhore, përfshirë edhe një thatësirë, e cila redukton prodhimin e hidrocentraleve në Shqipëri;

b) masave të marra nga strukturat shtetërore për garantimin e sigurisë kombëtare dhe mbrojtjen e vendit;

c) aksidenteve dhe avarive në pajisjet e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së sistemit të energjisë elektrike;

ç) mungesave afatgjata të burimeve parësore energjetike për prodhimin e energjisë elektrike.

2. Gjatë situatave emergjente, të licencuarit dhe klientët duhet të respektojnë kufizimet në përdorimin e energjisë elektrike. Në vendimin e Këshillit të Ministrave, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen shtrirja dhe mënyra e kufizimit të furnizimit me energji elektrike.

3. Kufizimet e furnizimit në situata të jashtëzakonshme bazohen në kritere të paracaktuara, që kanë të bëjnë me menaxhimin e disbalancave prej Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Çdo masë mbrojtëse merret në konsultim të ngushtë me operatorët e sistemeve të transmetimit të vendeve ndërkufitare, duke respektuar marrëveshjet përkatëse dypalëshe, përfshirë edhe marrëveshjet për shkëmbimin e informacionit.

4. Të licencuarit nuk janë përgjegjës për sanksionet e ardhura si rezultat i ndërprerjes ose kufizimit të energjisë elektrike, për rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, përveç rasteve kur situata e emergjencës vjen si rezultat direkt i fajit të të licencuarit.

5. Në situata emergjente, me propozimin e ministrit dhe pas marrjes së mendimit të Komitetit për Emergjencat Civile, Këshilli i Ministrave mund të vendosë për të licencuarit detyrimin e shërbimit publik në lidhje me sigurinë e furnizimit, duke përfshirë detyrimin e importit të energjisë elektrike, detyrimin e furnizimit vetëm të kategorive të caktuara të klientëve ose kushte të tjera të veçanta në kryerjen e aktiviteteve të licencuara. Ky detyrim do të jetë në përpjesëtim me emergjencën dhe nuk duhet të shtrihet përtej periudhës së nevojshme për kapërcimin e kësaj situate.

6. Çdo kosto shtesë e shkaktuar ndaj të licencuarit, për shkak të vendosjes së detyrimit të shërbimit publik, pasi vlerësohet nga ministria përgjegjëse për financat dhe ERE, me propozim të ministrit dhe Komitetit për Emergjencat Civile, kompensohet nga buxheti i shtetit. Ky kompensim do të jetë në përputhje me nenin 49 të këtij ligji dhe me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

7. Masat jashtë mekanizmave të tregut do të aktivizohen në një krizë të energjisë elektrike vetëm si mjet i fundit në rast se të gjitha opsionet e ofruara

nga tregu janë shteruar ose kur është e qartë se vetëm masat e bazuara në treg nuk janë të mjaftueshme për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të situatës së furnizimit me energji elektrike.

8. Dispozitat e këtij neni do të mbeten në fuqi deri në miratimin e Planit të Gatishmërisë ndaj Rreziqeve, në përputhje me nenin 6 të këtij ligji. Pas miratimit të Planit të Gatishmërisë ndaj Rreziqeve, menaxhimi i situatave emergjente në furnizimin me energji elektrike do të rregullohet nga ky plan dhe dispozitat përkatëse të këtij neni do të zëvendësohen në përputhje me të.

KREU II
PAGIMI I DETYRIMEVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDAJ FURNIZUESIT TË NGARKUAR ME SHËRBIMIN UNIVERSAL TË FURNIZIMIT SI DETYRIM I SHËRBIMIT PUBLIK

Neni 114
Pagesa e detyrimeve të energjisë elektrike ndaj furnizuesit të ngarkuar me shërbimin universal të furnizimit si detyrim i shërbimit publik

Klienti fundor i energjisë elektrike është i detyruar të paguajë detyrimet e energjisë sipas përcaktimeve të kontratës së furnizimit. Nëse klienti nuk e paguan detyrimin e energjisë elektrike, furnizuesi i energjisë elektrike, i ngarkuar me Shërbimin Universal të Furnizimit si detyrim i shërbimit publik, e njofton me shkrim klientin për masat që do të marrë për arkëtimin e detyrimit, sipas përcaktimeve të kontratës dhe/ose të këtij ligj.

Neni 115
Masat e ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve të papaguara

Për të siguruar ekzekutimin e detyrimit të papaguar, furnizuesi në përputhje me parashikimet e kontratës merr masat e mëposhtme:

a) fillon procedurën e ndërprerjes së energjisë elektrike;

b) fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, duke kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile dhe legjislacionit në fuqi për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike;

c) vendos barrën hipotekore mbi pasurinë e paluajtshme që furnizohet me energji elektrike pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nga gjykata kompetente, në rast se detyrimi i papaguar që rrjedh nga një kontratë furnizimi energjie elektrike është mbi 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për klientin jofamiljar.

Neni 116
Vendosja e barrës hipotekore

1. Për detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të përcaktuara në shkronjën "c" të nenit 115 të këtij ligji, furnizuesi njofton klientin për fillimin e procedurës për vendosjen e barrës hipotekore. Njoftimi bëhet me shkrim dhe i dërgohet klientit me postë me lajmërim marrjeje.

2. Klienti brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit, ka të drejtë të ankimojë fillimin e procedurave për vendosjen e barrës hipotekore pranë furnizuesit. Furnizuesi e shqyrton ankimin brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

3. Kur ankesa e klientit vlerësohet e drejtë nga furnizuesi dhe/ose konstatohet se klienti ka shlyer detyrimet e papaguara brenda afatit të ankimit, furnizuesi nuk vijon me procedurën për vendosjen e barrës hipotekore.

4. Kërkesa për të vendosur barrën hipotekore mbi pasurinë e paluajtshme bëhet me shkrim nga furnizuesi dhe i drejtohet zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme ku gjendet pasuria e paluajtshme vetëm pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit nga gjykata kompetente. Kërkesa i njoftohet me postë me lajmërim marrjeje klientit fundor. Kërkesa për vendosjen e barrës hipotekore duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme për të identifikuar klientin, detyrimin e papaguar dhe pasurinë objekt të barrës hipotekore.

5. Me lëshimin e urdhrit të ekzekutimit nga gjykata kompetente për vendosjen e barrës hipotekore, furnizuesi fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm nëpërmjet përmbaruesit gjyqësor sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile dhe legjislacionit në fuqi për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike.

6. Klienti ka të drejtë të ankimojë vendosjen e barrës hipotekore në gjykatë.

PJESA E SHTATË
KLIENTËT DHE MBROJTJA E KLIENTIT

Neni 117
Të drejtat dhe detyrimet e klientëve

1. Të gjithë klientët kanë të drejtë të zgjedhin furnizuesin e tyre të energjisë elektrike, vendas ose të huaj, me çmime të parregulluara, sipas kontratës së furnizimit, e cila është në përputhje me rregullat e tregut dhe kushtet e përgjithshme për furnizim të miratuara nga ERE-ja.

2. Klienti fundor ka të drejtë:

a) të furnizohet me energji elektrike në përputhje me kushtet e vendosura në kontratë;

b) të paraqesë ankesë pranë ERE-s nëse nuk furnizohet sipas kushteve të vendosura në kontratë;

c) të përfitojë nga furnizuesi një trajtim jodiskriminues;

ç) të marrë të gjitha informacionet e nevojshme nga furnizuesit në përputhje me nenin 104 të këtij ligji;

d) të marrë informacion të plotë për çmimet, tarifat, termat dhe kushtet standarde në lidhje me aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të energjisë elektrike;

dh) të përdorë mekanizma të ndryshëm të pagesës dhe të mbrohet prej metodave të padrejta të faturimit;

e) të mos paguajë asnjë kosto shtesë lidhur me ndryshimin e furnizuesit;

ë) të përfitojë nga procedura transparente e të thjeshta për trajtimin e ankesave të tyre, të cilat, kur është e mundur, parashikojnë një sistem rimbursimi dhe/ose kompensimi.

f) të informohet për të drejtën e tij për sa i përket shërbimit universal të furnizimit në përputhje me nenin 106 të këtij ligji;

g) të informohet për konsumin e tij dhe kostot përkatëse të energjisë elektrike, në varësi të pajisjeve matëse me të cilat është i pajisur klienti. Ky shërbim ofrohet pa kosto shtesë për klientin;

gj) të marrë një informacion për konsumin dhe gjendjen financiare të mbylljes pas çdo ndryshimi të furnizuesit të energjisë elektrike, jo më vonë se 20 ditë nga ndryshimi i tij.

3. Klienti fundor ka detyrim:

a) të paguajë për energjinë elektrike në përputhje me kushtet e kontratës;

b) t'i mundësojë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes ose Operatorit të Sistemit të Transmetimit instalimin, mirëmbajtjen dhe leximin e pajisjeve për matjen e konsumit të energjisë elektrike;

c) të respektojë kushtet e kontratës së furnizimit.

4. Të gjithë klientët kanë të drejtë të kontraktojnë disa furnizues njëkohësisht, me kusht që të vendosen pikat e nevojshme të lidhjes dhe matjes.

Neni 118
Klientët në nevojë

1. Ministria përgjegjëse për çështjet sociale në bashkëpunim me ministrinë përgjegjese për energjinë, ministrinë përgjegjëse për financat, dhe në konsultim me ERE-n e me grupet e interesit harton kriteret, procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Kriteret për përfitimin e statusit të klientit në nevojë marrin në konsideratë:

a) klientët me të ardhura më të ulëta, të cilët e përdorin energjinë elektrike për furnizimin e vendbanimit tyre të përhershëm;

b) klientët që kanë konsum të energjisë elektrike të lidhur në rrjetin njëfazor me një fuqi maksimale prej 16 amper;

c) nivelin maksimal të konsumit të energjisë për person, në varësi të sezonit;

ç) moshën e klientit;

d) çdo kriter tjetër të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

3. Për qëllimin e përcaktimit të numrit të klientëve familjarë në varfëri energjetike, ministria përgjegjëse për çështjet sociale në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energjinë, ministrinë përgjegjëse për financat, si dhe në konsultim me ERE-n dhe palët e interesuara harton një tërësi kriteresh, që mund të përfshijnë të ardhurat e ulëta, shpenzimet e larta të të ardhurave të disponueshme për energji dhe eficiencë të dobët energjetike, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Klientët në nevojë që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit regjistrohen në një regjistër të veçantë nga struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për mirëqenien sociale. Ky informacion i dërgohet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesit të energjisë elektrike.

5. Klientët në nevojë që përfitojnë mbështetje financiare nga buxheti i shtetit duhet të përdorin fondet e përfituara për të paguar detyrimet e energjisë elektrike.

6. Financimi për mbështetje të klientëve në nevojë duhet të bëhet në mënyrë jodiskriminuese, duke mos lejuar ndërfinancimin nga kategoritë e tjera të klientëve të energjisë elektrike.

7. Financimi dhe mbështetja e klientëve në nevojë nuk do të pengojë hapjen efektive të tregut shqiptar apo funksionimin e tij.

8. Ministria do të njoftojë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për çdo masë të ndërmarrë për mbrojtjen e klientëve në nevojë.

9. Nëse për shkak të ndryshimit të rrethanave, klienti humb statusin e klientit në nevojë, struktura përkatëse pranë ministrisë përgjegjëse për mirëqenien sociale e heq nga regjistri i klientëve në nevojë dhe njofton Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesin. Të dhënat e klientit të hequr nga regjistri i klientëve në nevojë duhet të ruhen për një periudhë prej 5 vjetësh pas çregjistrimit.

10. Mbi bazën e të dhënave të përcjella, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesi krijojnë dhe ruajnë një regjistër të të dhënave të klientëve në nevojë. Të dhënat e regjistrit mund t'i vihen në dispozicion klientit në nevojë në çdo kohë që kërkohen nga ky i fundit

Neni 119
Furnizimi për klientët në nevojë

1. Klientët familjarë, të cilët kanë përfituar statusin e klientëve në nevojë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 118 të këtij ligji kanë të drejtën e përfitimit të shërbimit të furnizimit universal sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Kontrata e furnizimit të klientëve në nevojë fillon në ditën që klienti regjistrohet prej Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes si klient në nevojë. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes paraqet informacion për furnizuesit e shërbimit universal për klientët në nevojë brenda 5 ditëve nga regjistrimi i tyre.

3. Furnizuesi i klientit në nevojë i paraqet këtij të fundit kontratën dhe e informon rreth të drejtave dhe kushteve të furnizimit nën shërbimin universal.

4. Klienti në nevojë furnizohet me energji elektrike sipas tarifave të miratuara nga ERE-ja dhe në përputhje me nenin 108 të këtij ligji.

5. Furnizuesi që furnizon me energji elektrike klientin në nevojë mund ta ndërpresë shërbimin bazuar në kushtet specifike të ndërprerjes për këtë kategori klientësh, në përputhje me rregullat përkatëse të miratuara nga ERE-ja.

6. Kontrata e furnizimit të klientëve në nevojë përfundon në fund të muajit të dytë nga momenti i çregjistrimit të klientit si klient në nevojë prej Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dërgon informacion te furnizuesi për klientët e çregjistruar sipas njoftimit për daljen nga kategoria e klientit në nevojë në fund të çdo muaji.

PJESA E TETË
TREGU I ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 120
Tregu i energjisë elektrike

1. Tregu i energjisë elektrike përfshin:

a) tregun bilateral të energjisë elektrike;

b) tregun e balancimit të energjisë elektrike;

c) tregun e organizuar të energjisë elektrike;

ç) tregun për kapacitetin e transmetimit ndërmjet zonave të tregtimit;

d) tregun për shërbime ndihmëse.

Sipas kornizave kohore të tregtimit, tregu i energjisë elektrike mund të jetë:

i. tregu i ardhmërisë (*forward market*);

ii. tregu i ditës në avancë (*day-ahead market*);

iii. tregu brenda ditës (*intraday market*).

Operatori i Sistemit të Transmetimit menaxhon dhe administron tregjet e listuara në shkronjat "b", "ç" dhe "d" të kësaj pike.

Subjekti që kryen operimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike (në vijim: operatori i tregut) menaxhon dhe administron tregun e përcaktuar në shkronjën "c" të kësaj pike në përputhje me parimet e transparencës dhe mosdiskriminimit.

2. Ministri në bashkëpunim me palët e interesuara në sektorin e energjisë elektrike dhe pasi merr mendimin e Autoritetit të Konkurrencës harton modelin e tregut të energjisë elektrike, që miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohen:

a) mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike;

b) marrëdhëniet kontraktore të nevojshme;

c) informacioni dhe shkëmbimi i të dhënave kryesore, të kërkuara mes pjesëmarrësve të tregut.

3. Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike përfshijnë:

a) prodhuesin e energjisë elektrike;

b) furnizuesin;

c) tregtarin;

ç) konsumatorin fundor;

d) Operatorin e Sistemit të Transmetimit;

dh) Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes;

e) operatorin e sistemit të mbyllur të shpërndarjes;

ë) operatorin e tregut;

f) Operatorin e Nominuar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO);

g) operatorin e ruajtjes së energjisë elektrike;

gj) agregatorin.

Përveç pjesëmarrësve të listuar më sipër, edhe subjekte të tjera juridike mund të marrin pjesë në tregun e organizuar të energjisë elektrike në përputhje me rregullat e tij të funksionimit.

Pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike janë të detyruar të paraqesin të gjitha të dhënat e nevojshme te Operatori i Sistemit të Transmetimit ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me rregullat e nenit 19 të këtij ligji që lidhen me sektorin e energjisë elektrike.

4. Tregtarët dhe furnizuesit e energjisë elektrike, të regjistruar në palë të tjera të Komunitetit të Energjisë, kanë të drejtë të marrin pjesë në tregjet e energjisë elektrike mbi bazën e parimeve të reciprocitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 121
Operatori i tregut

1. Tregjet e organizuara me shumicë dhe derivativët e tregut të energjisë elektrike organizohen dhe menaxhohen nga operatori i tregut, i licencuar nga ERE-ja. Operatori i tregut është subjekti përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin e tregjeve të organizuara të energjisë elektrike nëpërmjet platformave të tregtimit në lidhje me tregjet e ditës në avancë dhe të së njëjtës ditë dhe për aktivitetet që lidhen me të, përfshirë aktivitetin e klerimit dhe shlyerjes ndërmjet pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike, në përputhje me rregullat e tregut, aktet rregullatore, rregulloret dhe modelin e tregut.

2. Forma ligjore dhe struktura e pronësisë së kapitalit të operatorit të tregut miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit dhe ministrisë përgjegjëse për pronësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit.

3. Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit miraton përzgjedhjen e aksionerëve të operatorit të tregut, si dhe kriteret e veçanta që këto subjekte do të plotësojnë.

4. Operatori i tregut, pa kufizim, mund të kontraktojë dhe t'u kalojë palëve të treta shërbimet për funksionimin e platformave elektronike për tregjet e ditës në avancë dhe të së njëjtës ditë dhe tregun e derivativëve të energjisë elektrike, si dhe aktivitetin e klerimit dhe shlyerjes. Çdo palë e tretë që merr shërbime të tilla do t'i bazojë këto shërbime tek operatori i tregut, duke përdorur një sistem tregtimi të ankandit të ditës në avancë dhe algoritmin përkatës korrespondues të bazuar në një konfigurim të pajtueshëm me tregun e bashkuar të ditës në avancë (SDAC), duke përdorur platformën e porosive korresponduese të ankandit të tregut të së njëjtës ditë ose sistemin e tregtimit të pajtueshëm me tregun e bashkuar të së njëjtës ditë (SIDC) dhe algoritmin përkatës korrespondues ose një sistem klerimi dhe shlyerjeje financiare, si dhe një mjet të teknologjisë së informacionit për menaxhimin e riskut për klerimin dhe shlyerjen. Kur një ose më shumë institucione në Republikën e Shqipërisë ose subjekte/shoqëri publike të krijuara sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë nuk zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të regjistruar të operatorit të tregut dhe/ose nuk kontrollojnë më shumë se gjysmën e të drejtave të votave të lidhura me aksionet e kapitalit të operatorit të tregut dhe/ose nuk emërojnë më shumë se gjysmën e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës ose bordit drejtues të operatorit të tregut, atëherë operatori i tregut nuk do të kualifikohet si një autoritet kontraktual sipas kuptimit të legjislacioni në fuqi për prokurimin publik.

Neni 122
Rregullat e tregut

1. ERE-ja me propozimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe në bashkëpunim me të

gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike miraton rregullat e tregut që rregullojnë tregjet e energjisë elektrike, në përputhje me këtë ligj dhe modelin e tregut të energjisë elektrike, ku përfshihen rregullat për planifikimin, dispeçerimin, balancimin, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe kërkesat për menaxhimin e rezervës.

2. ERE-ja me propozim të operatorit të tregut dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike miraton rregullat e tregut të energjisë elektrike që rregullojnë aktivitetet e tregut të ditës në avancë dhe atij të të njëjtës ditë.

3. Rregullat e tregut do të sigurojnë që tregjet e energjisë elektrike të funksionojnë në përputhje me parimet e mëposhtme:

a) çmimet formohen në bazë të kërkesës dhe ofertës;

b) rregullat e tregut nxisin formimin e lirë të çmimeve dhe shmangin veprimet që pengojnë formimin e tyre mbi bazën e kërkesës dhe ofertës;

c) rregullat e tregut lehtësojnë zhvillimin e gjenerimit më fleksibël, gjenerimit të qëndrueshëm me karbon të ulët dhe kërkesës më fleksibile;

ç) klientët përfitojnë nga mundësitë e tregut dhe rritja e konkurrencës në tregjet me pakicë dhe fuqizohen të veprojnë si pjesëmarrës në tregjet e energjisë dhe në tranzicionin energjetik;

d) pjesëmarrja në treg e klientëve fundorë dhe ndërmarrjeve të vogla mundësohet përmes agregimit për të ofruar oferta të përbashkëta në tregun e energjisë elektrike dhe për të operuar në mënyrë të përbashkët në sistemin elektroenergjetik në përputhje me ligjin e konkurrencës;

dh) rregullat e tregut mundësojnë dekarbonizimin e sistemit elektroenergjetik dhe të ekonomisë, përfshirë integrimin e energjisë nga burimet e rinovueshme dhe nxitjen e eficiencës energjetike;

e) rregullat e tregut ofrojnë stimuj të përshtatshëm investimi për prodhim, veçanërisht për investime afatgjata në një sistem elektroenergjetik të dekarbonizuar dhe të qëndrueshëm, në depozitimin e energjisë, eficiencën energjetike dhe përgjigjen ndaj kërkesës, duke mundësuar konkurrencë të drejtë që garanton sigurinë e furnizimit;

ë) barrierat për rrjedhat ndërkufitare të energjisë elektrike dhe për transaksionet ndërkufitare në tregjet e energjisë dhe shërbimeve përkatëse eliminohen gradualisht;

f) rregullat e tregut parashikojnë bashkëpunim rajonal kur ai është efektiv;

g) prodhim i sigurt dhe i qëndrueshëm, depozitim i energjisë dhe përgjigjja ndaj kërkesës marrin pjesë në treg mbi baza të barabarta;

gj) të gjithë prodhuesit janë drejtpërdrejt ose tërthorazi përgjegjës për shitjen e energjisë elektrike që prodhojnë;

h) rregullat e tregut lejojnë zhvillimin e projekteve demonstruese në burime, teknologji ose sisteme energjetike të qëndrueshme, të sigurta dhe me karbon të ulët, të cilat realizohen dhe përdoren në dobi të shoqërisë;

i) rregullat e tregut mundësojnë dispeçerimin efikas të aseteve të prodhimit, depozitimit të energjisë dhe përgjigjes ndaj kërkesës;

j) rregullat e tregut lejojnë hyrjen dhe daljen nga tregu të shoqërive të prodhimit, depozitimit të energjisë dhe furnizimit me energji elektrike, bazuar në vlerësimin e tyre për qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të veprimtarisë së tyre;

k) për t'u mundësuar pjesëmarrësve në treg mbrojtje nga rreziku i luhatjeve të çmimeve në bazë tregu dhe për të reduktuar pasigurinë mbi kthimet e ardhshme të investimeve, produktet afatgjata të mbrojtjes nga rreziku tregtohen në bursa në mënyrë transparente dhe kontratat afatgjata të furnizimit me energji mund të negociohen jashtë bursës (OTC), në përputhje me ligjin e konkurrencës;

l) rregullat e tregut lehtësojnë tregtimin e produkteve ndërmjet palëve të Komunitetit të Energjisë dhe ndryshimet rregullatore marrin parasysh efektet si në tregjet dhe produktet afatshkurtra, ashtu edhe në tregjet dhe produktet afatgjata;

ll) pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike kanë të drejtë të aksesojnë rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes mbi kushte objektive, transparente dhe jodiskriminuese

4. Rregullat e tregut do të sigurojnë gjithashtu që të mos ketë as kufi maksimal dhe as kufi minimal për çmimin e shitjes me shumicë të energjisë elektrike. Kjo dispozitë do të zbatohet, ndër të tjera, për ofertat dhe klerimin për të gjitha afatet kohore dhe do të përfshijë çmimet e energjisë balancuese dhe të disbalancave, pa cenuar kufijtë teknikë të çmimeve që mund të zbatohen në kuadrin kohor të balancimit dhe në afatet kohore të ditës në avancë dhe të së njëjtës ditë, në përputhje me pikën 5 të këtij neni.

5. NEMO-t mund të zbatojnë kufij të harmonizuar për çmimet maksimale dhe minimale të kleringut për tregtimin e ditës në avancë dhe brenda ditës. Këta kufij duhet të jenë mjaftueshëm të lartë për të mos kufizuar në mënyrë të panevojshme tregtimin, duhet të jenë të harmonizuar për tregun e brendshëm dhe duhet të marrin parasysh vlerën maksimale të humbjes së ngarkesës (*Value of Lost Load*). NEMO-t duhet të zbatojnë një mekanizëm transparent për rregullimin automatik të kufijve teknikë të ofertimit në kohën e duhur, në rast se pritet që kufijtë e vendosur të arrihen. Kufijtë e rritur të rregulluar do të mbeten në fuqi deri kur kërkohen rritje të mëtejshme sipas atij mekanizmi.

6. Operatori i Sistemit të Transmetimit nuk do të marrë asnjë masë për qëllime të ndryshimit të çmimeve të shitjes me shumicë.

7. ERE-ja do të identifikojë politikat dhe masat e aplikuara që mund të çojnë në kufizimin indirekt të formimit të çmimeve me shumicë. Kur ERE-ja identifikon një politikë ose masë që mund të ketë çuar në kufizimin e formimit të çmimit të shitjes me shumicë, ajo do të marrë të gjitha veprimet e duhura për të eliminuar ose, nëse nuk është e mundur, për të ulur ndikimin e kësaj politike ose mase në qëndrimin e ofertës. ERE-ja do t'i japë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë një raport deri më 31 dhjetor 2026.

Neni 123

Tregjet e ditës në avancë dhe të së njëjtës ditë

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) organizojnë dhe menaxhojnë së bashku tregjet e integruara të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe NEMO bashkëpunojnë me operatorë të tjerë të sistemit të transmetimit dhe NEMO-t e Bashkimit Evropian dhe palë kontraktuese të Komunitet të Energjisë për të maksimizuar efikasitetin dhe efektivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë.

2. Tregjet e ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë duhet:

a) të jenë të organizuara në mënyrë të tillë që të mos jenë diskriminuese;

b) të maksimizojnë aftësinë e të gjithë pjesëmarrësve në tregun e energjisë elektrike për të menaxhuar disbalancat;

c) të maksimizojnë mundësitë e të gjithë pjesëmarrësve në treg për të marrë pjesë në tregtinë ndërzonale sa më afër kohës reale të jetë e mundur në të gjitha zonat e ofertimit;

ç) të ofrojnë çmime që pasqyrojnë bazat e tregut, duke përfshirë vlerën në kohë reale të energjisë, mbi të cilat pjesëmarrësit e tregut janë në gjendje të mbështeten kur lidhin produkte mbrojtjeje afatgjatë nga rreziku;

d) të garantojnë sigurinë operacionale duke mundësuar njëkohësisht përdorimin maksimal të kapaciteteve të transmetimit;

dh) të jenë transparente duke mbrojtur njëkohësisht konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm tregtar dhe duke siguruar që tregtimi të zhvillohet në mënyrë anonime;

e) të mos bëjnë dallim midis tregtive të kryera brenda një zone ofertimi dhe atyre ndërmjet zonave të ofertimit;

ë) të jenë të organizuara në mënyrë të tillë që të sigurojnë që të gjithë pjesëmarrësit në tregun e energjisë elektrike të kenë mundësi të aksesojnë tregun individualisht ose nëpërmjet agregimit.

3. Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike bashkëpunon me ACER-in, u përmbahet vendimeve të tij individuale, do të marrë në konsideratë mendimet dhe rekomandimet e tij dhe do t'i ofrojë atij informacion sipas kërkesës.

4. Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike u lejon pjesëmarrësve të tregut të tregtojnë energji sa më afër kohës reale të jetë e mundur dhe të paktën deri në kohën e mbylljes së portës ndërzonale brenda ditës.

5. Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike duhet t'u ofrojë pjesëmarrësve të tregut mundësinë për të tregtuar energji në intervale kohore, të cilat janë të paktën po aq të shkurtra sa periudha e shlyerjes së disbalancave si për tregjet e ditës në avancë dhe për ato brenda së njëjtës ditë.

6. Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike duhet të ofrojë produkte për tregtim në tregjet e ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, të cilat janë mjaftueshëm të vogla në madhësi, me madhësi minimale ofertash prej 500 kW ose më pak, për të lejuar pjesëmarrjen efektive të përgjigjes ndaj kërkesës, depozitimit të energjisë dhe burimeve të

rinovueshme në shkallë të vogël, duke përfshirë pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë nga klientët.

7. Periudha e rregullimit të disbalancës do të jetë 15 minuta në të gjitha zonat e planifikimit. Periudha e rregullimit të disbalancës nuk duhet të tejkalojë 30 minuta kur është dhënë një përjashtim nga të gjitha autoritetet rregullatore brenda një zone sinkrone.

Neni 124
Tregjet në avancë me çmime të paracaktuara

1. Operatorët e sistemeve të transmetimit duhet të akordojnë të drejta afatgjata transmetimi ose të vendosin masa ekuivalente në vend për të lejuar pjesëmarrësit e tregut, përfshirë pronarët e impianteve prodhuese që përdorin burime të rinovueshme të energjisë, të mbrohen nga rreziqet e çmimeve ndërmjet zonave të ofertimit, përveç rasteve kur një vlerësim i tregut të avancuar në kufijtë e zonave të ofertimit, i kryer nga autoritetet rregullatore kompetente, tregon se ka mundësi të mjaftueshme mbrojtjeje në zonat përkatëse të ofertimit.

2. Të drejtat afatgjata të transmetimit alokohen në mënyrë transparente, të bazuara në treg dhe jodiskriminuese përmes një platforme të vetme alokimi.

3. Operatori i tregut duhet të zhvillojë instrumente financiare tregtimi afatgjata për mbrojtje nga rreziku (*hedging*), pa e kufizuar përdorimin e tyre vetëm në zonat e tregtimit vendas.

Neni 125
Përgjegjësia e balancimit të pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike

1. Çdo pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike është përgjegjës për balancimin e tij. Për këtë qëllim pjesëmarrësit në treg ose duhet të jenë palë përgjegjëse për balancimin ose duhet t'ia delegojnë përgjegjësinë e tyre në mënyrë kontraktuale një pale përgjegjëse për balancimin sipas zgjedhjes së tyre. Çdo palë përgjegjëse për balancimin duhet të jetë financiarisht përgjegjëse për disbalancat e saj dhe duhet të përpiqet të jetë e balancuar ose duhet të ndihmojë që sistemi i energjisë elektrike të jetë i balancuar.

2. Këshilli i Ministrave me propozim të ministrit mund të zgjedhë të bëjë përjashtime nga përgjegjësia e balancimit për:

a) projektet demonstruese për teknologjitë inovative, subjekt miratimi nga ERE-ja, me kusht që këto përjashtime të kufizohen në kohën dhe masën e nevojshme për arritjen e qëllimeve të demonstrimit;

b) impiantet e prodhimit që përdorin burime të rinovueshme të energjisë me një kapacitet të instaluar të energjisë elektrike më të vogël se 200 kW.

3. Kur Këshilli i Ministrave bën një përjashtim sipas pikës 2 të këtij neni, sigurohet që përgjegjësia financiare për disbalancat e shkaktuara të përmbushet nga një pjesëmarrës tjetër në tregun e energjisë elektrike.

4. Pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike mund të rregullojnë përgjegjësinë për balancimin nëpërmjet një kontrate me Operatorin e Sistemit të Transmetimit, duke marrë statusin e palës përgjegjëse për balancim ose duke nënshkruar një kontratë për transferimin e përgjegjësisë së balancimit ndaj një pale tjetër përgjegjëse për balancimin, duke u bërë pjesëtar i një grupi balancimi, në përputhje me rregullat e tregut të balancimit.

5. Operatori i Sistemit të Transmetimit është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella për disbalancat e shkaktuara nga pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike.

6. Mënyra e trajtimit të disbalancave, të shkaktuara nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike, dhe kostot përkatëse për mbulimin e tyre miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 126
Tregu i balancimit të energjisë elektrike

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit siguron shërbimet e balancimit të sistemit prej ofruesve të këtij shërbimi në tregun e balancimit në përputhje me rregullat e balancimit.

2. Tregjet balancuese duhet:

a) të sigurojnë efektivisht jodiskriminim ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, duke marrë parasysh nevojat e ndryshme teknike të sistemit të energjisë elektrike dhe aftësitë teknike të ndryshme të

burimeve gjeneruese, depozitimit të energjisë dhe përgjigje ndaj kërkesës;

b) të sigurojnë që shërbimet të përcaktohen në mënyrë transparente dhe teknologjikisht neutrale, si dhe të prokurohen në mënyrë transparente, të bazuara në treg;

c) të sigurojnë akses jodiskriminues për të gjithë pjesëmarrësit e tregut, individualisht ose përmes agregimit, duke përfshirë energjinë elektrike të prodhuar nga burime të ndryshueshme të rinovueshme të energjisë, përgjigje ndaj kërkesës dhe depozitimin e energjisë;

ç) të respektojnë nevojën për të akomoduar peshën në rritje të prodhimit të ndryshueshëm, rritjen e përgjigjes ndaj kërkesës dhe futjen e teknologjive të reja.

3. Çmimi i energjisë balancuese nuk duhet të përcaktohet paraprakisht në kontratat për kapacitetin e balancimit. Proceset e prokurimit duhet të jenë:

a) procedura transparente, jodiskriminuese dhe të bazuara në treg;

b) pjesëmarrja e të gjitha ndërmarrjeve të kualifikuara të energjisë elektrike dhe pjesëmarrësve të tregut, duke përfshirë pjesëmarrësit e tregut që ofrojnë energji nga burime të rinovueshme, pjesëmarrësit e tregut të angazhuar në reagimin e kërkesës, operatorët e objekteve të magazinimit të energjisë dhe pjesëmarrësit e tregut të angazhuar në agregim.

Për qëllimet e shkronjës "b" të pikës 2 të këtij neni, autoritetet rregullatore dhe operatorët e sistemeve të transmetimit në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë pjesëmarrësit e tregut duhet të përcaktojnë kërkesat teknike për pjesëmarrjen në ato tregje, bazuar në karakteristikat teknike të atyre tregjeve, duke mbrojtur konfidencialitetin e informacionit komercialisht të ndjeshëm.

4. Tregjet e balancimit duhet të sigurojnë sigurinë operacionale, duke lejuar përdorimin maksimal dhe alokimin efikas të kapacitetit ndërzonal në kuadër të periudhave kohore.

5. Shlyerja e energjisë balancuese për produktet standarde dhe specifike të balancimit duhet të bazohet në çmimin marginal (*pay-as-cleared*), përveç rasteve kur të gjitha autoritetet rregullatore miratojnë një metodë alternative të çmimit mbi bazën e një propozimi të përbashkët nga të gjithë operatorët e sistemeve të transmetimit, pas një analize që demonstron se metoda alternative është më efikase. Pjesëmarrësve të tregut duhet t'u lejohet të ofrojnë oferta sa më afër kohës reale të jetë e mundur dhe koha e mbylljes së portës për energjinë balancuese nuk duhet të jetë para kohës së mbylljes së portës ndërzonale brenda ditës.

6. Disbalancat duhet të shlyhen me një çmim që reflekton vlerën e energjisë në kohë reale.

7. Çdo zonë çmimi pa balancim duhet të jetë e barabartë me një zonë ofertimi.

8. Dimensionimi i kapacitetit rezervë duhet të kryhet nga operatorët e sistemeve të transmetimit dhe të lehtësohet në nivel rajonal.

9. Prokurimi i kapacitetit të balancimit duhet të kryhet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe mund të lehtësohet në nivel rajonal. Rezervimi i kapacitetit ndërkufitar për këtë qëllim mund të kufizohet. Prokurimi i kapacitetit të balancimit duhet të bazohet në treg dhe të organizohet në mënyrë të tillë që të jetë jodiskriminues ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në procesin e parakualifikimit, pavarësisht nëse pjesëmarrësit marrin pjesë individualisht ose përmes agregimit. Prokurimi i kapacitetit të balancimit duhet të bazohet në një treg primar, përveç dhe në masën që autoriteti rregullator ka parashikuar një përjashtim për të lejuar përdorimin e formave të tjera të prokurimit të bazuar në treg për shkak të mungesës së konkurrencës në tregun e shërbimeve të balancimit. Përjashtimet nga detyrimi për të bazuar prokurimin e kapacitetit të balancimit në përdorimin e tregjeve primare duhet të rishikohen çdo tre vjet.

10. Prokurimi i kapacitetit të balancimit në rritje dhe në ulje duhet të kryhet veçmas, përveç rasteve kur autoriteti rregullator miraton një përjashtim nga ky parim bazuar në shkakun e efikasitetit më të lartë ekonomik, siç demonstrohet nga një vlerësim i kryer nga Operatori i Sistemit të Transmetimit. Kontratat për kapacitetin e balancimit lidhen ditën para ofrimit të kapacitetit të balancimit dhe periudha e kontraktimit nuk duhet të jetë më e gjatë se një ditë, përveç dhe në masën që autoriteti rregullator ka miratuar kontraktimin më të hershëm ose periudha më të gjata të kontraktimit për të garantuar sigurinë e furnizimit ose për të përmirësuar efikasitetin ekonomik.

Kur jepet një përjashtim për të paktën 40% të produkteve standarde të balancimit dhe minimumi 30% të të gjitha produkteve të përdorura për kapacitetin e balancimit, kontratat për kapacitetin e balancimit duhet të lidhen jo më shumë se një ditë

para ofrimit të kapacitetit të balancimit dhe periudha e kontraktimit nuk duhet të jetë më e gjatë se një ditë. Kontraktimi i pjesës së mbetur të kapacitetit të balancimit duhet të kryhet maksimumi një muaj përpara ofrimit të kapacitetit të balancimit dhe duhet të ketë një periudhë kontraktimi maksimale prej një muaj.

11. Me kërkesë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, ERE-ja mund të vendosë të zgjasë periudhën kontraktuale të pjesës së mbetur të kapacitetit të balancimit, të përmendur në pikën 9 të këtij neni, deri në një periudhë maksimale prej dymbëdhjetë muajsh, me kusht që një vendim i tillë të jetë i kufizuar në kohë dhe efektet pozitive në drejtim të uljes së kostove për konsumatorët finalë të tejkalojnë ndikimet negative në treg. Kërkesa duhet të përfshijë:

a) periudhën specifike gjatë së cilës do të zbatohej përjashtimi;

b) volumin specifik të kapacitetit të balancimit për të cilin do të zbatohej përjashtimi;

c) një analizë të ndikimit të përjashtimit mbi pjesëmarrjen e burimeve të balancimit; dhe

ç) një justifikim për përjashtimin që demonstron se një përjashtim i tillë do të çonte në ulje të kostove për konsumatorët finalë.

12. Pavarësisht nga pika 11 e këtij neni, nga 1 janari 2027 periudhat kontraktuale nuk duhet të jenë më të gjata se gjashtë muaj.

13. Operatorët e sistemeve të transmetimit ose operatorët e deleguar të tyre duhet të publikojnë, sa më afër kohës reale të jetë e mundur, por me një vonesë pas dorëzimit jo më shumë se 30 minuta, ekuilibrin aktual të sistemit në zonat e planifikimit, çmimet e vlerësuara të mosbalancimeve dhe çmimet e vlerësuara të energjisë balancuese.

14. Operatorët e sistemeve të transmetimit, kur produktet standarde të balancimit nuk janë të mjaftueshme për të garantuar sigurinë operacionale ose kur disa burime balancimi nuk mund të marrin pjesë në tregun e balancimit përmes produkteve standarde, mund të propozojnë, dhe autoritetet rregullatore mund të miratojnë përjashtime nga pikat 2 dhe 4 të këtij neni, për produkte specifike të balancimit që aktivizohen lokalisht pa i shkëmbyer me operatorë të tjerë të sistemeve të transmetimit.

Propozimet për përjashtime duhet të përfshijnë një përshkrim të masave të propozuara për të minimizuar përdorimin e produkteve specifike, subjekt të efikasitetit ekonomik, një demonstrim që produktet specifike jane efikase dhe nuk krijojnë shtrembërime në tregun e balancimit brenda ose jashtë zonës së planifikimit, si dhe, kur është e aplikueshme, rregullat dhe informacionin për procesin e konvertimit të ofertave të energjisë balancuese nga produktet specifike në oferta të energjisë balancuese nga produktet standarde.

15. Rregullat e balancimit përcaktojnë kushte lidhur me:

a) ofruesit e shërbimit të balancimit, sigurimin e shërbimeve të balancimit, përcaktimin e sasive të energjisë për t'u përdorur prej ofruesve të shërbimit të balancimit dhe shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj ofruesve të shërbimit të balancimit;

b) pjesëtarët përgjegjës të grupit të balancimit, përfshirë krijimin dhe menaxhimin e llogarive të grupit të balancimit, përcaktimin e sasive të energjisë që do të përdoren për disbalancat dhe përgjegjësitë financiare të palëve përgjegjëse të grupit të balancimit.

16. Rregullat e balancimit përfshijnë termat, kushtet dhe metodologjitë e parashikuara në rregulloren (BE) 2017/2195, që nxjerr udhëzimet për balancimin e energjisë elektrike dhe çdo rregull tjetër të nevojshëm për funksionimin e tregut të balancimit, të miratuar nga ERE-ja.

17. Operatori i Sistemit të Transmetimit bashkëpunon me operatorët e tjerë të rrjeteve të transmetimit të vendeve fqinje për sigurimin e tregut balancues në nivel rajonal, me qëllim garantimin e sigurisë operacionale dhe funksionimin e efektshëm të tregut të balancimit bazuar në parimin e konkurrencës efektive, mosdiskriminimit dhe transparencës.

18. Brenda datës 1 janar 2028 ERE-ja do t'i raportojë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë mbi pjesën e kapacitetit total të mbuluar nga kontratat me kohëzgjatje ose periudhë prokurimi më të gjatë se një ditë.

PJESA E NËNTË
TË DREJTAT E PRONËSISË

Neni 127
Të drejtat e pronësisë së të licencuarve

1. Për sigurinë e shërbimit të energjisë elektrike, i licencuari mund të kërkojë njohjen dhe ushtrimin e

një ose të disa prej të drejtave të mëposhtme mbi pronën:

a) të drejtën për linjat;

b) të drejtën e përdorimit;

c) të drejtën e servitutit;

ç) shpronësimin.

2. Kur ushtrohen të drejtat sipas pikës 1 të këtij neni, dëmet e shkaktuara nga:

a) vendosja e shenjave, matjeve apo testeve;

b) instalimi i pajisjeve, aksesi apo kryerja e punës në to;

c) pengimi ose kufizimi i përdorimit të pronës, i rimbursohen pronarit ose përdoruesit të pronës nga i licencuari, në përputhje me Kodin Civil dhe legjislacionin për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik.

3. Në zonat e mbrojtura, për të drejtat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, të respektohet legjislacioni në fuqi për zonat e mbrojtura. Në zonat që janë në administrim të njësive të qeverisjes vendore merret miratimi i njësive të vetëqeverisjes vendore dhe të respektohet legjislacioni sektorial në varësi të kategorisë së tokës.

4. Në rast të përfundimit të të drejtave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, i licencuari merr masa për rehabilitimin e plotë të pronës së përdorur.

5. Kur klienti fundor ndodhet në një ndërtesë me shumë njësi banimi ose strukturë me disa biznese, i licencuari ka të drejtë të ushtrojë të gjitha të drejtat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, të cilat janë të nevojshme për sigurinë e furnizimit të këtij klienti.

Neni 128

Servituti ligjor

1. Bazuar në dispozitat e neneve 58 dhe 79 të këtij ligji, e drejta e servitutit ligjor i garantohet OST-së ose OSSH-së për instalimin dhe funksionimin e rrjetit të shpërndarjes ose transmetimit mbi pronën e të tretëve, duke garantuar përdorimin e pronës në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

2. Në përputhje me servitutin ligjor, i licencuari për veprimtaritë e transmetimit ose shpërndarjes mund të kryejë në pronën e të tretit veprimet e mëposhtme:

a) instalon dhe vendos nën tokë dhe/ose mbi tokë linja elektrike dhe linjat e komunikimit elektronik;

b) instalon struktura mbajtëse, pajisjet e transformimit dhe ato kyçëse/shkyçëse të vendosura mbi to;

c) instalon dhe shfrytëzon në pronën e të tretit linja të varura (teleferik dhe linja) të përdorura për qëllimet e ndërtimit dhe shfrytëzimit të centralit elektrik, nënstacioneve, linjave të transmetimit dhe të strukturave të saj mbështetëse;

ç) shfrytëzon, mban, riparon, transformon dhe heq pajisjet e instaluara, të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike;

d) heq pemët, shkurret, degët e tyre dhe rrënjët e ndodhura brenda zonës së sigurisë së linjave, të cilat cenojnë sigurinë e funksionimit të tyre;

dh) mund të lidhet dhe të kapërcejë rrugët e transportit, lumenjtë, rrjedhat e ujërave, liqenet, kanalet dhe ndërtesat, sipas procedurave të parashikuara në rregulloret teknike dhe legjislacionin në fuqi.

3. Çdo e drejtë servituti, e vendosur sipas këtij neni, jepet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

4. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë të përjashtuar nga aplikimi i çdo takse apo tarife të vendosur prej organeve të qeverisjes vendore mbi asetet, rrjetet dhe instalimet përkatëse që u përkasin këtyre operatorëve.

Neni 129

Detyrimet e operatorëve ndaj rrjeteve të tyre

1. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes administrojnë rrjetet dhe marrin masa që gjatë ndërtimit dhe operimit të tyre të respektojnë të gjitha kërkesat dhe kushtet teknike e të sigurisë, duke përfshirë edhe respektimin e distancave të sigurisë së rrjeteve në raport me objektet e tjera që u përkasin palëve të treta.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nuk kanë asnjë detyrim ndaj pretendimeve të personave fizikë ose juridikë për dëme të shkaktuara, si rezultat i distancës së rrjeteve të transmetimit apo shpërndarjes në raport me çdo objekt apo strukturë, në pronësi apo posedim të tyre, në rast se objekti ose struktura apo pjesë të tij/të saj janë ndërtuar apo vendosur në këto distanca pas ndërtimit të rrjetit të shpërndarjes apo transmetimit.

Neni 130
E drejta e përdorimit të përkohshëm

1. Pjesë të centraleve prodhuese dhe pajisje të sistemeve të transmetimit, shpërndarjes dhe ato ndihmëse mund të vendosen, të funksionojnë dhe të mirëmbahen në pronën e të tretëve në bazë të së drejtës së përdorimit të përkohshëm.

2. E drejta e përdorimit të përkohshëm rregullohet sipas legjislacionit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik.

Neni 131
Shpronësimi

1. Për vendosjen e centraleve, të nënstacioneve, të kabinave elektrike ose të linjave të transmetimit të energjisë elektrike, i licencuari mund të kërkojë nisjen e procedurës së shpronësimit të pronës së një personi të tretë në përputhje me legjislacionin për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik.

2. Nisja e procedurës së shpronësimit, me qëllim instalimin dhe funksionimin e rrjeteve të transmetimit e të shpërndarjes dhe të strukturave të tyre mbështetëse, mund të kërkohet vetëm nëse e drejta e servitutit, sipas nenit 128 të këtij ligji, pengon ose ndërpret në mënyrë thelbësore përdorimin e rregullt të pronës.

3. Procedura e shpronësimit për instalimin dhe funksionimin e pajisjeve të transformimit dhe të pajisjeve kyçëse/shkyçëse që nuk janë të vendosura në struktura mbështetëse, që i përkasin centralit të prodhimit të energjisë elektrike, mund të fillojë vetëm nëse palët nuk bien dakord për të drejtën e përdorimit, sipas neneve 127 dhe 128 të këtij ligji, ose nëse autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe rregullimit të territorit nuk e kanë miratuar atë.

PJESA E DHJETË
DISPOZITA TË TJERA

Neni 132
Hetimet administrative

1. ERE-ja në përmbushje të detyrimeve të saj, sipas nenit 19 dhe nenit 20, shkronja "i", të këtij ligji, në bazë të fakteve të siguruara për shkeljen e dispozitave të këtij ligji, mund të vendosë fillimin e hetimit administrativ për këto shkelje të evidentuara.

2. Hetimet administrative bëhen në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative dhe me procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave të miratuara nga ERE-ja.

Neni 133
Kundërvajtjet administrative

1. Shkeljet e mëposhtme të kryera prej të licencuarve, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen nga ERE-ja me gjobë nga 500 000 lekë deri në 3 për qind të të ardhurave të të licencuarit të vitit financiar në të cilin është kryer shkelja:

a) moszbatimi i vendimeve të ERE-s;

b) refuzimi i paraqitjes së të dhënave dhe raporteve periodike apo dërgimi me vonesë i tyre ose dërgimi i të dhënave të pasakta nga i licencuari;

c) moszbatimi i detyrimeve lidhur me llogaritjen dhe aplikimin e kostove dhe tarifave;

ç) moszbatimi i detyrimeve të shërbimit publik, të vendosura sipas nenit 52 të këtij ligji;

d) moszbatimi i detyrimeve për ndarjen e veprimtarive të licencuara;

dh) moszbatimi i detyrimeve për mbajtjen e llogarive të ndara sipas neneve 38, 59 dhe 87 të këtij ligji;

e) moszbatimi i detyrimeve që lidhen me aksesin e palëve të treta në rrjet, siç përcaktohet në dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

ë) moszbatimi i detyrimeve të përcaktuara në kontratat e rregulluara;

f) mospublikimi i informacionit për tarifat dhe kushtet e përgjithshme të aksesit në rrjet, si dhe përdorimit të shërbimeve të rrjetit;

g) mosparaqitja e programeve të investimeve dhe/ose moskryerja e investimeve të planifikuara, sipas kërkesave të neneve 20, shkronja "g", 67 dhe 90 të këtij ligji, dhe rregullores përkatëse të ERE-s;

gj) shkelja e kushteve dhe kërkesave të cilësisë së furnizimit të miratuar nga ERE-ja;

h) moszbatimi i vendimeve të ERE-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;

i) shkelja e detyrimeve dhe kushteve të licencës, si dhe rregullave të ERE-s që nuk janë përmendur në shkronjat e mësipërme;

j) refuzimi i pjesëmarrësve të tregut për të nënshkruar kontrata të rregulluara brenda 15 ditëve kalendarike;

k) moskryerja e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar. Në këtë rast, ERE-ja, përveç gjobës, ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, për çdo ditë vonesë në pagesën e saj. Vlera e kamatëvonesës përcaktohet në bazë të ligjit nr.48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", i ndryshuar.

2. Kufiri i sipërm i gjobave të përmendura në pikën 1 të këtij neni do të jetë 10% e xhiros vjetore të Operatorit të Sistemit të Transmetimit ose deri në 10% të xhiros vjetore të ndërmarrjes së integruar vertikalisht në ndërmarrjen e integruar vertikalisht, sipas rastit, për mospërmbushje të detyrimeve përkatëse në zbatim të këtij ligji.

3. ERE-ja aplikon gjobë progresive për çdo ditë shkeljeje nga i licencuari për rastet e mëposhtme:

a) kur i licencuari nuk përmbush vendimin e ERE-s për korrigjimin e një shkeljeje brenda afateve të përcaktuara prej saj. Në këtë rast i licencuari dënohet me gjobë në masën 0,1% të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës për çdo ditë vonesë nga dita e afatit të përcaktuar në vendimin përkatës të ERE-s;

b) kur i licencuari nuk përmbush detyrimin e pagesës së taksës rregullatore ndaj ERE-s, dënohet me gjobë në masën 0,2% të xhiros mesatare ditore të vitit financiar paraardhës për çdo ditë vonesë nga dita e përcaktuar për pagesën.

4. Masat e gjobave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, mund të reduktohen nga ERE-ja në masën dhe rastet si më poshtë:

a) në masën 50% në rastet kur shkelja për të cilën parashikohet gjoba është njoftuar nga vetë i licencuari;

b) në masën 1/3 në rastet kur i licencuari bashkëpunon në mënyrë aktive në procesin e hetimit administrativ të ERE-s për konstatimin e shkeljes në fjalë;

c) në masën 40% në rastet kur i licencuari provon se ka ndërmarrë veprime konkrete për përmirësimin apo zhdukjen e pasojave që ka shkaktuar shkelja përpara ose gjatë konstatimit të shkeljes nga ERE-ja.

5. ERE-ja harton dhe miraton një rregullore të posaçme lidhur me kushtet dhe procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave.

6. Vendimi i ERE-s për konstatimin dhe vendosjen e gjobës ndaj të licencuarve është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.

7. Vendimet e ERE-s ankimohen sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

8. Gjobat e vendosura sipas këtij neni derdhen në buxhetin e shtetit.

Neni 134
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore sipas nenit 4, pikat 9 e 12; nenit 6, pika 2; nenit 8 pika 2; nenit 34, pika 2; nenit 36, pika 4; nenit 37, pika 1; nenit 39; nenit 45, pika 5; nenit 49 pika 2; nenit 50, pika 2; nenit 51, pika 2; nenit 52, pika 2; nenit 53, pika 10; neni 56, pika 2; nenit 58, pika 2; nenit 86, pikat 1 dhe 3; nenit 87, pika 3, shkronja "ç"; nenit 96, pika 2; nenit 110, pika 1; nenit 113, pika 1; nenit 118, pikat 1 dhe 3; nenit 120, pika 2; nenit 121, pikat 2 dhe 3; nenit 125, pikat 2 dhe 6, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore sipas nenit 4, pika 2; nenit 5, pika 2; nenit 6, pikat 5, 8 dhe 12; nenit 28, pika 1; nenit 53, pika 14; nenit 55, pika 6; nenit 83 pika 1; nenit 86, pika 2; nenit 94, pika 3; nenit 102, pika 7, të këtij ligji.

3. Ngarkohen ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për energjinë të miratojnë aktin nënligjor të përcaktuar në pikën 8 të nenit 93 të këtij ligji.

4. Ngarkohet ERE-ja që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore sipas nenit 7, pika 1; nenit 8, pika 1, shkronja "a"; nenit 9, pika 2; nenit 19; nenit 20, shkronja "b"; nenit 30, pika 3; nenit 40, pika 10; nenit 41, pika 1; nenit 42, pika 1; nenit 47, pika 1; nenit 51, pika 4; nenit 63, pika 4; nenit 65, pika 2; nenit 67, pika 9; nenit 76, pika 1; nenit 78, pika 4; nenit 79, pika 8; nenit 83, pika 4; nenit 90, pika 12; nenit 94, pika 1; nenit 99, pika 1; nenit 108, pika 1; nenit 109, pika 2, dhe nenit 122, pikat 1 dhe 2, të këtij ligji.

Neni 135
Dispozita kalimtare

1. Licenca e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, e lëshuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të jetë e vlefshme për të kryer aktivitetet e licencuara deri në certifikimin e saj sipas procedurës së përcaktuar në këtë ligj dhe lëshimin e një licence të re.

2. Kryetari dhe anëtarët e bordit që kryenin detyrat e tyre në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë t'i ushtrojnë ato deri në fund të mandatit të tyre.

3. Deri në vendosjen e detyrimit të shërbimit publik për të licencuarin, sipas përkufizimeve të nenit 49 të këtij ligji, përmbushja e këtyre funksioneve do të vazhdojë të kryhet nga i licencuari që i ushtron këto funksione kur ky ligj të hyjë në fuqi.

4. Të drejtat dhe detyrimet ekzistuese të pjesëmarrësve në treg do të vazhdojnë të përmbushen prej tyre deri në hyrjen në fuqi të akteve nënligjore, sipas dispozitave të këtij ligji.

5. Të gjithë përdoruesit e sistemit të lidhur me rrjetin e transmetimit janë të detyruar të sigurojnë përputhshmërinë me kërkesat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij deri më 31 dhjetor 2027. Në rast se ndonjë përdorues i sistemit nuk u përmbahet kërkesave dhe nuk i përmbush ato brenda këtij afati, Operatori i Sistemit të Transmetimit do të ketë të drejtë të shkëpusë nga rrjeti i transmetimit përdoruesin e sistemit që nuk u përmbahet kërkesave brenda afatit.

6. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 108 të këtij ligji, dhe me qëllim një periudhë tranzitore që nuk tejkalon datën 31 dhjetor 2027, çmimet e rregulluara të përcaktuara nga ERE-ja zbatohen edhe për klientët familjarë dhe ndërmarrjet mikro, të cilat tashmë furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal.

7. Pavarësisht nga dispozitat e nenit 108 të këtij ligji, dhe me qëllim një periudhë tranzitore që nuk tejkalon datën 31 dhjetor 2027, çmimet e rregulluara të përcaktuara nga ERE-ja zbatohen edhe për ndërmarrjet e vogla, të cilat tashmë furnizohen nga furnizuesi i shërbimit universal.

8. Neni 80, pika 1, shkronja "f", e këtij ligji zbatohet vetëm pasi Operatori i Energjisë së Rinovueshme të jetë funksional dhe pasi të jetë kryer një vlerësim pozitiv i gatishmërisë së tregut nga ERE-ja në përputhje me ligjin për promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, por jo më vonë se data 31 dhjetor 2027. Deri në atë kohë, procedura për sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në kuadër të detyrimeve të shërbimit publik.

9. Pavarësisht përcaktimeve të nenit 49 të këtij ligji, procedura për vendosjen e një detyrimi shërbimi publik ndaj një të licencuari për ofrimin e furnizimit të shërbimit universal përmes një procedure konkurruese, transparente dhe jodiskriminuese fillon jo më vonë se 12 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Deri në fillimin e kësaj procedure, rregullimet ekzistuese të detyrimeve të shërbimit publik për furnizimin e shërbimit universal mund të vazhdojnë të zbatohen.

Neni 136
Shfuqizimi i akteve

1. Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Neni 137
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.6.2026.

Shpallur me dekretin nr. 376, datë 30.6.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 376, datë 30.6.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 59/2026, "Për sektorin e energjisë elektrike".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 60/2026

PËR INFORMACIONIN ELEKTRONIK TË TRANSPORTIT TË MALLRAVE[2]

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Ky ligj ka për qëllim promovimin e digjitalizimit në fushën e transportit të mallrave dhe reduktimin e kostove administrative për transportin e mallrave nëpërmjet pranimit të informacionit rregullator shoqërues gjatë transportit të mallrave në formë elektronike.

2. Ky ligj krijon kuadrin ligjor për komunikimin elektronik të informacionit rregullator ndërmjet operatorëve ekonomikë përkatës dhe autoriteteve kompetente, lidhur me transportin e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Objekti

1. Ky ligj vendos kushtet mbi bazën e të cilave autoritetet kompetente janë të detyruara të pranojnë informacionin rregullator kur informacioni vihet në dispozicion në mënyrë elektronike nga operatorët ekonomikë përkatës, si dhe rregullat për ofrimin e shërbimeve që lidhen me vënien në dispozicion në mënyrë elektronike të informacionit rregullator nga operatorët ekonomikë përkatës për autoritetet kompetente.

2. Ky ligj përcakton kërkesat që platformat dhe shërbimet eFTI duhet të sigurojnë ndërveprueshmërinë me infrastrukturën kombëtare të sistemeve të teknologjisë së informacionit e të komunikimit në përputhje me standardet kombëtare në fuqi.

Neni 3
Fusha e veprimit

1. Ky ligj zbatohet për informacionin rregullator që kërkohet sipas legjislacionit në fuqi për transportin e të gjitha mallrave, përfshirë rastet e tranzitit, kur ky informacion vihet në dispozicion në formë elektronike.

2. Fusha e veprimit përfshin vënien në dispozicion dhe përdorimin e informacionit rregullator ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kompetente.

3. Fusha e veprimit shtrihet për informacionin rregullator që lidhet me transportin e mallrave në të gjitha mënyrat e transportit, përfshirë transportin rrugor, hekurudhor e ajror, si dhe rastet e transportit të mallrave të rrezikshme dhe të mbetjeve, siç jepet në shtojcën I të këtij ligji.

4. Ky ligj kufizohet në rregullimin e mënyrës së vënies në dispozicion të informacionit rregullator në formë elektronike dhe nuk ndikon në detyrimet e përcaktuara në legjislacionin sektorial në fuqi për informacionin rregullator që shoqëron transportin e mallrave.

5. Zbatimi i këtij ligji realizohet duke garantuar integrimin me sistemet shtetërore ekzistuese dhe

[2] Ky ligj është përafruar plotësisht me Rregulloren (BE) 2020/1056, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 15 korrik 2020, "Për informacionin elektronik të transportit të mallrave", e ndryshuar. Numri CELEX 32020R1056, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 249, datë 31.7.2020, faqe 33–48.

shmangien e dublimit të të dhënave në përputhje me parimet e ndërveprueshmërisë.

6. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, autoriteti kombëtar koordinues, në bashkëpunim me autoritetet kompetente sipas fushës së përgjegjësisë, njofton Komisionin Evropian për dispozitat e legjislacionit kombëtar, të cilat u korrespondojnë kërkesave të informacionit rregullator, që kërkojnë paraqitjen e informacionit identik, tërësisht ose pjesërisht, me informacionin e kërkuar sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën I të këtij ligji.

7. Pas njoftimit sipas pikës 6 të këtij neni, autoriteti përgjegjës për koordinimin e zbatimit të këtij ligji, në bashkëpunim me autoritetet kompetente sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, siguron që çdo ndryshim në dispozitat e legjislacionit kombëtar t'i njoftohet Komisionit Evropian në rastet kur:

a) sjell ndryshime në kërkesat e informacionit rregullator të përcaktuara në dispozitat e legjislacionit kombëtar; ose

b) përcakton kërkesa të reja për informacion rregullator, që kërkojnë dhënien e informacionit identik, tërësisht ose pjesërisht, me kërkesat e informacionit rregullator të kërkuar.

Ky njoftim do të bëhet brenda 1 muaji nga miratimi i këtij ligji.

Neni 4
Përkufizimet

Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Autoritet kompetent" është një autoritet publik, agjenci ose organ tjetër që, në përputhje me legjislacionin në fuqi kërkon, përpunon, verifikon, zbaton, validon ose monitoron përputhshmërinë e informacionit rregullator, lidhur me transportin e mallrave, përfshirë, por pa u kufizuar në:

a) autoritetet përgjegjëse për transportin rrugor, hekurudhor dhe ajror;

b) autoritetet doganore;

c) autoritetet tatimore;

ç) autoritetet përgjegjëse për kontrollin rrugor dhe zbatimin në terren;

d) autoritetet përgjegjëse për sigurinë ushqimore, kontrollin veterinar dhe fitosanitar;

dh) autoritetet përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit, përfshirë transportin e mbetjeve;

e) autoritetet përgjegjëse për transportin dhe kontrollin e mallrave të rrezikshme;

ë) autoritetet përgjegjëse për sigurinë publike dhe zbatimin e ligjit;

f) autoritetet përgjegjëse për shëndetin publik dhe kontrollin sanitar;

g) çdo autoritet tjetër publik që ka kompetencë përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

2. "Informacion rregullator" është informacioni, pavarësisht nëse paraqitet në formë dokumenti apo jo, që lidhet me transportin e mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë mallrat në tranzit, i cili vihet në dispozicion nga një operator ekonomik përkatës, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi, me qëllim demonstrimin e pajtueshmërisë me detyrimet rregullatore të zbatueshme në fushën e transportit të mallrave.

3. "Kërkesa për informacion rregullator" është një kërkesë për të ofruar informacion rregullator.

4. "Informacion elektronik i transportit të mallrave" ose "eFTI" është një grup elementesh të të dhënave që përpunohen në mënyrë elektronike, me qëllim shkëmbimin e informacionit rregullator ndërmjet operatorëve ekonomikë përkatës, si dhe ndërmjet operatorëve ekonomikë përkatës dhe autoriteteve kompetente.

5. "Nënbashkësi të dhënash eFTI" është një grup elementesh të strukturuara të të dhënave, që korrespondojnë me informacionin rregullator të kërkuar në përputhje me një akt të caktuar ligjor të legjislacionit kombëtar, të përmendur në pikën 3, të nenit 3 të këtij kreu.

6. "Grup i përbashkët i të dhënave eFTI" është një grup gjithëpërfshirës i elementeve të të dhënave të strukturuara, që korrespondojnë me të gjitha nënbashkësitë e të dhënave eFTI, ku elementet e të dhënave, që janë të përbashkëta për nënbashkësi të ndryshme të të dhënave eFTI, përfshihen vetëm një herë.

7. "Element i të dhënave" është njësia më e vogël e informacionit, që ka një përkufizim unik dhe karakteristika të sakta teknike, si: formati, gjatësia dhe lloji i karakterit.

8. "Përpunim" është një operacion ose grup operacionesh të kryera në platformën "eFTI", me ose pa mjete të automatizuara, të tilla si: grumbullimi, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, marrja, konsultimi, përdorimi, shpërndarja me anë të transmetimit ose,

ndryshe, vënia në dispozicion e eFTI-t, përafrimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi;

9. "Log i operacionit" është një regjistrim i automatizuar i përpunimit elektronik të eFTI-t;

10. "Platformë eFTI" është një zgjidhje e bazuar në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit (TIK), e tillë si një sistem operativ, një mjedis operativ ose një bazë të dhënash, që synohet të përdoret për përpunimin e eFTI-t;

11. "Zhvillues i platformës eFTI" është një person fizik ose juridik, i cili ka zhvilluar ose blerë një platformë eFTI qoftë për qëllime të përpunimit të informacionit rregullator në lidhje me aktivitetin e tij ekonomik, qoftë për ta vendosur këtë platformë në treg;

12. "Shërbim eFTI" është një shërbim që konsiston në përpunimin e eFTI-t përmes një platforme eFTI, në mënyrë të pavarur ose në kombinim me zgjidhje të tjera të TIK-ut, duke përfshirë platforma të tjera eFTI;

13. "Ofrues i shërbimit eFTI" është një person fizik ose juridik, i cili ofron një shërbim eFTI për operatorët ekonomikë, objekt të këtij ligji, në bazë të një kontrate;

14. "Operator ekonomik përkatës" është çdo operator transporti ose logjistik, si dhe çdo person fizik ose juridik tjetër, përgjegjës për vënien në dispozicion të informacionit rregullator për autoritetet kompetente, në përputhje me kërkesat përkatëse të informacionit rregullator;

15. "Format i lexueshëm nga njerëzit" është një mënyrë për të paraqitur të dhënat në formë elektronike, që mund të përdoret si informacion nga një person fizik pa kërkuar ndonjë përpunim të mëtejshëm;

16. "Format i lexueshëm nga një pajisje" është mënyra për t'i paraqitur të dhënat në formë elektronike, që mund të përdoret për përpunim automatik nga një pajisje;

17. "Organ i vlerësimit të konformitetit" është një organ i akredituar sipas legjislacionit në fuqi për akreditimin, i cili kryen vlerësimin e konformitetit të platformave eFTI ose të ofruesve të shërbimeve eFTI, në zbatim të neneve 12 e 13 të këtij ligji;

18. "Ngarkesë" është transporti i një grupi të caktuar mallrash, duke përfshirë mbetjet, ndërmjet vendit të parë të marrjes dhe vendit përfundimtar të dorëzimit, sipas kushteve të një kontrate të vetme transporti ose të kontratave të shumta të njëpasnjëshme të transportit, duke përfshirë, kur është e zbatueshme, transferimin ndërmjet mënyrave të ndryshme të transportit, pavarësisht nga sasia ose numri i kontejnerëve, paketave apo pjesëve të transportuara;

19. "Strukturat e të dhënave eFTI", përfshirë grupin e përbashkët të të dhënave dhe nënbashkësitë përkatëse, duhet të jenë në përputhje me standardet kombëtare të ndërveprueshmërisë dhe katalogët shtetërorë të të dhënave.

KREU II
INFORMACIONI RREGULLATOR I VËNË NË DISPOZICION ELEKTRONIKISHT

Neni 5
Kërkesat për operatorët ekonomikë përkatës

1. Çdo operator ekonomik përkatës, që vepron në fushën e transportit të mallrave, me hyrjen në fuqi të këtij ligji dhe sipas afatit të përcaktuar në pikën 1, të nenit 6 të këtij ligji, ka të drejtë mbi bazë vullnetare ta paraqesë informacionin rregullator të kërkuar sipas legjislacionit në fuqi për transportin e mallrave në format elektronik. Kjo nuk e pengon operatorin ekonomik ta paraqesë informacionin rregullator në formë shkresore.

2. Për qëllimet e pikave 1, 2 dhe 3, të nenit 6 të këtij kreu, operatorët ekonomikë përkatës, kur vënë në dispozicion informacion rregullator në formë elektronike për autoritetet kompetente, e bëjnë këtë mbi bazën e të dhënave të përpunuara, në një platformë eFTI të certifikuar dhe, kur është e zbatueshme, përmes një ofruesi shërbimi eFTI të certifikuar në përputhje me kërkesat e këtij ligji. Informacioni rregullator duhet të jetë i disponueshëm nga operatorët ekonomikë përkatës në një format të përpunueshëm elektronikisht dhe, me kërkesë të autoritetit kompetent, edhe në një format të lexueshëm për përdoruesin.

3. Informacioni rregullator në format të lexueshëm nga pajisja vihet në dispozicion përmes një lidhjeje të sigurt e të autentifikuar me platformën eFTI. Operatorët ekonomikë përkatës komunikojnë *link*-un elektronik unik të identifikimit, që përmendet në shkronjën "d", të pikës 1, të nenit 10 të këtij kreu, i cili i mundëson autoritetit kompetent identifikimin në mënyrë unike të informacionit rregullator, që lidhet me një ngarkesë.

4. Informacioni në format të lexueshëm nga njeriu, kur kërkohet nga autoriteti kompetent, duhet të vihet në dispozicion në vendin ku kryhet kontrolli, në ekranin e një pajisjeje elektronike, që disponohet nga operatori ekonomik përkatës.

5. Identifikimi dhe autentifikimi për aksesin në informacionin rregullator realizohen nëpërmjet platformave kombëtare të identitetit elektronik, sipas standardeve për shërbimet e besuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kërkesave për ndërveprueshmëri të sistemit eFTI.

Neni 6
Kërkesat për autoritetin kompetent

1. Autoritetet kompetente, të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, e pranojnë informacionin rregullator të vënë në dispozicion elektronikisht nga operatorët ekonomikë përkatës, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji, përfshirë rastet kur ky informacion kërkohet si informacion shtesë. Ky detyrim zbatohet për autoritetet kompetente dhe operatorët ekonomikë jo më vonë se data 1 korrik 2029.

2. Me përjashtim të pikës 1 të këtij neni, autoritetet kompetente e pranojnë informacionin rregullator elektronik të vënë në dispozicion nga operatorët ekonomikë përkatës, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji, përfshirë informacionin shtesë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për transportin e mbetjeve.

3. Kur informacion rregullator kërkon vërtetim zyrtar, si vula ose certifikata, autoriteti kompetent i përcaktuar në pikën 1, të nenit 4 të këtij kreu, siguron vërtetimin përkatës në mënyrë elektronike sipas kërkesave të përcaktuara në aktet nënligjore të përmendura në nenet 8 dhe 9 të këtij ligji.

4. Autoritetet kompetente sigurojnë aksesin e përpunimit të informacionit rregullator të vënë në dispozicion nga operatorët ekonomikë përkatës, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji. Këto masa do të jenë në përputhje me aktet nënligjore që parashikohen nga nenet 8 dhe 9 të këtij ligji. Autoriteti shtetëror përgjegjës për transportin përcakton rregullat dhe procedurat për shkëmbimin e informacionit, metodat e paraqitjes, ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave, si dhe aksesin në platformat eFTI dhe komunikimin ndërmjet palëve. Këto masa harmonizohen me aktet nënligjore të këtij ligji për të garantuar zbatimin e plotë dhe efektiv të tij.

Neni 7
Garantimi i konfidencialitetit për informacionin tregtar

Autoritetet kompetente të përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji, ofruesit e shërbimit eFTI dhe operatorët ekonomikë përkatës marrin masa teknike e organizative për të siguruar konfidencialitetin e informacionit tregtar dhe çdo informacioni tjetër të mbrojtur, që përpunohet, shkëmbehet ose vihet në dispozicion në përputhje me këtë ligj, duke respektuar kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sekretin tregtar. Ky informacion aksesohet dhe përpunohet vetëm me autorizimin përkatës të autoritetit përgjegjës për zbatimin e koordinimin e eFTI-t.

Neni 8
Grupi i përbashkët i të dhënave eFTI dhe nënbashkësia e të dhënave eFTI

Grupi i përbashkët i të dhënave eFTI dhe nënbashkësitë e të dhënave eFTI, si dhe specifikimet përkatëse që lidhen me krijimin, ndryshimin, përkufizimin, strukturën dhe karakteristikat teknike të elementeve të të dhënave që përbëjnë këto grupe, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për koordinimin dhe zbatimin e sistemit eFTI.

Neni 9
Procedura dhe rregulla të përbashkëta për aksesin dhe ndërveprueshmërinë

1. Procedurat dhe rregullat e përbashkëta për aksesin në platformat eFTI, si dhe për përpunimin e shkëmbimin e informacionit rregullator përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me bashkëpropozimin e ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrave kompetentë përkatës. Këto rregulla garantojnë ndërveprueshmërinë, sigurinë dhe integritetin e të dhënave, në përputhje me kërkesat e këtij ligji, rregullat e eFTI-t dhe legjislacionin në fuqi për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara.

2. Sistemet dhe platformat eFTI duhet të sigurojnë ndërveprueshmëri me sistemet ekzistuese

shtetërore të teknologjisë së informacionit, duke shmangur dublikimin e të dhënave dhe duke garantuar shkëmbimin efikas të informacionit ndërmjet institucioneve.

KREU III
PLATFORMAT EFTI DHE OFRUESIT E SHËRBIMIT EFTI

Neni 10
Kërkesat funksionale për platformat eFTI

1. Platformat eFTI të përdorura për përpunimin e informacionit rregullator duhet të përmbushin kërkesat funksionale që sigurojnë se:

a) të dhënat personale përpunohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale;

b) të dhënat tregtare përpunohen në përputhje me nenin 7 të këtij ligji;

c) autoritetet kompetente mund të aksesojnë dhe të përpunojnë të dhënat bazuar në specifikimet e miratuara me anë të akteve nënligjore, të përmendura në nenet 8 dhe 9 të këtij ligji;

ç) operatorët ekonomikë përkatës e vënë në dispozicion informacionin për autoritetet kompetente, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji;

d) krijohet një lidhje unike elektronike identifikuese ndërmjet një ngarkese transporti dhe elementeve përkatëse të të dhënave, përfshirë një referencë të strukturuar në platformën eFTI, ku këto të dhëna janë të disponueshme, si p.sh. një identifikues unik referimi;

dh) të dhënat mund të përpunohen vetëm mbi bazën e aksesit të autorizuar dhe të autentifikuar;

e) të gjitha të dhënat e përpunuara regjistrohen në *log*-et e operacioneve (*operation logs*), në mënyrë që të lejohet të paktën identifikimi i çdo veprimi të veçantë përpunimi i personit fizik ose juridik që ka kryer veprimin dhe i renditjes kronologjike të veprimeve për çdo element të veçantë të të dhënave; nëse një veprim përfshin ndryshimin ose fshirjen e një elementi ekzistues të të dhënave, elementi origjinal i të dhënave duhet të ruhet;

ë) të dhënat mund të arkivohen dhe të jenë të aksesueshme për autoritetet kompetente në përputhje me legjislacionin kombëtar, që përcakton kërkesat përkatëse për informacionin rregullator;

f) *log*-et e operacioneve të përmendura në shkronjën "e" të kësaj pike arkivohen dhe janë të aksesueshme për autoritetet kompetente për qëllime auditimi për periudhën kohore të përcaktuar në aktet përkatëse në legjislacionin kombëtar, që rregullojnë kërkesat përkatëse për informacionin rregullator, dhe për qëllime monitorimi për periudhat kohore të përmendura në nenin 16 të këtij kreu;

g) të dhënat janë të mbrojtura nga dëmtimi dhe vjedhja;

gj) elementet e të dhënave të përpunuara korrespondojnë me grupin e përbashkët të të dhënave eFTI dhe me nënbashkësinë e të dhënave eFTI, siç përcaktohet në aktet nënligjore të përmendura në nenin 8 të këtij kreu, dhe mund të përpunohen në gjuhën shqipe e në gjuhën angleze, siç parashikohet nga legjislacioni kombëtar që përcakton kërkesat përkatëse për informacionin rregullator. Pas anëtarësimit të dhënat mund të përpunohen në cilëndo nga gjuhët zyrtare të Bashkimit Evropian.

2. Kërkesat specifike dhe të detajuara, që garantojnë ndërveprueshmërinë e platformave eFTI, marrin në konsideratë zgjidhjet e standardet teknike ekzistuese, si dhe sigurojnë që specifikimet të mbeten, në masën më të madhe të mundshme, neutrale nga pikëpamja teknologjike, sipas pikës 1 të këtij neni, dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për zbatimin e koordinimin e eFTI-t.

3. Elementet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, që lidhen me përpunimin e informacionit rregullator, miratohen në përputhje me aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Këto rregulla përcaktojnë kërkesat teknike dhe procedurale për ndërveprimin e platformave, vlerësimin e përputhshmërisë dhe mbajtjen e listës së platformave të certifikuara.

Neni 11
Kërkesat për ofruesit e shërbimeve eFTI

1. Ofruesit e shërbimeve eFTI duhet të sigurojnë, që:

a) të dhënat të përpunohen vetëm nga përdorues të autorizuar dhe në përputhje me të drejtat e përcaktuara qartë për përpunimin brenda platformës eFTI, dhe me kërkesat përkatëse të informacionit rregullator;

b) të dhënat të ruhen dhe të jenë të aksesueshme në përputhje me legjislacionin kombëtar, që

përcakton kërkesat përkatëse për informacionin rregullator;

c) autoritetet kompetente kanë akses të menjëhershëm në informacionin rregullator, që lidhet me një operacion transporti mallrash, të përpunuar përmes platformave të tyre eFTI, pa asnjë tarifë apo pagesë;

ç) të dhënat sigurohen në mënyrë të përshtatshme, përfshirë këtu kërkesat kundër përpunimit të paautorizuar ose të paligjshëm dhe kundër humbjes, shkatërrimit apo dëmtimit të rastësishëm.

2. Ofruesit e shërbimeve eFTI duhet të garantojnë ndërveprueshmërinë me sistemet shtetërore dhe përputhshmërinë me standardet teknike kombëtare të përcaktuara nga autoritetet kompetente.

3. Rregullat e hollësishme për kërkesat e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni miratohen nga Këshilli i Ministrave me bashkëpropozim të ministrave përgjegjës për transportin, ekonominë dhe financat.

Neni 12
Organet e vlerësimit të konformitetit

1. Organet e vlerësimit të konformitetit për qëllimet e certifikimit të platformave eFTI dhe të ofruesve të shërbimeve përkatëse, sipas përcaktimeve të neneve 13 dhe 14 të këtij ligji, akreditohen nga organi kombëtar i akreditimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për akreditimin.

2. Për qëllime akreditimi, organet e vlerësimit të konformitetit duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në shtojcën II të këtij ligji. Organi kombëtar i akreditimit duhet t'i komunikojë autoritetit kombëtar të caktuar, në përputhje me pikën 3 të këtij neni, adresën e faqes së internetit ku bëjnë publik informacionin për organet e akredituara të vlerësimit të konformitetit, përfshirë një listë të përditësuar të këtyre organeve.

3. Autoriteti kombëtar që mban listën e përditësuar të organeve të akredituara të vlerësimit të konformitetit, platformave eFTI dhe ofruesve të shërbimeve eFTI, që kanë një certifikim të vlefshëm, bazuar në informacionin e dhënë, në përputhje me pikën 2 të këtij neni, si dhe me nenet 13, pika 2, dhe 14, pika 2, të këtij kreu, përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për ekonominë. Autoriteti kombëtar i caktuar e bën këtë listë të disponueshme për publikun.

4. Brenda datës 31 mars të çdo viti autoriteti kombëtar për akreditimin njofton Komisionit Evropian listën e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, së bashku me adresën përkatëse të faqes zyrtare të internetit ku kjo listë është bërë publike. Komisioni Evropian do t'i publikojë këto adresa në faqen e tij zyrtare.

Neni 13
Certifikimi i platformave eFTI

1. Me kërkesë të zhvilluesit të platformës eFTI, organi i vlerësimit të konformitetit vlerëson përputhshmërinë e platformës eFTI me kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 10 të këtij kreu. Në rast vlerësimi pozitiv, organi i vlerësimit të konformitetit lëshon një certifikatë përputhshmërie për atë platformë eFTI. Në rast vlerësimi negativ, organi i vlerësimit të konformitetit i jep aplikuesit arsyet për vlerësimin negativ.

2. Çdo organ i vlerësimit të konformitetit mban një listë të përditësuar të platformave eFTI, që ka certifikuar dhe për të cilat ka tërhequr ose pezulluar certifikimin. Ky organ duhet ta bëjë listën publike në faqen e tij të internetit dhe duhet t'ia komunikojë adresën e kësaj faqeje autoritetit kombëtar të caktuar të përmendur në pikën 3, të nenit 12 të këtij kreu.

3. Informacioni i vënë në dispozicion të autoriteteve kompetente nëpërmjet një platforme eFTI të certifikuar duhet të shoqërohet me një shenjë certifikimi.

4. Zhvilluesi i platformës eFTI duhet të aplikojë për një rivlerësim të certifikimit të tij nëse rishikohen specifikimet teknike të përmendura në aktin nënligjor sipas pikës 2, të nenit 10 të këtij kreu.

5. Rregullat për certifikimin e platformave eFTI dhe për përdorimin e shenjës së certifikimit, përfshirë rregullat për rinovimin, pezullimin dhe tërheqjen e certifikimit, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë.

Neni 14
Certifikimi i ofruesve të shërbimeve eFTI

1. Me kërkesë të një ofruesi të shërbimit eFTI, organi i vlerësimit të konformitetit vlerëson përputhshmërinë e tij me kërkesat e përcaktuara në

pikën 1 të nenit 11 të këtij ligji dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij. Në rast vlerësimi pozitiv, organi i vlerësimit të konformitetit lëshon certifikatën e përputhshmërisë; në rast vlerësimi negativ, organi i vlerësimit të konformitetit njofton aplikuesin për arsyet përkatëse.

2. Organi i vlerësimit të konformitetit mban dhe përditëson informacionin për ofruesit e shërbimeve eFTI të certifikuar, si dhe për certifikatat e tërhequra ose të pezulluara dhe e bën këtë informacion të disponueshëm për publikun në faqen e tij zyrtare. Ky informacion i komunikohet autoritetit shtetëror përgjegjës për koordinimin e eFTI-t.

3. Rregullat e detajuara për certifikimin e ofruesve të shërbimeve eFTI, përfshirë procedurat e rinovimit, pezullimit dhe tërheqjes së certifikimit, miratohen nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë.

KREU IV
ZBATIMI, MONITORIMI, DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 15
Zbatimi i ligjit dhe koordinimi

1. Të gjitha institucionet kompetente, sipas legjislacionit sektorial në fushat që mbulon ky ligj, në veprimtarinë e tyre janë përgjegjëse për zbatimin e tij, duke siguruar përputhjen e legjislacionit sektorial dhe praktikave administrative me parimet e këtij ligji, me aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe me praktikën e Bashkimit Evropian.

2. Ministria përgjegjëse për transportin koordinon zbatimin e këtij ligji në nivel kombëtar, në bashkëpunim me autoritetet kompetente sipas fushës së tyre të përgjegjësisë.

3. Autoritetet kompetente e zbatojnë këtë ligj në përputhje me kompetencat e tyre sektoriale të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

4. Koordinimi sipas pikës 1 të këtij neni realizohet për qëllime të harmonizimit të procedurave, ndërveprueshmërisë së sistemeve dhe shkëmbimit të informacionit, pa cenuar pavarësinë funksionale të autoriteteve kompetente.

5. Rregullat për funksionimin e platformave e sistemeve eFTI dhe formatet e raportimit miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrave përgjegjës për transportin, ekonominë dhe financat.

Neni 16
Monitorimi dhe raportimi

1. Monitorimi i zbatimit të këtij ligji realizohet nga autoritetet kompetente, secili brenda fushës së tij të përgjegjësisë, në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi. Autoritetet kompetente i raportojnë autoritetit koordinues me kërkesë të tij.

2. Autoritetet kompetente, sipas rastit, mbledhin dhe përpunojnë të dhëna që lidhen me përdorimin e informacionit elektronik të transportit të mallrave për qëllime monitorimi e vlerësimi, duke siguruar vërtetësinë e të dhënave.

3. Ministria përgjegjëse për transportin, në cilësinë e autoritetit koordinues, duke filluar nga viti 2032 dhe çdo 5 vjet pas kësaj date, përgatit raporte përmbledhëse për zbatimin e këtij ligji bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga autoritetet kompetente, në masën e disponueshmërisë së tij.

4. Raportimi sipas pikës 3 të këtij neni realizohet në bashkëpunim me autoritetet kompetente dhe nuk krijon detyrime shtesë përtej atyre të përcaktuara në legjislacionin sektorial në fuqi.

5. Kur kërkohet, informacioni i përmbledhur mund t'u vihet në dispozicion institucioneve të Bashkimit Evropian në kuadër të proceseve të përafrimit dhe raportimit.

Neni 17
Akte nënligjore

1. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore në zbatim të neneve 8; 9, pika 1; 10, pika 2; 11, pika 3; 13, pika 5, dhe 14, pika 3, të tij, me propozimin apo bashkëpropozimin e autoriteteve kompetente sipas këtij ligji.

2. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ngarkohen autoritetet e përcaktuara në pikën 5, të nenit 15 të tij, për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët për funksionimin e platformave dhe sistemeve eFTI.

3. Brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ngarkohet ministri përgjegjës për ekonominë për caktimin e autoritetit kombëtar që do të mbajë listën e përditësuar të organeve të akredituara të vlerësimit të konformitetit, platformave eFTI dhe ofruesve të shërbimeve eFTI, që kanë një certifikim të vlefshëm sipas pikës 3, të nenit 12 të këtij ligji.

Neni 18
Përditësimi i legjislacionit sektorial dhe përafrimi i plotë me të drejtën e Bashkimit Evropian

Rishikimi dhe përditësimi i legjislacionit sektorial realizohet në mënyrë të vazhdueshme, sipas nevojës, për të siguruar përputhshmërinë me kërkesat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore për zbatimin eFTI, si dhe, kur është e zbatueshme, me aktet përkatëse sektoriale të Bashkimit Evropian.

Neni 19
Shfuqizime

Shfuqizohen në datën e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dispozitat e krerëve I, II, me përjashtim të neneve 8 e 9, pika 1, III, me përjashtim të neneve 10, pika 2, 11, pika 3, 12, pika 3, 13, pika 5, e 14, pika 3, dhe IV, me përjashtim të neneve 15, 16 e 17 të këtij ligji.

Neni 20
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.6.2026.

Shpallur me dekretin nr. 377, datë 30.6.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

SHTOJCA I
INFORMACIONI RREGULLATOR, REFERUAR NENIT 3

1. Ky ligj zbatohet për:

a) informacionin rregullator të kërkuar për transportin e çdo ngarkese mallrash brenda vendit, që konsiderohen si të dhëna parësore dhe përfshin të dhënat e mëposhtme:

i. emrin dhe adresën e dërguesit;

ii. natyrën dhe peshën e mallit;

iii. vendin dhe datën e pranimit të mallit për transport;

iv. vendin ku do të dorëzohen mallrat.

Në rastin e transportit të kombinuar me qira ose shpërblim, dhe për sa është e zbatueshme sipas legjislacionit në fuqi, një dokument transporti që plotëson të paktën kërkesat e lidhura me heqjen e diskriminimit nga tarifat dhe kushtet e transportit, që do të specifikojë, gjithashtu, stacionet e ngarkimit dhe shkarkimit hekurudhor, në lidhje me stacionet hekurudhore ose portet e ngarkimit dhe shkarkimit të rrugëve ujore të brendshme në lidhje me pjesën e brendshme të rrugës ujore;

b) informacionin rregullator të kërkuar sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e transportit rrugor kombëtar dhe ndërkombëtar të mallrave, në përputhje me dispozitat e nenit 3 të këtij ligji;

c) informacionin rregullator të kërkuar për transportin e mbetjeve sipas legjislacionit në fuqi për mbetjet, në lidhje me dokumentin shoqërues vetëm për fazën e transportit të mbetjeve në Republikën e Shqipërisë për aq sa është e zbatueshme dhe në përputhje me kërkesat e eFTI-t;

ç) informacionin rregullator të kërkuar për transportin e mallrave të rrezikshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon transportin e këtyre mallrave, duke përfshirë transportin rrugor, hekurudhor dhe ujor të brendshëm, për aq sa është i zbatueshëm për secilin prej këtyre llojeve të transportit;

d) kërkesat rregullatore të informacionit të përcaktuara në ligjin nr.142/2016, "Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë" dhe aktet nënligjore në zbatim të tij për transportin hekurudhor, si dhe informacioni rregullator i kërkuar sipas kuadrit ligjor në fuqi për përcaktimin e standardeve bazë për ruajtjen e aviacionit civil nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme, që rrezikojnë sigurinë e aviacionit civil, si dhe për përcaktimin e masave të detajuara për zbatimin e standardeve themelore të përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil.

2. Referencat e legjislacionit të përmendura në këtë shtojcë përditësohen në përputhje me parashikimet e nenit 18 të këtij ligji.

SHTOJCA II
KËRKESAT QË LIDHEN ME ORGANET E VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT

1. Një organ i vlerësimit të konformitetit duhet të krijohet sipas legjislacionit në fuqi dhe të ketë personalitet juridik.

2. Një organ i vlerësimit të konformitetit duhet të jetë një organ i palës së tretë i pavarur nga organizata

ose platforma e eFTI-t ose ofruesi i shërbimit të platformës që ai vlerëson.

Një organ që i përket një shoqate biznesi ose federate profesionale, që përfaqëson ndërmarrje të angazhuara në projektimin, prodhimin, ofrimin, montimin, përdorimin ose mirëmbajtjen e platformës së eFTI-t ose të ofruesit të shërbimit të platformës që ai vlerëson, mund të konsiderohet si një organ i tillë, me kusht që të vërtetohet pavarësia e tij dhe mungesa e çdo konflikti interesi.

3. Një organ i vlerësimit të konformitetit, drejtuesit e tij të nivelit të lartë dhe personeli përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit nuk duhet të jenë projektuesi, prodhuesi, furnizuesi, instaluesi, blerësi, pronari, përdoruesi ose mirëmbajtësi i platformës eFTI ose ofruesi i shërbimit të platformës, që ata vlerësojnë, as përfaqësuesi i ndonjërës prej atyre palëve.

Një organ i vlerësimit të konformitetit, drejtuesit e tij të nivelit të lartë dhe personeli përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit nuk duhet të jenë të përfshirë drejtpërdrejt në projektimin, prodhimin ose ndërtimin, tregtimin, instalimin, përdorimin ose mirëmbajtjen e asaj platforme të eFTI-t ose në proceset e ofruesit të shërbimit të platformës, apo të përfaqësojnë palët që merren me këto aktivitete. Ata nuk duhet të angazhohen në asnjë aktivitet që mund të cenojë pavarësinë e gjykimit apo integritetin e tyre në lidhje me aktivitetet e vlerësimit të konformitetit për të cilat ata janë të akreditуar. Kjo vlen në veçanti për shërbimet e konsulencës.

Organet e vlerësimit të konformitetit duhet të sigurojnë që aktivitetet e degëve të tyre ose të nënkontraktorëve të mos ndikojnë në konfidencialitetin, objektivitetin apo paanshmërinë e aktiviteteve të tyre të vlerësimit të konformitetit.

4. Organet e vlerësimit të konformitetit dhe personeli i tyre duhet të kryejnë aktivitetet e vlerësimit të konformitetit me shkallën më të lartë të integritetit profesional dhe me kompetencën teknike të nevojshme në fushën përkatëse, si dhe duhet të jenë të lira nga çdo presion dhe nxitje, veçanërisht financiare, që mund të ndikojnë në gjykimin ose në rezultatet e tyre të vlerësimit të konformitetit, veçanërisht në lidhje me personat ose grupet e personave, që kanë interes në rezultatet e këtyre aktiviteteve.

5. Një organ i vlerësimit të konformitetit duhet të jetë në gjendje të kryejë të gjitha detyrat e vlerësimit të konformitetit që i janë caktuar nga nenet 13 dhe 14 të këtij ligji, pavarësisht nëse këto detyra kryhen nga vetë organi i vlerësimit të konformitetit ose në emër të tij dhe nën përgjegjësinë e tij.

Një organ i vlerësimit të konformitetit është e nevojshme të ketë në dispozicion:

a) personel me njohuri teknike dhe përvojë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të kryer detyrat e vlerësimit të konformitetit;

b) përshkrimet e procedurave në përputhje me të cilat kryhet vlerësimi i konformitetit;

c) procedurat për kryerjen e aktiviteteve që marrin parasysh madhësinë e një ndërmarrjeje, sektorin në të cilin ajo operon, strukturën e saj dhe shkallën e kompleksitetit të teknologjisë në fjalë.

Një organ i vlerësimit të konformitetit duhet të ketë mjetet e nevojshme për të kryer detyrat teknike dhe administrative që lidhen me aktivitetet e vlerësimit të konformitetit në mënyrën e duhur.

6. Personeli përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit duhet të ketë:

a) trajnim teknik dhe profesional, që mbulon të gjitha aktivitetet e vlerësimit të konformitetit;

b) njohuri të kënaqshme për kërkesat e vlerësimeve që ata kryejnë dhe autoritet të përshtatshëm për të kryer ato vlerësime;

c) njohjen dhe kuptimin e duhur të kërkesave të përcaktuara në nenet 10 dhe 11 të këtij ligji;

ç) aftësi për të hartuar certifikata të përputhshmërisë, regjistrime dhe raporte, që tregojnë se vlerësimet janë kryer.

7. Paanshmëria e organeve të vlerësimit të konformitetit, drejtuesve të tyre të nivelit të lartë dhe personelit përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit duhet të garantohet.

Shpërblimi i drejtuesit të nivelit të lartë dhe personelit përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit të një organi të vlerësimit të konformitetit nuk duhet të varet nga numri i vlerësimeve të kryera ose nga rezultatet e këtyre vlerësimeve.

8. Organet e vlerësimit të konformitetit duhet të bëjnë sigurimin e përgjegjësisë, përveç rastit kur përgjegjësia merret nga shteti, në përputhje me legjislacionin kombëtar ose vetë shteti anëtar është drejtpërdrejt përgjegjës për vlerësimin e konformitetit.

9. Personeli i një organi të vlerësimit të konformitetit duhet të respektojë sekretin profesional në lidhje me të gjitha informacionet e

marra në kryerjen e detyrave të tyre, sipas neneve 13 e 14 të këtij ligji ose çdo dispozite të ligjit kombëtar, që u jep fuqi atyre, me përjashtim të autoriteteve kompetente të shtetit anëtar, në të cilin kryhen aktivitetet e tij. Të drejtat e pronësisë duhet të mbrohen.

10. Organet e vlerësimit të konformitetit duhet të marrin pjesë ose të sigurojnë që personeli i tyre përgjegjës për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit të jetë i informuar për aktivitetet përkatëse të standardizimit dhe aktivitetet përkatëse rregullatore.

DEKRET
Nr. 377, datë 30.6.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 60/2026, "Për informacionin elektronik të transportit të mallrave".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 2, datë 9.6.2026

PËR NJË SHTESË DHE DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 8, DATË 19.7.2022, "PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR KRYERJEN E SHËRBIMIT TË PËRKTHIMIT ZYRTAR DHE INTERPRETIMIT TË GJUHËS SË SHENJAVE DHE RREGULLAVE PËR PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E TARIFAVE PËR KATEGORI TË PERSONAVE PËRFITUES TË NDIHMËS JURIDIKE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 11, të ligjit nr. 82/2021, "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar", të ndryshuar, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr. 8, datë 19.7.2022, "Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike", bëhet shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në kreun II, pika 6, ndryshohet si më poshtë:

"6. Tarifa e shërbimit të përkthimit me gojë është 4200 (katër mijë e dyqind) lekë për çdo orë përkthimi, pa përfshirë TVSH. Kur ora e fundit e filluar zgjat më shumë se 30 minuta ajo përllogaritet si orë e plotë, përndryshe tarifa e përkthimit përllogaritet sa gjysma e tarifës për një orë të plotë. Kur ofrimi i shërbimit të përkthimit bëhet i pamundur për arsye, për të cilat nuk mban përgjegjësi përkthyesi, ai paguhet për një orë të plotë.".

2. Në kreun II, pas pikës 6, shtohet pika 7, me përmbajtje si vijon:

"7. Për kohën e domosdoshme të udhëtimit nga vendbanimi i tij deri në vendin e ofrimit të shërbimit të përkthimit dhe kohën e kthimit, si dhe për kohën e pritjes përkthyesi paguhet me 1.000 (një mijë) lekë, për çdo orë. Fjalia e dytë e pikës 6, zbatohet edhe për kohën e udhëtimit dhe të pritjes.".

3. Në kreun III, pika 2, ndryshohet si më poshtë:

"2. Tarifa e shërbimit të interpretimit të gjuhës së shenjave për një kohëzgjatje prej një ore është 4200 (katër mijë e dyqind) lekë për çdo orë përkthimi, pa përfshirë TVSH lekë. Pikat 6 dhe 7, të kreut II, zbatohen respektivisht.".

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë, përkthyesit zyrtarë dhe interpretët e gjuhës së shenjave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Toni Gogu

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 448 lekë

||FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË|Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 137|Datë: 30.06.2026 16:46:05 +02:00|4f32d01a-27cb-48a1-8bcb-24a556e375e2

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë|të një procedure automatike nga një sistem elektronik|(Qendra e Botimeve Zyrtare)